

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLIII nr. 107 / 2014

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XLIII nr. 107 / 2014

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Pajazit Nushi, Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti,
Nexhat Ibrahim, Hajrullah Hoxha dhe Dr. Xhabir Hamiti

Sekretar i redaksisë:

Hajrullah Hoxha

Lektor:

Bislim Berisha

Realizimi: **Shtëpia Botuese**



Redaktor teknik &

Operator kompjuterik:

Nuhi Simnica

Shtypi: “Grafika REZNIQI” - Prishtinë

Tirazhi: 600

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLIII nr. 107 / 2014

Prishtinë
2014

EDITORIALI

Qemajl Morina

A DUHET FAJËSUAR ISLAMIN PËR SULMIN NDAJ CHARLIE HEBDO, NË PARIS?

Këtë titull e kishte zgjedhur për artikullin e tij analisti Nicholas Cristof, për të përditshmen “Ney York Times”, të datës 8 janar 2015, për të shprehur mendimin e tij lidhur me tragjedinë që kishte ndodhur ato ditë.

Ai, në shkrimin e tij përveç tjerash shkruan:

“Gazeta satirike franceze ‘Charlie Hebdo’ rreth vetes mbledh njerëz të të gjitha besimeve dhe formimeve kulturore.

Një nga karikaturat, nxori një letër tualetit me mbishkrimet “Bibla”, “Torah” dhe “Kurani” dhe një sqarim: “Në tualet, të gjitha religjionet.”

Kur sulmuesit e maskuar dhe me AK-47 në duar, iu sulën zyrës së Charlie Hebdo-s, duke lënë të vrarë 12 persona, në sulmin më të egër terrorist që ka parë toka franceze prej dekadash, shumë prej nesh, menjëherë supozuam se autorët e krimit nuk do të kenë qenë të krishterë apo hebrenj, por me shumë gjasë ekstremistë islamikë.

Të krishterët, hebrenjtë apo dhe ateistët, të lemerisur nga ngjarja shfryjnë frustrimin në Facebook dhe Twitter. Edhe pse ende nuk e dimë se kush janë në të vërtetë sulmuesit, pandehim se edhe kësaj radhe ekstremistët islamikë shprehën pakënaqësitë e tyre përmes plumbave.

Shumë prej tyre pyesin, a ka diçka të pandreqshme tek islami që shpie në dhunë, terrorizëm dhe nënshtrim të gruas? Kjo pyetje lind ngase myslimanët fanatikë shpeshherë vrasin në emër të Zotit, qysh prej sulmit të 2004, në trenin Madrilen, që vrau 191 njerëz e deri te vrasja e pengjeve në një kafe në Sidnej të Australisë, muajt e kaluar. Vitin e kaluar kam shkruar për rritjen e intolerancës mes botës islamike, atëherë kur avokati i guximshëm pakistanez dhe miku im Rashid Rehman, u vra ngase mbrojti një profesor universiteti që u akuzua se gjoja ka fyer Profetin Muhamed. Persekutimi ditor i pakicave të krishtera dhe pakicave tjera fetare që nga Bahai në Jazidi deri në Ahmedi, është terrorizmi më sistematik që ushtrohet në botën islame.

Pastaj vjen shtypja e gruas. Nëntë nga dhjetë shtetet e fundit të radhitura në raportin e Forumit Ekonomik Botëror mbi dallimet gjinore, janë të populluara me shumicë myslimane.

Andaj, sigurisht që mbi intolerancën e ekstremizmin e pranishëm në botën islame u ngrit dhe bazua edhe sulmi ndaj Charlie Hebdo. Magazina u sulmua me bombë zjarri në 2011, pasi që në faqen e parë nxori Muhamedin duke thënë “100 fshikullime nëse nuk je duke vdekur së qeshuri’.

Kohë më parë, Charlie Hebdo, publikoi një karikaturë tjetër që nxirrte Muhamedin, duke qarë e duke thënë, “Qenka shumë e vështirë të të duan idiotët.”

Akte terroriste bëjnë shumë përfundimorë që perceptojnë islam si qenësisht ekstremist, por unë mendoj se një perceptim i tillë është shumë sipërfaqësor dhe mendjelehtë. Një numër i vogël terroristësh bëjnë lajmet kryesore megjithëse ata nuk janë përfaqësuesit të një religjioni kompleks dhe divers të 1.6 milion përkrahësve. Postimi im në Twitter këtë të mërkurë u plotësua nga ato të myslimanëve që denonconin sulmin-dhe që theksonin se myslimanët fanatikë dëmtojnë imazhin e Muhamedit më shumë se ç’mund të bëjë cilado karikaturë poshtëruese. Natyrisht, shumica e myslimanëve nuk kanë fare të bëjnë me çmendurinë e sulmeve të tilla-veçse janë disproporcionalisht viktimat e terrorizmit. Në të vërtetë, sulmi ndaj Charlie Hebdo, nuk ishte më vdekjeprurësi këtë të mërkurë. Një makinë-bombë që shpërtheu

para kolegjit policor në Jemen, e sipas gjasave e vënë aty nga Al-Qa-eda, vrau më së paku 37 njerëz. Një nga gjërat që m'i ka mësuar gazetaria është se duhet pasur kujdes nga të perceptuarit e botës nëpërmjet rrëfimesh të thjeshta, ngase informacioni i ri, pavëmendshëm ngulitet mes rreshtash.

Gjatë udhëtimeve të mia prej Mauritanie në Arabi Saudite, Pakistan e deri në Indonezi, ekstremistët myslimanë kanë ndarë me mua rrëfenjat e tyre thellësisht të rreme mbi Amerikën, si një shtet opresiv të kontrolluar nga sionistët dhe të përbetuar për të shkatërruar islam.

Ajo është një karikaturë absurde, dhe ne duhet të jemi të kujdesshëm kur në karikaturë paraqesim një religjion aq divers sa ç'është islami. Le të përmbahemi nga profilizmet religjioze. Një i krishterë nuk ka asnjë arsye për të kërkuar falje ngase krishterë fanatikë kryen gjenocid ndaj myslimanëve në ish-Jugosllavi. Kritikuesit e islamit nuk janë për t'u fajësuar ngase një fanatik antimysliman vrau 77 njerëz në vitin 2011, në Norvegji. Të mos harrojmë që njerezit më kurajozë, paqedashës në Lindjen e Mesme, që u kundërvihen myslimanëve fanatikë, në të shumtën e rasteve janë vetë myslimanë të devotshëm. Disa lexojnë Kur'anin dhe djegin shkolla vajzash, por më shumë e lexojnë Kur'anin dhe ndërtojnë shkolla vajzash. Talibanizmi përfaqëson një rrymë në islam, ndërsa fituesja e Çmimit Nobel për Paqe, Malala Yousafzai, të kundërtën polare.

Është një tregim përulës, mbase dhe apokrifik, që Gandhin e pyetën njëherë: Çfarë mendimi keni mbi civilizimin perëndimor? Dhe ai, supozohet se u përgjigj: Mendoj se do të kishte qenë një ide e mirë.

Ndasia e madhe nuk është mes religjionesh. Më tepër, është mes terroristësh dhe të moderuarish, mes atyre që janë tolerantë dhe mes atyre që krijojnë ndasitë.

Në Australi, pas krizës së pengmarrjes, disa myslimanë u frikësuan nga sulme të mundshme hakmarrjeje. Pastaj një valë australianësh jomyslimanë u dolën në ndihmë, duke iu ofruar përcjellje për të garantuar sigurinë e tyre, dhe duke përdorur hashtag-un RideWithYou (do të të përcjell) në Twitter. Më shumë se 250.000 komente u postuan në Twitter-një model i dhembshurisë zemërgjerë, pas sulmeve terroriste.

Unë nuk jam Charlie Hedbo

Në kohën kur në botën perëndimore si dhe në një pjesë të madhe të botës myslimane u paraqiten njerëz me parulla, të cilët thërrisnin se ne jemi Charlie Hedbo, shohim analistin David Brooks, më 10 janar 2015, në të përditshmen "New York Times", që mban titullin: "Unë nuk jam Charlie Hedbo!"

Gazetarët e revistës satirike "Charlie Hebdo", me shumë të drejtë quhen martirë në emër të lirisë së shprehjes, por, sikur ata të ishin përpjekur ta botojnë gazetën e tyre satirike mbi ndonjë kampus universitar amerikan gjatë dy dekadave të fundit, atëherë kjo nuk do të zgjaste më shumë se 30 sekonda. Studentët dhe grupet e universitetit do të ishin aukuzuar për gjuhën e urrejtjes. Administrata do ta ndërpriste financimin dhe do ta mbyllte atë.

Reagimi i opinionit ndaj sulmit në Paris, ka nxjerrë në pah se ka shumë njerëz që tregojnë interes të madh mbi ata që ofendojnë pikëpamjet e terroristëve islamikë në Francë, por ka shfaqur se ka shumë pak tolerantë ndaj atyre që ofendojnë pikëpamjet e tyre në shtëpi.

Shikoni se si kanë reaguar të gjithë njerëzit, me një lloj ashpërise. Universiteti i Illinois ka përjashtuar nga puna një profesor, që studentëve u mësoi mbi pikëpamjen që kishin katolikët romakë ndaj homoseksualitetit. Universiteti i Kansasit pezulloi një profesor vetëm pse në Twitter kishte shkruar kundër N.R.A Universiteti i Vanderbilt, ku kishte thënë se ky Universitet fshihet pas një grupi të krishterësh dhe këmbënguli se udhëhiqej nga të krishterët.

Amerikanët edhe mund të lavdërojnë gazetarët e Charlie Hebdo, që ishin shumë të guximshëm për të publikuar karikaturat e Profetit Muhamed, por në qoftë se Ayaan Hirsi Ali ishte ftuar në një kampus, atëherë shpeshherë do bënin thirrje për mospjesëmarrje në atë podium.

Pra, ky mund të jetë një moment mësimi. Ndërsa, ne ndjehemi të turpëruar nga disfata e atyre gazetarëve dhe redaktorëve në Paris, është kohë e mirë për të shfaqur sa më pak qasje hipokrite me figurat tona kontraverse, provokatore dhe satiristike.

Mendoj, se së pari, edhe mund ta keni vënë re që në profilet e Facebook-ut tuaj, shumica nga ju keni vendosur parullën “Je suis Charlie”, apo “Unë jam Charlie”. E vërteta është se shumica prej nesh, nuk është se jemi të lidhur fort pas specializimit të humorit ofendues që ka kjo revistë.

Mund ta kishim filluar në këtë mënyrë. Kur jeni 13 vjeç, mund t’ju duket i guximshëm provokimi për “épater la bourgeoisie”, që autoriteteve t’ia drejtoni gishtin, të tallni të tjerët mbi besimin fetar.

Pas një kohe, ky gjest do t’iu duket fëmijërorë. Shumica nga ne ka ecur përpara drejt pikëpamjeve të komplikuar të realitetit dhe shumica tjetër duke falur pikëpamjet e të tjerëve. (Tallja bëhet më pak qesharake, sapo të vetëdijësoheni për talljet e shpeshta që bëni) Shumica nga ne, përpiket që sadopak të tregojë një sasi të vogël të respektit për njerëzit e ndryshëm dhe për besimet e ndryshme. Ne përpiqemi që të bëjmë debat, e jo të fyejmë.

Megjithatë, në të njëjtën kohë, shumica prej nesh e dimë se provokatorët dhe figurat tjera të huaja, shpërbejnë për një rol me vlerë. Satiristët dhe humoristët, vënë në dukje dobësinë dhe kotësinë tonë atëherë kur ne ndjehemi krenarë. Ata shpojnë me suksesin e vetë-fyerjes. Ata e nivelojnë shoqërinë, duke e ulur fuqishëm. Kur janë të efektshëm, ata ndihmojnë për të trajtuar manitë tona në grup, përderisa përqeshja është përfundim i një lidhjeje.

Për më tepër, provokatorët dhe satiristët vënë në dukje marrëzinë e fundamentalistëve. Fundamentalistët janë njerëz që çdo gjë e marrin si të vërtetë. Janë të paaftë që të kenë botëkuptime të ndryshme. Janë të paaftë të shohin se feja e tyre mund të jetë e denjë dhe për nderim të madh, por është shumë e vërtetë që shumica e religjioneve janë paksa të çuditshme. Satiristët ekspozojnë ata që janë të paaftë të përqeshin me veten e tyre dhe pjesën tjetër e mësojnë për atë që ndoshta duhet bërë.

Shkurt, mbi mendimin për provokatorët dhe satiristët, ne duam të ruajmë standardet e mirësjelljes dhe respektit, ndërsa në të njëjtën kohë, lëmë hapsirë për ata si krijues dhe sfidues të jenë të papërmbytshëm nga sjellja dhe nga shija.

Nëse, këtë ekuilibër delikat, provoni ta realizoni me ligj, me kode në të folur dhe me ndalim të fjalës, atëherë do të përfundoni në një censurë të vrazhdë dhe te bisedat që të zënë frymën. Pothuajse, gjithmonë, kjo është një përpjekje e gabuar për të mposhtur fjalën, për të ndërtuar kode mbi fjalë dhe për të shfuqizuar folësin.

Fatmirësisht, sjelljet shoqërore janë më të lakueshme dhe përkulen ndaj ligjeve dhe kodeve. Shumica e shoqërisë kanë ruajtur standardet e mirësjelljes dhe respektit, duke i mbajtur hapur udhët për ata që janë qesharakë, primitivë dhe ofendues.

Në shumicën e shoqërive, ka “tryezë për të rriturit dhe për fëmijët”. Njerëzit që e lexojnë “Le Monde”, apo themeluesit homogjenë janë në tryezën e të rriturve. Karaxhozët, budallenjtë e shenjtë dhe njerëzit si Ann Coulter dhe Bill Maher, janë te tryeza e fëmijëve. Ata nuk janë të dhënë pas respektit të plotë, por që dëgjohen për arsye se kanë një mënyrë udhëheqëse që përdorin, dhe që ndonjëherë edhe mund të thonë gjëra të rëndësishme që askush tjetër nuk i thotë.

Me fjalë të tjera, shoqëritë e shëndosha nuk e vrasin fjalën e lirë, por e lejojnë të depërtojë te njerëzit e ndryshëm, në forma të ndryshme. Të diturit dhe studiuesit dëgjohen me respekt të madh. Satiristët janë dëgjuar me një respekt mesatar, por të mahnitshëm. Racistët dhe anti-semistët janë dëgjuar përmes një filtri të hollë, të njollosur dhe pa respekt. Njerëzit që duan të dëgjohen me vëmendje duhet ta fitojnë atë përmes sjelljes së tyre.

Maskara në Charlie Hebdo duhet të merret si një rast për t’u dhënë fund kodeve të fjalës. Dhe, kjo duhet të na bëjë të kujtojmë që ne duhet të bëhemi tolerantë ndaj zërave sulmues në mënyrë ligjore, edhe pse ne jemi një shoqëri diskriminuese.

Ndodhia e Parisit dhe islamizimi i Evropës

Pas tragjedisë që ndodhi në revistën satirike “Charly Ebdu” në Paris, e cila e tronditi tërë botën perëndimore. Shumë shpejt filluan zërat konvulsivë të fshihen prapa zërave të arsyeshëm, të cilët nisën ta shqyrtojnë problemin me qetësi dhe urtësi, duke e shikuar temën në aspekte dhe dimensionet e ndryshme.

Ta lëmë anash ndodhinë e shëmtuar dhe t'i lexojmë me kujdesin më të madh këto statistika paralajmëruese, me të cilat doli një institucion kishtar evropian, ku tregon se përqindja e shtimit të myslimanëve në Evropë, në Francë, ku ndodhën incidente e shëmtuara, arrin në 8.1%, kundruall 1.8% në pjesën tjetër të Francës. Kjo gjë shkaktoi rritjen e numrit të xhamive mbi atë të kishave në jug të Francës. Po ashtu, përqindja e fëmijëve myslimanë në krahasim me ata francezë arrin në 20% më e lartë, kjo përqindje arrin në 45% në qytetet siç janë: Nici, Marseja dhe Parisi. Kështu pra me fillimin e vitit 2025, çdo i 5-ti francez do të jetë mysliman, kjo do të thotë se pas 39 vjetëve Franca do të kthehet në "Republikë Islamike të Francës", ashtu siç përmend institucioni kishtar evropian në vërejtjen e tij. Një shkrimi këtillë ishte botuar në një gazetë franceze pak ditë para ndodhive në Francë.

Vlen të theksohet se numri i myslimanëve në Britaninë e Madhe, gjatë 30 vjetëve të fundit, është shtuar prej 80.000 në 2.500.000, që do të thotë ishte një shtim për 30 herë më i lartë.

Në Holandë, mbi 50% e të lindurve janë myslimanë, kjo do të thotë se nëse ky trend vazhdon, brenda 15 vjetëve mbi 50% të popullatës së Holandës do të jenë myslimanë.

Qeveria gjermane ishte prej vendeve të para që kishte shqyrtuar këtë çështje në mënyrë të hapur, me ç'rast në një deklaratë zyrtare për opinion kishte thënë: "Riprodhimi negativ i popullsisë nuk mundësi ndalja e tij. Kjo çështje ka dalë prej duarve tona. Kështu pra me fillimin e vitit 2050, Gjermania do të jetë shtet islamik".

Në Evropë, sot jetojnë 52.000.000 myslimanë. Ky numër, pas 20 vjetëve do të arrijë dyfishin, që do të thotë numri i tyre do të jetë 104.000.000.

Kështu shohim se Kisha Katolike Amerikane, në një raport të saj të publikuar kah fundi vitit të kaluar, për shtimin e myslimanëve në botë shkruan: "Shtimi i myslimanëve ka tejkaluar të gjithë kufijtë. Islami, sot është feja me përhapje më të madhe në botë. Nëse përhapja e tij vazhdon me të njëjtin trend, atëherë ai do të jetë religjioni me

shtrirjen më të madhe në rruzullin tokësor", përfundon raportin e saj Kisha Katolike Amerikane.

Pa marrë parasysh kredibilitetin dhe saktësinë e numrave dhe statistikave, disa prej të cilave mund të jenë të hiporbolizuara nga ana institucionit kishtar katolik, mirëpo kjo nuk e mohon afërsinë e shumicës së të dhënave me realitetin. Andaj, ajo që neve na intereson është rritja e lartë e natalitetit të popullata e komunitetit mysliman në Evropë dhe në vendet perëndimore në mënyrë të përgjithshme. Kjo çështje po paraqitet si shqetësim, apo thënë më mirë për disa qarqe perëndimore burim rreziku. Atëherë mund të shtrohet pyetja se ndodhia terroriste si kjo e Francës, a mund të jenë komplot i thjeshtë?

Përgjigjja me mohim apo pohim është shumë e vështirë. Mirëpo, ekzistojnë tregues dhe prova, të cilët përkrahin njërin prej këtyre dy teorive, mirëpo kjo nuk është objekt shqyrtimi, analize, pohimi apo mohimi. Mirëpo, ajo çka mund të vërtetohet me këtë rast është se këto apo ato ndodhi nuk kemi qëllim që ky artikull t'i ketë objekt trajtimi në aspektin e radhitjes, analizës pastaj konfirmimin dhe mohimin e tij.

Mirëpo, është më se e vërtetë se këto ngjarje kanë role të caktuara, të cilat ndodhën në tokën e Francës, Britanisë së Madhe si dhe të vendeve tjera perëndimore për të vendosur shkopin në dollapin e komuniteteve islamike për të kufizuar ndikimin e tyre politik dhe ekonomik përmes shpikjes së ligjeve dhe rregullave. Në sipërfaqen e saj të jashtme është lufta kundër terrorizmit kurse në brendinë e saj ekzistojnë qëllime strategjike tjera. Ne jemi dëshmitarë të ngjarjeve të shumta që po ndodhin për çdo ditë në Irak, Siri, Palestinë, për të cilat edhe sot vendet perëndimore po i zbatojnë politikat irrituese, joparimore, të padrejta, që i shikojnë viktimat myslimane si viktimë të armatimit dhe të terrorit sistematik në Irak dhe në Siri. Vlen të theksohet se viktimat në fjalë ishin me dhjetëra mijëra, të cilët shikohen pa kokëçarje të madhe. Në ndërkohë që e tërë bota ngrihet në këmbë për ndonjë rast terrorist, kur viktimë janë perëndimorët, të cilët janë me numra të kufizuar në dhjetëra. Ky shpirt racor është njëra prej degëve ushqyese të terrorizmit në vendet perëndimore, të cilën ato duhet ta mbyllin.

Qemajl Morina

IS ISLAM TO BLAME FOR THE SHOOTING AT CHARLIE HEBDO IN PARIS?

(Summary)

This is the title Nicholas Kristof chose for the column published in the New York Times on January 8, 2015, to express his opinion about the tragedy that had occurred in Paris earlier.

In his column, among others, he writes:

“The French satirical newspaper Charlie Hebdo skewers people of all faiths and backgrounds. One cartoon showed rolls of toilet paper marked “Bible,” “Torah” and “Quran,” and the explanation: “In the toilet, all religions.”

Yet when masked gunmen stormed Charlie Hebdo’s offices in Paris on Wednesday with AK-47s, murdering 12 people in the worst terror attack on French soil in decades, many of us assumed immediately that the perpetrators weren’t Christian or Jewish fanatics but more likely Islamic extremists”.

كمال مورينا

هل يمكن توجيه اللوم على الاسلام بشأن الهجوم

على شا رلى هبدو في باريس؟

(خلاصة البحث)

هذا العنوان الذى اختاره لمقالته المحلل نيكولاس كريستوف لصحيفة "نيو يورك تايمس" المؤرخة.

بناريخ ٨ يناير ٢٠١٥ ليعبر عن رأيه حول المأساة التى حدثت فى تلك الايام. و نرى المحلل فى مقالته يكتب فيما يلى:

"ان الصحيفة الفرنسية الساخرة "شارلى هيدبو" تجمع بينها أناسا من كل الاديان وكذلك من العناصر الثقافية المختلفة.

فى حدى الرسوسومات نرى لجريدة أخرجت فى ورقة تواليت مكتوب عليها الانجيل التوراة و القرآن مع توضيح: "الى تواليت جميع الاديان!"

و عندما قاموا الاشخاص المثلثون بفتح نيرانهم على الموظفين الموجودين بالمكتب حيث راح الضحية ١٢ نفرا فى أشنع هجوم حصل فى الارضى الفرنسية فى العقود اخيرة كان الكثر منا يتوقع بان اصحاب الجريمة لن يكون من المسيحيين و اليهود و لكن من المحتمل أنهم سيكونوا من مسلمين متطرفين.

JURISPRUDENCË ISLAME

Mr. Ejup Haziri

KARTA E MEDINËS DHE MAGNA CARTA LIBERTATUM (trajtesë krahasimtare)

Hyrje

Kjo është një trajtesë krahasimtare mes Kartës së Medinës dhe Magna Carta Libertatum, ku për shqyrtim do të jenë rrethanat historike të të dyja marrëveshjeve, për të kuptuar më mirë se në çfarë kohe erdhën këto marrëveshje dhe çfarë ishin arsyet dhe shkaqet thelbësore për marrëveshje të tilla. Më pas do të jepet edhe një përshkrim i shkurtër rreth dy protagonistëve që formuluan këto dy marrëveshje, ndonëse këtu mund të bëjmë një sqarim se nuk është qëllimi që të bëhen dallimet mes dy protagonistëve, sepse dihet fare mirë se nuk mund të krahasohet dikush me të Dërguarin e Allahut. Thjesht, ai është i pakrahasueshëm me të tjerët. Mirëpo, qëllimi ynë është të përmenden disa prej shkaqeve që ndikuan të arrihet një marrëveshje e tillë dhe të përmenden disa të dhëna rreth dy protagonistëve të këtyre dy marrëveshjeve, në mënyrë që të kuptohet më mirë se kush ishte i Dërguari i Allahut e kush ishte mbreti. Gjithashtu, në këtë trajtesë do të përmendet edhe përmbajtja e marrëveshjeve, në mënyrë që lexuesi të kuptojë se çfarë në realitet përmbajnë këto marrëveshje. Në fund të kësaj

trajtese do të jepet një pasqyrë e përbashkët krahasimtare mes dy marrëveshjeve, që më tepër i ngjan një analize. Megjithatë edhe në krahasime, siç do ta vërejë lexuesi, janë krahasime gjenerale, pa u ndalur në secilin nen për ta zbërthyer dhe analizuar atë. Jemi mjaftuar me një analizë të përgjithshme, që besoj se hedh në dritë gjërat që janë më thelbësore.

Mendoj se tema të tilla janë të një rëndësie të veçantë, sepse hedhin në dritë çështje që ndonëse i takojnë së kaluarës, janë një pasuri e madhe dhe bazament i fuqishëm që mund të na shërbejë për të tashmen dhe për të ardhmen.

Sfondi historik i Kartës së Medinës

Pas disa viteve të thirrjes së Pejgamberit Muhamed a.s. në Mekë, ku pjesa dërrmuese e banorëve mekas nuk i besuan, madje ata tentuan që me çdo kusht ta ndalonin thirrjen e tij, duke përdorur lloj-lloj metodash, si akuza dhe fyerje të ndryshme ndaj protagonistit të thirrjes, pengim, forcë fizike dhe likuidim ndaj atyre që i besuan shpalljes dhe metoda tjera që kishin për synim pengimin e misionit të shpalljes, sepse misioni i shpalljes binte në kundërshtim me praktikën dhe veprimet e tyre. Veprimet dhe praktikat e tyre ishin tejet të çoroditura dhe nuk përputheshin me normat njerëzore.

Mekasit jetonin në fise dhe shpeshherë krijonin grindje të panevojshme mes vete, ku zakonisht fiset e mëdha kishin krijuar një lloj sundimi karshi fisve të vogla. Situata ishte e brishtë, morali ishte në shkallë të ulët, ndërkaq reformat politike dhe humane as që ekzistojnin.

Pas qëndrimit të të Dërguarit të Allahut për disa vite në Mekë dhe ftesës së tij të vazhdueshme, qëndrimi i kundërshtarëve të tij sa vinte e bëhej edhe më i ashpër. Ata çdo ditë armiqësoheshin më shumë ndaj tij dhe ndaj atyre që i besuan atij. Përfundimisht vendosën që protagonistin e shpalljes ta mbysnin e për këtë ata kishin përgatitur edhe planin, por plani i tyre dështoi sepse Allahu kishte vendosur diçka tjetër. Për këtë Allahu thotë:

وَإِذْ يَمْكُرُ بِكَ الَّذِينَ كَفَرُوا لِيُثْبِتُوكَ أَوْ يَقْتُلُوكَ أَوْ يُخْرِجُوكَ وَيَمْكُرُونَ وَيَمْكُرُ اللَّهُ
 وَاللَّهُ خَيْرُ الْمَاكِرِينَ

“(Kujtoje) kur bënë dredhi mohuesit kundër teje: për të burgosur, mbytur ose dëbuar. Ata bënë ngatërresa, por Allahu ua prapësonte dredhitë e tyre, se Allahu është shkatërruesi më i mirë i dinakërive.”

I Dërguari i Allahut me lejen dhe urdhrin e Allahut ia mësyu Medinës. Në udhëtimin e tij ishte edhe shoku më i ngushtë i tij, Ebu Bekri, i cili për asnjë çast nuk ia nda të Dërguarit të Allahut. Allahu i Madhëruar thotë:

إِلَّا تَنْصُرُوهُ فَقَدْ نَصَرَهُ اللَّهُ إِذْ أَخْرَجَهُ الَّذِينَ كَفَرُوا ثَانِيَ اثْنَيْنِ إِذْ هُمَا فِي الْغَارِ إِذْ يَقُولُ لِصَاحِبِهِ لَا تَحْزَنْ إِنَّ اللَّهَ مَعَنَا فَأَنْزَلَ اللَّهُ سَكِينَتَهُ عَلَيْهِ وَأَيَّدَهُ بِجُنُودٍ لَمْ تَرَوْهَا وَجَعَلَ كَلِمَةَ الَّذِينَ كَفَرُوا السُّفْلَى ۗ وَكَلِمَةُ اللَّهِ هِيَ الْعُلْيَا ۗ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ

“Nëse ju nuk i ndihmoni atij (Pejgamberit), Allahu i ka ndihmuar, kur e dëbuan mohuesit atë vetë të dytën, kur këta të dy ishin në shpellë, e kur i tha shokut të vet: “Mos u dëshpëro! Se pa dyshim Allahu është me ne!” E, Allahu e zbriti qetësinë mbi shokun e tij, kurse atë e ndihmoi me ushtrinë, të cilën ju nuk e keni parë. Dhe bëri që fjala e mohuesve të jetë e ulët, kurse fjala e Allahut të mbetet lart. Me të vërtetë Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm.”

Udhëtimi i Pejgamberit a.s. nga Meka në Medine quhet hixhret, që nënkupton shpërngulje apo emigrim. Ky udhëtim i tij nuk ishte pse ai deshi të largohej nga vendlindja, por ishte i domosdoshëm, sepse rrethanat ishin të tilla dhe kundër tij ishin bërë plane që ai të mbytej. I Dërguari i Allahut u largua nga Meka vetëm atëherë kur shokët e tij besimtarë ishin shpërngulur më parë dhe se ata tanimë ndiheshin të sigurt në vendet ku ata u shpërngulën. Ai nuk iku nga armiqtë për ta shpëtuar jetën e tij, por ai u largua që të marr forcë e të kthehet përfundimisht në Mekë si triumfues i pasqor.

Ishte viti 622, kur i Dërguari i Allahut u drejtua kah Jethribi i atëherëshëm e që më vonë mori emrin Medine. Në Medine jetonin medianasit dhe komuniteti i vogël i hebrenjve, që përbëhej nga tre fise

kryesore, kurse komuniteti arab përbënte shumicën e popullatës. Për shkak të luftërave mes fiseve arabe, komuniteti hebrenj ishte pasuruar duke e rritur ekonominë dhe pasurinë e tyre personale, por edhe ishin tregtarë të suksesshëm që shfrytëzonin përçarjen dhe luftërat e komunitetit arab. I Dërguari i Allahut u ballafaqua me tri klasa të ndryshme në Medine, ku secila klasë dallohej në mënyrë të veçantë nga tjetra. Ato klasa shoqërore ishin:

- a.) Shokët (as’habet) e tij, gjegjësisht elita e ndershme dhe besnike ndaj të Dërguarit të Allahut.
- b.) Jobsimtarët, të cilët ende nuk e kishin pranuar islamin, e që kryesisht ishin fise me prejardhje medinase, dhe
- c.) Çifutët apo hebrenjtë.

I Dërguari i Allahut synonte të sillte paqe dhe siguri për të gjitha komunitetet në Medine. Madje, për shkak të luftërave të pandërprera mes fiseve të njohura Evs dhe Hazrexh, të gjithë pritnin një lider që të merrte udhëheqjen e shtetit për t’i shuar trazirat e brendshme, në mënyrë që të mbretëronte paqja dhe siguria në vend pas dëshpërimit dhe pikëllimit të shumë viteve.

I Dërguari i Allahut, themeloi një shoqëri të re, me ligje krejtësisht të ndryshme deri në atë kohë, e cila u dallua nga të gjitha sistemet ekzistuese shoqërore të botës. Ai u bë lider i të gjitha komuniteteve ekzistuese të Medinës, me gjithë skepticizmin dhe dyshimin e disave, kështu që Medina u bë një shoqëri e larmishme.

Me gjithë strukturat e ndryshme të komuniteteve në Medine, i Dërguari i Allahut me mendjemprehtësinë dhe largpamësinë e tij ndërtoi një shoqëri të garantuar me ligje dhe norma. Së pari bëri vëllazërimin e myslimanëve të shpërngulur që s’kishin asgjë me vete, me myslimanët vendas që ishin në gjendje të mirë, e më pas vuri themelet stabile të shoqërisë më të re islame, e cila u ngrit mbi bazamentet e një uniteti fetar, politik dhe legjislativ. Dhe krejt në fund, ai bëri Kartën e mirënjohur të Medinës, që secilit fis apo komunitet u jepte të drejta të barabarta.

Me këtë gjest madhor rregulloi raportet e myslimanëve me jomyslimanët, e që secilit i garantonte liri, rehati, paqe dhe siguri. Medinën

e bëri atdhe të të gjithëve, që deri atëherë bota nuk kishte përjetuar një marrëveshje të tillë si atë të Medinës, andaj, këtu do ta sjellim këtë marrëveshje, të njohur me emrin Karta e Medinës, për të reflektuar më pas nenet dhe ligjet e saj, kur kihet parasysh koha kur është krijuar ajo marrëveshje.

Sfondi historik i Magna Carta-së

Pas pushtimit të Anglisë nga ana e danezëve në periudhën mesjetare, ku fiset gjermane anglo-saksone u mposhtën në betejën e njohur të Hasting-ut në vitin 1066, mbreti William që fitoi betejën u kurorëzua si “Mbret i Anglisë”. Ai solli edhe ndryshimet në vend, ngase ndërroi gjuhën, literaturën dhe idealet e shoqërisë.

Mbreti William sponsorizoi një lloj sistemi të kombinuar të anglezëve dhe të të huajve. Ai centralizoi feudalizmin, sepse tokat e atyre që e kishin luftuar atë, ua mori dhe ndau mes vete dhe pasuesve të tij. Bëri reforma në aspektin luftarak dhe udhëheqës sa që krijoi një sistem të fuqishëm centralist.

Reformat e tij pushtuese në tokën e anglezëve do ta preknin edhe klerin fetar, ngase ai ndërroi klerin fetar anglo-sakson në atë francez. Këto ndryshime sigurisht se nuk do të mirëpriteshin në vend, por pushteti i tij do të shtypte çdo thirrje ndryshe dhe kundërshtarët do t'i eliminonte shumë lehtë.

Pas vdekjes së tij, gjërat do të ndryshonin, sidomos në fillim të shekullit të trembëdhjetë, ku për udhëheqës do të jetë mbreti Gjon (John Lackland). Baronët filluan të kurdisnin mashtrime kundër mbretit në fjalë përgjatë viteve 1209-1212, në mënyrë që ta kufizojnë pushtetin e mbretit. Gjatë mbretërimit të tij, taksat ishin të larta, luftërat u bënë të pasuksesshme dhe një sërë skenarësh tjerë ndikuan që rënien e popullaritetit të mbretit. Beteja e njohur e Bouvines në vitin 1214 dhe konflikti me Papën Inocent III thujse u dhanë vulë pakënaqësive të banorëve.

Në vitin 1215, baronët bënë një rebelim të hapur kundër mbretit. Rebelimet e tyre në këtë kohë ishin të zakonshme, por për dallim nga

herët e kaluara, rebelimi i fundit ishte pak më ndryshe, sepse ofruan disi alternativa, por jo të kënaqshme, ngase gjatë rebelimeve të mëherëshme, ata vetëm kërkonin shkarkimin e mbretit, duke mos ofruar një alternativë për ndonjë monark të ri. Arthur-i do të kishte qenë një alternativë ideale, sepse ai thujse gjithnjë ishte opozitë e mbretit, madje mbreti e kishte burgosur atë, por ai qe zhdukur, prandaj edhe populli kishte mbetur pa ndonjë personalitet të fuqishëm që do të mund ta zëvendësonte mbretin. Madje, besohej se Arthuri ishte vrarë nga Gjoni.

Një tjetër alternativë shikohej edhe Princi Louis i Francës, por ishin disa pengesa që mund ta zhvlerësonin një alternativë të tillë, sepse ai ishte bashkëshorti i mbesës së Henry II, po ashtu edhe fakti se francezët për kohë të gjatë ishin në luftë me anglezët, ia humbnin shpresat.

Në vitin 1215, kërkesat e baronëve ishin strikte dhe kërkohej që mbreti të merrte masat e duhura për të siguruar liritë dhe të drejtat e banorëve, që ishin nëpërkëmbur, sidomos gjatë viteve të fundit.

I ndodhur para një sfide të madhe, mbreti, në koordinim me subjektet tjera hartuan dokumentin e njohur si Magna Carta Libertatum.

Magna Carta ishte një përpjekje nga ana e baronëve për të ndaluar një mbret –në këtë rast mbretin Gjon- që të abuzojë me të drejtat e popullit. Dokumenti ishte një seri premtimesh, të shkruara nga mbreti dhe subjektet tjera, që nënvizonin se mbreti do ta qeverisë Anglinë, por subjektet tjera do të kenë një lloj fuqie që deri atëherë nuk e kishin, madje subjektet tjera ishin të marginalizuara.

Ajo u nënshkrua (me vulë mbretërore) mes baronëve feudalë dhe Mbretit Gjon i Runnymede pranë Windsor Castle. Dokumenti ishte një seri e premtimeve të shkruara midis mbretit dhe subjektet e tij se ai, mbreti, do të qeverisin Anglinë dhe të merren me njerëzit e saj në bazë të zakoneve të drejtës feudale. Magna Carta ishte një përpjekje nga ana e baronëve për të ndaluar një mbret - në këtë rast Gjonin - që ka abuzuar me popullin e Anglisë.

Themeluesi i Kartës së Medinës

Themelues i Kartës së Medinës është Muhamedi, i biri i Abdullahit, i lindur rreth vitit 570. Babai i tij, Abdullahi, vdiq dy muaj para se Muhamedi të lindte, ndërsa nëna e tij e kishte emrin Emine. Arabët e kishin zakon që fëmijët e porsalindur të çojnë në fshatra për të thithur ajër të pastër dhe për mësimin e gjuhës së pastër arabe. Në moshën 6-vjeqare atij i vdiq edhe e ëma e tij dhe kështu ai mbeti jetim pa asnjërin prind.

Gjyshi i tij Abdulmutalibi kujdesej për të, por shpejt edhe ai ndërroi jetë dhe kështu përkujdesjen e tij e mori axha i tij, Ebu Talibi. Punoit si tregtar dhe si bari. U martua në moshën 25-vjeqare, ndërsa në moshën 40-vjeqare i erdhi shpallja. Më pas filloi predikimin haptazi dhe ftoi njerëzit në besim monoteist. Thirrja e tij nuk u mirëprit mirë dhe kështu ai u përball me armiqësi të ndryshme nga fiset mekase, por edhe ndjekësit e tij u trajtuan ashpër, madje pati raste kur disa prej tyre edhe u mbytën nga kurejshët mekas. Për t'i shpëtuar persekutimit, Muhamedi a.s. dërgoi shokët e tij në Abisininë e krishterë, përpara se shokët e tij së bashku me të të migronin në Medine, në vitin 622. Historia e migrimit nga Meka në Medine njihet si hixhret dhe kjo ngjarje është e një rëndësie të veçantë në islam. Në Medine (Jethribin e dikurshëm) Muhamedi a.s. me Kartën e Medinës iu parapriu ngjarjeve dhe ai bashkoi fiset e përçara. Secilit fis dhe komunitet i caktoi detyra dhe obligime, por para këtyre u dha të drejta të barabarta me komunitetin mysliman. Këtu sigurisht se edhe ndodhi që për herë të parë të gjitha komuniteteve, si atyre që ishin komunitet i vogël e i papërfillshëm, t'iu jepen të drejta të barabarta, pa dallim kombësie, race, feje apo ngjyre. Kjo kartë ishte një lloj i veçantë, sepse në të kaluarën marrëveshjet, kartat dhe traktatet zakonisht bëheshin pas luftërave, grindjeve dhe mosmarrëveshjeve, ndërsa i Dërguari i Allahut hartoi këtë kartë me të drejta me të shkuar në Medine. Me këtë veprim të suksesshëm, ai jo vetëm që shoi ëndrrat e dikujt për ndarje, përçarje e grindje, mi-

rëpo ai edhe strukturën homogjene të Medinës, thaujse e bëri një të vetme dhe unike.

Pas qëndrimit tetë vite në Medine, ai së bashku me shokët e tij ia mësyn Mekës dhe e çliruan atë, pa luftë. Pastroi shtëpinë e shenjtë, prej së cilës ishte përzënë dhe fali ata që për kohë të gjatë e kishin luftuar dhe e kishin ndjekur. Ai i trajtoi armiqët e tij më mirë se ne miqtë tanë. Përfitoi zemrat e pjesës dërmuese të njerëzve, madje edhe të armiqve të tyre. Me drejtësinë e tij varrosi format e diskriminimit dhe padrejtësive të ndryshme. Drejtësisë së tij udhëheqës, liderë dhe mbretër ia hapën dyert dhe bashkëpunuan me shokët e tij. Për këtë revolucion kaq të madh të Pejgamberit, filozofi Lafajet me të drejtë pati thënë: “O Muhamed, nivelin që arrite ti në realizimin e drejtësisë, askush nuk e arriti dot më pas teje!”

Me shkathtësinë e tij u bë udhëheqës politik jashtëzakonisht i mirë, duke arritur suksese të jashtëzakonshme, bëri atë që të tjerët kurrë nuk do të mund ta bënin. Ai zgjidhi problemet e shoqërisë, nxori njerëzimin nga influenca e injorancës në dritën e besimit.

Me gjenialitetin dhe mendjemprehtësinë e tij shpëtoi njerëzimin nga padrejtësitë dhe dhuna e ushtruar që në atë kohë ishte mjaft e theksuar. Bashkoi komunitetet me besime të ndryshme, me moton e drejtësisë, paqes dhe të sigurisë.

Me besnikërinë dhe ndershmërinë e tij, predikoi dhe praktikoi demokracinë që ende as sot nuk e ka shijuar bota. Predikoi fenë, krijoi shtetin, ndërtoi kombin, rregulloi kodin moral, bëri reforma të ndryshme, përmirësoi statusin e shoqërisë dhe bota përjetoi një revolucion drastik në të mirë të njerëzimit.

Ai arriti përmes misionit të tij paqësor që Gadishullin Arabik ta largojë nga paganizmi dhe idhujtarizmi dhe shoqërinë e ndarë ta reformojë dhe ta bëjë model për gjeneratat që do të vijnë pas tyre. Ai kështu bashkësitë e ndara e të hasmuara arabe i ktheu në një bashkësi të vetme, të quajtur ummet. Ummeti paraqet një bashkësi të vetme, ku në gjirin e saj kishte nacionalitete të ndryshme që i bashkonte një besim i vetëm dhe unik.

Kah fundi i jetës së tij bëri haxhin lamtumirës, ku kumtoi edhe mesazhin e tij madhor. Më pas iu shpallën edhe ajetet e fundit, dhe kështu ai kreu mesazhin hyjnor dhe çoi në vend amanetin e Zotit. Në vitin 632, pas një sëmundjeje, vdiq.

Themeluesi i Magna Carta-së?

Themeluesi i Magna Carta-së është mbreti Gjon (John) i lindur më 24 dhjetor 1166. Ai ishte mbret i Anglisë nga 6 prilli i vitit 1199 deri në vdekjen e tij më 1216. Pas betejës së Bouvines, Gjoni humbi një pjesë të Normandisë nga Mbreti Philip II i Francës, e cila rezultoi në rënien e më të madhe të Perandorisë Angevin dhe kontribuoi në rritjen e mëvonshme në pushtet të dinastisë Capetian gjatë shekullit të 13-të. Revolta baronite në fund të mbretërimit të Gjoni çoi në nënshkrimin e Magna Carta, një dokument nganjëherë konsiderohet të jetë një hap i hershëm në evoluimin e Kushtetutës së Mbretërisë së Bashkuar.

Gjoni ishte më i vogli nga pesë bijtë e mbretit Henry II të Anglisë. Mes viteve 1173 dhe 1174, vëllezërit e tij u rebeluan dhe rebelimi i tyre dështoi, Gjoni u bë fëmija më i preferuar i Henryt. Në vitin 1177, u emërua si mbret i Irlandës dhe atij iu dhanë edhe një pjesë nga tokat e Anglisë. Vëllezërit e tij Williami, Henry dhe Xheofrey kishin vdekur të rinj. Gjoni ishte një trashëgimtar potencial për të kaluar në fron, sepse rrethanat ishin të tilla, sidomos pas rebelimit të vëllezërve të tij dhe vdekjes së tyre në moshë të re. Ai nuk kënaqej vetëm si mbret i Irlandës. Gjithnjë synonte që të bëhej edhe mbret i Anglisë, por në fron e kishte mbretin Riçard I, ku ndaj të cilit bëri një rebelim, por që rebelimi i tij nuk pati sukses dhe që në start dështoi. Kështu Gjoni nuk do të mund të bëhej mbret deri në vitin 1199, gjegjësisht me vdekjen e mbretit Riçard I. Vetëm atëherë Gjoni u shpall Mbret i Anglisë dhe arriti në një marrëveshje me mbretin Filip II të Francës për të njohur posedimin e tokave kontinentale. Marrëveshje e realizuar në Goulet, në vitin 1200.

Kur lufta shpërtheu përsëri me Francën, gjatë vitit 1202, Gjoni arriti fitoret e hershme, por mungesa e burimeve ushtarake dhe trajti-

mi i tij ndaj fisnikëve të vendeve Norman, Breton dhe Anxhou, rezultoi me rënien e perandorisë së tij në Francën veriore në vitin 1204. I irrituar nga këto humbje, ai u përpoq që gjatë dekadës së ardhme t'i rifitojë këto toka e vende, duke ua rritur të ardhurat dhe duke bërë reformime në forcat e armatosura dhe ndërtimin e aleancave kontinentale.

Reformat gjyqësore të Gjoni kishin një ndikim afatgjatë mbi sistemin anglez të ligjit të përbashkët, si dhe duke siguruar një burim shtesë të të ardhurave. Një argument me Papa Inosentin III çoi në shkishërim të Gjoni në vitin 1209, më në fund një mosmarrëveshje zgjidhet nga mbreti në vitin 1213. Përpjekjet e Gjoni për të mundur Filipin më 1214, dështuan për shkak të fitores franceze mbi aleatët e Gjoni në betejën e Bouvines. Kur ai u kthye në Angli, u përball me një rebelim nga baronët e tij, të cilët ishin të pakënaqur me politikën e tij fiskale dhe trajtimin e tij ndaj shumë prej fisnikëve më të fuqishëm të Anglisë. Edhe pse të dyja palët, Gjoni dhe baronët ranë dakord për një traktat të paqes Magna Carta më 1215, mirëpo asnjëra nga palët nuk arritën të pajtoheshin me kushtet e palës tjetër, dhe kështu lufta civile shpërtheu menjëherë, me baronët e ndihmuar nga mbreti Luis i Francës. Gjoni vdiq gjatë fundit të vitit 1216, ndërsa mbështetësit e djalit të tij Henry III vazhduan për të arritur fitoren ndaj mbretit Luis dhe rebelëve baronë deri në vitin tjetër.

Kronikët bashkëkohore shfaqen kritikë ndaj performancës së Gjoni si mbret, sepse mbretërimi i tij ka qenë subjekt i një debati të rëndësishëm dhe rishikimit periodik nga ana e historianëve që nga shekulli i 16-të e tutje. Historiani Jim Bradbury mendon se Gjoni ka qenë një administrator i punës, një njeri i aftë dhe një gjeneral i suksesshëm. Megjithatë, historianët modernë janë dakord se ai gjithashtu kishte shumë gabime si mbret, duke përfshirë edhe atë që historiani Ralf Turner e përshkruan atë si njeri me "tipare të personalitetit shkatërrues, madje edhe me tipare të rrezikshme, të tilla si ligësia dhe mizoria."

Çfarë përmban Karta e Medinës?

Karta e Medinës përmban mbi 50 nene. Ku të gjitha nenet e saj do t'i sjellim këtu:

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Kjo marrëveshje e Pejgamberit të Allahut, Muhamedit, s.a.v.s. u drejtohet të imigruarve, Kurejshëve, qytetarëve të Jethribit (Medinës) që e kishin pranuar Islamin dhe të gjithë atyre njerëzve që ishin në marrëveshje me grupet e përmendura më lart dhe që kishin marrë anën e tyre në kohë lufte.
2. Të gjithë ata që bëjnë pjesë në këtë marrëveshje do të trajtohen si grup i ndarë prej të gjithë atyre që nuk janë pjesë e kësaj marrëveshjeje.
3. Kurejshët e migruar, si edhe më parë, përbëjnë një grup më vete. Ata duhet të jenë përgjegjës për shpagimin e gjakut të kriminelëve të tyre dhe ata vetë duhet t'i lirojnë robërit e tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të jetë në përputhje me parimet e besimit (Imanit) dhe drejtësisë.
4. Benu Auf duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpagimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.
5. Benu El-Haris duhet të jenë përgjegjës për fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpagimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.
6. Benu Sa'ida duhet të jenë përgjegjës për fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre

- pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.
7. Benu Xhusham duhet të jenë përgjegjës për fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.
 8. Benu En-Nexhxhar duhet të jenë përgjegjës për fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.
 9. Benu Amr duhet të jenë përgjegjës për fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.
 10. Benu El-Wabijjat duhet të jenë përgjegjës për fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.
 11. Benu El-Ews duhet të jenë përgjegjës për fisin e tyre dhe duhet bashkërisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.
 12. Nëse në radhët e myslimanëve, një njeri i varfër është fajtor i ndonjë sulmi, për të cilin shpagimi i gjakut bëhet i detyrueshëm ose ai merret rob dhe nuk është i aftë ta paguajë shpërblimin për lirim; duhet të jetë detyrë e myslimanëve të tjerë ta paguajnë në emër të tij shpagimin e gjakut ose shpërblimin për lirim dhe ta lirojnë atë,

- me qëllim që, në marrëdhëniet e ndërsjella të myslimanëve, të krijoheshin virtytet dhe dashamirësia.
13. Asnjë mysliman nuk duhet të armiqësohet me një rob të liruar prej një myslimani tjetër.
 14. Është detyrë e myslimanëve të kundërshtojnë hapur çdo person që shkakton dëme dhe trazira, shqetëson njerëzit ose me forcë do t'u grabisë diçka dhe përdor dhunën. Të gjithë myslimanët duhet të mbeten të bashkuar me njëri-tjetrin, në dënimin e një personi të tillë, madje edhe nëse ai është djali i ndonjërit prej tyre.
 15. Myslimani nuk ka të drejtë të vrasë një mysliman tjetër në shkëmbim të një të pafeje (i cili është në gjendje lufte) ose të ndihmojë një person, i cili është në gjendje lufte me myslimanët.
 16. Premtimi i Allahut, përgjegjësia dhe përkrahja janë të njëjta për të gjithë. Kjo do të thotë se nëse një mysliman i jep strehim ndonjërit, duhet të jetë detyrë e të gjithë myslimanëve ta nderojnë atë, edhe nëse myslimani që e ka siguruar të strehuarin mund të jetë prej një shtrese të ulët. Në krahasim me të tjerët, të gjithë myslimanët janë të vëllazëruar ndërmjet vete.
 17. Është detyrë e të gjithë myslimanëve të ndihmojnë dhe t'u ofrojnë sjellje miqësore çifutëve, të cilët kanë hyrë në marrëveshje me ta. Asnjë shtrëngim i çfarëdo lloji qoftë nuk duhet ushtruar mbi ta dhe nuk duhen ndihmuar armiq të tyre, kundër tyre.
 18. Armëpushimi i të gjithë myslimanëve duhet të jetë i njëkohshëm: Kur ka luftë në rrugë të Allahut, asnjë prej myslimanëve s'duhet të mënjanohej prej myslimanëve të tjerë, apo të hyjë në traktat paqe me armikun, veçse nëse traktati është i njëkohshëm dhe i njëjtë për të gjithë myslimanët.
 19. Të gjitha grupeve, të cilat marrin pjesë në luftë bashkë me ne, do t'u jepet mundësia për të pushuar me radhë.
 20. Nëse një mysliman bie dëshmor në rrugë të Allahut, furnizimi i jetës së atyre që varen prej tij duhet të jetë përgjegjësi e të gjithë myslimanëve.

21. Pa asnjë dyshim të gjithë myslimanët e devotshëm që i frikësohen Zotit janë në rrugë të drejtë dhe janë pasues së rrugës më të mirë të jetës.
22. Asnjë jomysliman që është palë e kësaj marrëveshjeje, nuk duhet të sigurojë strehim të jetës dhe të pronës së ndonjë Kurejshi, e as duhet të ndihmojë ndonjë jomysliman kundër një myslimani.
23. Nëse dikush vret një mysliman dhe për këtë ka fakte kundër tij, vrasësi duhet të ndëshkohet. Por, nëse farefisi është pajtuar të pranojë shpagimin e gjakut, vrasësi duhet të lihet i lirë. Duhet të jetë obligim i të gjithë myslimanëve ta respektojnë këtë vendim pa asnjë përjashtim. Asgjë tjetër përveç asaj që paracaktojnë urdhrat nuk duhet të pranohet.
24. Për një mysliman i cili pas pranimi të marrëveshjes ka rënë dakord që ta respektojë atë, dhe ai beson në Allah dhe në Ditën e Gjykimit, atij nuk i lejohet të sajtojë asnjë veprim apo zakon të ri, e as do të ishte e pranueshme që të ketë marrëdhënie tregtare me një person që nuk e respekton këtë marrëveshje. Mallkimi dhe zemërimi i Zotit do të bjerë në ditën e Gjykimit mbi cilindo që shkel këtë marrëveshje dhe në këtë drejtim asnjë shfajësim dhe asnjë kërkesë për falje nuk do të pranohet prej tij.
25. Kur të lindin mosmarrëveshje të dyanshme rreth ndonjë pike të kësaj marrëveshjeje, çështja do të drejtohet për vendim Allahut dhe Muhamedit s.a.v.s..
26. Pas traktatit, çifutët do të jenë të obliguar t'u dorëzojnë myslimanëve ndihmë financiare, kur ata janë në luftë me armikun.
27. Çifutët e fisit Benu Auf, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të myslimanëve, duhet t'u përmbahen me vendosmëri fesë së tyre, e myslimanët, të tyre. Përveç çështjeve fetare, myslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen që i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej tyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.
28. Çifutët e Benu En-Nexhxhar, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të myslimanëve, duhet t'u përmbahen me vend-

- osmëri fesë së tyre, e myslimanët, të tyre. Përveç çështjeve fetare, myslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen që i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej tyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.
29. Çifutët e fisit Benu El-Haris, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të myslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre, e myslimanët, të tyre. Përveç çështjeve fetare, myslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen që i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.
30. Çifutët e fisit Benu Sa'id, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të myslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre, e myslimanët, të tyre. Përveç çështjeve fetare, myslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen që i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.
31. Çifutët e fisit Benu Hashim, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të myslimanëve, duhet t'u përmbahen me vendosmëri fesë së tyre, e myslimanët, të tyre. Përveç çështjeve fetare, myslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen që i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.
32. Çifutët e fisit Benu El-Avs, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të myslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre, e myslimanët, të tyre. Përveç çështjeve fetare, myslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen që i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

33. Çifutët e fisit Benu Sa'laba, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të myslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre, e myslimanët, të tyre. Përveç çështjeve fetare, myslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen që i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.
34. Çifutët e fisit Benu Xhafna, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të myslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre, e myslimanët, të tyre. Përveç çështjeve fetare, myslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen që i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.
35. Çifutët e fisit Benu El-Shataiba, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të myslimanëve, duhet të përmbahen me vendosmëri fesë së tyre, e myslimanët, të tyre. Përveç çështjeve fetare, myslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen që i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.
36. Degët e varura prej fiseve të përmendura më lart do të kenë të drejta të njëjta me ato që gëzojnë degët bazë.
37. Asnjë prej hartuesve të traktatit nuk mund të marrë ndonjë aksion ushtarak pa lejen e Muhammedit s.a.v.s..
38. Asnjë pengesë nuk duhet të shkaktohet në kompensimin apo shpëgimin e ndonjë plage apo goditje. Kushdo që bën shkeljen e betimit, meriton të ndëshkohet për këtë dhe cilido që i përmbahet me shumë vendosmëri këtij traktati, Allahu do ta ndihmojë.
39. Nëse një bashkësi e tretë zhvillon luftë kundër myslimanëve dhe çifutëve, pjesëmarrës në traktat, ata duhet të luftojnë bashkërisht. Duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin reciprokisht dhe ndërmjet tyre duhet të ekzistojë dashamirësia dhe besueshmëria e ndërsjellë. Çi-

- futët duhet t'i përballojnë shpenzimet e tyre të luftës dhe myslimanët, shpenzimet e tyre.
40. Është detyrë e palëve të kësaj marrëveshjeje të sillen me njëri-tjetrin sinqerisht dhe t'i dëshirojnë të mirën njëri-tjetrit. Asnjëri nuk duhet ta bëjë tjetrin, objekt shtypjeje dhe padrejtësie dhe i shtypuri duhet të ndihmohet.
 41. Çifutët duhet t'i ndajnë shpenzimet së bashku me myslimanët për aq kohë sa ata luftojnë bashkërisht.
 42. Rrafshina e Jethribit, e cila rrethohet prej kodrave do të jetë haram (strehim) për palët pjesëmarrëse të traktatit.
 43. I njëjti trajtim duhet të bëhet edhe ndaj një refugjati, që konsiderohet person që i është dhënë e drejta e strehimit dhe nuk duhet të dëmtohet. I strehuari duhet ta respektojë këtë marrëveshje dhe nuk duhet të lejohet ta thyejë premtimin.
 44. Askush nuk duhet të strehojë një refugjat pa lejen e njerëzve të këtij vendi.
 45. Nëse ka ndonjë moskuptim apo mosmarrëveshje të mendimeve midis palëve pjesëmarrëse të traktatit, e që mund të çojë në prishjen e paqes, çështja duhet t'i drejtohet për zgjidhje, Allahut dhe Muhamedit, të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.. Allahu do të jetë me atë, i cili më së shumti i përmbahet traktatit.
 46. Askush nuk duhet të garantojë mbrojtje për Kurejshët e Mekës apo për ndonjë nga përkrahësit e tyre.
 47. Nëse Jethribi (Medina) do të pushtohet, myslimanët dhe çifutët bashkërisht duhet t'u kundërvihen me një mbrojtje të bashkuar.
 48. Nëse myslimanët bëjnë traktat paqeje me ndokënd, çifutët duhet ta respektojnë atë. Edhe nëse çifutët bëjnë paqe me ndokënd, myslimanët janë të obliguar të ofrojnë bashkëpunim të ngjashëm me çifutët. Por, në rast të një lufte fetare të njëres palë, nuk do të jetë përgjegjësi e palës tjetër të bashkëveprojë në të.
 49. Në rast të pushtimit të Medinës, secila palë duhet të mbrojë pjesën që është përpara saj.
 50. Përkrahësit e fisit Evs do të kenë të drejta të njëjta ashtu sikurse gëzojnë edhe palët pjesëmarrëse të këtij traktati, me kusht që ata të

dëshmojnë besnikërinë e tyre. Allahu është Mbrojtësi dhe Përkrahësi i atij, që i përmbahet me vendosmëri më së shumti këtij traktati.

51. Nëse ndonjëri prej palëve pjesëmarrëse të këtij traktati, duhet të dalë jashtë Medinës për shkak të kërkesave urgjente të luftës, duhet të gëzojë të drejtën e mbrojtjes dhe përkrahjes. Gjithashtu edhe cilido që qëndron në Medinë gëzon të drejtën e paprekshmërisë. As nuk duhet të dhunohet ndokush e as nuk duhet të lejohet që të shkel premtimin. Allahu dhe i Dërguari i Tij s.a.v.s., do të jenë mbrojtësit e cilitdo, që do ta respektojë me gjithë zemër këtë marrëveshje dhe do t'i bindet asaj.

Çfarë përmban Magna Carta?

Dokumenti i vitit 1215, përmbante një pjesë të madhe që quhet tashmë Klauzola 61 (klauzolat nuk u regjistruan fillimisht). Ky seksion kishte krijuar një komitet prej 25 baronëve, që mund të takohen në çdo kohë dhe të anulojnë vullnetin e Mbretit nëse ai pranoi dispozitat e Kartës, duke kapur kështjellat dhe pasurinë e tij në qoftë se ajo konsiderohet e nevojshme. Kjo është e bazuar në rregulla mesjetare të njohura si praktika ligjore si sekuestrim, por kjo ishte hera e parë që ajo kishte qenë e aplikuar në një monarki.

Pjesë të Magna Carta-s, përveç mbretit dhe baronëve ishin edhe peshkopët, të cilët luanin një rol të rëndësishëm në ato kohëra. Magna Carta ka 63 nene dhe do të bëjmë një përzgjedhje të disa seksioneve apo neneve që do të përmenden këtu:

Gjon, shërbyesi i Perëndisë, mbreti i Anglisë dhe Irlandës. Duka i Normandisë dhe Aquitanine, Konti i Angjout. Për peshkopët, kryepeshkopët e tij, baronët, gjyqtarët, pylltarët, administratorët, shërbëtorët dhe për të gjithë zyrtarët e tij të subjekteve besnike ndaj mbretit. Përshëndetje të gjithëve.

Ky ishte një paragraf hyrës, gjithashtu edhe ai vijues është hyrës, ku përmenden emrat e kardinalëve, peshkopëve dhe subjekteve tjera, që janë ishin ndaj mbretit.

Së pari, iu kemi betuar Perëndisë, edhe me anë të kësaj karte të pranishme për të konfirmuar për ne dhe për trashëgimtarët tanë, se Kisha Angleze do të jetë e lirë dhe do të ketë të drejtat e saj të pushuara dhe liritë e saj do të jenë të pacenueshme... Me këtë ne dëshirojmë që ajo (kisha) të respektohet dhe të garantohet ruajtja e saj. Duke u nisur nga fakti se me vullnetin tonë të lirë, para shpërthimit të mosmarrëveshjeve të pranishme mes nesh dhe baronëve, kemi dhënë konfirmimin tonë për të ruajtur statutin e lirisë së zgjedhjeve të Kishës...kjo do të konfirmohet edhe nga Papa Inosenti III.

Për të gjithë njerëzit e lirë që i përkasin mbretërisë sonë dhe trashëgimtarëve tanë, të gjitha liritë e shkruara më poshtë, t'i ruajmë dhe t'i mbajmë për veten tonë dhe për trashëgimtarët tanë.

Nenet nga dy deri në gjashtë flasin për baronët, kujdestarët, tokën dhe të ngjashme me këto, duke tentuar të sjellin një rend dhe rregull sa u përket këtyre gjërave.

7- Pas vdekjes së burrit të saj, gruaja e ve mund të marrë pjesën e saj nga martesja dhe trashëgiminë, pa ndonjë problem...ajo mund të qëndrojë në shtëpinë e burrit të saj për dyzet ditë që nga dita e vdekjes së burrit të saj dhe brenda kësaj periudhe do t'i caktohet edhe prika e saj.

8- Asnjë e ve nuk do të detyrohet të martohet, përderisa një gjë të tillë ajo nuk e dëshiron dhe dëshiron të mbetet e vetme, pa burrë. Ajo mban tokat e saj që i takonin sipas kurorës dhe se pa pëlqimin e saj, askush s'mund t'ia marrë ato.

9- As ne por as zyrtarët tanë nuk mund të marrin secilën tokë apo me qira në këmbim të borxhit, përderisa debitori ka mallra (pasuri) të tundshme të mjaftueshme sa për të shlyer borxhin. E, nëse për shkak të mungesës së mjeteve, debitori nuk është në gjendje të kryejë borxhin e tij, garantuesit e tij do të jenë përgjegjës për të. Ata mund t'i kenë tokat e debitorit dhe qiratë deri në shlyerjen përfundimtare të borxhit...

10- Në qoftë se dikush që ka huazuar një shumë parash nga hebrenjtë vdes përpara se borxhi të jetë shlyer, atëherë trashëgimtari i tij nuk do të paguajë asnjë interes mbi borxhin...

11- Nëse dikush vdes për shkak të të hollave nga hebrenjtë, gruaja e tij nuk do të paguajë asgjë për borxhin e tij...

13- Qyteti i Londrës do t'i gëzojë të gjitha liritë e saj të lashta (antike) dhe liri doganore (jo taksa), si nga toka ashtu edhe nga uji. Ne, gjithashtu do t'u japim të gjitha liritë të gjitha qyteteve tjera, lagjeve, paralagjeve, porteve, që t'i gëzojnë ato.

20- Për kundërvajtje të lehtë, një njeri i lirë do të gjobitet vetëm në proporcion me shkallën e veprës së tij, ndërsa nëse vepra është e rëndë, ai duhet të ndëshkohet rëndë, por jo aq shumë saqë ta privoj atë nga jeta e tij.

Një tregtar që kursen mallin e tij, dhe një bujk që zbaton rregullat e përcaktuara, janë nën në mëshirën e oborrit mbretëror. Asnjëri prej këtyre nuk do të gjobitet dhe ndaj tyre nuk do të ketë imponime, me përjashtim të vlerësimit nga betimi i njerëzve të lagjes që kanë reputacion.

21- Baronët do të ndëshkohen vetëm nga njerëz të barabartë me ta dhe në proporcion me peshën e veprës së tyre.

27- Në qoftë se një njeri i lirë vdes, pa lënë testament, mallrat e tij të tundshme duhet të shpërndahen mes të afërmeve dhe të miqve të tij, gjithnjë nën mbikëqyrjen e Kishës. Të drejtat e debitorëve të tij duhet të ruhen.

28- Asnjë zyrtar mbretëror, polic qoftë apo ndonjë lëmi tjetër, nuk duhet të marrë grurë apo mallra tjera të tundshme nga dikush pa pagesë të menjëhershme, përveç nëse shitësi vullnetarisht ofron shtyrjen e kësaj (pagese).

41- Të gjithë tregtarët mund të hyjnë ose të largohen nga Anglia, pa u dëmtuar ata dhe pa pasur frikë. Ata mund të qëndrojnë apo të udhëtojnë brenda saj, nga toka ose uji, për qëllime të tregtisë, të lirë dhe pa taksa të paligjshme, në përputhje me zakonet e lashta dhe të ligjshme. Kjo, megjithatë nuk mund të zbatohet në kohë lufte për tregtarët që i përkasin vendit që është në luftë me ne...

45- Ne do të emërojmë gjyqtarët, njerëzit e ligjit dhe zyrtarët tjerë, por do të emërohen vetëm ata që e njohin ligjin e mbretërisë dhe janë të njëjtut mendim për ta mbajtur atë të tillë.

Nenet në vazhdimësi flasin për zakonet e këqija që ishin praktike në atë kohë në Angli për pyjet, pylltarët, sherifët, shërbëtorët, gardianët dhe të tjerëve, në mënyrë që ato të eliminohen nga mentaliteti anglez. Mbreti dhe nënshkruesit e kësaj marrëveshje, kërkonin që ato principe dhe vese të këqija, të hiqeshin plotësisht.

51- Sa më shpejt që paqja të arrihet, kjo do të largojë nga mbretëria jonë kalorësit e huaj dhe të gjithë mercenarët e huaj që kanë ardhur këtu, në dëmin tonin, me kuaj dhe me armë.

52- Ndaj secilit njeri të cilin e kemi privuar apo dëbuar nga tokat, kështjellat apo është privuar nga liritë dhe të drejtat, pa aktgjykim të ligjshëm, ne do të rivendosim dhe do t'ia rikthejmë të drejtat e tij. Në rast të kontestit, çështja do të zgjidhet nga gjykimi i njëzet e pesë baronëve që do të përmenden më poshtë në klauzolën për sigurimin e paqes (neni 61)...

55- Të gjitha gjobat që janë dhënë në mënyrë të padrejtë dhe kundër ligjit, si dhe të gjitha gjobat që i kemi bërë në mënyrë të padrejtë, do të ketë lirim prej tyre dhe çështjet e tilla do të vendosen përmes një aktgjykimi, ku do të marrin pjesë njëzet e pesë baronët e referuar poshtë në klauzolën për sigurimin e paqes. Së bashku me ata do të marrë pjesë edhe kryepeshkopi i Kanterburit, Stefani, nëse do të mund të jetë i pranishëm dhe nëse dëshiron të marrë edhe dikë me vete. E nëse kryepeshkopi nuk mund të jetë i pranishëm, procedimi do të vazhdojë pa atë. Por, nëse ndonjëri prej njëzet e pesë baronëve është i përfshirë në ndonjë akt të tillë, atëherë ai s'mund të marrë pjesë në gjykim, mirëpo si zëvendësim do të përzgjidhet një tjetër që do të betohet në vendin e tij dhe pjesa tjetër nga njëzet e pesë baronëve do të marrin pjesë.

57- Në rastet kur një vellsian është privuar ose dëbuar nga çdo gjë, pa ndonjë aktgjykim të ligjshëm e të drejtë, nga babai ynë Henri apo vëllai ynë mbreti Riçard, dhe çështja mbetet në duart tona dhe nën

garancinë tonë, ne do të kemi afat për një periudhë që zakonisht lejohet për kryqtarët, ose nëse hetimi është bërë para se ne të kemi marrë ndonjë kryqëzatë, me kthimin tonë prej kryqëzatës, do të arrihet drejtësia e plotë në përputhje me ligjet e Vellsit dhe të rajonit.

58- Menjëherë do ta kthejmë djalin e Llyvelinit si dhe të gjitha pengjet e Vellsit, duke u dorëzuar edhe dokumentet që do të shërbejnë si siguri për paqe mes nesh.

59- Lidhur me kthimin e motrave dhe pengjeve të Aleksandrit, mbretit të Skocisë, ne do ta trajtojmë këtë rast njëjtë me rastet e baronëve tanë dhe të tjerëve që jetojnë në Angli, nëse për këtë çështje nuk kemi ndonjë dokument nga babai i tij, Villiami, ish-mbret i Skocisë, që e trajton ndryshe. Sigurisht se kjo çështje do të zgjidhet nga një gjykim i drejtë në gjykatën tonë.

61- Ne për këto gjëra ia kemi dhënë besën Perëndisë, për urdhërimin në të mirë të mbretërisë sonë dhe për t'u dhënë fund këtyre mosmarrëveshjeve që kanë lindur mes nesh dhe baronëve tanë, ne dëshirojmë që të kemi forcë të qëndrueshme dhe të jemi të sigurt dhe të gëzuar, të gjithë ne.

Baronët duhet të zgjedhin me vota njëzet e pesë anëtarët e tyre baronë, në mënyrë që të respektohen të drejtat, të vëzhgohen ato dhe të arrihet paqja dhe liria, sipas konfirmimit të këtij statuti.

63- Në përputhje me dëshirën dhe komandën tonë, kisha angleze do të jetë krejtësisht e lirë dhe se njerëzit në mbretërinë tonë do t'i jetësojnë këto liri dhe të drejta, në paqe të plotë për ta e për ne, për trashëgimtarët e tyre dhe tanë, në gjithë vendin tonë.

Si ne ashtu edhe baronët betohen se e gjithë kjo do të respektohet në mirëbesim dhe pa mashtrim. Dëshmitarë për këtë do të jenë njerëzit e lartpërmendur dhe të tjerët.

Si ne ashtu dhe baronët betohem se e gjithë kjo do të respektohet në mirëbesim dhe pa mashtrim. Dëshmitarë njerëzit e lartpërmendur dhe shumë të tjerë.

Betimi i kësaj marrëveshje u bë në ditën e pesëmbëdhjetë të muajit qershor të vitit 1215, gjegjësisht në vitin e shtatëmbëdhjetë të mbretërimit të Gjonit.

Krahasime mes Kartës së Medinës dhe Magna Carta-s

Karta e Medinës, është marrëveshja e parë që ka lidhur Pejgambëri a.s. kur kaloi në Medine. Konsiderohet një dokument apo një traktat politik, fetar dhe shoqëror, që i ngjan një pakti të rëndësishëm. Fillon si gjithë të tjerat, me emrin e Allahut, që nënkupton një lloj shenjtërie të pacenuar dhe një vlerë sublime, dhe si e tillë ajo ka dëshmi Krijuesin e njerëzimit, që rezulton në vlefshmërinë dhe aplikueshmërinë e saj, duke i trajtuar të gjithë banorët njësoj.

Kjo kartë e atëhershme ka luajtur rolin e një kushtetute, gjë e cila nuk ishte aplikuar deri në atë kohë, madje ajo mund të konsiderohet edhe model për kohën moderne, pavarësisht faktit se është bërë para 14 shekujve.

Ajo u drejtohet të imigruarve nga Meka dhe vendësve nga Medina, ku bënë vëllazërim mes tyre mbi parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë që bota deri atëherë nuk e kishte përjetuar. Në mes të të shpërngulurve që s'kishin asgjë me vete me mikpritësit që ndanë pasurinë dhe gjithë atë që posedonin karshi vëllazërve të tyre imigrantë. Akti i vëllazërimit është akti i mençurisë dhe i vigjilencës së të Dërguarit të Allahut, dhe ishte një zgjidhje e mrekullueshme për problemet e shumta që ishte përballur ajo shoqëri.

Përderisa Magna Carta vjen krejtësisht në një situatë tjetër me rrethana tjera. Ajo nuk fillon sikur Karta e Medinës me emrin e Zotit, por ajo fillon me emrin e mbretit Gjon, e më pas përmend me emra gjithë ata që morën pjesë në betimin e tyre për të hartuar një kartë të tillë. Edhe kjo vjen sikur Karta e Medinës, me qëllimin e bashkimit të njerëzve, për ta parandaluar konfliktin dhe për të sjellë paqe mes komuniteteve të ndryshme, por me një dallim thelbësor; Karta e Medinës u formulua që kur i Dërguari i Allahut shkoi në Medine dhe gjendja ishte e mirë, pa ndonjë rrezik trazire apo revolte, përderisa Magna

Carta u formulua në rrethana krejtësisht tjera, sepse jo erdhi pas trazirave dhe revoltave. Magna Carta vjen pas konflikteve të brendshme në Angli, Skoci dhe Vells. Vjen pas reagimeve të shoqërisë dhe padrejtësive të mbretit, i cili për të mbetur në fronin mbretëror, kishte shtypur grupet shoqërore, për ç'arsye edhe shpesh kishte pasur revolta popullore. Mbretërimi kishte shtypur baronët, të cilët edhe më parë kishin pasur fuqi, por që mbreti tentonte që fuqinë e tyre ta reduktonte dhe për vendimet e tij të mos kishte reagime nga baronët. Megjithatë, baronët arritën që të ruajnë vendin e tyre në shoqëri dhe të forconin ndikimin e tyre në mbretëri. Prandaj, marrëveshja krijonte një komitet baronësh të përbërë prej njëzet e pesë vetave, të cilët do të marrin pjesë nëpër gjykime të ndryshme dhe tejet të rëndësishme.

Magna Carta flet edhe për drejtësinë e tokave të sekuestruara apo të privura prej të zotëve të tyre. Përmes saj tentohej që ato toka t'u ktheheshin pronarëve të tyre, përmes gjykimeve të drejta e të paanshme. Marrja e tokave ishte një praktikë e asaj kohe, ku rivalëve politikë dhe kundërshtarëve të mbretit, u sekuestrohej e tërë pasuria, në mënyrë që të mos kishin ndikim në ngritjen e popullatës kundër mbretit. Edhe një pjesë e baronëve kishin pasur dhe përjetuar një fat të tillë.

Karta e Medinës cek edhe obligimet dhe detyrat që dalin nga kjo marrëveshje, ku në mënyrë të prerë dhe direkt përmendën fiset që duhet të jenë përgjegjëse për bashkësitë e tyre, për shpagimin e gjakut dhe lirim të robërve. Për herë të parë u trajtuan robërit që në atë kohë nuk kishin asnjë të drejtë dhe ishin privuar nga të gjitha të drejtat civile dhe vlerat morale. Ky trajtim i ri vjen nga ideatori i ri që dëshiron përmirësimin e shoqërisë pa përfitime personale.

Deri atëherë në rast se një i varfër shpallej fajtor për ndonjë sulm tragjik, në mungesë të shpagimit të gjakut, merrej rob dhe ndoshta e tërë jeta i shkonte në robëri. Mirëpo, i Dërguari i Allahut me kartën e Medinës bëri revolucion, duke kërkuar që pagesa për lirim nga robëria apo shpagimi i gjakut të jetë detyrë e kolektivit mysliman, në mënyrë që ai të mos përjetojë robërinë. Andaj, Islami imposhtoi dhe shoi barrierat e robërisë, e në vend të saj proklamoi dashamirësi, paqe e barazi mes gjithë njerëzve. Ky ishte një trajtim i ri në shoqëri, i cili

pothuajse zhdukë epokën e errët të robërisë, përpos robërisë në luftë që praktikohet në çdo vend.

Përveç robërisë, ai i dha fund edhe armiqësisë, që akoma reziston-te nga koha e injorancës, duke mbajtur gjallë rrënjët e thella nga koha e paditurisë dhe e idhujtarisë. Për shkak të lëvizjeve hipokrite dhe rrymave të rrezikshme, armiqësia ishte mjaft aktuale në atë shoqëri, madje si shkak i saj ishin ndezur edhe luftëra.

Krahas armiqësisë, vizionari i madh, proklamoi një rregull krejtësisht të re në atë shoqëri; kundërshtimin e hapur ndaj secilit person që shkakton dëme, bën trazira, shqetëson njerëzit ose me forcë do t'u grabisë diçka dhe përdor dhunën. Këto të këqija kishin shkallëmuar shoqërinë e atëhershme. Trazirat ishin të shpeshta për shkak të situatës ndër-fisnore që shpesh nga incidentet më të vogla krijonin rrëmuja dhe gjendje jostabile. Populli jetonte i ndarë në shtresa. Shtresa sundimtare shtypte pa mëshirë shtresën skllëvërve. Grabitja e diçkajes ishte një fenomen tjetër real në atë shoqëri, ashtu siç ishte përdorimi i dhunës, ku shpeshherë i forti shtypte të dobët me anë të forcës dhe dhunës. Andaj, i Dërguari i Allahut, jo vetëm që ishte kundër këtyre dukurive, por vendosi edhe t'i luftojë deri në eliminimin e tyre, dhe kjo vërehet qartë kur kundërshtimin e këtyre dukurive negative ia bëri detyrë çdo myslimani, që jo vetëm të distancohet prej tyre, por t'i kundërshtojë haptas, e me këtë arriti edhe të eliminonte ato. Me këtë gjest human, bashkoi njerëzit pranë njëri-tjetrit dhe luftoi përçarjet dhe trazirat e brendshme që do ta trazonin shoqërinë e re. Andaj, me vigjilencën e tij, urdhëroi bashkimin e komunitetit, distancimin nga e keqja, si dhe dënimin e një personi që kryen ndonjë prej atyre dukurive negative. Madje, kolektivi duhej mbetur i bashkuar në dënimin e një personi të tillë edhe nëse ai është djali i ndonjërit prej tyre.

Kjo ishte drejtësia kulmore për një shoqëri të shëndoshë, të ndërtuar mbi baza vëllazërore dhe të bashkuar për t'i luftuar dukuritë e këqija, madje të vendosur për t'i ndëshkuar autorët e krimit edhe po qe se autorët e tillë janë nga familjet e tyre, dhe ky akt vërtet është kulmi i drejtësisë.

Magna Carta, përveç aspektit të ndalimit të konfliktit dhe rikthimit të çështjeve kontestuese në gjykata, flet edhe për çështjet familjare dhe trashëgimore, ku kësaj pike i jepet një rëndësi e veçantë. Flet për të drejta dhe obligime, në rast se njëri bashkëshort vdes, se kujt i takon pasuria dhe si ndahet trashëgimia. Ajo flet për financa, mall, pasuri, borxh dhe të ngjashme me këto që ndërlidhen me të drejtat civile, ku jepen sqarime të nevojshme se çfarë duhet të veprojë ai që ka borxhe ndaj komuniteteve tjera. Tematikave të tilla që kanë të bëjnë me aspektin civil u kushtohen disa nene, që flasin për detyra, obligime, të drejta dhe sqarojnë dispozitat përkatëse.

Magna Carta rol të rëndësishëm i kushtonte edhe kishës angleze, ku thirret që ajo të jetë e lirë dhe të mos imponohet nga rrethanat ekzistuese në vend. Ajo duhet ta ketë rolin e vet, pa marrë parasysht ndasitë në shoqëri. Përmes kësaj marrëveshjeje, fuqizohet edhe më tutje roli i kishës.

Një tjetër pikë shumë e rëndësishme zë vend në Magna Carta, e që ka të bëjë me privimet dhe dëbimet nga vendi, pa aktgjykime të drejta dhe të ligjshme, e këto në shumicën e rasteve kishin të bënin me vellsianët dhe komunitetet tjera, që ishin dëbuar nga pararendësi i Gjonit, Henri apo edhe nga Riçardi. Në raste të tilla kërkohej që me marrëveshje të krijoheshin gjykime të drejta dhe secilit t'i jepej e drejta. Po ashtu, një pikë e veçantë kishte të bënte edhe pengjet e Vellsit dhe me kthimin e motrave dhe pengjeve të Aleksandrit, mbretit të Skocisë, para një trupi gjykues të drejtë e të paanshëm. Përmes këtyre akteve kërkohej që të vihej drejtësia në vend dhe kundërshtarët e mbretit (pengjet dhe të burgosurit) të liroheshin, nëse për këtë trup gjykues e sheh si të drejtë.

Me këtë synohej që toleranca mes komuniteteve të jetë më e fuqishme dhe se mbreti duhet të reflektojë më pozitivisht karshi komuniteteve dhe kundërshtarëve të tij, sidomos rastet e gjykatës, ku kundërshtarët e mbretit dënoheshin edhe në rastet kur mungonin dëshmitë dhe faktet. Mjaftonte për dëshmi të ishte kundërshtar i mbretit.

Nëse i referohemi kësaj pike, pra tolerancës, në Kartën e Medinës, i Dërguari i Allahut që nga momenti i parë kur shkoi në Medinë syno-

nte bashkëjetesë me të gjitha komunitetet. Prandaj, edhe në formulimin që i bëri Kartës së Medinës, synonte raporte të mira mes myslimanëve dhe komuniteteve të tjera, me theks të veçantë me çifutët e Medinës, të cilët ishin të ndarë në fise të ndryshme pas emigrimit të tyre nga presioni i romakëve. Ata kishin zënë vend në Medine, Hajber dhe Tejma, duke ndërtuar vendbanime, fshatra dhe kështjella. Kështu depërton feja hebraike në Arabi. Çifutët bëhen edhe faktor politik, për të cilët flitej para ardhjes së Islamit, e sidomos gjatë shekullit të parë të islamit. Fiset çifute kishin kontribuar shumë në përçarjen e arabëve, sidomos në përçarjen dhe luftërat e fiseve të njohura të Medinës, Ews dhe Hazrexh. Këtyre dy fiseve, çifutët u shitnin armë dhe ndiznin zjarrin e betejës, me qëllim që ata të mbeteshin përherë të përçarë dhe të dobët, e krahas kësaj, çifutët forcoheshin dita-ditës.

I Dërguari i Allahut, çifutët nuk i anashkaloi, por i bëri palë të kësaj marrëveshjeje. U dha liri të plotë në ushtrimin e fesë së tyre, dhe ky diversitet fetar ishte i ri në shoqëritë e atëhershme, për faktin se deri atëherë ai që sundonte një vend, detyronte të gjitha komunitetet t'i bashkohen atij besimi, madje edhe me anë të forcës dhe presionit. Mirëpo, i Dërguari i Allahut si mëshirë për mbarë njerëzimin, trajtoi njësoj të gjitha komunitetet, duke i bërë para ligjit të barabartë. Përveç çështjeve fetare, myslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen që i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej tyre kryen shkelje brutale, ose thyen betimin, ose është fajtor për ndonjë krim, meriton të ndëshkohet për krimin e tij. Myslimanët dalloheshin nga çifutët në besimin e tyre, në të kundërtën konsideroheshin një grup i vetëm.

Me këtë rast gjenial, i Dërguari i Allahut në vend të përçarjeve të brendshme, forcoi unitetin e të gjitha komuniteteve. Kjo liri e plotë ndaj çifutëve i bëri ata të mos jenë armiq me myslimanët, së paku hapazi, ngase fshehurazi armiqësinë ndaj myslimanëve nuk e fshihnin kurrë, ngase armiqësia e çifutëve ndaj myslimanëve u vërtetua në shumë raste.

Përderisa Karta e Medinës pati jehonë të madhe dhe ajo u mirëprit mirë dhe ishte një kapitull suksesi, Magna Carta Libertatum ishte një

dështim, sepse ajo që kundërshtuar nga shumica e baronëve dhe ishte e vlefshme për jo më tepër se tre muaj.

Përfundim

Kjo ishte një pasqyrë e shkurtër rreth Kartës së Medinës dhe Magna Carta Libertatum, gjegjësisht një trajtesë krahasimtare, në të cilën janë shpjeguar gjërat kryesore, duke filluar nga rrethanat ekzistuese në shoqëri, ato që i kanë paraprirë formulimit të këtyre marrëveshjeve, e duke vazhduar në kontekstin historik të marrëveshjeve, themeluesit e tyre dhe përmbajta e marrëveshjeve.

Është e nevojshme të flitet për marrëveshje të tilla dhe të shkruhet më tepër rreth tyre, sepse ka pak shkrime që trajtojnë tematika të tilla. Çështja e marrëveshjeve, traktateve dhe kartave për të drejtat e njeriut, nuk iu kushtohet rëndësi e posaçme. Nevojitet të flitet më tepër për to, në mënyrë që njerëzimi ta kuptojë më mirë paqen dhe komunitetet e ndryshme të jetojnë mes vete në tolerancë dhe paqe.

Mr. Ejup Haziri

THE MEDINA CHARTER AND MAGNA CARTA LIBERTATUM (COMPARATIVE REVIEW)

(Summary)

Introduction

In this paper we will compare the Medina Charter and Magna Carta Libertatum, the historic circumstances in which both these documents were born in order to better understand the time when this occurred as well as the purpose of such agreements. Afterwards, we will make a brief presentation of those, who formulated these agreements. Initially, we need to clarify that our intention is not to compare the authors as it is a well-known fact that no one can be compared to the Messenger of Allah, who is beyond any comparison.

أيوب حازيري

وسيقة المدينة و ماجنا كارتا (دراسة مقارنة)

(خلاصة البحث)

هذه دراسة مقارنة بين وسيقة المدينة و بين ماجنا الكارتا حيث ستم مناقشة الظروف التاريخية للاتفاقيتين و نفهم جيدا الاسباب التي ادت الى ابرام الاتفاقيتين. ثم بعد ذلك سوف نعطي نبذة مختصرة عن مؤسسي الاتفاقيتين مع ذلك يمكن التوضيح هنا بانه ليس الغرض اجراء مقارنة بين شخصيتين لانه من المعروف سلفا بانه لا يمكن مقارنة احد بالرسول صلى الله عليه و سلم.

specialistët e hadithit) ose si jashtëzakonisht të dobëta dhe me dobësi të vogla. Ky fakt e bën këtë çështje pakëz më të ndërlikuar në raport me çështjet tjera. Megjithatë, është për të shpresuar se në fund të këtij kapitulli suneti dhe metoda më e mirë e pozicionit të duarve në namaz do të bëhet e qartë.

Dallimi i parë në mendime

Dallimi i parë në mendime është lidhur me çështjen nëse duart duhen mbajtur apo jo të lidhura për trupi gjatë namazit (d.m.th. të lëshuara poshtë trupit). Mendimi më i përhapur i Imam Malikut, siç tregohet nga Ibn El-Kasimi, është se duart duhet lënë të lëshohen në dy anët e trupit. Sipas një mendimi tjetër të tij, të përcjellë nga Ibn ‘ul-Mundhiri, është se duart duhen ngjitur dhe të lëshohen për trupi.

Imam Ebu Hanifja, Imam Shafiu dhe Imam Ahmedi, sikur edhe shumica e dijetarëve, janë të mendimit se duart duhen lidhur së bashku dhe jo të lëshohen në dy anët e trupit. Dijetari i madh maliki, Ibn Abdul-Berr, lidhur me këtë çështje pohon: "Nuk ekziston kurrfarë përcjelljeje prej Pejgamberit s.a.v.s., e cila është në kundërshtim me mendimin e shumicës së dijetarëve dhe ky është mendimi unanim i të gjithë sahabëve dhe tabiinëve". (Evxhaz ‘ul-mesalik, 2, 116).

Dallimi i dytë në mendime

Ndër dijetarët të cilët mendonin se duart duhen lidhur në namaz, ekziston një dallim në mendim rreth faktit se ku saktësisht duhen vendosur duart, pasi ato të jenë lidhur së bashku. Imam Ebu Hanifja dhe Ebu Is’hak El-Marvazi (nga shkolla shafi’ite) pohojnë se duart duhen pozicionuar poshtë kërthizës. Mendimi i Imam Shafiu, sipas librave El-Vasit dhe Kitab’ul-Um, është se duart duhen pozicionuar poshtë kraharrorit. Ky është mendimi i tij më i përhapur. Mendimi i dytë i tij, siç përmendet te vepra El-Havi, është se duart duhen vendosur drejt-përsëdrejti në kraharror.

Nga Imam Ahmedi kemi tre mendime, nga të cilët i pari është i ngjashëm me atë të Ebu Hanifes. Ibn Hubejra ka thënë se ky është

FIKH

Myfti Abdurrahman ibn Jusuf

VENDOSJA E DUARVE NË NAMAZ

Duke hyrë në xhami, njeriu vëren se falësit e namazit qëndrojnë me duar të lidhura në forma të ndryshme. Disa nga ata qëndrojnë në namaz me duar të lidhura nën kërthizë, disa me duar të gërshetuara në kraharror dhe disa të tjerë me duar të vendosura poshtë kraharrorit. Gjithashtu vëren edhe disa individë, të cilët falen me duar të lëshuara poshtë në të dy anët e trupit.

Pas shikimit të një skene të tillë, pyetja që imponohet menjëherë në kokën e vështuesit është: Cili është pozicioni i saktë i duarve gjatë namazit"? Ose: Ku i vendoste Pejgamberi s.a.v.s. duart gjatë namazit?

Diskutimi në vijim do të përqipet t’u përgjigjet këtyre pyetjeve dhe të përcaktojë sunetin dhe metodën më të preferuar të pozicionit të duarve gjatë qëndrimit në këmbë në namaz.

Çështja e parë e cila këtu duhet sqaruar është se të gjitha pozicionet e përmendura në hadithet pejgamberike janë të lejuara dhe se dallimi i mendimeve është vetëm në çështjen se cili prej pozicioneve të lartpërmendura është më e drejtë.

Çështja e dytë është lidhur me faktin se ka shumë pak hadithe të sakta (sahih) lidhur me këtë çështje dhe se shumica e përcjelljeve të cilat shpjegojnë pozicionet e duarve në namaz janë klasifikuar (nga

mendimi i tij më i përhapur. Mendimi i dytë i Imam Ahmedit është i ngjashëm me atë të Shafiut, ndërsa mendimi i tij i tretë është se falësi është i lirë të vendosë duart e tij poshtë kërthizës ose në kraharor, meqenëse të dyja këto metoda janë nxjerrë nga suneti pejgamberik.

Hadithet lidhur me këtë çështje

Dijetarët pohojnë se nuk ka asnjë hadith të saktë që të vërtetojë mendimin e Imam Malikut për lëshimin e duarve, gjatë namazit, në dy anët e duarve. Disa kanë përmendur se arsyeja për një veprim të tillë është frika e thellë, droja dhe nderimi për Allahun e Lartësuar, se pasi një person qëndron përpara Tij, ai harron t'i lidhë duart e tij së bashku dhe ato lihen të varen në dy anët e trupit. Cilado qoftë arsyeja, ekzistojnë transmetime nga disa sahabë, të cilët janë falur me duart e varura në dy anët e trupit, (Shih Musannaf Ibn Ebi Shejba 2:391).

Nga ana tjetër, ekzistojnë raportime të shumta që vërtetojnë se profeti (a.s.) i vendoste duart në trupin e tij, ndërsa qëndronte në këmbë gjatë lutjes dhe nuk i lëshonte ato në dy të anët e trupit. Këto raportime, gjithsesi, ndryshojnë shumë rreth faktit se ku saktësisht i vendoste ai duart në trupin e tij. Një transmetim shumë i njohur lidhur me këtë çështje është ai i Vail ibn Huxhr-it (r.a.) i cili gjendet në shumë koleksione hadithesh. Sidoqoftë, dijetarët e kanë etiketuar këtë transmetim si problematik (mudtarib) dhe kontradiktor. Në një version të këtij raportimi, që gjendet në Sahihun e Ibn Huzejmes, Vail Ibn Huxhr-i ka thënë:

"Kam falur namazin me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe ai vendosi dorën e tij të djathtë mbi të majtën në kraharor".

Versioni që gjendet te Musnedi 'ul-Bazzari thotë "afër kraharorit të tij" në vend të "në kraharorin e tij", ndërsa versionin e Musanaff ibn Ebi Shejbes thotë "nën kërthizë".

"E kam parë Pejgamberin s.a.v.s. se si në namaz e vendos dorën e djathtë mbi dorën e majtë nën kërthizë."

Dy versionet e para mbështesin mendimin e atyre të cilët pohojnë se është më e preferuar që të vendosësh duart në kraharor ose diç më

poshtë, ndërsa version i tretë mbështet mendimin e medhhebit hanefi. Sidoqoftë, duhet pasur parasysh se të tre këto versione përmbajnë njëfarë elementi dobësie. Secili prej tyre do të analizohet në paragrafët në vijim, së bashku me përcjelljet tjera, për të përcaktuar statusin e tyre dhe shkaqet për dobësinë e tyre.

Versioni i parë

1. Versioni i Vail Ibn Huxhriut r.a., i cili transmetohet nga Ibn Huzejme në Sahihun e tij dhe që përmban fjalët "në kraharorin e vet", është sigurisht përcjellja më e dobët nga të gjitha versionet. Arsyet për këtë janë të shumta:

a.) Mu'emmel ibn Ismail është një prej përcjellësve të këtij versioni. Ai është quajtur një përcjellës i dobët qysh nga koha kur gabonte në përcjelljet e tij pasi iu dogjën librat dhe ai u detyrua të përcillte nga mbamendja.

Imam Buhariu pohon: "Përcjelljet e tij janë të refuzuara" (munker el-hadith).

Al-lame Dhehebiu pohon: "Ai bënte shumë gabime"(kethir'ul-hata').

Ebu Zur'a pohon: "Përcjelljet e tij përmbajnë shumë gabime" (Fet'h'ul-Mulhim 2:40).

b.) Kjo përcjellje, ndonëse gjendet në shumë libra të tjerë përmes zinxhirëve të ndryshëm të përcjelljeve, në asnjë prej tyre nuk përmban fjalët "në kraharor". Versione të tij gjenden në Sunenin e Ebu Davudit, Nesaiut, Ibn Maxhes dhe në Musnedin e Ebu Davud Et-Taxhalisit. Asnjë prej tyre, në asnjë mënyrë, nuk e përmban shtesën "në kraharor". Al-lama Nimavi pohon se kjo shtesë gjendet vetëm në versionin e Mu'emmel ibn Ismailit (të përcjellë nga Ibn Huzejme). Së këndejmi, ky version është i dobët dhe jo i saktë.

c.) Një tjetër pikë është fakti se Mu'emmel ibn Ismaili e rrëfen këtë hadith nga Sufjan Eth-Thevriu. Hafiz Ibn Haxher Askalani pothon se lidhja midis Mu'emmel ibn Ismailit dhe Sufjan Eth-Thevriut

është e dobët (Fet'h'ul-Bari, 206). Kjo është një tjetër dobësi e këtij versioni.

ç.) Vetë Sufjan Eth-Thevriu ka qenë i mendimit se duart (në namaz) duheshin pozicionuar poshtë kërthizës. Së këndejmi, kur është konstatuar se përcjellja e tij bie në kundërshtim me veprimin e tij personal, kjo përcjellje nuk do të pranohet sipas parimeve të shkencës së hadithit (usul'ul-hadith).

d.) Disa kanë pohuar se të gjitha përcjelljet nga Sahihu i Ibn Huzejmes janë të vërteta. Por, kjo nuk është e vërtetë. Imam Sujutiu në librin e tij "Tedrib'ul-Rawi" pohon se Sahihu i Ibn Huzejmes përmban disa përcjellje të dobëta dhe të refuzuara (munker). Mbi të gjitha, Ibn Huzejme, njësoj si Imam Tirmidhiu, zakonisht bënte komente pas çdo përcjelljeje, duke konstatuar nivelin e tij të saktësisë. Megjithatë, lidhur me versionin e Vail Ibn Huxhriut, ai nuk ka bërë asnjë koment rreth saktësisë së tij. Prandaj, kjo përcjellje nuk mund të etiketohet si e saktë vetëm për faktin se gjendet te Sahihu i Ibn Huzejmes. Është e qartë se, nëse ky hadith do të kishte qenë strikt i saktë, atëherë Ibn Huzejmja do ta kishte shënuar atë si të tillë.

dh.) Disa madje kanë thënë se edhe nëse ky hadith pranohet si i saktë, vendosja e duarve në kraharor sigurisht do të duhej konsideruar si një praktikë e izoluar (shadh) - diçka të cilën Pejgamberi s.a.v.s. e ka bërë disa herë thjesht për të informuar sahabët e tij për lejueshmërinë e saj (bejan li'l-xhevaz). Nisur nga kjo përcjellje nuk mundet në asnjë mënyrë të provohet se vendosja e duarve në kraharor gjatë namazit ka qenë një praktikë e përhershme e Pejgamberit s.a.v.s.

Versioni i dytë

2. Versioni i dytë i përcjelljes së Vail Ibn Huxhriut, që gjendet në veprën Musned'ul-Bazzar, i cili përmban fjalët "afër kraharorit", është i dobët. Një prej përcjellësve të tij është Muhamed Ibn Huxhriu rreth të cilit Imam Buhariu ka pohuar: "Çështja e tij është e paqartë (në përcjelljen e hadithit)", ndërsa Imam Dhehebiu ka thënë: "Disa prej përcjelljeve të tij janë të refuzuara". (Mexhma'ul-Zavaid, 2, 135). Së

këndeimi, edhe ky version është i dobët dhe për rrjedhojë duhet hedhur poshtë.

Transmetime të tjera

3. Një përcjellje tjetër, e cila përmend vendosjen e duarve në kraharor, është edhe përcjellja e Hulbit, që përcillet nga Imam Ahmed:

"E kam parë të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. se si është kthyer nga ana e djathta në të majtë dhe e kam parë se si e ka vendosur këtë dorë në kraharorin e tij", (Musned Ahmed)

Al-lame Nimavi ka provuar me fakte të qarta se në mënyrën e përcjelljes së këtij hadithi ka një gabim. Në vend të fjalëve ala hadhihi (mbi dorën tjetër) përkthyesi ka shkruar gabimisht ala sadrihi (në kraharorin e tij). (Athar'us-sunan, 87). Po ashtu, as kjo përcjellje nuk mund të merret si argument.

4. Edhe një tjetër përcjellje, e ngjashme me atë të lartpërmendur, e gjetur në veprën Sunenu El-Bejhekij, thotë:

"Aliu r.a. për të shpjeguar kuptimin e ajetit kur'anor: "... andaj falu për hir të Zotit tënd dhe prej kurban!" (El-Kevther, 2), e vendosi dorën e tij të djathtë mbi mesin e dorës së tij të majtë dhe i vendosi ato në kraharor, si për të thënë se kuptimi (tefsir) i këtij ajeti që duart në namaz vendosen në këtë mënyrë", (Sunen'ul-Bejheki, 2, 30).

Megjithatë, Imam Ibn El-Turkumani El-Mardini, në veprën e tij El-Xhevher'ul-Naki, pohon se si edhe zinxhiri i transmetimit (isnad) ashtu edhe teksti (metn) i kësaj përcjelljeje janë të papajtueshme. Imam Bejhekiu ka përmendur një përcjellje të ngjashme nga Ibn Abbasi r.a., në të cilën gjendet edhe përcjellësi Revh ibn El-Musejjibi. Për të Ibn Hibbani ka thënë:

"Ai përcjell hadithe të trilluara. Nuk lejohet përcjellja prej tij".

Al-lame Sa'ati shkruan:

"Nuk është e saktë t'ia përkthueshëm këtë shpjegim (tefsir) Aliut r.a. apo Ibn Abasit r.a.. Kuptimi i saktë i ajetit është, ashtu siç pohon edhe Ibn Kethiri, se ai lidhet me kurbanin", (Fet'h'ur-Rabbani, 3, 174).

Nga të katër përcjelljet të cilat deri tash i analizuam, për secilën prej tyre është vërtetuar që ka mangësi të ndryshme. Ka edhe transmetime të tjera, të ngjashme ato që kemi përmendur, në të cilat pohohet se Pejgamberi s.a.v.s. nuk i ka vendosur duart e tij (gjatë namazit) poshtë kërthizës. Shpjegimi hanefi lidhur me këto përcjellje është se Pejgamberi s.a.v.s. herë pas herë i vendoste duart e tij në kraharor ose pak më poshtë. Këtë ai e bënte vetëm për të dëshmuar lejueshmërinë e një veprimi të tillë (bejan li'l-xhevaz), ndërsa praktika e zakonshme e Pejgamberit s.a.v.s. ishte ajo e vendosjes së duarve poshtë kërthizës. Përcjelljet në vijim do ta provojnë këtë pohim të fundit në mënyrë më të qartë.

Provat e dijetarëve hanefijë

1. Vail Ibn Huxhri r.a. përcjell: "E kam parë të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. duke vendosur dorën e tij të djathtë mbi të majtën poshtë kërthizës gjatë namazit". (Musannaf Ibn Ebi Shejbe, Athar 'us-Sunen 90).

Ky është versioni i tretë i përcjelljes së Vail Ibn Huxhriut, të cilën e përmendëm në fillim të kapitullit tonë, që përmban fjalët "poshtë kërthizës". Disa dijetarë hanefi kanë pohuar se ky version nuk mund të përdoret si provë përfundimtare për opinionin e mbështetur nga medhhebi hanefi, për arsye se fjalët "poshtë kërthizës" gjenden vetëm në disa botime të Musanafit të Ibn Ebi Shejbes dhe jo në të gjitha botimet. Duhet marrë parasysh edhe fakti që, siç e kemi përmendur edhe më parë, kjo përcjellje ka një tekst jo të harmonizuar.

Gjithsesi, është cekur në Fet'h'ul-Mulhim Imam Kasim Ibn Kutlubgahu e ka vlerësuar këtë version si të saktë. Imam Muhamed Ebu'l-Tajib El-Madani në komentimin e tij të Sunenit të Tirmidhiut shkroi se kjo përcjellje ka një zinxhir të fortë përcjellësish, ndërsa Shejh Abid Sindhi pohon: "Përcjellësit e këtij transmetimi janë të besueshëm". Gjithashtu, një numër dijetarësh kanë vërtetuar se shtesa "poshtë kërthizës" gjendet në shumë dorëshkrime të Musanafit të Ibn Ebi

Shejbes, ndonëse jo në të gjitha variantet e publikuara së fundi. (shih: Athar 'ul-Sunen, 148).

Prandaj, përkundër natyrës problematike të përcjelljeve të Vail Ibn Huxhriut, ky version nuk mund të konsiderohet plotësisht i papranueshëm, duke qenë se ka edhe përcjellje të tjera të besueshme që e fuqizojnë këtë version.

2. Aliu r.a. pohon:

"Të vendosësh njëren pëllëmbë të dorës mbi tjetrën poshtë kërthizës është një sunet në namaz". (Sunenu El-Bejheki, 312, Musanaf Ibn Ebi Shejbe, 1, 391).

Është një fakt i mirënjohur se sa herë që një sahab shqipton fjalët "është prej sunetit", lidhur me ndonjë veprim, kjo do të thotë se veprimi në fjalë është marrë nga vetë Pejgamberi s.a.v.s.. Kështu që Aliu r.a. ka mundur këtë veprim ta shënojë si sunet pasi ta ketë parë Pejgamberin s.a.v.s. duke vepruar në këtë mënyrë.

Problemi me këtë përcjellje është se në zinxhirin e përcjellësve gjendet Abdurrahman ibn Is'haku, i cili është klasifikuar si përcjellës i dobët. Hanefijtë nuk janë mbështetur plotësisht mbi këtë përcjellje si bazë për mendimin e tyre, por duke qenë se ka shumë përcjellje që e përforcojnë atë, atëherë ai mund të konsiderohet si një provë plotësuese.

3. Haxhaxh ibn El-Hasani përcjell: Ose e kam dëgjuar nga Ebu Mixhlezi, duke e thënë ose e kam pyetur vetë: "Si t'i vendos dikush duart e tij (gjatë namazit)"? Ai u përgjigj: "Vendose pjesën e brendshme të dorës së djathtë mbi shpinën e dorës së majtë nën kërthizë." (Musannaf Ibn Ebi Shejbe, 1, 390).

Përcjellja e këtij hadithi është e mirë (hasen), siç thotë Imam Ibn El-Turkumani El-Mardini në veprën e tij El-Xheuher el-Naki.

4. Ibrahim En-Nahaiu përcjell: "falësi i namazit do të duhej ta vendosë poshtë kërthizës dorën e tij të djathtë mbi atë të majtën". (Musanaf Ibn Ebi Shejbe, 1, 390). Edhe përcjellja e këtij hadithi është, gjithashtu, e mirë (hasen).

5. Ebu Hurejre r.a. përcjell: "Vendosja e njërës dorë mbi tjetrën në namaz do të duhej të jetë nën kërthizë, (El-Xhevher ul-Naki, 2, 31).

6. Enesi r.a. përcjell se ekzistojnë tre aspekte karakteristike të pejgamberisë (nubuvveh): të çelësh iftarin herët, të shtysh syfyryn deri në dalje të kohës dhe ta vendosësh dorën e djathtë mbi atë të majtën nën kërthizë gjatë namazit". (El-Xhevher 'ul-Naki 2:31U).

Provat tjera të mendimit hanefi

Dijetarët kanë gjetur arsye të shumta të ndryshme përse është më e preferuar që duart të vendosen poshtë kërthizës (gjatë namazit) dhe përse kjo metodë është klasifikuar si më e preferuara.

1. Ndonëse shumica e haditheve rreth kësaj çështjeje janë të dobëta, në një apo në një mënyrë tjetër, përcjelljet e paraqitura nga hane-fijtë janë vlerësuar si më të mira nga pjesa tjetër.

2. Juristi i madh hanefi Ibn'ul-Humam pohon:

"Për shkak të papajtuësshmërive dhe kundërthënieve midis përcjelljeve të ndryshme, më e mira është që t'i drejtohem analogjisë dhe gjykimit racional. Qëndrimi përballë Zotit kërkon një qëndrim i cili shpreh respekt dhe përkushtim. Duke qenë se vendosja e duarve poshtë kërthizës është ndoshta mënyra më e respektuar e qëndrimit (në këmbë gjatë namazit), ajo duhet konsideruar si më superiore. Nga ana tjetër, arsyeja përse gratë udhëzohen t'i vendosin duart e tyre në kraharor, është për shkak se përmes kësaj mënyre mund të arrihet një modesti më e madhe", (Fet'h'ul-Kadir).

3. Al-lame Badr'ud-din Ajniu, autori i komentit të mrekullueshëm mbi Sahih'ul-Buharij, të quajtur Umdet'ul-Kari, shkruan:

"Vendosja e duarve poshtë kërthizës është virtyt i madh. Është një qëndrim i cili tregon respekt të madh. Paraqet një dallim të madh me qëndrimet e jobesimtarëve".

Ai, gjithashtu, shkruan: "Ky është i njëjti qëndrim që individi mban përballë sundimtarëve (të kësaj bote)".

Më pas ai shkruan: "Vendosja e duarve në kraharor krijon një ngjashmëri me gratë, së këndejmi, kjo nuk mund të konsiderohet si një sunet për burrat". (Umdat'ul-Kari, 3, 16).

Përmbyllje

Mund të përfundohet se hadithet të paraqitura nga shkollat e ndryshme të mendimit përmbajnë njëfarë dobësie ose diç tjetër, derisa hadithet e paraqitura nga shkolla hanefite kanë hasur në rezistencë më të vogël dhe kanë përcjellje më të fuqishme, të cilat i plotësojnë ato më të dobëtat. Prandaj, hadithet e paraqitura si provë për vendosjen e duarve në kraharor ose poshtë tij nuk mund të merren si tregues të praktikës normale të të Dërguarit të Allahut xh. sh.. Hanefitët, megjithatë, pajtohen se Pejgamberi s.a.v.s. i ka vendosur duart e tij në kraharor ose poshtë tij për të shprehur lejueshmërinë e një pozicionimi të tillë (bejan li'l-xhevaz).

Vendosja e duarve poshtë kërthizës shfaq respekt dhe përunjtësi më të madhe dhe mu ashtu siç shumë pozita të faljes për meshkujt ndryshojnë nga ato të femrave, ashtu edhe pozita e duarve në namaz ndryshon nga mashkulli kundrejt femrave. (Burimi për përkthim: Abdur Rahman ibn Yusuf, Fiqh al-Imam - Key Proofs in hanani Fiqh, California, USA, fq. 55-63 ose: Kljucni dorazi hanefijskog fikha, Sarajevë, 2014, fq. 73-83).

Përktheu:
Nexhat Ibrahimi

Maulana Abdur-Rahman Ibn Yusuf

THE POSITION OF HANDS IN NAMAZ

(Summary)

Upon entering a *Masjid*, a person sees a multitude of different people. Some of them he sees standing in prayer with their hands clasped together on the chest. Others he sees with their hands beneath the navel. Then as he proceeds further he observes one with his hands held together just beneath the chest. Following that he catches sight of a person who seems to be merely standing there. However, when he takes a closer look, he finds that this person too is engrossed in prayer, but he has not brought his hands together. Instead he has left them at his sides.

It is from situations such as these, where the questions arise, 'Where exactly did Rasoolullah (Sallaho Alaihe Wassallam) place his hands whilst standing in prayer?'

المفتي عبدالرحمن بن يوسف

وضع اليدين في الصلاة

(خلاصة البحث)

عندما يدخل الانسان في الجامع يرى المصلين و هم يصلون بأيدي مرتبطة بأشكال مختلفة فبعضهم يصلون و أيديهم مرتبطة تحت المسرة و بعضهم يصلون بأيدي مضمورة على الكتف و آخرون بأيدي تحت الكتف . و قد ترى آخرين و هم يصلون بأبد ممدودة على الجانبين.

بعد نظر الى مشهد من هذا القبيل فان السؤل الذي يطرح نفسه على رس الملاحظ هو: ما هو الوضع الصحيح لليدين اثناء الصلاة؟ او أين كان يضع الرسول صلى الله عليه و سلم يديه اثناء الصلاة ؟

ISLAMI DHE DITURIA

Mr.sc. Artan Mehmeti

TË KËRKUARIT E DITURISË SIPAS ISLAMIT

Hyrje

Feja Islame, e cila u shpall para 1400 vjetëve përmes pejgamberit Muhammed a.s., i nxit besimtarët në kërkim të diturisë, si dhe e urren paditurinë dhe injorancën.

Zoti xh.sh. përmes Kur'anit iu bën thirrje besimtarëve në kërkimin e diturisë, e atë jo vetëm një herë por më dhjetëra herë, ku në disa raste në formë këshille, nxitje, apo edhe në formën urdhërore. Gjithashtu Zoti xh.sh. e ngre lart pozitën e dijetarit, bile në pozitë edhe më të lartë se të atij myslimani që lufton në rrugën e Tij. Edhe Muhammedi a.s. iu bën thirrje myslimaneve që t'i përkushtohen kërkimit të diturisë. Këtë e vërtetojnë me dhjetëra hadithe, ku i Dërguari a.s. herë i nxit, herë i urdhëron, dhe herë i këshillon, në kërkimin e diturisë, mjafton ta cekim hadithin e të Dërguarit a.s. ku thotë: *“Kërkoni diturinë nga djepi deri në varr”*.

Siç do të shohim edhe më poshtë, Zoti xh.sh. në Kur'an, si dhe Muhammedi a.s. në hadithet e tij, iu kanë treguar myslimaneve për vlerën e diturisë që ka për besimtarin në veçanti dhe besimtarët në përgjithësi.

Të nxitur nga Kur'ani, si dhe hadithet, shumë myslimanë iu përkushtuan arritjes së diturisë, do të thotë, filluan të merren me shkencë. Këta nuk studiuan vetëm shkencën islame, por edhe shkencat natyrore si dhe ato humane-shoqërore. Rezultatet e tyre nuk munguan, arritjet e tyre shkencore kontribuan në zhvillimin e shkencës moderne. Sot, janë të njohur me qindra myslimanë që ndihmuan zhvillimin e shkencës. Me zbulimet e këtyre myslimaneve janë vënë edhe themelet e disa shkencave, siç është ajo e algjebërës.

Në këtë punim jemi mundur që ta trajtojmë rolin dhe nxitjen e diturisë, si dhe marrjen me hulumtime shkencore, sipas fesë islame.

Vlera e diturisë në Islam

Islami i kushton rëndësi të veçantë diturisë, meqë është bazë e përparimit të njerëzve në këtë botë dhe në botën tjetër. Vetë fakti se fjala e parë e shpallur ishte *“lexo”*, tregon për vlerën dhe nivelin në të cilin e ngre Islami diturinë. Në Kur'an fjala dituri përmendet në 660 vende. Vlera e diturisë peshohet me vlerën e adhurimeve që bëjmë ndaj Allahut të Madhërishëm. Nuk ka asnjë adhurim në Islam i cili nuk realizohet pa dituri dhe të gjitha adhurimet që bëhen pa dituri, në fakt janë të destinuara që të shkatërrojnë jetën tonë, dhe në këtë mënyrë të cenojnë integritetin e zemrës sonë.¹

Pejgamberit që s'dinte shkrim-lexim i zbret shpallja e parë në shpellën Hira, gjë që është lidhje e tokës me qiellin dhe natyrisht në rend të parë edhe lidhje e qiellit me tokën, pas një periudhe që zgjati dhe qëndroi gjashtë shekuj (Ajo është periudha ndërmjet Pejgamberisë së Isait a.s. dhe Muhammedit a.s.). Shpallja nuk fillon me urdhrin e adhurimit, njohjen e Allahut të Madhërishëm dhe nënshtrimin atij, apo thirrjen në Allahu xh.sh., të cilat janë prej gjërave pozitive; apo braktisjen e idhujve dhe putave, vajtimin e xhahilijetit, dokeve dhe za-

¹ <http://www.islamjakova.net/artikulli.php?id=1546>, (Mr. Lutfi Nexhipi) 15.09.2014

koneve të tij, të cilat janë prej gjërave negative, gjë që plotësisht do të ishte me vend, por shpallja fillon me fjalën **“Lexo”**.²

Njeriu nëpërmjet arsimit dhe shkencës e kupton qëllimin e krijimit të tij dhe e njeh vetveten, e kupton gjithësinë dhe e njeh Krijuesin e tij. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse Muhamedit a.s. ajetet e para i kanë zbritur për hulumtim, studim dhe shkencë, e jo në adhurim.³

“Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte”. (Alek 1)

Kjo është jehona e parë e cila e lartëson vlerën e lapsit, e çmon vlerën e diturisë dhe i shpall luftë analfabetizmit neglizhent. Allahu i Madhërishëm i lartësoi aq tepër gradat e dijetarëve, saqë i bashkëngjiti me Veten e Tij dhe melekët në dëshmimin e Njeshmërisë së Tij dhe konfirmimin e drejtësisë së Tij.⁴

“Allahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtë-sisë. Nuk ka zot, përveç Tij, Fuqplotit e të Urtit”. (Ali Imran: 18)

Ai i cili analizon ajetet e Kur'anit kupton qartë se Islami e obligon myslimanin të studiojë dhe ia obligon shkencën dhe arsimimin. Në personalitetin e myslimanit shkenca dhe arsimit janë dy pjesë të pandashme. Në islam feja është shkencë dhe dituri, dituria dhe shkenca janë fe, që do të thotë Islami bën bashkimin e shkencës me fenë. Prej qëllimeve kryesore të Islamit është edukimi dhe arsimimi i njeriut, me fjalë tjera kompletimin e njeriut në të gjitha aspektet si në aspektin

² Ebul-Hasen Ali en-NEDEVIJ, ISLAMI - ndikimi i tij në civilizim dhe merita e tij për njerëzimin, Përktheu nga arabishtja Bashkim ALIU, KOMITETI I BASHKUAR SAUDIT - NDIHMË KOSOVËS, Prishtinë 2002, f. 62-63

³ http://www.radioislame.com/index.php?frame_rd=artikulli.php?id=6952 (Dr. Musli Vërbani) 12.09.2014

⁴ Muhammed GAZALI, KARAKTERI I MUSLIMANIT, Përkthyes Bashkim ALIU, KOMITETI I BASHKUAR SAUDIT - NDIHMË KOSOVËS, Prishtinë 2002, f. 261

trupor ashtu edhe në atë shpirtëror, pasi që dihet se njeriu udhëhiqet prej mendjes dhe zemrës e jo prej syrit dhe veshit.⁵

Në Islam shumë ajete kur'anore dhe thënie të Muhamedit a.s., tregojnë për vlerën që Islami i jep diturisë.

Ajetet që flasin për vlerën e diturisë janë të shumta, por ne do t'i përmendim vetëm disa nga ato:

“Po, Allahut i kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët.” (Fatir 28)

“...Thuaj: ‘A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?’ Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.” (Zumer 9)

“A është i njëjtë ai që e di se ajo që t'u shpall ty nga Zoti yt është e vërtetë, si ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndoshë e kuptojnë të vërtetën”. (Rad, 19)

Për sa u përket haditheve të cilat na tregojnë për vlerën e diturisë për myslimanet, ato të jenë të shumta. Pejgamberi a.s. në disa hadithe ka thënë:

“Vlera e diturisë është më e madhe sesa vlera e adhurimit.” (Transmeton Bezzari);

“Dituria e paktë është më e dobishme se adhurimi i shumtë.” (Transmeton Taberaniu);

“Vlera e dijetarit ndaj adhuruesit, është si vlera ime ndaj njeriut më të ulët prej jush.” (Transmeton Tirmidhiu);

“Nëse ngrihesh në mëngjes dhe e mëson një ajet prej librit të Allahut, është më e dobishme për ty sesa të falësh njëqind rekate. Nëse ngrihesh në mëngjes dhe e mëson një çështje shkencore, pa marrë parasysh se a veprohet apo jo me të, është më e dobishme për ty sesa të falësh njëmijë rekate.” (Transmeton Ibën Maxhe).

“Kush i mëson dikujt dituri, ai do të marrë shpërblimin e atij që punon sipas saj duke mos i munguar aspak shpërblimi edhe atij që vepron sipas saj.” (Sehl ibn Muadhi transmeton nga Enesi, i cili transmeton nga babai i tij).

⁵ http://www.radioislame.com/index.php?frame_rd=artikulli.php?id=6952 (Dr. Musli Vërbani) 12.09.2014

Siç shihet edhe më lart, Zoti xh.sh. e ka lavdëruar dijen dhe poseduesit e saj, gjithashtu i ka nxitur robërit e Tij që të mësojnë. Po ashtu edhe në Sunetin e të Dërguarit të Allahut a.s. shohim se gjejmë nxitje në kërkimin e dijes.

Islami obligon në arritjen e diturisë

Mësimi dhe arsimit janë baza dhe jeta e Islamit. Në historinë islame zënë vend qendror, sepse janë shtyllat themelore të kulturës dhe të civilizimit islam. Mësimi dhe arsimimi në Islam janë të përcaktuar me fjalën e Zotit xh.sh në Kur'anin e madhërshëm, me thëniet e Pejgamberit a.s. në hadithet, dhe janë të urdhëruara për të gjithë myslimanët *“prej djepit deri në varr”*.⁶

Natyra e Islamit ia imponon popullatës, e cila e ka përqafuar atë, që të jetë popull i arsimuar, popull ndër të cilët do të jetë e lartë përqindja e intelektualëve dhe do të ulet apo do të zhduket krejtësisht përqindja e analfabetëve.⁷ Nëse njeriu dëshiron të arrijë imanin e rregullt, është i obliguar ta studiojë shkencën.⁸

Feja islame qysh në fillim, të detyron të mësosh me shpalljen e parë: *“Ikre’ bismi Rabbike...”* (Alek 1) *“Lexo, në emër të Zotit tënd...”* (Alek 1). Më këtë dhe shumë ajete tjera Kur’ani udhëzon në udhëtime, hulumtime dhe kundërime të gjithësisë dhe të njeriut në gjithësi, në makro - e mikrokozmos, në mënyrë që të zbulohet harmonia dhe ligjet e kësaj bote të krijuar dhe t’i hapë rrugën mendjes dhe zemrës së njeriut kah Krijuesi. Aty është, sipas fesë islame qëllimi i jetës dhe fatit në këtë botë kalimtare, si parakusht i lumturisë për në botën e amshueshme. Sipas disa mufesireve, feja Islame, është e vetmja nga fetë botërore, e cila insiston në arritje të diturisë, duke përmendur në

Kur’an në më shumë se pesëqind vende “akl”-logjikë, kurse “kalb” zemër në katërqind vende. Ata e arsyetojnë këtë me faktin esencial se shpallja e mëhershme u drejtohet fiseve të caktuara, kurse feja islame si fe e fundit vjen në shekullin e shtatë kur logjika dhe provoja njerëzore kishte përparuar deri në atë masë sa që njerëzit në të ardhmen të mund zbulojnë vetë të vërtetën për Zotin xh.sh. me anë të njohjes së botës dhe përjetimit religjioz, pa shpallje të veçantë dhe pa mrekulli, të cilat më përpara i kanë përcjellë pejgamberet, që më lehtë t’i bindin popujt te të cilit ishin dërguar.⁹

Sa i përket obligueshmërisë së të kërkuarit të diturisë, Pejgamberi a.s. shpreh: *“Kërkimi i diturisë është farëz (obligim) për çdo myslimanin”*. Obligimi i të cekurit në këtë hadith, përfshin të gjithë myslimanët pa dallim, ngase obligimi është kolektiv. Për çdo mysliman apo myslimane është detyrë të zotërojë dituri rreth obligimeve të domosdoshme - primare - që lidhet me jetën besimtare, me moralin dhe dispozitat themelore të jetës. Në aspektin juridik islam, kjo dituri themelore përfshihet në kategorinë e “Farzit ajn”, gjë që do të thotë se kjo dituri është obligim i çdo individi besimtar. Njeriu vlerësohet si gjynahqar, kur nuk e zotëron këtë dituri themelore fetare - morale, apo është zotëruesi i saj por nuk e zbaton atë.¹⁰

Islami në mënyra të ndryshme i motivon kërkuesit e diturisë, njëra prej tyre është thënia e Pejgamberit a.s. ku thotë: *“Kush merr rrugë për kërkim të dijes, Allahu ia lehtëson atij rrugën për në xhenet.”* Nga hadithi kuptojmë se prej punëve më të vërtetshmeve në islam është studimi, orvatja me kërkim të diturisë dhe kjo është njëra prej rrugëve që e shpie njeriun në xhenet.¹¹

Edhe as’habët (shokët) e Pejgamberit a.s., edhe gjeneratat më pas, kanë qenë shumë të përpiktë në kërkimin e diturisë, sepse kërkimi i diturisë është obligim për çdonjërin, sepse Pejgamberi a.s. ka thënë:

⁶ <http://www.radiodituria.com/rendesia-e-kerkimit-te-diturise-dhe-e-arsimit-ne-islam-2/> Muhidin Ahmeti 16.09.2014

⁷ Muhammed GAZALI, KARAKTERI I MUSLIMANIT,..... f. 261

⁸ ABDUL - MEXHID EZ ZINDANI, EL IMAN Të besuarit e vërtetë në dritën e Kuranit, Sunnetit dhe argumenteve shkencore (Përktheu dhe përshtati Nig’jar Bajrami - HOTI, Prishtinë 2000-1421 Hexhër, f. 27

⁹ Sulejman Mashoviq, Pikëpamje islame, përktheu Dr. Feti Mehdiu, Grafo Beni, Prishtinë 2007, f. 82

¹⁰ [Mr. Abdylkader Durguti](#), Vlora e diturisë dhe veprës në Islam, Publikuar në revistën Etika, nr. 30, Shtator 2010, f. 44

¹¹ Po aty.f.44

“Kërkimi i diturisë është obligim për çdo mysliman”; Omeri r.a. thotë: “O ju njerëz, e keni për borxh të kërkonit diturinë, ngase për Allahun është kostum i dashurisë. Ai që kërkon një derë të diturisë, Allahu do ta mbulojë me atë kostum të Tij”; Një njeri e kishte pyetur Ibn Abbasin për xhihadin. Ai iu ka përgjigjur: “A nuk dëshiron të të tregoj ty diçka që është më e mirë se xhihadi? - ia ktheu ai dhe i tha: Mësyja një xhamie dhe aty mëso Kur’anin, sunnetet e Pejgamberit a.s. dhe parimet e fesë”; Aliu r.a. thotë: “Dituria është më e mirë se pasuria, sepse pasurinë duhet ta ruash ti, ndërsa dituria të ruan ty; pasuria pakësohet me anë të dhënies, ndërsa dituria shtohet me anë të dhënies; dituria është gjykues, ndërsa pasuria e gjykuar; grumbulluesit e pasurisë kanë vdekur, edhe pse janë të gjallë, ndërsa dijetarët janë të gjallë sa të këtë jetë mbi tokë; trupat e tyre janë të humbur, ndërsa gjurmët e tyre ekzistojnë në zemrat e njerëzve”; Ebu Hurejre, radijallahu anhu, rrëfen se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kur të vdesë biri i Ademit, i ndërpriten të gjitha veprat, me përjashtim të triave: Lëmosha në vijim, dituria që është e dobishme ose fëmija i mirë, i cili do të lutet për të”; El-Gazaliu ka thënë: “Përveç dijetarëve, të tjerët nuk llogariten njerëz, sepse veçoria që i dallon nga shtazët është dituria. Njeriu është njeri për shkak të asaj që është me vlerë dhe fisnik, jo për shkak të fuqisë fizike, ngase deveja për nga aspekti fizik është më e fuqishme se njeriu, jo për shkak të ashtit, sepse elefanti është më i fortë, jo për shkak të trimërisë, sepse luani është më trim se njeriu, jo për shkak të ngrënies ngase demi e ka barkun më të gjerë, jo për shkak të marrëdhënieve intime, sepse harabelat e nivelit më të ulët janë më të fuqishëm në marrëdhënie intime prej tij. Njerëzit nuk janë të krijuar për diç tjetër përveç për dituri dhe shkencë”.¹²

Feja e nxit shkencën

Nuk njohim ndonjë fe prej feve, e as libër prej librave qiellor, e cila ka thirrur në përdorimin e logjikës dhe shfrytëzimin e saj në të menduar dhe konkludim, lidhjen e pasojave me shkaqet dhe rezultatet me premisat, vështrim dhe përkujtim, qortim të pasivizimit të aftësisë, të cilën Allahu xh.sh. ia fali njeriut për të soditur atë që është rreth tij, shmangies nga dëshmitë e Allahut në persona dhe horizonte, vende dhe popuj, shembuj dhe leksione që kaluan në jetën e popujve dhe ajo që u pa prej rezultateve të veprave dhe moralit, në nivel të individëve, popujve, pushteteve dhe kombeve, ashtu siç veproi për këtë Kur’ani.¹³

Në Kur’an vazhdimisht përsëritet thirrja e besimtarëve për të kërkuar dituri, e në të njëjtën kohë aty paraqiten një mori observimesh për shumë fenomene si p.sh., si qiejt, shiun, bimët, kafshët, lindja dhe perëndimi i Diellit, shenjat gjeografike, procesi i krijimit të njeriut, planetët, etj. Për t’i eksploruar këto duhet t’i studiojmë! Në ajetet që vijnë vërehet qartë rëndësia e kërimit të diturisë dhe përdorimit të intelektit për të kuptuar shenjat - argumentet e Allahut xh.sh. në Tokë, kudo që janë ato. Sa u përket ajeteve kur’anore, të cilat na thërrasin që ta studiojmë hapësirën ku jetojmë si dhe hapësirën e gjithësisë, jenë të shumta. Ne në këtë punim i kemi zgjedhur vetëm tre prej tyre. Zoti xh.sh. për këtë çështje në Kur’an thotë:

“A nuk shikojnë ata me vëmendje nga qielli se si mbi ta e kemi ndërtuar atë, e kemi zbuluar atë duke mos pasur në të ndonjë zbrazëti? Edhe tokën se si e kemi shtrirë e në të kemi vendosur kodra përforcuese dhe kemi bërë që në të të mbijnë gjithfarë bimësh të bukura. Dëshmi të dukshme dhe përkujtuese për secilin njeri që ka drejtuar mendjen. Ne, nga qielli lëshuam shiun e dobishëm dhe me të bëmë që të kultivohen kopshte e drithëra që korren. Dhe rritëm trungje të gjata hurmash me fruta të palosur njëri mbi tjetrin”. (Kaf 6-10)

¹² <http://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=1546>, (Mr. Lutfi Nexhipi) 15.09.2014

¹³ Ebul-Hasen Ali en-NEDEVIJJ, ISLAMI - ndikimi i tij në civilizim,..... f. 72

“Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon All-llahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhapë në te nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës, (në të gjitha këto), për një popull që ka mend ka argumente”. (Bekare 164)

“A nuk i shikojnë devetë se si janë krijuar? Edhe qiellin se si është ngritur lart? Edhe malet se si janë vendosur? Edhe tokën se si është shtruar?” (Gashijeh 17-20)

Edhe pse Allahu xh.sh. u ka dhënë njerëzve atë që nuk ua ka dhënë në krijesave tjera - logjikën dhe fuqinë e të menduarit, prapëseprapë kjo nuk mjafton që ai të njohë dispozitat e drejta të fesë islame dhe të njohë këtë botë në të cilën jeton, as mund t'i gëzojë frytet dhe zbulimet shkencore. Prandaj, Islami i urdhëron myslimanët që në emër të Allahut xh.sh. të studiojnë, të mësojnë dhe t'i shfrytëzojnë të gjitha dituritë, pasi që feja islame nuk bën dallim mes shkencës se është fetare apo jofetare.¹⁴

Islami urdhëron në një arsimim të përgjithshëm, të pa kufizuar dhe thotë: **“...Thuaj, a janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë”.** (Zumer, 9). Në këtë ajet, konkretisht me fjalën *ilmun* nënkuptohet shkenca në përgjithësi dhe nuk kufizohet vetëm në shkencat fetare, siç mendon dikush por qëllimi kryesor është për çdo dituri, e cila e largon paditurinë, qoftë ajo të jetë dituri fetare apo për çështjet e kësaj bote. Për të vërtetuar se bëhet fjalë për shkencën në përgjithësi, mund të na shërbejë si shembull edhe hadithi i njohur i Pejgamberit a.s.: **“kërkoni diturinë bile edhe në Kinë”**, - përpjekje që sot mund të korrespondojë me udhëtimin për në Hënë. Mbase në Kinë atëherë nuk ka pasur myslimanë, kuptohet qartë se me këtë Muhamedi a.s. ka pasur për qëllim diturinë (shkencën në përgjithësi). Kur'ani nxit që të studiohet dhe të hulumtohet Toka dhe Gjithësia. Ai intelektin e njeriut e identifikon me aparatin për të menduar dhe studiuar, në realitet është pranim i arsyes dhe kërkesë që arsyeja të zhvillohet dhe të forcohet, sepse njeriu

¹⁴ <http://www.mesazhi.com/artikuj/islami-dhe-dituria> (Kujtim Kasami) 16.09.2014

duke zhvilluar intelektin e vet do t'i njohë të vërtetat shkencore, më mirë do ta njohë Zotin xh.sh., dhe do të lirohet nga trillimet dhe përrallat. Në këtë mënyrë Islami u bë fe e logjikës, fe e arsyes, fe e shkencës, sepse Kur'ani për sa i përket diturisë në formë të imperativit, ka konstatuar se për lënien e shkencës pas dore do të ketë përgjegjësi edhe në botën tjetër dhe citon fjalët e atyre, të cilët intelektin e vet nuk e shfrytëzuan për të njohur të vërtetën dhe thotë: **“...sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim ndër banuesit e zjarrit”** (Mulk, 10).¹⁵

Nga ajo që u tha më lart, del edhe një e vërtetë tjetër thelbësore: që feja Islame e shikon shkencën - dijen si një mjet mik për njohën e botës materiale dhe shpirtërore, pa i ndarë njohuritë fetare nga të tjerat, pasi që shkencat shoqërore dhe ato natyrore përbejnë tërësinë, duke përfshirë edhe fenë edhe filozofinë, të cilat duhet të na shpijnë kah domethënia më e thellë e jetës dhe botës. Ajeti në të cilin thuhet se Allahu xh.sh. më së tepërmi i shfaqin respekt e drojë dijetarit, zbulon një realitet për shumë hulumtues të natyrës, të cilët kanë qenë edhe sot janë besimtarët më të mirë, ngase njohja e tyre me harmoninë dhe ligjshmëritë e botës së pa fund i udhëzojnë kah Logjika Supreme e Përgjithshme që krijon, drejton dhe shkatërron. Deklarata e drejtorit të përgjithshëm të UNESCO-s, zotëri M. Bov, se zhvillimi i shkencës moderne i ndihmon Islamizimit që afirmohet me të vërtetat, e gjithashtu i udhëzon myslimanët që të merren edhe më tepër me shkencë, e cila njeriun bashkëkohor e magjeps, e lë të mahnitur, por edhe i ndihmon të zbulojë rrugën ka Allahu xh.sh. krahas fisnikërimit të zemrës me jetën etike. **“Ilm”** është nga atributet e para të Zotit xh.sh. me anë të cilit besimtarët, duke arritur dije, i afrohen të gjithëdijshmit.¹⁶

¹⁵ http://www.radioislame.com/index.php?frame_rd=artikulli.php?id=595 (Kujtim Kasami) 15.09.2014

¹⁶ Sulejman Mashoviq, Pikëpamje islame,..... f. 82-83

Islami obligon edhe femrën në arritjen e diturisë

Lidhur me të drejtën për arsimim, Kur'ani ka kërkuar nga njerëzit që të kërkojnë diturinë e që shumë ajete i referohen rëndësisë që ka dija, shkenca dhe kërkimi i diturisë në vazhdimësi. Për këtë kemi ajete të shumta por edhe hadithe që obligojnë kërkimin e diturisë. Islami e bëri obligim kërkimin e diturisë për çdo mysliman dhe myslimane, dhe se në shoqërinë islame asnjëherë nuk mund të këtë ndalesë për marrjen e diturisë për asnjërën gjini.¹⁷

Kërkimi i dijes dhe arsimimit është një e drejtë që i Islami e miraton në mënyrë të njëjtë për burrat dhe për gratë, si në rastin e diturisë fetare ashtu edhe të asaj shekullare. Është i saktë identifikimi i arsimimit si një e drejtë si për burrat ashtu edhe për gratë, por në të vërtetë kjo është diçka më shumë se kaq: ajo është një kërkesë, madje një obligim, që gjen mbështetje në shprehjen e qartë të një hadithi që deklaroi se *“kërkimi i dijes është një detyrë e çdo myslimani”*. Në shprehjen *“çdo mysliman”* përfshihen natyrisht edhe gratë. Një tjetër version i të njëjtit hadith vazhdon me fjalët *“për burrat dhe gratë”*. Bashkëshortja e Profetit a.s., Aishja, është njohur gjerësisht si një dijetare (shkollare) kryesore midis shokëve (sahabëve) të Profetit a.s. dhe shfaqet në mënyrë të dukshme në shkollarizëm për shkak të njohjes që kishte rreth Kur'anit dhe Sunetit. Gjithashtu, Profeti a.s. punësoi një grua, Shifa el-Adavijeh, për t'i mësuar gruas tjetër të tij, Hafsa-së, shkrim e këndim. Ibn Hazmi ka vërejtur me të drejtë se Islami na ka obliguar me disa detyra fetare, të tilla si pesë faljet ditore, agjërimin, haxhin etj., të cilat e bëjnë të nevojshme njëfarë njohjeje rreth bazave të besimit. Si pasojë, pritet që çdokush të këtë një njohje bazë të hallallit dhe haramit. Lidhur me këtë nuk ka asnjë dallim

midis burrit dhe gruas, të cilët kanë të njëjtën të drejtë, madje janë të obliguar që të kërkojnë dije.¹⁸

Myslimanët, që nga e kaluara e hershme, ishin të vëmendshëm në arsimimin e femrave, për faktin se ato janë edukatore në familje dhe shoqëri. Edhe në gjenerata të mëvonshme kërkimi i diturisë nga femrat myslimane ishte parim jetësor për t'u aftësuar dhe për të ngritur vetëdijen e tyre e të shoqërisë, kështu që për hir të etjes së madhe për t'u pajisur me dije, pati prej tyre që kërkuar për dhuratë martese - meher që burri i saj ta pajiste me dije nga ajo që dispononte ai, siç ishte rasti edhe me fekihen Fatime, bijën e dijetarit të mirënjohur të shkollës juridike hanefite - Alaudin es-Samerkandi, autori i librit "Tuhfe-telfukaha", të cilin e memorizoi e bija e tij, kurse Alaudin el Kasaniu përpiloi librin "Kitabul bedai'a", që ishte koment i tuhfes, e për ta shpërblyer mundin e tij, atë ia bëri dhuratë martese me vajzën e tij, e të tjerët, lidhur me këtë, thanë: "E komentoj librin e tij - tuhfën dhe ia dha të bijën".¹⁹

Myslimanët që kontribuan në zhvillimin e shkencës

Shkencëtarët myslimanë, të cilët ishin nxitur nga mësimet kuran'ore për të studiuar dhe hulumtuar, iu përkushtuan jo vetëm shkencës islame, por edhe shkencës në përgjithësi. Këta shkencëtarë bënë zbulime të rëndësishme si në fushat e shkencave natyrore ashtu edhe të atyre humane-shoqërore. Të arriturat e myslimanëve në këto fusha shkencore janë të pamohueshme.

Këta myslimanë i kushtuan vëmendje të madhe gjeografisë, astronomisë, mjekësisë, biologjisë, matematikës, fizikës, sociologjisë, farmacisë, filozofisë etj. Kontributet e qindra personaliteteve myslimane që kontribuan në zhvillimin e shkencës në përgjithësi, gjenden nëpër shumë publikime të njohura të historianëve perëndimorë. Në pamu-

¹⁸ <http://www.e-zani.com/2012/02/18/statusi-i-gruas-ne-islam/> (Mohammad Hashim Kamali) 16.09.2014

¹⁹ <http://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=5086> (Mr. Sadat Rustemi) 16.09.2014

¹⁷ <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=1198> (Mr. Bekim Jashari) 15.09.2014

ndësi për t'i përmendur të gjithë këta shkencëtar, ne do t'i përmendim shkurtimisht vetëm disa prej tyre.

Mes emrave më të njohur myslimanë që kontribuan në shkencë janë: **Abu Musa Xhabir Ibn Haijan** (vdiq 880 e.r.) - i njohur më emrin Geber, kontributi i tij më i madh ishte në fushën e kimisë, njihet edhe si babai i kimisë; **Abdul Malik ibn Kureib el-Esmi** (740-828 e.r.) - konsiderohet si shkencëtari i parë mysliman, i cili kontribuo në zoologji, botanikë dhe përkujdesjen e kafshëve; **Muhamed Bin Musa Al-Khwarizmi** (770-840 e.r.) - ishte njëri nga matematikanët më të mëdhenj e kohës së tij. Al-Khwarizmi ishte gjithashtu edhe astronom dhe gjeograf i njohur. Njihet si themeluesi i algjebërës. Emri algjebër rrjedh nga libri i tij i famshëm "Al-Xhabr ua-al-Mukabilah"; **Jakub Ibn Ishak Al-Kindi (Alkindus)** (800-873 e.r.) - ishte një filozof, astronom, fizikan, matematikan dhe gjeograf. Mes tjerash ai ishte edhe një ekspert në muzikë; **Ali Ibn Rabban El (Tabari)** (838-870 e.r.) - u bë i famshëm me trajtimin e tij mjekësor "Firdeus El-Hikmah". Përveç njohurive në shkencat mjekësore ai gjithashtu ishte edhe filozof, matematikan dhe astronom; **Thabit Ibn Kurrah (Thebit)** (836-901 e.r.) - i njohur në botën perëndim me emrin Thebit, njihet për kontributin e tij në mekanikë, astronomi, matematikë dhe gjeometri; **Ebu Abdullah El-Batani** (858-929 e.r.) - është i njohur si astronomi më i madh gjatë kohës së tij, gjithashtu Thebiti është nga astronomët më të njohur në Mesjetës; **Abd El-Rrahman El-Sufi (Azofi)** (903-986 e.r.) - në botën perëndimore është i njohur si Azofi, kontribuo në astronomi dhe ishte ndër dy astronomët më të njohur gjatë mesjetës; **Ebul Kasim Halaf ibn El-Abas El- Zahravi (Albukasis)** (936-1013 e.r.) - shërbeu si fizikan në oborrin mbretëror të mbretit El-Hakami II të Spanjës, gjithashtu ishte një kirurg i dalluar. Pacientët dhe studentët nga gjithë vendet e Evropës vinin tek ai për mjekim si dhe këshilla; **Ebu El-Hasan Ali Ibn Muhammed Ibn Habib el-Mavardi** (927-1058 e.r.) - ishte një nga mendimtarët më të njohur të shkencave politike në epokën e mesjetës. Ai ishte gjithashtu sociolog, jurist dhe muhadithin i madh; **Ebu Raihan Muhamed el-Biruni** (973-1048 e.r.) - ishte një astronom, matematikan, fizikan, gje-

ograf, gjeolog dhe historian i shquar; **Ebu Ali el-Husein ibn Abdul-lah ibn Sina** (981-1037 e.r.) - është i njohur në filozofi, enciklopedi, matematikë dhe astronomi, ku ishte astronomi më me famë gjatë kohës së tij. Kontributi kryesor i tij ishte në shkencën e mjekësisë. Në botën perëndimore ishte i njohur me emrin Avicena; **Omar Al-Khajami** (1044-1123 e.r.) - ishte i njohur si matematikan dhe astronom i shquar. Gjithashtu u njoh edhe si poet, filozof dhe fizikan; **Abu Maruan Abd Al-Malik Ibn Zuhri (Avenzoar)** (1091-1161 e.r.) - në perëndim ishte i njohur më emrin Avenzoar, ishte një nga fizikanët, specialistët klinikë dhe parazitologjistët më të mëdhenj në kohën e mesjetës. **Nasir al-din al-Tusi** (1201-1274 e.r.) - është njëri nga shkencëtarët më të njohur të kohës së tij, kontributi i tij ishte në matematikë, astronomi, filozofi, teologji, fizikë dhe poezi. Shkroi edhe shumë teori në fusha të algjebërës, trigonometrisë, gjeometrisë, logjikës, metafizikë, etikës dhe teologjisë; **Ibn Khalduni** (1332-1395 e.r.) - njihet si themeluesi dhe babai i sociologjisë dhe i shkencave të historisë; **Abu Abd Allah Muhammad al-Idrisi** (1099-1166 e.r.) - kontributi i tij njihet edhe në gjeografi, hartografi, zoologji, botanikë. Ai gjithashtu dha ndihmesë të madhe në bimët mjekësore; **Muhamed al-Bujzani** (940-997 e.r.) - kontribuo në zhvillimin e matematikës, astronomisë, gjeometrisë dhe trigonometrisë; **Abas ibn Firnas** (810-887 e.r.) - kontribuo në shkencën e gjeografisë dhe historisë; **Ibn al-Baitar** (1197-1248 e.r.) - kontributi i tij është në botanikë, farmaci. Si dhe shumë myslimanë tjerë që kontribuan në zhvillimin e shkencës.²⁰

²⁰ Më gjerësisht rreth muslimaneve që kontribuan në zhvillimin e shkencës mund të shikon në: BIOGRAPHY Muslim Scholars and Scientists, Dr W. Hazmy C.H. Dr Zainurashid Z. Dr Hussaini R.

(<http://www.social-sciences-and-humanities.com/PDF/Biographies-of-Muslim-Scholars-and-Scientists.pdf>); si dhe në uebfaqen <http://mendohu.ucoz.com/blog/2009-03-20-150>

Përfundim

Vlera e diturisë për fenë Islame është e veçantë. Këtë e vetëton fakti, se shpallja nuk fillon me urdhrin e adhurimit, apo njohjen e Allahut xh.sh. dhe nënshtrimin ndaj tij, mirëpo shpallja fillon me fjalën **“Lexo”**. Çdo njeri i cili analizon ajetet e Kur’anit kupton qartë se Islami na obligon që të merremi me hulumtimin dhe arritjen e diturisë dhe zhvillimin e shkencës. Siç u tha edhe më lart, **“në islam feja është shkencë dhe dituri, dituria dhe shkenca janë fe”**, nga kjo kuptojmë se feja Islame e vlerëson aq shumë arritjen e diturisë sa që kjo fe e bën bashkimin e shkencës me fenë. Këtë e vërtetojnë shumë ajete kur’anore dhe hadithe të të Dërguarit a.s.

Feja islame ia imponon popullatës, e cila e ka përqaftuar atë, që të jetë popull i arsimuar, që ta ulë nivelin - përqindjen e analfabetizmit, si dhe të ngrejë përqindjen e intelektualëve. Kjo fe na mëson se nëse një besimtar dëshiron që të jetë besimtar dhe ta arrijë imanin e rregullt, ai besimtar është i obliguar ta studiojë shkencën. Lidhur me obligueshmërinë e të kërkuarit të diturisë, Pejgamberi a.s. shprehet: **“Kërkimi i diturisë është farëz (obligim) për çdo myslimanin”**. Obligimi i të cekurit në këtë hadith, përfshinë të gjithë myslimanët pa dallim, ngase obligimi është kolektiv, për çdo mysliman apo myslimane.

Në Kur’an vazhdimisht përsëritet thirrja e besimtarëve për të kërkuar dituri. Në Kur’an janë të paraqitura shumë fenomene natyrore si p.sh., si qiejt, shiu, bimët, kafshët, lindja dhe perëndimi i Diellit, krijimi i universit, procesi i krijimit, planetet, shenjat gjeografike, etj., ku na bën thirrje në mënyrë të vazhdueshme që t’i eksplorojmë dhe t’i studiojmë. Në shumë ajete, vërehet qartë rëndësia e kërkimit të diturisë dhe përdorimit të intelektit për të kuptuar shenjat - argumentet e Zotit xh.sh. në Tokë, kudo që janë ato.

Islami e bëri obligim kërkimin e diturisë për çdo mysliman dhe myslimane. Në shoqërinë islame asnjëherë nuk mund të këtë ndalesë për marrjen e diturisë për asnjërin gjini. Kërkimi i dijes dhe arsimimi

është një e drejtë që nuk u mohet as burrave as grave, si në rastin e diturisë fetare ashtu edhe të asaj shkencore. Se feja Islame nuk bën dallim mes femrave dhe meshkujve në kërkimin e diturisë, si dhe nxitjes së të marruarit me shkencë, e gjen mbështetjen në shprehjen e qartë të një hadithi që deklaron se **“kërkimi i dijes është një detyrë e çdo myslimani”**. Në shprehjen **“çdo mysliman”** përfshihen natyrisht edhe gratë. Një tjetër version i të njëjtit hadith vazhdon me fjalët **“për burrat dhe gratë”**.

Shumë myslimanë, të nxitur nga mësimet kur’anore dhe hadithet për të studiuar, hulumtuar, iu përkushtuan jo vetëm shkencës islame, por edhe shkencës në përgjithësi. Këta nuk studiuuan vetëm shkencën islame, por edhe shkencat natyrore si dhe ato humane-shoqërore. Të arriturat e myslimanëve që u morën me hulumtime shkencore janë të pamohueshme. Në ditët e sodit janë të njohur me qindra myslimanë që kontribuan në zhvillimin e shkencës moderne.

Mr.sc. Artan Mehmeti

THE QUEST FOR KNOWLEDGE ACCORDING TO ISLAM

(Summary)

Introduction

Islam was founded 1400 years ago. It encourages its followers to seek knowledge. Islam detests the lack of knowledge and ignorance.

Allah, through the Qur'an, calls upon the faithful to seek knowledge (sometimes in the form of advice, encouragement or even an order). To Allah the status of those who have knowledge is higher than the status of those who fight in his path. Muhammad too, calls upon Muslims to dedicate themselves to the acquisition of knowledge. This is best proved by several hadiths, through which the Messenger of Allah, advises, encourages or even orders his followers to seek knowledge. One of his hadiths says: "Seek knowledge from the cradle to the grave".

آرتان محمد

طلب العلم فى الاسلام

(خلاصة البحث)

الدين الاسلامى الذى أوحى الى نبينا محمد عليه الصلاة والسلام قبل أكثر من اربعة عشر قرنا يحض المسلمين على طلب العلم و يكرهم من الجهل .
 الله جل شأنه يطلب من المؤمنين عبر القرآن الكريم الى طلب العلم و هذا ليس مرة واحدة بل عشرات مرات و الطريقة التى يتوجه اليها تكون على شكل موعظة او جوافز او قد يكون على شكل أمر . و قد رفع الله جل شأنه درجة العالم أكثر من المسلم الذى يجاهد فى طريقه . و كذلك نرى النبى عليه الصلاة و السلام يحث المسلمين على طلب العلم و الاهتمام به هذا ما تؤكد عليه عشرات لاحاديث النبوية حيث نلاحظ النبى عليه السلام يستعمل أساليب الموعظة و الحث و الامر فى طلب العلم و أحسن مثل على ذلك يمكن أن نذكر الحديث النبوى : "اطلب العلم من المهد الى اللحد".

HISTORIKU I KIRAETEVE

Kurra hfz. doc. dr. Xhevad Shoshiq

KIRAETET E KUR'ANIT (Historiku i kiraeteve)

Shkenca e kiraeteve, me interesim të veçantë për rajonin tonë, ndonjëherë e pranishme vetëm në traditën gojore, të cilën e kultivonin kurra hafëzët tanë, duke transmetuar përmes ixhazetnameve, sot e pre-zantuar në disa monografi shkencore dhe revista, meriton një vend të veçantë në projektet tona kërkimore. Kiraetet nuk janë vetëm stilet ekzotike të variacioneve dhe modulimit të zërit, ashtu siç mendojnë shumë myslimanë, por janë pjesë përbërëse e gjuhës kuranore, strukturës së saj leksikore, morfologjike dhe sintaksore. Kuptimi i këtij aspekti është kusht për interpretimin më të madh të tekstit të duhur kuranor.

Interpretimin e Kur'anit përmes kiraeteve autentike (mutevatir) di-jetarët islamë e klasifikojnë si mënyrën e interpretimit të Kur'anit nga ana e Kur'anit, sepse kiraetet autentike janë vetë teksti kuranor, sigu-risht, në atë masë në të cilën janë të përfaqësuar. Kjo do të thotë se kiraetet autentike mund të jenë subjekte kërkimore të tefsirit në konte-kstin e kuptimit të një ajeti ose njësie semantike ose mund të përdoren si metodë e zgjedhjes dhe të argumentimit të kiraeteve tjera.

Situatë ndryshe është me kiraetet jo autentike (shaz). Ato nuk i përmbushin kriteret e vërtetësisë edhe për këtë arsye nuk mund të traj-tohen si teksti i Kur'anit. Sipas tyre, nuk është i lejuar leximi i Kur'a-nit në namaz edhe jashtë tij. Ata kanë statusin e haditheve individuale ('ahad) ose statusin e informacioneve (njoftimeve) të transmetuara nga sahabët (haber), që do të thotë se ata janë të lejuar të përdoren për që-llime të tefsirit, me përjashtim të të ashtu quajturave kiraete mevdu' (të fabrikuar).

Rreth rolit dhe rëndësisë së kiraetit në interpretimin e Kur'anit nuk ekzistojnë hulumtime të rëndësishme në vendin tonë. Komentuesit e mëdhenj, si: Et-Taberiu, el-Kurtubiu, Ez- Zamahsheriu, Ebu Hajjani dhe të tjerët, me arritjet e tyre të mëdha në lëmin e tefsirit, kanë qenë prej kohësh të pranishëm në thesarin tonë tradicional. Secili prej kë-tyre mufesirëve dhanë kontribut të paparë në kiraete veçanërisht në metodologjinë e interpretimit të tekstit kuranor, por këtij fakti nuk i është dhënë vëmendje e duhur.

1. Themelimi dhe zhvillimi i shkencës së kiraeteve

Çdo përpjekje për të sqaruar natyrën e kiraeteve kuranore na kthen në periudhën e hershme të Islamit, në kohën e zbritjes së Kur'anit. Është e rëndësishme të dihet se si e mori shpalljen Pejgamberi, s.a.v.s, si ka ndodhur pritja e saj në mesin e sahabëve dhe se si është përhapur dhe transmetuar në gjeneratat e ardhshme të myslimanëve.

Kur'ani është shpallur në formë të fjalimit gojor, veçanërisht citi-mit (të mësuarit), të cilin Pejgamberi, s.a.v.s., e pranoi nga engjëlli Xhibril dhe në të njëjtën mënyrë i mësoi sahabët e tij. Lloji i këtillë i shpalljes i dha traditës gojore ose memorizimit (hifzit) një rol kyç në ruajtjen, përhapjen dhe studimin e tekstit kuranor, veçanërisht nëse merret parasysh se një numër i madh i popullsisë mekase në atë kohë ishte analfabete dhe se arritjet më të rëndësishme janë trashëguar me fuqinë e memories njerëzore.

Mënyra graduale në zbritjen e Kur'anit mundësoi jo vetëm adop-tim më të lehtë e mënyrës së leximit të tij, por edhe një shqyrtim ku-

alitiv të tekstit të tij, burimit kryesor dhe themelor të parimeve të besimit islam, vlerave morale dhe dispozitave ligjore të Sheriatit, që ishin me rëndësi të veçantë dhe të domosdoshëm për formimin dhe strukturën e komunitetit të parë mysliman. Është i njohur mirë transmetimi nga Abdullah b. Mes'udi dhe sahabët tjerë në të cilin ata thonë se Pejgamberi, s.a.v.s., i mësoi tërësinë nga dhjetë ajete, dhe nuk kalonin në dhjetë të tjera derisa nuk i përvetësonin dhjetë të fundit dhe praktikisht t'i vënin në përdorim. Në këtë kontekst duhen shikuar edhe kira'ete, format e ndryshme të shpallura për mësimin e Kur'anit. Pejgamberi, s.a.v.s., disa sahabëve ua mësonte leximin e Kur'anit në një mënyrë (harf), disave në ndonjë mënyrë tjetër, në këtë mënyrë sahabët e praktikonin kiraetin që e dinin, përkatësisht të cilin e kishin përvetësuar, direkt ose indirekt, nga Pejgamberi, s.a.v.s.

Sahabët të cilët janë dalluar me aftësitë e tyre në recitimin e Kur'anit si dhe me hifzin permanent, fituan titullin e nderit - k'urra (recituesit e Kur'anit). Midis tyre ishin shquar: katër halifët, Ubej b. Ka'b, 'Abdullah b. Mes'ud, Ebu Ed-Derda', Zejd b. Thabit, Ebu Musa el-Esh'ari, etj. Ata paraqesin shtyllën kurrizore e rrugëve të transmetimit - senedit (zinxhirit të transmetuesve) të dhjetë imamëve të kira'etit, që arrijnë deri te Pejgamberi, s.a.v.s.

Kiraetet e sahabëve ishin të ndryshëm. Disa recitonin Kur'anin vetëm në një version që e kishin dëgjuar nga Pejgamberi, s.a.v.s., disa kanë njohur dhe praktikuar dy apo më shumë versione, në mënyrë që format e ndryshme të kiraeteve (vexhhet) filluan të përhapen (gjallërohen) në traditën gojore (rivajetit), veçanërisht pas hixhretit në periudhën Medinase, siç dëshmon, si shembull, rasti i Omer b. Hattabit dhe Hisham b. El-Hakimit në lidhje me versionet e leximit të sures El-Furkan.

Me zgjerimin e shtetit islam sahabët i linin shtëpitë e tyre dhe vendoseshin në krahinat dhe zonat e pushtuara. Misioni i tyre kryesor ishte që të përcjellin mësimin islamik në popullsinë myslimane, e cila dita-ditës ishte në rritje të shpejtë. Si pjesë e kësaj ata i kishin mësuar njerëzit me mësimin e duhur të Kur'anit sipas versionit që kanë dëgjuar nga Pejgamberi, s.a.v.s. Shtigjet transmetuese e mënyrës së të më-

suarit të Kur'anit, gjithnjë janë degëzuar te gjeneratat e reja, numri i kiraeteve ishte rritur, dhe me ta devijime dhe shmangie nga versione origjinale, ka ardhur deri te mosmarrëveshja mes myslimanëve për çështjen e vërtetësisë së këtij apo atij versionit të kiraetit.

Mosmarrëveshjet kulmuan gjatë kohës së kalifatit të Osmanit, r.a. Për të zgjidhur situatën, kalifi Osman urdhëroi kodifikimin dhe shumëzimin e Musafit, drejtshkrimi i të cilit do të përshtatet, ose të paktën të supozohet, shumicës së versioneve të kiraeteve të njohur dhe të verifikuar. Kur kjo është bërë, kalifi kishte dërguar në çdo qytet nga një Musaf, dhe me Musafin edhe kariun (recituesin) profesional kiraeti i të cilit, në masë të madhe, është praktikuar në mesin e banorëve të qytetit, ku ishte dërguar. Pasimi i ortografisë zyrtare së musafit u prezantua (fut) si detyrim i sheriatit, të gjitha variantet e kiraeteve që nuk ishin ortografikisht të vërtetuara u shpallën të pavlefshëm, ndërkaq përdorimi i tyre trajtohet si shkelje e ligjeve islame.

Myslimanët, padyshim, i kanë pranuar Musafët e Osmanit, r.a., dhe versionet zyrtare të kiraeteve. Aplikimi i tyre është bërë nën mbikëqyrjen e autoriteteve kryesore në këtë fushë.

Në Medinë nga gjenerata e tebanëve, në gjysmën e dytë të shekullit të parë dhe gjysmën e parë të shekullit të dytë të hixhretit, shkollën e kiraeteve në Medinë e përfaqësuan: Seid b. el-Musejjeb, 'Urve b. Ez-Zubejr, 'Abdu'r-Rahman el-'Erexh, Ibn Shihab ez-Zuhri (vdiq në vitin 123 H.), etj; në Mekke: 'Ubejdullah b. 'Umejr el-Lejli, Tavus b. Kejsan, 'Ata' b. Ebi Rebbah, 'Ikrimë (i mbrojturi i Ibn Abbasit, vdiq në vitin 105 H.), etj; në Kuffë, 'Amr b. Sherhabil, 'Alkameh b. Kajs, Mesruk b. el-'Exhda', El - Esved b. Jezid, etj; në Basra: 'Amir b. 'Abdullah, Ebu'l - 'Alije er-Rijahi, Nasr b. 'Asim, Jahja b. Ja'mer, etj; në Sham: El - Mugire b. Ebi Shihab el-Makzumi, Halid b. Sa'd, etj.

Kur pjesëtarët e sekteve të ndryshme, të tilla si rafiditë dhe mu'tezilët, filluan të lexonin Kur'anin në kiraete që nuk kishin bazë në traditë, ishte e nevojshme që të vendosen parimet dhe normat metodologjike të çdo kiraeti apo rivajeti autentik. Kjo ide u realizua nën kujdesin e recituesve më të shquar të Kur'anit të kohës - Imamëve të kiraeteve. Sipas tyre, kiraetet ose rivajetet kanë marrë emrat e tyre, si

për shembull: kiraeti i Nafiut, rivajeti i Vershit, etj. Një nga autoritetet kryesore në fushën e shkencës së kiraeteve, Ibnu'l-Xhezeriu lidhur me këtë thotë: "Atribuimi i çfarëdo harfi (mënyrat e të lexuarit të Kur'anit) sahabiut apo dikujt tjetër është dashur të tregohet se personi në fjalë më së shumti ka kontribuar në përhapjen dhe praktikimin e tij, dhe asgjë tjetër. Gjithashtu, emërtimi i kiraeteve sipas emrave të imamëve të tyre do të thotë se këta imamë kanë zgjedhur kiraetin e vet në bazë të "shijes" gjuhësore, se e kishin interpretuar, duke ndikuar në popullaritetin dhe përhapjen e tij. Bëhet fjalë, pra, në zgjedhjen, aftësinë dhe qëndrueshmërinë dhe jo në krijimin dhe ixhtihadin."

Në mesin e imamëve në Medine u dalluan: Ebu Xha'fer Jezid b. el-Ka'ka', Shejbe b. Nessah, Nafi' b. Ebi Ne'im etj. Në Mekë më të dalluar ishin: 'Abdullah b. Kethir, Humejd b. Kajs al-E'rexh, Muhamed b. Muhajsin, etj; në Kuffë: Jahja b. Vellab, 'Asim b. Ebi en-Nexhud, Sulejman b. Mihran al-E'mesh, Hamza b. Habib ez-Zejjat, 'Alij b. Hamza el-Kisa'i, etj; në Basra: 'Abdullah b. Ebi 'Is'haku, Ebu 'Amr b. el-'Ala', 'Asim el-Xhuhderi, Jakub el-Hadremi, etj; në Sham: 'Abdullah b. 'Amir el-Jahsibi, 'Atijje b. Kajs el-Kilabi, Shurejh b. Jezid el - Hadremi, etj.

2. Fillet dhe zhvillimi i punës kërkimore në fushën e kiraeteve

Të dhënat e shkruara nga kjo lëmi janë shumë të hershme, duke marr parasysh që mësimi të Kur'anit i është dhënë një vëmendje e veçantë, madje nga disa konsiderohej edhe si akt (ibadet) më i vlefshëm se xhihadi. Historianët kanë mendime të ndryshme lidhur me atë se cili ishte i pari që kishte shkruar për kiraetet. Emrat që zakonisht përmenden janë: Ebu el-Kasim Ubejd b. Selam (vdiq në v. 224 h.), Ebu Hatim E-Sigijistani (vdiq në v. 255 h.), pastaj Jahja b. Ja'mer (vdiq në v. 89 h.), etj. Përpjekjet më të rëndësishme në aspektin e evidencimit të kiraeteve u shfaqën në fund të shekullit të parë dhe në fillim të shekullit të dytë të hixhretit, por ata nuk kishin karakter shkencor. Prej autorëve të njohur nga kjo periudhë duhet përmendur: Eban b. Taglib

el-Kufi (vdiq në v. 141 h.), Mukattil b. Sulejman (vdiq në v. 150 h.) dhe Zejd, b. Kudame el-Lekafi (vdiq në v. 161 h.). Gjatë shekullit të tretë të hixhretit vjen deri te zhvillimi i rëndësishëm i veprimtarisë shkencore dhe kërkimore në disiplinat e kiraeteve, për të arritur lulëzimin e vetë në shekullin e katërt dhe të pestë. Ndër veprat më të njohura të kësaj periudhe patjetër janë: El-Xhami' nga Ja'kub b. Is'hak el-Hadremi (vdiq në v. 205 h.), El-Gaje fi'l-kira'ati'l-'ashr, El-Mebsut fi'l-kira'ati'l-'ashr dhe El-Kira'at es-seb'a nga Ebu Bekr Ahmed b. el-Husejn el-'Asbehani (vdiq në v. 381 h.), Et-Tebisire fi'l-kira'at es-seb', El-Keshf 'an wuxhuhi'l-kira'at dhe El-Muxhez fi'l-kira'at nga Ebu Muhamed Mekki b. Ebi Talib el-Kajsi (vdiq në v. 437 h.), Et-Tejsir fi'l-kira'at es-seb' nga Ebu Amr Ulman b. Seid ed-Dani (vdiq në v. 444 h.), etj. nga shekulli i gjashtë deri në shekullin e nëntë hixhri, janë veprat e shkruara nga kiraetet në mënyrë permanente janë reduktuar në lëmi që tashmë janë diskutuar nga autorët e mëhershëm, siç janë veprat: El-'I xhaz fi'l-kira'at es-seb' nga Ebu Muhammed Abdullah b. Aliju (vdiq në v. 541h.), Fethu'l-wesid fi sherhi'l-Kasid nga Ebu el-Hasan Alij b. Muhamed es Sekawiju (vdiq në v. 643 h.), Tuhfetu'l-berere fi'l-kira'at el-'ashere nga Ebu Muhammed Abdullah b. Abdu'l - Mu'min el-Wasitiju (vdiq në v. 740 h.), etj. Pas kësaj, shkrimet, kryesisht, ishin të kufizuara në komente të veprës Esh-Shatibije - veprës kapitale në formën e vargjeve, të shkruar nga Imam el-Kasim b. Halef b. Firruh esh-Shatibi (vdiq në v. 590, h.). Natyrisht, përveç veprave të veçanta, kiraetet ishin objekt interesimi në kuadër të literaturës së gjerë kuranore, p.sh., në veprat nga tefsiri, hermeneutikës kuranore 'ulumu'l-Kuran, gramatikës së gjuhës arabe e stilistikës.

3. Paraqitja e idesë rreth kufizimit të kiraeteve

Ideja për të kufizuar numrin e kiraeteve daton nga shekulli i tretë të hixhretit, kur Ahmed b. Xhubejri (vdiq në v. 258 h.) shkroi veprën për kiraetet e quajtur El-Hamse (të pestë). Pastaj u shfaq vepra e Ebu Bekr Ed-Daxhunisë (vdiq në v. 324 h.) e quajtur Eth-Themaniye (të tetë). Pasi që numri i lexuesve të Kur'anit (kari) dhe rrugëve të transme-

timit janë rritur në mënyrë të vazhdueshme, dhe se ekzistonte rreziku i konfuzionit në përdorimin e tyre, imami Ibn Muxhahid (vdiq në v. 324 h.) doli me idenë që përdorimi i kiraeteve të reduktohet në kiraete të recituesve më të shquar të Kur'anit nga qendrat më të famshme islame. Në kërkimin e tij për të realizuar idenë e tij, ai ka shkruar një vepër të famshme e quajtur Es-Seb'a (të shtatë). Në këtë hap është vendosur, sepse mendonte se metodologjinë e aplikimit të kiraeteve duhet ruajtur në mënyrë që të mos dalë nga suazat e traditës së themeluar. Sipas mendimit të tij, ekzistojnë katër lloje të recituesve të Kur'ani (karive):

1. Hafëzët e Kur'anit, ekspertë në fushën e gramatikës së gjuhës arabe, fjalorit dhe stilistikës, njohësit e varieteteve dhe formave të kiraeteve, karakteristikave të tyre sintaksore dhe të transmetimit.
2. Hafëzët e që flasin (rrjedhshëm) gjuhën arabe dhe recitojnë Kur'anin, por janë të kufizuar në dialektin e tyre, pra, nuk janë në gjendje për të zbatuar në mënyrë korrekte versione të ndryshme të kiraeteve;
3. Hafëzët që nuk e dinë mjaftueshëm gjuhën arabe dhe gramatikën e saj, dhe që duke harruar bëjnë gabime tekstuale;
4. Hafëzët që janë të njohur me gramatikën e gjuhës arabe, semantikën dhe dialektet, por nuk kanë njohuri të mirë në kiraetet e Kur'anit. Atyre u ndodh që të recitojnë disa ajete nga Kur'ani, në mënyrë të lejuar në gjuhën arabe, por të pabazuara në traditën autentike.

Pas një studimi të detajuar dhe analizave të shumta të versioneve të kiraeteve, Ibn Muxhahidi kishte mbledhur rivajetet autentike të shtatë imamëve të njohur në lëmin e kiraeteve të Kur'anit, duke i përfshirë ato në veprën e tij Es-Seb'a (të shtatë). Atë e konsideruan si autoritetin kryesor në shkencën e kiraeteve, kritikun e besueshëm dhe të përgjegjshëm, i cili i ndau kiraetet autentike (mutevatir) prej shumicës jo autentike (shaz), edhe pse disa prej tyre ishin të lidhur për ndonjërin nga radhët e shtatë imamëve të kiraeteve. Kjo është arsyeja pse vepra e tij Es-Seb'a kishte përjetuar popullaritet të madh në mesin e

dijetarëve islamë dhe që është bërë vepra themelore në teorinë dhe aplikimin në shkencën e kiraeteve.

Dijetarët, emrat e të cilëve i zgjodhi Ibn Muxhahidi janë:

1. Nafi b. Abdur-Rahman b. Ebi Ne'im nga Medina (vdiq në v. 169 h.);
2. Abdullah b. Kethir nga Mekka (vdiq në v. 120 h.);
3. Ebu. Amr b. el-Ala' nga Basra (vdiq në v. 154 h.);
4. Abdullah b. Amir el-Jahsibi nga Shami (vdiq në v. 118 h.);
5. Asim b. Ebi en-Nexhud nga Kufa (vdiq në v. 127 h.);
6. Hamza b. Habib ez-Zejjat nga Kufa (vdiq në v. 156 h.);
7. Alijj b. Hamza el-Kisa'i nga Kufa (vdiq në v. 189 h.).

Këto janë emrat e përfaqësuesve (imamëve) të shtatë kiraeteve mutevatir, të cilët nga shkronja e parë deri tek ajo e fundit e recituar nga Kur'ani, me transmetimin mutevatir, e lidhin deri te Pejgamberi s.a.v.s. Falë punës së Ibn Muxhahidit, janë krijuar kriteret e sakta për të vërtetuar saktësinë e ndonjë kiraeti, për të cilën gjë më vonë do të bëhet fjalë. Ibn Muxhahidi nuk kishte për qëllim që me zgjedhjen e tij, pos kësaj shtatësheje të përmendur, të mohojë mundësinë e vërtetësisë së kiraeteve të imamëve tjerë, por u mundua që të bëjë përcaktimin e vërtetësisë së rangut më të lartë të transmetimit (rivajetit), në mënyrë që gjeneratave të atëhershme dhe atyre të më vonshme t'u sigurojë një konsensus të përgjithshëm, kur është në pyetje recitimi i Kur'anit. Përveç kësaj, Ibn Muxhahidi as që mund të paramendonte se kiraetet e këtyre shtatë imamëve, do të barazohej me shtatë harfe të Kur'anit, për të cilat kishte përmendur vetë Pejgamberi s.a.v.s. në hadithet e tij. Përputhja e këtyre shifrave është, padyshim, një ko incidencë rastësie.

Me ardhjen e Ebul-Kayr Muhamed b. Muhamedin, i njohur si Ibnu'l-Xhezeri (vdiq në v. 833 h.), numri i kiraeteve mutevatir është rritur në dhjetë. Ibnu'l-Xhezeri në veprën e tij En-Neshr fi'l-kira'ati'l-Ashr, kategorisë së kiraeteve mutevatir u bashkoi edhe tre kiraete meshur, senedet e të cilave kontrolloi tërësisht dhe vërtetoi se numri dhe besueshmëria e tyre plotësojnë kërkesat e kësaj kategorie. Është

fjala për kiraetet e tre imamëve të njohur, emrat e të cilëve i kemi përmendur më parë e të cilit. janë:

1. Ebu Xha'fer b. Jezid el-Ka'ka (vdiq në v. 130 h.);
2. Jakub el-Hadremi (vdiq në v. 205 h.), dhe
3. Halef b. Hisham el-Bezzar (vdiq në v. 229 h.).

Me këtë përfundimisht, me konsensus të Ummetit islam, është pranuar aplikimi i dhjetë versioneve autentike të të recituarit (leximit) të tekstit kuranor.

Para se të merren parasysh kriteret me të cilat është bërë klasifikimi i kiraeteve, është e këshillueshme që të njihemi me kuptimin dhe konceptin e termit el-kira'at, e për të cilin do të bëjmë fjalë në rreshtat vijues.

4. Rëndësia dhe kuptimi i konceptit El-Kira'at

Emri kira'at është shumësi i fjalës arabe Kira'etun), folje në formën paskajore (infinitivë) kare'e : për të mësuar, për të lexuar, për të recituar etj. Përndryshe, morfemë leksikore në gjuhën arabe, graviton rreth kuptimit: për të mbledhur, për të bashkuar, për të grupuar etj.

Sipas definicionit terminologjik, të përcaktuar nga Ibnu'l-Xhezeriu - "kiraetet janë shkenca se si të realizohet shqiptimi i fjalëve të Kur'anit, në format e tyre të ndryshme, në përputhje me traditat e autoriteteve përkatëse në këtë fushë."

Shihabu'd-din el-Kastalani (vdiq në v. 923 h.) kiraetet i përkufizon si "shkenca që na ndihmon të kuptojmë se ku transmetuesit e kiraeteve bien dakord, dhe ku ndryshojnë kur është fjala për leksikonin, sintaksën, shtimin ose përjashtimin, kalimin ose moskalimin, ndarjen ose bashkimin, si dhe karakteristika të tjera në artikullimin dhe ndryshimet në kushtet e traditës gojore."

Abdul-Fattah El-Kadi thotë se kiraetet janë: "shkenca për realizimin e shqiptimit të fjalëve dhe metodave të artikullimit të tyre, në njërin ose më shumë versione të kiraeteve kuranore, në përputhje me traditat e autoriteteve përkatëse në këtë fushë"

Këto përkufizime përfshijnë të paktën tri determinonte të termit kira'at: së pari - kiraetet janë rezultat i shqiptimit të ndryshëm të fjalëve

ve kuranore apo bashkëtingëlloreve dhe zanoreve; së dyti - përdorimi i tyre është i kushtëzuar nga tradita e besueshme, dhe së treti - divergjenca e tyre ka justifikimin dhe thelbin e saj.

Kiraetet duhet kuptuar si aftësi për të aplikuar forma të ndryshme fonetike dhe leksikore gjatë recitimit të Kur'anit. Kjo mundësi nuk do të thotë përvojë gjuhësore apo zgjedhje e lirë nga recituesit e Kur'anit. Përkundrazi, ajo është e vendosur me traditën autentike dhe në përputhshmëri me drejtshkrimin kuranor.

(...)

*Përktheu dhe përshtati nga boshnjakishtja:
Azmir Jusufi*

Kurra hfz. doc. dr. Xhevad Shoshiq

QIRA'AT OF THE QUR'AN History of Qira'at

(Summary)

The science of Qira'at, which was cultivated by the kurra hafiz in our region, is sometimes present only in the oral tradition. Nowadays it is the subject of a number of scientific monographs and magazines and as such deserves a special place in our research projects. Qira'at is not only exotic styles and variations and modulations of voice as is thought by many Muslims but a constituent part of the language of the Qur'an, its lexical, morphological and syntactic structure.

جواد شوشيش

قراءات القرآن الكريم (تاريخ القراءات)

(خلاصة البحث)

ان علم القراءات باهتمام خاص في منطقتنا قد تكون حاضرة في تقالينا الشفهية و التي مارسها قراؤنا و الذين اتبعوها عن طريق الاجازتنامة و التي نراها اليوم حاضرة في بعض الدراسات العلمية و المجالات هي تستحق مكانا خاصا في مشاريعنا العلمية .

القراءات ليست فقط اساليب خاصة تعنى بجمال الصوت كما يظن كثير من المسلمين و لكنها جزء لا يتجزء من لغة القرآن و بثبتها النحوية و الصرفية و المعجمية. ان فهم هذا الجانب يعتبر شرطا اساسيا لفهم النص المطلوب للقرآن الكريم.

SHTYPI SHQIPTAR

Shpend Avdiu

Instituti Albanologjik – Prishtinë

KRIMET E ALENCËS BALLKANIKE SIPAS SHTYPIT SHQIPTAR TË KOHËS (1912-1913)

Përmbledhje: Në këtë artikull jemi mbështetur kryesisht në informacionet që ofrojnë shkrimet e gazetave të kohës që janë botuar në Shqipëri dhe jashtë saj: “Përlindja e Shqipëriës”, “Atdheu”, “Shqypnia e Re”, “Taraboshi”, “Besa Shqiptare”, “Dielli”, etj. Këto gazeta sillnin për lexuesin shqiptar edhe qëndrimet e shtypit botëror për krimet serbe, malazeze dhe greke. Shkrimet në fjalë kanë vlerë të madhe për studimin e krimeve të Aleancës Ballkanike gjatë viteve 1912-1914. Krahas shtypit shqiptar kemi pasur parasysh edhe disa gazeta të huaja, si dhe studime të ndryshme rreth ngjarjeve të viteve 1912-1914 në Ballkan.

1. Vazhdimi i krimeve serbe, malazeze e greke edhe pas vendimeve të Konferencës së Londrës

Me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dolën edhe gazetat e para brenda shtetit shqiptar. Gazeta e parë, organ i qeverisë së Vlorës, ishte “Përlindja e Shqipëriës”, e cila u pasua nga gazeta dhe revista të tjera. Në fillim këto gazeta nuk patën ndonjë ndikim në opinionin ndërkombëtar, ndërsa ndikimi i tyre brenda vendit ka qenë i kufizuar, pa mu-

ndur të krijonin një opinion publik gjithëshqiptar. Megjithatë është me shumë rëndësi se ato në faqet e veta pasqyruan ngjarjet kryesore të kohës, duke filluar nga akti i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. U pasqyrua gjendja e kohës në Shqipëri, idealet, synimet, por edhe kundërshtitë e krerëve dhe intelektualëve shqiptarë; u pasqyruan krimet e forcave ushtarake serbe, malazeze dhe greke, që në atë periudhë kishin pushtuar pothuajse të gjitha tokat shqiptare; u pasqyruan synimet dhe prapaskenat e shteteve shoviniste fqinje për pushtimin dhe ndarjen e tokave shqiptare, për shfarosjen e shqiptarëve si komb dhe shkatërrimin e kulturës dhe gjuhës së tyre.

I gjithë shtypi shqiptar, si në Veri ashtu edhe në Jug, u kushtonte rëndësi të veçantë shqiptarëve të mbetur në Serbi, në Mal të Zi dhe në Greqi dhe merrej gjerë e gjatë me gjendjen e tyre tragjike. Shtypi shqiptar dhe shtypi i huaj raportonin për krimet që kryheshin nga Serbia dhe Mali i Zi në Veri dhe nga Greqia në Jug. Edhe pas përcaktimit të kufijve në Konferencën e Ambasadorëve në Londër shtetet ballkanike nuk i kishin larguar forcat e tyre nga Shqipëria, ndonëse Fuqitë e Mëdha ua kishin bërë të qartë shteteve ballkanike se nuk duhej të mbetej brenda këtyre kufijve as edhe një ushtar i vetëm.¹ Por, vendimet e Fuqive të Mëdha nuk u respektuan. Forcat greke e serbe kryen krime dhe mizori jo vetëm në tokat shqiptare që kishin pushtuar, si Kosova e Çamëria, dhe që tashmë Fuqitë e Mëdha e kishin njohur aneksimin e tyre. Por, krimet i vazhduan edhe brenda kufijve të shtetit shqiptar të sapoformuar dhe të njohur ndërkombëtarisht².

Gazeta “Dielli” e datës 24 nëntor 1913, në gjuhën shqipe, boton një shkrim të gazetës londineze “Daily Telegraph” të datës 1 nëntor 1913, ku shkruhet: “Guvernatorët e Austrisë dhe Italisë kanë rënë dakord ta zgjidhin çështjen e kufijve shqiptaro-grek në çdo mënyrë, edhe në qoftë se Komisioni Ndërkombëtar s’e përfundon punën e vet. Austro-Hungaria dhe Italia do të bëjnë marrëveshje me aleatin e tyre, Gjermaninë, që të mos lëshojnë as edhe një pikë pe për këtë çështje.

¹“Përlindja e Shqipëriës”, 22/4 Kallëduar 1914.

²“Atdheu”, 15 Vjesht’ e II-të 1913.

Në qoftë se Greqia nuk vepron në bazë të kërkesave që dolën nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër që t'i largojë të gjitha forcat e veta nga Shqipëria, në të kundërtën do të merren masa vepruese ndaj saj"³. Kurse gazeta "Përlindja e Shqipëniës" shkruan: *Mishrat e zemrat na dridhen nga lajmet e këqija që mësojmë për vuajtjet e vëllezërve tanë që fati i zi i dënoi që të mbesin rob nën barbarët serbë, grekë, dhe malazezë!*⁴ Në këtë artikull thuhet se egërsirat e Afrikës janë lule para këtyre barbarëve që jetojnë në mes të Europës. Më tej në këtë shkrim thuhet se "barbarizmat serbë nuk dallojnë nga ato të inkuizicionit, ku qeveritari i Shkupit, Ceroniçi, u ka futur tmerrin shqiptarëve dhe bullgarëve, ku u thoshte qeveritarëve serbë që do t'u shkurtojë këmbët këtyre po qe se nuk bëhen serbë. Po kështu veproi dhe Mali i Zi e Greqia"⁵.

Gazeta "Dielli" raporton krime të shumta të grekëve në Shqipërinë e Jugut, ku me dhunë para Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit shqiptarët detyrohen të shtiren si grekë dhe ata që nuk u bindeshin këtyre urdhrave, rriheshin pa mëshirë ose dërgoheshin në burgjet greke⁶.

2. Terrori shtetëror dhe konvertimi me dhunë i shqiptarëve në fenë ortodokse

Shtypi shqiptar, që dilte në Shqipëri dhe jashtë saj, gjatë viteve 1913-1914 raportonte për shumë krime që bëheshin nga ana e Malit të Zi dhe Serbisë në Kosovë dhe në rrethin e Dibrës. Në një artikull të gazetës shkodrane "Besa Shqiptare" raportohet për gjendjen e rëndë të shqiptarëve të cilët më dhunë detyroheshin të ktheheshin nga feja

myslimane në atë ortodokse. Kjo gazetë bën fjalë për rreth 80 mijë shqiptarë të vrarë në territorin e Kosovës gjatë viteve 1912-1913⁷.

Çështja e konvertimit me dhunë në fenë ortodokse trajtohet gjerë e gjatë në një shkrim tjetër të gazetës "Besa Shqiptare" të datës 3 korrik 1913. Në një artikull me titull "Salvimi i Katolikëve në Kosovë", gazeta shkodrane pasi i bën një përshkrim gjendjes së Famullisë dhe kishës së Zllakuçanit, përmend vrasjen e famullitarit Luigj Palaj⁸, shkruan për një torturë që kishte përjetuar kushëriri i famullitarit të vrarë, që tashmë e kishte zëvendësuar atë në udhëheqjen e kësaj famullie. Pasi përshkruan dhunën që komandanti serb i xhandarmërisë kishte ushtruar mbi priftin katolik, në maj të vitit 1913, jepet edhe ky përshkrim⁹: *... Të shtunën mrama tuj dasht meshtari me i ra kumbones, sikur ash dokja, serbet nuk e lanë, nadjë (në mëngjes-vër-jonë) ushtarët serbë i ranë vet kumbonës e për'i herë u mblodh katundi me shpnesë se tu ken' lirue. Frati prej ndryemit, kishte per t' ju predikue si tjetër herë; por puna duel krejt ndryshe. Porsa famullia ja mbrini te kisha e pane vedin t' rrethuem prej serbve, të cilët u orvaten me të gjitha mënyrët me ja u mushë mendin me mohue fenë katolike e me u ba shkje...*¹⁰. Edith Duraham, e cila ishte dëshmitare e ngjarjeve që po zhvilloheshin në atë kohë në Shqipëri shkruante: *Nga Gjakova vinin lajme edhe më të këqija. Malazezët po përpiqeshin t'i kthenin me forcë myslimanët dhe katolikët në fe tjetër*¹¹. Edhe në Guci po thuaj ishte e njëjta gjendje: *Myslimanët u desh ose ta zgjedhin vdekjen ose pagëzimin*". Më tej Durham shkruan: *Një numër i madh burrash vdiqën në tortura, gratë i çuan në kishë, "si delet" dhe i pagëzuan. Ato që kundërshtonin, i dhunonin ushtarët*¹².

⁷ "Besa Shqiptare", 23 gusht 1913.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

¹⁰ "Besa Shqiptare", 3 korrik 1913.

¹¹ Edith Durham, *Brenga e Ballkanit*. Tiranë, 2000, f. 282.

¹² Po aty.

³ "Dielli", 14 Vjeshtë III 1913.

⁴ "Përlindja e Shqipëniës", 28 gusht 1913.

⁵ Po aty.

⁶ "Besa Shqiptare", 23 gusht 1913.

⁶ "Dielli", 14, Vjeshtë II 1913.




Foto: Konvertimi me dhunë i shqiptarëve në fenë ortodokse nga Mali i Zi (Plavë, 1913)

Për konvertimin e shqiptareve në ortodoksë në territoret e pushtuara nga ana e Malit të Zi flasin po ashtu dhe dokumente malazeze të kohës, të cilat raportojnë se konvertimi kishte kaluar me dhunë¹³. Lazer Mjeda, arqipeshkvi i Prizrenit, në një dokument të datës 24 janar 1913 të dërguar në Vjenë shkruante: *Shembulli i Gjakovës është i jashtëzakonshëm dhe më makabër. Ushtarëve iu dha e drejta të bënin gjithçka, nuk kursyen as gratë, as fëmijët, plaçkitën çdo gjë*¹⁴.

Për krimet serbe flasin edhe dokumentet angleze. Nënkonsulli, Peckham, më 28 shkurt 1913 i shkruante një telegram sekretarit të Parë Shtetëror të Punëve të Jashtme, ku raportonte për 60 shqiptarë të vrarë në rrethin e Gjilanit. Ky dokument shkruante dhe për 1200 të vrarë në Ferizaj, dhe për një numër të pacaktuar kufomash të hedhura në Vardar, menjëherë pas pushtimit serb të Kosovës. Nënkonsulli

¹³ Për më shumë shih: Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913* (Dokumente), Prishtinë, 1996, f. 215-216; Lush Cullaj, *Argjipeshkvi Mjeda në dokumente malazeze të vitit 1913*: në: "Imzot Lazer Mjeda - mbrojtës dhe lëvruar i identitetit shqiptar", Prishtinë - St Gallen, 2011, f. 300-301.

¹⁴ Për më shumë shih: Gjergj Gashi, *Kosova- altari i Arbërisë 1910-1914, Vëll III* (Dokumente), Tiranë, 1996, f. 87.

britanik në Shkup supozonte se këto krime ishin bërë për shkak se në atë kohë ishin përhapur thashetheme se në ato pjesë ku 75 për qind e popullsisë ishte shqiptare, do t'i takonin Shqipërisë. Konsulli supozonte se këto krime janë bërë për qëllime statistikore.¹⁵

Për krimet serbe në territoret shqiptare ka shkruar dhe Dimitrije Tucović, i cili ishte themelues i Partisë Socialdemokrate Serbe (Srpska socijaldemokratska partija), ishte dhe drejtues i gazetës "*Radničke novine*" dhe "*Borba*". Në librin "*Serbia e Shqipëria*", Tucović, ndër të tjera konstatonte: "*Shtypi serb, duke u përpjekur të justifikonte politikën e mbrapshtë, trilloi për shqiptarët një kështjellë mendimesh të rreme e tendencioze. Kurse politika pushtuese e Serbisë, me metodat e saj barbare, i mbushi shqiptarët me një urrejtje të thellë ndaj nesh.*"¹⁶ Në dallim nga shtypi shqiptar dhe ai europian, shtypi serb e paraqiste gjendjen si të qetë dhe të qëndrueshme dhe raportonte me hipokrizi se ushtria serbe ishte pritur me entuziazëm nga shqiptarët. Ky shtyp shkruante se ushtria serbe kujdeset për sigurinë e banorëve vendës pa dallim kombësie dhe feje.¹⁷ Ndërsa shtypi i huaj raportonte se në Shkup serbët po therrnin gra, fëmijë dhe në vendet shqiptare krime bëhen edhe ku s'ka pasur fare kryengritje.¹⁸ Gazeta "*Taraboshi*" në një fejtון shkruante për krimet e serbëve në Kosovë. Përshkruante dëgjien e fshatrave të tëra e deri të krimet më çnjerëzore¹⁹.

Një meritë e veçantë e shtypit shqiptarë të kësaj kohe është se përcillte me vëmendje të madhe edhe shtypin serb i cili raportonte mbi

¹⁵ Për më shumë shih: Gazmend S. Rizaj, *Shqipëria e Sipërme*, Prishtinë, 2012, f. 531-534.

¹⁶ Për më shumë shih: Dimitrije Tucović, *Sërbia e Shqipëria*, Prishtinë, 1975, f. 97-99.

¹⁷ "Politika", 15.XII.1912; *Serpske novine*, 17. X. 1912, Cituar nga: Sreten Martinović, *Qëndrimi i ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve në viset e pushtuara në vitet 1912-1913*, "Gjurmime Albanologjike", Seria e shkencave historike VII/1977, Prishtinë, 1978, f. 254-255.

¹⁸ "Dielli", Boston, 11 vjeshtë e III, 1913.

¹⁹ "Taraboshi", 28 t'shtatorit, 1913.

krimet serbe në Kosovë dhe në Dibër²⁰. Kontribut tjetër i shtypit shqiptar të kohës është se i ka botuar të gjitha memorandumet, letrat, korrespondencat dhe protestat e krerëve shqiptarë dërguar personaliteteve dhe kancelarive të Fuqive të Mëdha të kohës, ku protestohej për pa-

²⁰ “Nji gazetë serbishte mi barbarizmat sërbe, “Atdheu”, 30 vjeshtë e III-të 1913; Tuj diftue ne ato pak lajme qi marrim mi barbarizmat serbe në Shqypnie të Sipërme..., përkthejmë këtu fjalë për fjalë mizorinat qi ka ba ushtria serbe në vise të Dibrës e të Kosovës, si i shkruen gazeta serbishte e socialistëve “Radničke Novina” e të shifet sheshazi qytetimi, qi diplomatët serb shkruheshin, se dojshin me na prue ne shqypetarëve. Mbas qi kjen thye shqypetarët prej Struget, Dibret e Pishkopjes nisne m’u bashkue rreth Prizrendit, ku nji tufë ushtore serbe, tuj ardh prej Tetovet mi mal të Sharrit shkoj e i rrethoj. Nji tejskrim u dha asi kohet zyrtarisht prej qeveries serbe, i diftofte botës, se keta të rrethnuemit nuk deshtne me ranë dorë, por kjo asht nji rrenë! Të gjith këta shqypetarë u bane teslim, e mandej kjen da nër trupa ka dhet e dhet, kjen vra të gjith! Usharet kishin urdhënin e përgjithshëm mos me xan rob asnji. Në krahinë të Lumës vepronte taborri X. E I XVIII, I Bor. I X. tabori ishte ma perpara edhe ndër ditët e para shqypetarët i ranë me shpejtim edhe e thynë. Mbas qi erdhi taborri I XVIII me 6 topa shqypetarët kjen shtërngue me ik. Shume kjen nxan rob edhe, tuj ra nër gjuh lypshin me i fal jeten, por kot se kjen mbyt të gjith, o mbytun me ka nji syngji në bark, ose me ka nji plumb kresë. Midis Prizrendit edhe kufinit shqypetar gjindshin nja 15 copë katunde shqyptare, prej të cilave ma e shumëta e tyne nuk kishin marr aspak pjesë në kryengritje edhe mashkullia e tyne po rrihishin nër shpija të veta tuj i pritun si nënurdhës të qetë ushtarët serb. Ato shpresoshin se kishin me kenë të falun, por urdhëni ishte: “ Asnji t’falun, asnji pshtim”. Dy të parat katunde kjenë rrethue edhe komandanti serb bani me ardh të gjith mashkujt e rritshëm, 83 vetë i mblodh në nji vend e i vran të gjith. Në tjerat katunde i muerne shqypetarët e i lidhne nër çeta 40 vetësh edhe i thernë të gjith. Kështu bitë ma lirë, se për ta nuk vinte me harxhue fyshekun. Midis t’ushtarëve gjindeshe edhe nje gabel, i cili me gjith gëzim e bate at punë, në vent qi shum ushtarë t’onë nuk doshin me marr pjesë në këtë gjakderthje. Por kjo nuk asht gjith, ndër gjitha këto katunde shqyptare kjen mytun të gjithë e deri qejt e pulat. Gra e fëmie midis brimëve qi lshoshin, kjenë të therun me syngjia e me thika, ose të vramun. Shpijat gjene ndezun të gjitha, e gratë, të cila si t ë tërbueme, tuj bjertitun u lshoshin, në zjarm, per me pshtue fëmiet e tine kjene vra. Të vramit e te plagnuemit kjenë hjedhun në zjarm, për mos me bjerr kohë tuj i vorrue. Disa gra me fëmie nër durë qi mudoieshin me pushtue në t’ikun prej kësaj mizorie, por kot, se plumbat ishin ma të shpejt, Ushtarët i mbytshin tuj thirr: “ Ndal! Për Zotin ti s’ke me ba ma fëmie!”. Prej 15 katundeve 9 kjene rrënue krejt, në vënt qi nër tjerat muerne të gjith mashkujt qi muejtne me i zan e i vrane. Në rreth të Dibrës vepronte taborri i XII. Ndësisit e atyne katundeve ikne tuj kërke pshtim nër male. Por ndjekist, mas qi i dogjën katundet e tyne mbrinne edhe mizorinat e tine jane të mëdha, sa s’diftohen. Askush nuk pshtoj prej tërbimit t’ushtarëve. Katundet qi ishin shkje për qark, u banë të zotët e gjasë e të mallit të tyne...Në Serbie Jugore (Në Kosovë e Dibër) mbretrojnë paqja. Nuk asht ma kush atje, qi të ngrehet përseri!-“

drejtësitë që ishin bërë ndaj shqiptarëve me caktimin arbitrar të kufijve të Shqipërisë dhe për dhunën që ushtrohej mbi shqiptarët e pushuar nga Serbia²¹. Leo Freundlich, i cili mblodhi raportet e gazetave më të njohura të Evropës mbi krimet serbe në Kosovë në librin tij “Golgota e Shqipërisë” shkruante: *Korrespondenti special i “Daily Telegraph” e raportoi këtë: Sjelljet mizore të trupave të gjeneralit Jankoviq ua shkuan të tana tmerreve të historisë. Serbët, në marshimin e tyre drejtë Shqipërisë, i vranë pabesisht jo veç shqiptaret e armatosur, por në terimin e tyre edhe individet e paarmatosur – pleqtë, gratë, fëmijët dhe bebet në gji të nanave. Të dehun prej fitores, oficerët sërbe shpallën se mënyra e vetme për me prue paqe në Shqipëri ishte me i shfarosë shqiptarët. I vranë 3000 njerëz veç në zonën ndërmjet Kumanovës dhe Shkupit. U vranë 5000 shqiptarë nga sërëbët në zonën e Prishtinës²². Gazeta “Dielli” lidhur me gjenocidin dhe shfarosjen që po bëhej mbi popullatën shqiptare shkruante: *Për çudi moti 1912-1913 na tregoj që Turqia megjithëse humbte luftën, por ushtria e saj u tregua e qytetëruar, se s’trazoj, s’prishi, s’theri njeri, për kundër Aleancës Ballkanike që banë të gjitha barbarizmat, ushtritë e tyre qenë bashibozuk, kasape, vandale, kanibale. Këta s’lanë gurë mi gurë, përmbysën, therën, dogjën, çnderuan, të tëra të ligat i bënë këta qena. Pastaj kanë sy e fytyrë e faqe e thonë luftojmë për kryq e të krishterë²³.**

²¹ Besa Shqyptare, 5 korrik 1913; “Shqypnia e Re”, 6 korrik 1913.

²² Leo Freundlich, *Golgota e Shqipërisë*, Prishtinë 2010, f. 23.

²³ “Dielli”, 1 Gusht, 1913.



Shqiptarë të masakruar nga ushtritë e Aleancës Ballkanike në ballinën e gazetës "Österreichische Illustrierte Zeitung", 15 dhjetor 1912.

3. Krime greke në viset e Jugut

Shtypi shqiptar i kohës raportonte për krime të shumta të grekëve mbi popullatën shqiptare në trevat Jugore të Shqipërisë. Me këtë temë u morën shumica e gazetave të kohës si: "Përlindja e Shqipëniës", "Atdheu", "Shqypnia e Re", "Taraboshi", "Besa Shqiptare", pa dallim,

nëse dilnin në Veri apo në Jug të Shqipërisë apo edhe jashtë atdheut²⁴. Për krimet greke shkruante edhe shtypi i huaj dhe dokumentet e kohës. Në librin "Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit" Haris Silajxhiqi shkruan se nga tetori i vitit 1913 janë djegur rreth 35 mijë shtëpi dhe janë vrarë 20 mijë njerëz në Jug të Shqipërisë, qindra mijëra njerëz kishin mbetur pa ushqim, fondi amerikan për ndihmë të Shqipërisë, i cili përfaqësohej nga Pil Vilit dhe i cili vizitoi Shqipërinë në gusht të vitit 1913, raportonte se në Shqipëri as nuk mund të mendohet se do të gjendeshin aq shumë vuajta të tmerrshme njerëzore.²⁵ Sipas të dhënave të tij, mijëra njerëz janë pa strehë dhe vdesin nga uria dhe malaria. Janë kryer krime të padëgjueshme ndaj grave të pafajshme. Për këto krime çnjerëzore, Pil Vilit akuzonte kishën greke: "Viktimat janë gati të gjithë myslimanë, 200 mijë bektashinj dhe 100 mijë synitë me përjashtim të 10 mijë katolikëve, të cilët nuk provokonin askënd."²⁶ Autori i këtij fondi theksonte se këto kanë ndodhur pas përfundimit të luftërave ballkanike, pra në kohë paqjeje. Pil Vilit theksonte se shqiptarët duhet të ndihmohen se ata meritojnë përkrahje po aq sa edhe shtetet e tjera europiane, sepse ata nuk janë lindorë dhe nuk janë turq, arabë apo persianë; ata janë perëndimorë dhe pjesa më e madhe prej tyre kanë sytë e kaltër dhe janë biond²⁷.

Gazeta "Dielli" e datës 22 gusht 1913 shkruante: *Grekët kur mësuhan se Korça, Gjirokastra, Delvina, Himara dhe Permeti etj., i mbetën Shqipërisë u tërbuan dhe po bëjnë barbari të cilat as hote-ntotët e Afrikës nuk do të pranonin ndonjëherë t'i bënin.*²⁸ "Në Korçë, ushtarët grekë zënë dhe dhunojnë gratë dhe vajzat në mes të rrugëve, si kafshë të egra! Burrat që guxojnë të kundërshtojnë i vrasin menjëherë. Kështu, të birin e Delian Panaritit e vranë, duke

²⁴Fatmira Rama, *Shtypi shqiptar rreth copëtimit të Shqipërisë në Konferencën e Londrës të vitit 1913*, "Studime Historike", 3-4, Tiranë 1999, f. 53.

²⁵Haris Silajxhiq, *SHQIPËRIA dhe SHBA në arkivat e Washingtonit*, Tiranë, 1999, f. 7.

²⁶Po aty.

²⁷Po aty.

²⁸"Dielli", 22, gusht, 1913.

e goditur me një dru në kokë, nga se tentoi të mbronte një zonjë, të cilën oficerët e Greqisë e kishin zanë ta turpëronin. Zotin Nepsi Furxhinë e rrahën nga se nuk deshi të iu bashkohej tradhtarëve dhe të ndihmonte oficerët grekë që t'i rrëmbejnë e t'i dhunojnë femrat e Korçës. Atdhetarin Rehmi Rusi Leskuvikun e burgosën nga se pati kurajo t'i qortojë grekomanët për ndihmën që u japin oficerëve për t'i mbaruar barbaritë e tyre. Në anën tjetër lajmërojmë së grekët po bëhen gati që t'i vënë zjarr Korçës, ta bëjnë pluhur, pastaj të ikin”.²⁹ Lidhur me krimet greke dëshmojnë edhe dokumentet e kohës të cilat raportojnë për krimet të shumta. Për këto krime, delegatët e Çamërisë dhe të Delvinës më 28 dhjetor 1912 i ishin drejtuar Qeverisë së Përkohshme, dhe ky dokument i përshkruan kështu zhvillimet në viset e Jugut të Shqipërisë³⁰: Brenda disa ditëve kur ushtria greke pushtoi Sarandën komitet grekë dhe kretas, sasia e të cilëve arrin në dhjetë mijë me pëlqimin e ushtrisë së rregullt greke, përveç që janë duke grabitur e shkatërruar pasuritë dhe pronat, posaçërisht të popullsisë muhamedane, por janë duke ua prishur nderin grave, vepër të cilin nuk e kanë bërë as popujt e paqytetëruar të mesjetës; kanë vrarë, e therë në mënyrë mizore fëmijët para syve të prindërve të tyre dhe kanë zhdukur krejtësisht popullsinë muhamedane. Dhe disa bashkatdhetarë, që kanë pretenduar kombësinë shqiptare, nuk kanë shpëtuar nga keqbërjet e tyre³¹. Për krimet që sollën Luftërat Ballkanike ka shkruar dhe Vladimir I. Lenini në gazetën “Pravda” e datës 28 tetor 1912³².

Shpend Avdiu

Institute of Albanology – Prishtina

THE CRIMES OF THE BALKAN LEAGUE ACCORDING TO THE ALBANIAN PRESS OF THE TIME (1912-1913)

(Summary)

Summary: In this paper we will mainly present facts which were published in the Albanian press of the time: “Përlindja e Shqipëniës”, “Atdheu”, “Shqypnia e Re”, “Taraboshi”, “Besa Shqiptare”, “Dielli”, etc. The latter also brought to the Albanian readers the views of the international press on the crimes committed against the Albanians by Serbs, Greeks and Montenegrins. These articles are of great importance as they shed light on the crimes of the Balkan League between 1912-1914. Apart from the Albanian press we have also used a number of international newspapers and studies regarding the events that took place in the Balkans during that period.

²⁹ Po aty.

³⁰ Republika e Shqipërisë, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, *Dokumente për Çamërinë 1912-1913*, Tiranë, 1999, f. 2.

³¹ Po aty.

³² Vladimir I. Lenin, *Mbi çështjet ballkanike*, Tiranë, 1971, f. 36.

شبنه عفديو

مجازر تحالف البلقانيين ضد الالبانيين طبقا للصحافة الالبانية

(١٩١٢-١٩١٤)

(خلاصة البحث)

ملخص : لقد اعتمدنا على هذه المقالة عن المعلومات التي وفرت لنا الجرائد التي صدرت في تلك الحقبة التاريخية في البانيا او خارجها مثل: "مولد البانيا" "الوطن" "البانيا الجديدة" "طرابوشى" "بيسا الالبانية" "الشمس" الى آخره . هذه الجرائد كانت تنقل الى القارىء الالبانى موقف الصحافة العالمية عن جرائم الصرب و الجبل لاسود و اليونان ضد الشعب الالبانى . يكمن في هذه المقالات قدر كبير من الاهمية لدراسة مجازر تحالف دول البلقان ضد الالبانيين خلال الفترة ١٩١٢-١٩١٤ . الى جانب الصحافة الالبانية اعتمدنا على بعض الصحف الاجنبية و كذلك دراسات مختلفة حول الاحداث التي حدثت خلال سنوات ١٩١٢-١٩١٤ في البلقان .

KUMTESË

Mr. sc. Rezehana Hysa

ÇAMËRIA SHQIPTARE

Hyrje

Konferenca e Londrës, me vendimet e saj u dha një goditje të rëndë trojeve etnike shqiptare. Ato jo vetëm që u shkëputën nga trualli i tyre, Kosova dhe viset tjera shqiptare, por njëkohësisht në mënyrë krejtësisht të padrejtë, më 11 gusht të vitit 1913, iu fal dhe iu njoh Greqisë de jure gjithë Krahina e Çamërisë. Andaj, në shenjë revolte ndaj këtij vendimi famëkeq kudo në Shqipëri, dhe në në trojet etnike shqiptare shpërthyen kryengritje të mëdha, ndaj të cilave formacionet ushtarake greke ndërmorën masa të rrepta ushtarake, gjegjësisht arrestime, burgosje, terrorizime, ekzekutime dhe dëbime me forcë të popullsisë çame në Greqi. Ndërkohë, një fenomen i egër që ndërmori qeveria greke në atë kohë ndaj shqiptarëve, ishte edhe konvertimi i fesë nga mysliman në ortodoks, duke e trajtuar popullsinë çame ortodokse si greke dhe duke iu ofruar asaj disa privilegje. Si rezultat i gjendjes së krijuar dhe ndasisë në çamë ortodoksë dhe myslimanë, popullata çame në shenjë revolte dërgoi një memorandum te Qeveria Austro-Hungareze për të shprehur vullnetin e saj, gjegjësisht bashkimin e tyre me shtetin e pavarur shqiptar.

I.Gjeografia politike dhe historike e Çamërisë

Çamëria¹ është krahina që përbën pjesën më jugore të trevave të banuara me shqiptarë, e cila shtrihet përgjatë bregdetit Jon dhe zgjerohet në lindje deri në vargun e maleve që ndajnë prej pellgut të Janinës. Në veri ka kufi lumin Pavël, kurse në jug gjirin e Prevezës, rripi i saj verior me qendër Konispolin, bën pjesë nën juridiksionin shqiptar, kurse pjesa tjetër me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve më 1913, i përket shtetit grek. Emri çam lidhet me emrin antik të I.Thyamis-Kalamas). Në sundimin osman Çamëria bënte pjesë në Sanxhakun e Delvinës, si dhe të Janinës dhe u bë shesh i kryengritjeve anti-osmane në shek.XVI dhe në fillim të shek. XVII. Në vitet 1820-1850, Çamëria u përfshi në kryengritjet e mëdha anti-osmane. Ndërsa në vitet 1854 dhe 1877, inkursionet e bandave të andartëve grekë u pritën me armë në dorë nga popullsia shqiptare. Degët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në Çamëri, morën pjesë në luftën e përgjithshme të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi dhe në mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë. Gjatë kryengritjeve anti-osmane të viteve 1908-1912, Çamëria ka qenë fushëveprimi e çetave patriotike shqiptare dhe e një varg komitetesh kombëtare. Ndërsa gjatë kryengritjeve të Luftës Ballkanike të viteve 1912-1913, në Çamëri vërshuan trupat greke, ku popullsia vendëse, gjegjësisht shqiptare u mobilizua në mbrojtjen e tërësisë territoriale nga andartët grekë. Edhe pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, shteti i ri shqiptar dërgoi forca ushtarake për çlirimin e Çamërisë, por ² për fat të keq ajo u shkëput dhunshëm nga shteti amë me vendimin e Konferencës së Londrës, më 1913, për të cilën u zhvillua një luftë e ashpër në pranverë po të këtij viti. Qindra mijëra luftëtarë shqiptarë dhanë jetën në luftë me pushtuesit grekë, të cilët i udhëhiqte vetë mbreti i tyre, çuditërisht edhe sot e kësaj dite nuk hi-

¹ Çamëria është krahinë shqiptare në Epirin e jugut që fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite është nën juridiksionin grek.

² Fjalori enciklopedik shqiptarë, Tiranë, 1985, faq.149

dhet dritë mbi fatin tragjik e gjenocidial të Janinës, kryeqendrës së famshme të Epirit, apo thënë ndryshe të Shqipërisë së Jugut.³ Mbi 200.000 e më shumë çamë që jetojnë të përzënë me dhunë larg vatrave të tyre amtare, në qytetet më pranë Shqipërisë si Filati, deri në Prevezë, pranë gjirit të Artës, kanë frigë të shprehen hapur në gjuhën e nënës, ngase shteti nacionalist grek pa mëshirë do t'i ndëshkonte ata në forma të ndryshme.⁴ Çamëve në Greqi, u mungon arsimimi në gjuhën shqipe, shtypi i shkruar, mediet elektronike po në gjuhën shqipe etj., ndërsa Athina zyrtare vazhdon të valvisë me të madhe në Ballkan flamurin e BE-së. Sipërfaqja e Çamërisë është diku 100.000 km katrore. Gjeografia politike e tij përmbledh jugun e sotëm shqiptar si dhe veriperëndimin grek. Në të hyjnë krahinat e Vlorës, Tepelenës, Gjirokastrës, Këlcyrës, Përmetit, Kolonjës, Delvinës, Sarandës, Konispolit, nën juridiksionin e Shqipërisë, si dhe Konica, Delvinaqi, Janina⁵, Mecova, Arta,⁶ Preveza,⁷ Parga⁸, Gumenica,⁹ Paramithia¹⁰,

³ Arben Kondi: Si Kosova, Çamëria është gjaku ynë "Tiranë, 2008 dhe e publikuar edhe në gazetën "Flaka, Shkup, 2002, faqe 8

⁴ Po aty...faq.9

⁵ Janina prej shekujsh njihet si kryeqendra e Epirit. Dëshmi të cilën e ka pranuar edhe vetë presidenti i parë grek, Kapo D. Istria. Janina njihet për gjimnazin "Zosimea", ku kanë studiuar shumë figura të shquara të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, midis tyre edhe tre vëllezërit Frashëri. Luftat heroike të kryeqendrës së Epirit, Janinës, nga pushtuesit e huaj zë vënd me rëndësi në shkrimet e shumë historianëve me permasa ndërkombëtare. Kështu, historian i shquar Tuqiditi, në kryeveprën e tij "Lufta e Peleponesit" 432-404 p.e.s. midis tjerash shkruante: "Në luftën e madhe që përbiu grekët kishte dhe një pjesë të fiseve barbare që nuk ishin greqishfolës (cituar sipas Arben Kondit: "Rikthim në Çamëri, Tiranë 2008, faq.26)

⁶ Arta është qytet shqiptar, i mbetur në shtetin grek të Epirit. Ka një popullsi prej mbi 20 mijë banorësh ose më saktësisht është qyteti i dytë më i madh në Epir, pas Janinës, e cila ka mbi 60 mijë banorë. Copëtimi i saj prej trungut mëmë ka ndodhur pas Kongresit të Berlinit, më 1878, ku Fuqitë e Mëdha për të kënaqur lakmitë e Greqisë ia bashkangjiten qytetin e Artës asaj. Politikisht ndarja është bërë në vitet 1881-1882. Po këto vite shënojnë edhe copëtimin e një pjese të veriperëndimit të Shqipërisë me trevat e Ulqinit dhe Tivarit, të cilat u bënë lakmi të Malit të Zi. (cituar sipas: "Arben Kondit" Epiri, Tiranë, 2008, faq.120)

⁷ Preveza, para 120 vjetësh konsiderohej qendra e atdhetarizmit shqiptar. Në Shtëpinë e Abedin Dinos mbledheshte gjithë paria e Shqipërisë, në të cilën diskutohej për mbrotjen e trojeve etnike. Konzulli francez i Janinës, Moro, në një raport që i dërgonte shefit të tij në Paris, ministrit të Jashtëm Vandino, më 7 shkurt 1879, ndër të tjera shkruan: "Në kë-

to momente Preveza është caktuar qendra e veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pikërisht sot kam pasur rastin të shoh një kërkesë të shqiptarëve drejtuar të gjithë ministrave të Punëve të Jashtme të qeverive të përfaqësuesve të Kongresit të Berlinit. Ata edhe me shkrim po deklarohen se" në qofë se Epiri do t'i aneksohej Greqisë, atëherë kjo krahinë do të mbrohej deri në pikën e fundit të gjakut të tyre. Një forcë prej 30.000 njerëzish, thuhet se janë të gatshëm t'i kundërshtojnë çdo përparësi greke."

Falë këtij mobilizimi megaliedistët grekë filluan të tërhiqen, ndërsa fatkeqësisht në vend të saj e pësoi Arta, që historia e njeh si kryeqendër të princit mesjetar çam, Gjin Bua Shpata. Kështu, Arta u bë viktimë e pazarllëqeve mes Portës së Lartë me Fuqitë e Mëdha, të cilat vazhdonin ta trajtonin me përkëdheli Greqinë. Ndërkaq, Sami Frashëri thekson se Preveza quhet Berenika, sipas emrit të vjehrës Piro –Burrit dhe i ndërtuar po nga ai. Në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Preveza mbetet porta hyrëse në gjirin e Ambrakisë, me një infrastrukturë të rregulluar mirë dhe me një ekonomi të zhvilluar si dhe me tri shkolla, dy nga të cilat shkolla fillore. Sipas burimeve arkivore, Prevezën e patën pushtuar edhe francezët në shekullin e XVIII, ndërsa Ali Pashë Tepelena vendosi ta merrte Prevezën me luftë. Aleanca Ballkanike ishte një tjetër goditje për Prevezën, ngase shteti grek qëndronte në krye të kësaj Aleancë, gjegjësisht i erdhi rasti i përshtatshëm për ta pushtuar Epirin. Kështu u vendos që sulmi të niste pikërisht mbi Prevezë, ku anije të shumta luftarake greke dhe goditjet artilerike prej zjarrit të pandërprerë e dogjën dhe e shkatërruan barbarisht kryeqendrën e Çamërisë. Edhe përkundër rezistencës heroike të shqiptarëve dhe humbjes së madhe të ushtrisë greke, shqiptarët nuk i rezistuan dot armatimit më modern të kohës greke dhe u detyruan të tërhiqen, që nënkupon që Preveza ra definitivisht në duart e shovenistëve grekë. Sot, Preveza është një qytet me rreth 15-20 mijë banorë, për nga madhësia qyteti i tretë në gjithë Epirin e jugut. Renditet menjëherë pas Janinës dhe Artës, me godina të ulëta dy—tre katëshe. Preveza kaqzës shekullore shqiptare i dha shumë burra trima dhe atdhetarë të vërtetë, të cilët ushtarakisht u vunë në ballë të mbrotjes dhe dinjitetit shqiptar. (më gjëresisht në librin e Arben Kondit: "Rikthim në Çamëri, Tiranë, 2008, faq.154

⁸ Parga është një qytet i mrekullueshëm në Çamëri, ku të huajt e quajnë perla e Çamërisë. Barbaria greke gjatë shekujve ka krijuar dhe vënë në skenë sa e sa tragjedi mizore. Sa e sa çamë të pafajshëm janë pushkatuar brenda Kalasë së Pragës. (cituar sipas Arben Kondit: "Epiri", Tiranë 2008, faq.142)

⁹ Gumenica shtrihet përgjatë bregdetit, përballë këndit fundor të ishullit të Korfuzit. Për nga madhësia vjen pas Janinës, Artës dhe Prevezës. Qytet me rreth 10.000 banorë. Diktatura nacionaliste shovene greke ushtron presion të fortë mbi ta. Gumenicasit nuk mund të përdorin gjuhën shqipe lirshëm nëpër ambiente publike, andaj shqipja flitet nën zë. (Arben Kondi: "Rikthim në Çamëri, Tiranë, 2008, faq.97)

¹⁰ Paramithini është kërthiza e Çamërisë, gjeografikisht gjendet mes Sulit dhe Mininës. Gjuha shqipe flitet edhe sot e kësaj dite. Se Paramithini është shqiptar, e dëshmon edhe Fjalori shqip-frengjisht, i shkruar nga kryetrimi suliot Marko Boçari, me sugjerimin e Pukëvilit (konzull francez pranë Ali Pashë Tepelenës), i cili ruhet me fanatizëm si një dokument tepër i rëndësishëm në Bibliotekën Kombëtare të Parisit. Edhe pse histografia greke ende vazhdon ta trumbetojë krahinën shqiptare të Sulit, si një vatër të zjarrtë të atdhetarizmit grek. Paramithini, më 27 qeshor të vitit 1944, do të mbetet në kujtesë si një Shën Bartolome i vërtetë. Brenda pak orëve u vranë e u prenë si bagëti mbi 800 shqip-

Margëlliçi¹¹, Filati¹² dhe qindra fshatra shqiptare nën juridiksionin grek (Greqi). Çamët e Çamërisë, prej Filatit e deri në Prevezë, këndojnë dhe kërcëjnë njëllon sikur çamët e Shqipërisë. Shtëpitë çame si këtej kufirit po ashtu edhe andej kufirit janë njëllon. Shtëpitë e Filatit, Margëlleçit e Paramëthisë janë sikur ato të Konispolit. Ato më të vjetrat, tërësisht me gurë, të ngritura mes një arkitekture të thjeshtë dhe pa ndërlikime. Madje, edhe shtëpitë gjermadha të çamëve myslimanë shquhen për mënyrën e ndërtimit të thjeshtë me dhomë përmbi dhomë. Me një korridor mesatar në mes, identik si për katin e parë ashtu edhe për të dytin. Por, ajo që është më me rëndësi është që çamët e të dy anëve si këtej kufirit po ashtu edhe jashtë kufirit kanë

tarë të pafajshëm. Mes tyre nuk u bë as më i vogli dallim. Por, sidoqoftë paramithiotët arritën t'u bënin ballë përkohësisht bishave rezerviste, edhe pse Paramithia kërthiza e Çamërisë u zaptua. (cituar sipas "Epiri" v.p.e cituar, faq.126)

¹¹ Margëriçi bën pjesë në Çamërinë e Mesme. Dikur ky qytet kishte 5000 banorë (cituar sipas Arben Kondit "Rikthim në Çamëri" Tiranë, 2008, faq.124)

¹² Filati është qytet tipik shqiptar, mes Konispolit dhe Delvinës, me 5-6 mijë banorë dhe me plagë të pambyllura të gjenocidit antiçam. Edhe pse gati një shekull vuan në robëri ajo përsëri mbetet kryeqendra e Çamërisë Veriore, por edhe një ndër qytetet liridashëse të Epirit, Shqipërisë Jugore. Filati konsiderohej si një ndër qytetet më të rëndësishme në kryengritjen shqiptare të viteve 30-40 të shekullit XIX, kundër pushtuesit osman. Qëndresë e çamëve ndaj mobilizimit ushtarak të Mehmet Reshit Pashës, në vitin 1829, e pati pikënisjen në veri të lumit Kalama. Dështimi i këtij mobilizimi ndikoi më tej në konsolidimin e pavarësisë së shtetit të ri grek. Ndërkaq, lëvizja shqiptare aspironte për lirinë e vet nga zgjedhja otomane. Kësaj kryengritësit shqiptarë ndodheshin mes dy zjareve, në njërën anë ishin forcat osmane, ndërsa anën tjetër shtriheshin thonjtë e megalidesë që sapo kishin nisur të skicoheshin. Kështu në mes të hekurit osman e pabesisë greke u shuan njëra pas tjetrës vatrën e rëndësishme të kryengritësve shqiptarë për gjatë Epirit. Në fillim të viteve 50, si pasojë e konsolidimit të shtetit grek dhe përkrahjes së disa fuqive të mëdha europiane, gjegjësisht në vitin 1854, megaloida në Çamëri u vu menjëherë në krye të luftimeve si rezultat i së cilës u bë një gjenocid i paparë ndaj popullatës shqiptarë çame, ndërsa luftëtarët çamë iu kundërvunë grekëve dhe i detyruan të tërhiqen prej Filati dhe tërë Çamërisë së Mesme. Në vitin 1878, andarët grekë do të shkelnin përsëri tokat shqiptare. Duke qenë se ky vit shënon krijimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashëri synonte sërisht të bashkëpunonte me grekët, mirëpo mirëkuptimi dështoi. Tashmë megaloida mbizotëronte prej vitesh politikën helene. Luftërat e ashpra midis shovenistëve grekë, të cilët nuk heqnin dorë kurrë nga synimet e pushtimit të tokave shqiptare dhe luftëtarëve shqiptarë vazhdonin, andaj Greqia tentoi t'i pushojë edhe njëherë në vitin 1897, por përsëri rezistenca shqiptare ishte e fuqishme. (Arben Kondi: "Rikthim në Çamëri, Tiranë, 2008, faq.112)

identitetin e njëjtë, traditat, kulturën dhe gjuhën mijëvjeçare shqipe të njëjtë.¹³

II. Epiri

Epiri, kryeqendra e Shqipërisë së Jugut¹⁴, në kohën antike përbëhej prej tri fiseve kryesore. Kaonët, të cilët shtrihen që prej lumit Vjosë, e deri në lumin e vogël të Pavlit (të Shalsit) duke përfshirë në këtë hapësirë bregdetin e Vlorës, të Himarës, të Sarandës. Thesprotët (çamët e sotëm), të cilët jetojnë përgjatë bregdetit jugor të Jonit, prej lumit të Pavlit (Shalsit) e deri në gjirin e Ambrakisë (Preveza e sotme). Pa harruar këtu edhe disa fise të vogla si amfilotët, apodotët, të cilët kanë pasur gjuhë dhe zakone të njëjta me ato të fisit të madh të Thesprotëve. Fisi i tretë dhe i rëndësishëm për Epirin kanë qenë Mollosët. Ata shtriheshin prej ujërave të detit Jon, në brendi, duke përfshirë Tepelenën, Gjirokastrën, Grebenenën, Meçovën dhe Artën e skajshme.

¹³ Epiri, v.p.e cituar, faq.70

¹⁴ Në aspektin historik, Epiri është një trevë e vjetër, ku mijëra vite kanë jetuar shqiptarët e jugut ose siç i quajnë ndryshe toskët. Po t'i referohemi historisë, Epiri banohej nga shumë fise, ndër të cilat më kryesorët ishin tesprotët, kaonët dhe molosët. Me gjithë disa veçori të jetës kulturore e politike këto fise ishin etnikisht të një trangu me ilirët, me të cilët i lidhte gjatë gjithë periudhave të historisë së tyre, një fond i gjërë i përbashkët traditash, që ndryshonin nga ato të Greqisë antike. Epiri i dha historisë një numër të konsiderueshëm të luftëtarëve trima, të cilët njihen botërisht edhe sot e kësaj dite. Ndër emrat më të dëgjuar është mbreti Pirro(307-272 p.e.r). Pirroja arriti të sundonte për një kohë jo vetëm tërë Epirin, por edhe një pjesë të madhe të Maqedonisë dhe të Tesalisë, në lindje si dhe mbi krahinat greke të Ambrakisë, Amfilokisë dhe Akarnanisë në jug etj. Gjatë sundimit të Pirros, shteti i Epirit u bë një nga fuqitë më të rëndësishme ushtarako-politike të kohës që luajti rol të shënuar në zhvillimin e ngjarjeve në Maqedoni, Greqi e Itali, ndërsa në vitet 30 të shekullit të III p.e.s u kthye në një bashkim shtetëror republikan me emrin Lidhja Epirote. Me reformën administrative të Dioklecianit në fund të shekullit III emërtimi Epirot u shtri edhe në trevat në veri të Vjosës, të cilat formuan provincën Epiri i ri, i cili përfshinte krahinat e Shqipërisë së sotme qëndrore dhe jugore dhe kishte qendër Dyrrahun (Durrësin e sotshm), ndërsa për t'u dalluar nga kjo trevat tradicionale të Epirit, u quajtën provinca të Epirit të vjetër me qendër Nikopolin (Prevezën e sotme). Këto emërtime vazhduan të përdoren gjatë mesjetës nga autorë të ndryshëm, ndërsa administrata bizantine njëjtë vetëm themat e Nikopojës dhe të Durrësit. Ndërsa në shekullin XV-XVI, termin Epiri e përdorën pa e dalluar Epirin e Rri me atë të Vjetrit për mbarë trevat shqiptare që në të vertetë përputheshin vetëm pjesërisht me shtrirjen e Epirit.(cituar sipas Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985, faq.241)

Dëshmi të cilën e kanë pohuar shumë dijetarë të lashtë helenë, duke përfshirë edhe historianin e famshëm grek Herodotin, të cilët kanë konfirmuar se këto fise nuk e flasin gjuhën greke, por ata flisnin një gjuhë të panjohur dhe të pakuptueshme për ta.¹⁵

Ndërrimi i shekujve e profilizon Epirin sipas qytetërimeve të ndryshme. Kështu, do të lënë gjurmë romakët, bizantinët, sllavët, osmanët. Pjesa dërrmuese e kronikanëve të Perandorisë, asnjëherë nuk i kanë njësuar epiriotët me helenët dhe grekët. Gjenezën e tyre shqiptare ata do ta shfaqin më së shumti gjatë mesjetës e këtej. Në mënyrë të veçantë, Epiri do të shkëlqente gjatë periudhës së Ali pashë Tepelenës¹⁶, shekulli XVIII-XIX.¹⁷

Prej një popullsie prej 650.000 banorësh që kishte Epiri në fund të shekullit XIX dhe në fund të shekullit të XX, grekët rezultojnë vetëm 60-70 mijë veta, ndërsa shqiptarët 550 mijë. Pjesa e mbetur përbëhej prej vllahëve dhe çifutëve.¹⁸ Gjenocidi grek ndaj epiriotëve dhe sjellja në Epir e ardhacakëve të Anadollit, në periudhën e viteve 1923-1926, do ta ndryshonin raportin etnik mes shqiptarëve dhe grekëve. Vetëm se ky raport nuk mund të tjetërsohet kurrësi në favor të grekëve.¹⁹

¹⁵ Arben Kondi: "Shqipëria etnike" Tiranë, 2003, , faq.183

¹⁶ Ali Pashë Tepelena, themelues i Pashallëkut autonom të Janinës, kryengritës kundër pushtetit të Portës Osmane në Shqipëri. Më 1784 fitoi gradën e "pashait" si komandant ushtarak pranë Valiut të Rumelisë në Sofje. Po në këtë vit siguroi qeverisjen e Sanxhakut të Delvinës. Në vitin 1786-1788 u bë qeveritar i Sanxhakut të Tërhallës dhe në ndërkohë mori në dorë qeverisjen e Sanxhakut të Janinës, duke e shtrirë kështu pushtetin e vet mbi Epirin dhe një pjesë të trojeve jugore shqiptare. Në kohën e qeverisjes së tij, Janina u bë një nga qytetet më të rëndësishme dhe më të begatë në viset përëndimore të Ballkanit, që përfshinte një varg krahinash të Shqipërisë, një vatër arsimore dhe kulturore, ku filloi të përdorej përveç greqishtes si gjuhë shkrimi edhe gjuha shqipe. Në vitet 1798-1812 Ali Pashë Tepelena arriti të zgjeronte e të përforconte pushtetin e vet, duke përfshirë trevat që nga gjiri i Prevezës deri në afërsi të lumit Shkumbin. Kështu Pashallëku i Janinës u bë faktor me rëndësi ndërkombëtare në kushtet kur forcat franceze dhe ruse që ishin vendosur në ishujt Jonianë si dhe Anglia, drejtuan vëmendjen e tyre ndaj sundimitarit të fuqishëm shqiptar dhe krijuan lidhje direkte diplomatike me të, duke kapërcyer Portën e Lartë. (cituar sipas Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985, faq.1085)

¹⁷ Arben Kondi: "Shqipëria Etnike, Tiranë 2003, faq.183

¹⁸ Po aty..., faq.184

¹⁹ Po aty..., faq.185

Ndërlikimet në Epir, do të krijohen fill pas pavarësisë së Greqisë, më 1832. Megalaidea, kjo strategji pushtuese do të synojë përçarjen e shqiptarëve të krishterë me ata myslimanë. Besimi fetar do të shpallej më i rëndësishëm se kombi. Në këtë mënyrë, çdo shqiptar i krishterë konsiderohej grek. Kisha dhe shkollat greke do të përbëjnë kolonat e fuqishme, ku do të mbështetej kolonizimi i Epirit. Thika në emër të kryqit do të përgjakë shumë atdhetarë shqiptarë të besimit ortodoks, si Papa Kristo Negovani, Petro Nini Luarasi, At Stath Melani etj., të cilët konsiderohen se janë ndër viktimat e gjenocidit grek.²⁰

Ndërkohë, që copëtimi i parë i Epirit është pasojë e Kongresit të Berlinit, më 1878, që shkëputi nga trungu amë qytetin e Artës, tok me rrethinën e saj.²¹

Fatkeqësisht Konferenca e Ambasadorëve në Londër, siç bëri me trojet veriore shqiptare, të cilat një pjesë të madhe ia fali ish-Jugosllavisë, po ashtu veproi edhe me pjesën tjetër të shtetit shqiptar, duke ia falur një pjesë të konsiderueshme shtetit të përkëdhelur grek.²²

III. Roli i kishës ortodokse greke në asimilimin e shqiptarëve

Kisha ortodokse i përçau shqiptarët në myslimanë dhe ortodoksë, duke i quajtur ortodoksit grekë dhe myslimanët shqiptarë. Prifërinjtë ortodoksë kanë qenë në krye të lëvizjeve antishqiptare në Ballkan. Ata kanë qenë frymëzuesit shpirtërorë të nacionalizmit grek dhe të masakrave që janë ndërmarrë ndaj shqiptarëve. Madje, priftërinjtë u predikonin epiriotëve që të mësonin gjuhën greke, duke u thënë: *"Dërgojeni fëmijët tuaj të mësojnë në gjuhën greke sepse kisha jonë është greke dhe ti vëllai im, po nuk mësove greqisht nuk mund të kuptosh atë që thotë kisha. Më mirë të kesh shkollë greke në vendin tënd sesa të kesh burime dhe lumenj. Cilido i krishterë burrë apo grua qoftë, i cili më premtonte që nuk do të flisë shqip në shtëpi le të ngrihet në këmbë dhe*

²⁰ Po aty...faq.16

²¹ Epiri, v.p. e cituar...faq.16

²² Po aty...faq.16

do më thotë këtu. Unë do t'i marrë të gjithë mëkatet e tij mbi vete që nga dita e lindjes së tij deri më sot dhe do t'i porosis të gjithë të krishterët që t'i flasin dhe do t'ia shlyej të gjithë mëkatet. Atij nuk do t'i jepej kjo mundësi edhe sikur të japë para me thasë"²³. Kështu kisha ortodokse greke i ftonte shqiptarët që të flasin dhe të mësojnë në gjuhën greke, ngase kisha greke nuk mund të bëhej asnjëherë shqiptare. Pra, siç shihej qëllimi i kishës greke ishte asimilimi i shqiptarëve në grekë.²⁴

IV. Rezistenca shqiptare në ruajtjen e identitetit kombëtar

Në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, skicohet portreti i Ali Pashë Tepelenës, ndërsa në dekadat e mëtejshme të shek. XIX, vatrat kryengritëse do të shpërndahen në mbarë Epirin. Kapedanët e njohur, si Zenel Gjoleka, Rrapo Hekali, Hodo Nivica, Tafil Buzi, Zylyftar Poda, Islam Pronjo etj., bashkë me çetat e tyre do të luftojnë për lirinë e Çamërisë. Shpejt betejat e shqiptarëve do të shtriheshin në dy fronte. Do të luftohej si ndaj pushtuesve osmanë ashtu edhe ndaj provokimeve të herëpashershme të andartëve grekë²⁵. Tashmë shteti i ri grek e kishte konsoliduar pavarësinë e tij. "Megaloidea"²⁶ kishte zgjatur kthetrat.

²³ Elena Kocaqi: Planet për zhdukjen e shqiptarëve, Tiranë, 2009, faq.11

²⁴ Po aty..faq.12

²⁵ Epiri, v.p. e cituar, faq.50

²⁶ Megaloidea ishte program i nacionalistëve helen që pretendonin të ndërtonin një shtet të madh grek, i cili do të përfshinte territore me popullsi të huaj. Ky shtet i madh grek do të shtrihej nga deti Jon deri në Azinë e vogël duke përfshirë Epirin, Trakën, dhe një pjesë të Turqisë së sotme me kryeqytet Konstandinopojën. Megaloidea deri në vitin 1923, gjegjësisht Greqia arriti të marrë në territorin e saj Epirin e Jugut të Shqipërinë, si dhe një pjesë të Maqedonisë dhe Trakës antike. Megaloidea arriti të zgjerohet edhe në Azinë e Vogël, por kjo ëndërr u prish nga Ataturku. Megaloidea u realizua nga Venetolosi, i cili mori pjesë në luftrat ballkanike dhe në Luftën e Parë Botërore, vetëm për t'i përmbushur dëshirat ekspansioniste të shtetit "artificial" grek. Pra, siç shihej helenistët si ai donin të zëvendësonin Perandorinë Osmane me një Perandori të re greke që do të përfshinte edhe kombe të tjera, të cilat për pak vite do të bëheshin automatikisht greke. Kështu që Greqia të justifikonte këto pretendime duhet të nxirte fakte të qena dhe të paqena, me qëllim që të vërtetonte së këto territore i përkisnin asaj. (Cituar sipas Elena Kocaqi, Plani për zhdukjen e shqiptarëve, Tiranë.... faq.96

Pas viteve 1850, do të sulmohej disa herë Çamëria, jugperëndimi i Epirit. Krimet e andartëve grekë bëhen të panumërta. Përballë rezistencës së çetave të Çelo Picarit, Halit Frashërit, Ahmet Çaparit, etj., grekët do të pësojnë disfata të rënda. Në këtë mënyrë do të detyrohen të kthehen në Thesali, nga u nisën.²⁷

Në vitin 1878, andartët gjakatarë grekë u dyndën përgjatë bregdetit. Zbarkimi dhe organizimi i trupave andarte greke u bë në Himarë, në Ksamil, në Sarandë, mes tyre kishte shumë kretas, kriminelë ordinerë. Që këtej andartët grekë iu drejtuan Delvinës. Në fillim ata mundën të zmbropsin mbrojtësit shqiptarë. Pas luftimeve të ashpra, andartët grekë arritën të pushtojnë edhe pikën strategjike të Qafës së Gjashtës. Në mbrojtje të atdheut ranë me dhjetëra luftëtarë shqiptarë. Kriminelët grekë nuk u kënaqën me kaq, ata përgjakën mizorisht popullsinë e pafajshme të fshatrave përreth. Mbi 150 veta u masakruan. Ndërkohë shtypi grek trumbetonte me të madhe "fitoret" e andartëve grekë. Gazetat e Athinës buçisnin prej titujve bombastikë si p.sh., "çlirohen viset e okupura" etj., etj. Ndërkaq, Qeveria e Athinës vendosi të shtojë forcat e reja ushtarake, kështu në Korfuz zbarkuan formacione të reja me synim për t'u shpërndarë përgjatë gjithë bregdetit të Epirit, ku për pasojë ra edhe Saranda. Situata po ndërlikohej edhe më shumë, prej Lëkurës largohen edhe rrefugjatët e parë, mbi 100 fëmijë, gra dhe pleq lanë shtëpitë e tyre. Mirëpo, sukseseve të andartëve grekë shpejt do t'iu vinte fundi. Reparte ushtarake të shqiptarëve të Janinës, Çmërisë, Gjirokastrës, Labërisë, Himarës me në krye Myslim Gjolekën iu kundërvunë fuqishëm pushtuesve grekë. Shqiptarët nga ana e detit patën edhe mbështetjen e anijes luftarake osmane "Mahmudie". Për rrjedhojë pika strategjike e Qafës së Gjashtës bie në duar të vendësve. Pas kësaj forcat andarte greke u thyhen keqas edhe në Lëkurë, Sarandë e në ndonjë pikë tjetër. Gjatë tërheqjes kaotike përdrejt Korfuzit nga ku ishin zbarkuar një numër i madh ushtarësh grekë do të mbyten në det. Mirëpo, mbetën pa u shpartalluar disa njësi kretase, të cilat vepronin më në brendi të bregdetit. Kështu

²⁷ Epiri, v.p.e cituar, faq.50

grekët, duke kuptuar se gjithçka kishte marrë fund në favor të shqiptarëve, kriminelët ordinerë kretas detyrohen të tërhiqen përtej Epirit.²⁸

Në korrik të vitit 1880, figura më madhore e Çamërisë, Abedin Dino²⁹, ish-ministër i Jashtëm i Perandorisë Osmane, në një letër dërguar ambasadorëve të Fuqive të Mëdha lidhur me rishikimin e kufirit shqiptaro-grek, ndër të tjera shkruan: *"Si mund të pranojmë të lëshojmë Janinën, po të merret parasysh që shqiptarët e kanë quajtur gjithmonë atë si kryeqytetin e Shqipërisë së poshtme dhe e mbrojnë zotërimin e saj, siç dihet me aq këmbëngulje". Për sa i përket minoritet grek që ka banuar në Janinë, si dhe në mbarë Epirin, duhet thënë se ata nuk kanë qenë vetëm se mbeturina të ngulmimeve të vjetra heles në fushë të Helopisë, apo të ardhur si bujq në tokat e bejlerëve shqiptarë.*³⁰

²⁸ Epiri, v.p.e cituar, faq.74

²⁹ Abedin Dino, figura më e rëndësishme dhe më madhështore e historisë së Çamërisë, ndër personalitetet më të shquara të kombit, i cili nuk lejoi që për plot 35 vjet, gjegjësisht prej vitit 1878-1913 të mos pushtohet Epiri nga grekët. Abedin Dino është nga Preveza, edhe pse origjina e familjes së tij është nga Lopsi i Filatit. Babai i tij, Ahmet Dino, qe një emër i shquar i kryengritjeve anti-greke dhe anti-osmane, i cili për shkak të aktivitetit të tij luftarak Porta e Lartë e burgosi larg në Anadoll, ku edhe vdiq, ndërsa fëmijëve iu la pasuri të madhe. Abedin Dino i shkolluar në Stamboll, njohës i gjuhëve kryesore të Perëndimit dhe të Lindjes si: italisht, frengjisht, greqisht, turqisht, persisht, arabisht etj. Erudicionin i tij vlerësohet prej shtypit europian. Kështu gazetat franceze, turke, greke shkruajnë për talentin e tij. Në vitet e para të karrierës së tij diplomatike kthehet në vendlindje dhe punon si nënprefekt në qytetet e Prevezës dhe Artës. Ndërkaq, kulmi i shkëlqimit të tij politik konsiderohet viti 1904, ku pasi pati punuar në detyra tepër të larta në Selanik, ishujt e Egjeut etj., thirret nga sulltani Abdyl Hamiti në Stamboll, për të marrë postin e kryeministrit të Perandorisë. Por, papritur vdes në oborrin e madh. Thuhet se u helmua nga një agjent rus, kamarier në pallatin perandorak. Në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abedin Dino shpejt bëhet udhëheqës kryesor i saj për pjesën e poshtme të Shqipërisë (Epirin, Çamërinë). Ndërsa në vitin 1878, kur Kongresi i Berlinit i kërkonte me ngulm Portës që ta lëshonte Epirin e në këtë kuadër edhe Çamërinë, në shtëpinë e tij në Prevezë, organizohet një Kuvend i madh, ku merr pjesë e gjithë paria shqiptare e jugut dhe e veriut. Në këtë mbledhje historike, të mbajtur në janar të vitit 1879, u deklarua vendosmëria dhe gatishmëria e mbi 20.000 luftëtarëve shqiptarë për mbrojtjen e Epirit dhe të Çamërisë. Kështu, Perandoria Osmane detyrohet të mos i bëjë koncension Greqisë. (Arben Kondi: "Rikthim në Camëri" Tiranë, 2008 faq.162)

³⁰ Epiri, v.p.e cituar, faq.119

Në vitin 1897, andartët grekë sulmuan sërish Epirin, Shqipërinë e Jugut. Por, edhe kësaj here u zmbrapsën nga forcat shqiptare, sa që grekët detyrohen të ndërojnë politikën ndaj shqiptarëve, duke propaganduar në Athinë se " grekët dhe shqiptarët trima janë vëllezër të një gjaku dhe se besimet e tyre fetare nuk duhet të ndikojnë në vëllazërimin e tyre" dhe shumë propaganda të tilla sikur kjo.³¹

Lufta Ballkanike si dhe Lufta e Parë Botërore i gjetën shqiptarët përsëri në këmbë në mbrotje të trojeve shqiptare. Kështu në gusht të vitit 1912, mijëra luftëtarë çamë, nën udhëheqjen e Muharrem Rushitit, u ndeshën për jetë a vdekje me andartët grekë. Për fat të keq pas një rezistence 6- mujore, grekët arrijnë të pushtojnë Janinën. Kjo ishte ndër humbjet e mëdha që iu kushtoi rëndë shqiptarëve. Kryeqendra e Shqipërisë së Jugut (Epiri) tashmë bie nën kthetrat e Megalaidësë.³²

Ndërkaq, pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë andartët grekë kryejnë krime nga më të llahtarshmet ndaj shqiptarëve. Athina zyrtare pati dhënë urdhër që të përsëritej gjëma e pahiruar e vitit 167, para krishtit. Kështu Epiri i sipërm shndërrohet në gërmadhë vetëm se kësaj here në krye të krimit nuk vihej një i huaj, por një renegat shqiptar i shitur kokë e këmbë te pushtuesit grekë. Bëhet fjalë për famëkeqin Zografos, ish-ministër i Jashtëm i Greqisë. Në verë të vitit 1913, kur kryente detyrën e guvernatorit të Janinës, ai pati deklaruar para shqiptarëve që të mos kishin iluzion, në qoftë se do të shtrëngoheshin ta braktisin Epirin, do të linin vetëm tokën djerrë dhe kështu bëri me të vërtetë. Në vitet 1914-1918, andartët grekë do të kryenin tragjedinë më të fundit greke. Epiri i sipërm gjatë të ashtuquajturës "periudhë autonomiste" do të bëhej shkumb e hi. Mbi 800 fshatra shqiptare u dogjën, qindra mijëra njerëz u vranë. U arrit deri atje sa nënave shtatëzëna t'u u nxirreshin me bajonetë foshnjat nga barku. Madje, në Pesh-tan, fshat që dominohet prej ritit ortodoks janë therur si bagëti rreth 217 burra të zonës³³. Në muajin shkurt të vitit 1914, në rrethin e Gjir-rokastrës, andartët grekë me në krye ish-ministrin e Jashtëm Zografos,

³¹ Po aty...faq., 75

³² Po aty..., faq.89

³³ Po aty..., fa.22

shpallin të ashtuquajturën "Republika Autonome e Vorio-Epirit". Në Himarë, një grusht gjakprishurish ngrenë flamurin grek. Shqiptarët reagojnë. Gjaku sërish derdhet lumë. Qindra fshatra shqiptare plaçkiten dhe digjen në trevat e Epirit. Rrethinat e Tepelenës, Delvinës, Kurvelshit, Çamërisë së mbetur, Përmetit, Këlcyrës, Korçës, bëhen shkru- mb e hi.³⁴

Në vitin 1913, si dhe pas Kongresit të Berlinit, Epiri do të copë- tohet sërish, dy të tretat e territorit shqiptar Fuqitë e Mëdha do t'ia ka- lonin Greqisë njerë, kurse një e treta, pra pjesa më e vogël do t'i mbetej Shqipërisë. Ky coëptim i ri i krijoi mundësi më të madhe Athi- nës për ta thelluar më tej "Megalaidenë". Spastrimi etnik dhe gjenoci- di grek i rrethinave të Follorinës, Kosturit, si dhe i Çamërisë, mbetet i paharuar. Kësisoj prej një popullsie prej 65 mijë banorësh që kishte Epiri në fund të shekullit të XIX, dhe në fillim të shekullit XX, grekët rezultonin vetëm 60-70 mijë banorë kundrejt shqiptarëve me rreth 550 mijë veta, ndërsa pjesa tjetër përbëhej prej vllahëve dhe çifutëve.³⁵ Po kjo gjëmë e madhe nuk do të mbaronte këtu. Kërbaçi grek kishte zënë të bënte kërdi. Në periudhën e viteve 1923-1926.35.000 shqiptarë my- slimanë do të dëboheshin me dhunë prej trojeve etnike në hapësirat e Follorinës dhe Kosturit. Ndërkaq, në vitet 1944-1945, gjegjësisht në mbarim të Luftës së Dytë Botërore do ta pësojë rëndë Drenica e Epir- it, Çamëria. Mijëra fëmijë, gra, burra, e pleq do të theren me thikë dhe plumb, ndërsa 25.000 të tjerë dëbohen prej vatrës së tyre amtare. Kë- shtu, kryhet në këtë mënyrë një gjenocid tjetër që ka vulë të njëjtë me gjenocidin më të madh millosheviqian në Kosovë, në vitet (1998- 1999).³⁶

Njëra ndër epopetë më të lavdishme të luftës së viteve 1941-1945, mbetet edhe ajo e Konispolit, e cila zgjati plot 55 ditë, gjegjësisht prej datës 5 deri më 25 shtator të vitit 1943. Pothuajse çdo krahinë mori pjesë në betejë, duke dërguar një apo më shumë pjesëtarë të saj, pra u bë një mobilizim gjithëpopullor, ndërkohë qindra të tjerë u dërgonin

luftëtarëve furnizime me ushqime dhe materiale luftarake. Humbjet e nazistëve në Konispol, qenë të ndjeshme. U vranë mbi 300 ushtarë dhe pati shumë të plagosur. U shkatërruan shumë materiale luftarake. Kështu, pas një rezistence gjithëpopullore dymujore, Konispoli nuk arriti të pushtohej, edhe pse ai u sulmua në tri drejtime, nga toka me mjete të blinduara dhe këmbësori, ndërsa nga ajri me aeroplanë lufta- rakë dhe nga deti (Gjiri i Sajadhës) nëpërmjet dy anijeve luftarake.³⁷ Ndërkaq, shumë çamë të qyteteve si Paramithi, Margëllëçi, Filati, Par- ga, Gumenica etj., gjegjësisht mbi 200.000 çamë për t'i shpëtuar vde- kjes nga bandat shoviniste greke, të udhëhequra nga Napolon Zerva, bashkëpunëtor i fashizmit, u drejtuan për në Shqipëri, ndërsa më tepër se 200 çamë vdiqën, duke u endur rrugëve të Shqipërisë në mes të dimrit.³⁸

Përfundim

Minoriteti grek në Shqipëri, i gëzon të gjitha të drejtat e parapara sipas konventave ndërkombëtare dhe lirive themelore të njeriut, fakt i cili njihet botërisht. Ndërsa shqiptarët në Greqi, nuk kanë të drejtë të flasin në gjuhën shqipe dhe as që diskutohet për shkolla dhe medime qoftë elektronike apo të shkruara në gjuhën shqipe.

Janina dhe qytetet tjera që janë nën juridiksionin grek nuk bëjnë aspak përjashtim nga Tirana, Prishtina, Shkodra, Tivari, Ulqini, Pre- sheva etj. Pra, ato mbeten qytete tipike shqiptare dhe populli çam pa- dyshim autokton shqiptar që kurdoherë do t'i bashkangjiten shtetit amë, dhe kështu do të përmbillet ëndrra shekullore e popullit çam dhe patriotëve të shquar të kësaj treve, si Luli Çapari, Marko Boçari, Ha- san Tahsini, Osman Taka, Çelo Mezani, Abedin Dino, Mustafa Rushi- ti, e shumë të tjerë. Ndërsa ajo që është më me rëndësi çamët me shkëputjen e tyre nga Greqia, do t'i japin fund presionit të vazhdue- shëm të politikës sistematike të shtetit grek dhe forcave të ndryshme ultranacionaliste për çkombëtarizimin e kësaj treve.

³⁴ P o aty..., faq.40

³⁵ Arben Kondi: "Shqipëria Etnike, Tiranë, 2003, faq.184

³⁶ Epiri, v.p.e cituar, faq.6

³⁷ Epiri, v.p. e cituar, faq.65

³⁸ Grup autorësh: Historia e popullit shqiptarë, Tiranë, 1999, faq, 233.

Literatura e shfrytëzuar dhe e konsultuar:

- ASHSH: Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985.
- Fjalori Enciklopedik, Tiranë, 2002.
- Arben Kondi: Epiri, Tiranë, 2008.
- Arben Kondi: "Rikthimi në Çamëri", Tiranë, 2008.
- Arben Kondi: "Si Kosova Çamëria është gjaku ynë", Tiranë, 2008.
- Arben Kondi: Shqipëria Etnike, Tiranë, 2003.
- Grup autorësh: Historia e popullit shqiptar, Tiranë, 1999.
- Elena Kocaqi: "Plani për zhdukjen e shqiptarëve", Tiranë, 2009.

Mr. sc. Rezehana Hysa

ALBANIAN ÇAMËRIA

(Summary)

Introduction

The London Conference, with its decisions, gave a severe blow to the aspirations of the Albanians to preserve their ethnic lands. Large chunks of Albanian lands were ceded to Serbia and Greece. On August 11, 1913, Çamëria was ceded to Greece. In opposition to this decision riots broke out throughout Albania and the Albanian lands. Greece undertook severe military measures to deal with this situation by arresting people, terrorizing them, executing people and by deporting forcibly the Albanian population of Çamëria from Greece.

رزھانا حوسا

تشاموريا الالبانية

(خلاصة البحث)

ان مؤتمر لندن بقا راراته لفد قضى على الاراضى الالبانية ضربة قاضية بموجب قراراته تم فصل ولاية كسوبا من الارضى لالبانية و فى ١١ اغوشطوس من سنة ١٩١٣ بموجب قرله تم منح ولاية تشاموريا بكاملها الى اليونان . لذا تمرد السعب الالبانى ضد هذا القرار الظالم و المشؤم الذى تم اتخاذه فى مؤتمر لندن فى كل من البانيا و بقية الاراضى الالبانية مما دفع الجيش اليونانى بانخاذ تدابير عسكرية مثل الاعتقالات و السجن و الارهاب و الاعدامات و عملية الاخلاء القسرى للشعب الالبانى من اراضيه فى اليونان .

KUMTESË

Ramadan Shkodra
Sadik Mehmeti

Hafëz BAJRAM AGANI (1899-1962) **- hoxhë, pedagog, udhëheqës dhe vizionar i shquar -**

1.

Dihet mirëfilli se popujt e qytetëruar kanë prosperuar me shumë sukses, ngaqë, përveç tjerash, kanë njohur, kanë çmuar dhe kanë vlerësuar drejt e në mënyrë objektive punën dhe angazhimin e pararendësve të tyre; ata kanë vazhduar aty ku e kishin lënë të parët e tyre, natyrisht, gjithnjë sipas kërkesave të kohës, duke plotësuar e përmirësuar, ku kishte zbrazëti dhe vend për të plotësuar, kurse të tjerët, ndërkaq, kanë ngelur mbrapa pikërisht për shkak të konceptit të gabuar se “historia fillon dhe mbaron me mua!”

Një nga figurat më të spikatura të brezit të tij, që edhe sot është një frymëzim i gjallë, për ato që la fjala dhe pena e tij, i dalluar në kuptimin e plotë të fjalës, pikërisht për vizionin dhe largpamësinë e tij, i nderuar nga kolegët dhe besimtarët, hoxhë e alim erudit me plot kuptimin e fjalës, hafëz i dalluar, udhëheqës, prijës dhe organizator i shquar, dashamirës i dijes dhe i fesë në çdo pikëpamje, me virtyte e cilësi të larta prej hoxhe e intelektual të mirëfilltë, pionier në shumë fusha e segmente të jetës intelektuale islame; i nderuar ndër kolegë dhe në popull, i njohur për shumë angazhime, organizime e aktivitete të ndry-

shme, që do të shënonin rifillimin, riorganizimin, rimëkëmbjen dhe rritjen e Bashkësisë së Fesë Islame të Kosovës, në një kohë jo të favorshme për këtë bashkësi dhe për besimtarët e saj; më vonë i sulmuar dhe i papërshtatshëm për sistemin që dalëngadalë po nguliste kthetrat e tij në Kosovë, ky është edhe hafëz Bajram ef. Agani.

2.

Të parët e hafëz Bajram ef. Aganit janë nga Plava, që tani e sa kohë ka ngelur nën administrimin e Malit të Zi. Gjyshi nga ana e babait ishte myderrizi dhe hoxha i shquar Ibrahim efendiu, kurse babai i tij ishte atdhetari, myderrizi, patrioti e kryengritësi i shquar kundër çetave malazeze, mulla Abdylgani Koja, i njohur si Mulla Agan Koja. Ndërsa, nga ana e nënës, hafëz Bajrami ishte nip i derës së vjetër dhe fisnike të Dizdarëve të Shkodrës.

Në këtë familje bujare e me tradita fetare e kombëtare, më 15 dhjetor 1899, në Plavë, u lind Bajrami, si sugari i kësaj familjeje.

Kur i mbushi shtatë vjet, Bajram ef. Aganin e dërguan në mejtepin, përkatësisht në shkollën fillore të fshatit, të cilën e kreu me sukses të shkëlqyeshëm. Ndërsa një vit më vonë, më 1910, që dërguar së bashku me vëllain e tij Ademin në Shkodër, që të regjistrohej në gjimnazin- Idadinë e atjeshme, por, meqë këtë nuk kishte arritur ta bënte, hafëz Bajram ef. Agani kishte regjistruar një shkollë fillore të atjeshme në gjuhën shqipe, të cilën e kishte mbaruar me sukses të shkëlqyeshëm. Më pastaj hafëz Bajrami që kthyer në Plavë, dhe më 1911, që regjistruar në klasën e parë të Idadisë, në Pejë.

Me fillimin e luftërave ballkanike, familja e Bajram Aganit, për shkak se shquhej për aktivitetin e saj kombëtar kundër malazezve, u detyrua të shpërngulej nga Plava në Gjakovë.

Edhe pse të shpërngulur dhe në kushte të vështira ekonomike, Bajram efendiu rrugën e nisur për dije nuk e ndërpreu, por ai u bë nxënës i ulemave të shquar të Gjakovës. Më 1913, kishte regjistruar Medresenë e Madhe të Gjakovës, te myderrizi kryesor, dijetari i shquar Islam ef. Nuredini, tek i cili në vitin 1924, mori edhe diplomën-ixhazetnamenë. Meqë kishte treguar suksese dhe ishte dalluar në mësim, që

angazhuar si asistent/ligjërues për klasat e para në këtë medrese, detyrë të cilën e kreu edhe pas diplomimit deri në vitin 1926.

Krahas mësimit në medrese, në vitin 1915, Bajram efendiu për një afat shtatë muaj kishte mbaruar hifzin e Kur'anit, duke iu shtuar kështu radhëve të hafizëve të shquar të Gjakovës, aq sa po atë vit kishte falë namazin e teravive me hatme.

3.

Nga viti 1917 deri 1921, Bajram ef. Agani kishte qenë imam për Ramazan në fshatin Morinë, të Gjakovës, kurse gjatë viteve 1921-1926, kishte qenë imam i Ramazanit në fshatin Çellopek, të Pejës.

Hafëz Bajram Agani (1935)

Me dekretin e Ministrisë së Fesë në Beograd, hafëz Bajrami, më 10 shkurt 1926, emërohet imam ofiqar pranë "Xhamisë së Re" të Gjakovës, detyrë të cilën e kryen deri më 13 gusht 1928, kur me ndryshimet administrative të asaj kohe, transferohet si imam ofiqar në fshatin Irzniq të Pejës.

Në këtë detyrë Bajram ef. Agani qëndron deri në korrik të vitit 1936, kur kalon në detyrën e imamatit ofiqar në "Xhaminë e Qerimit" në Gjakovë.

Në Gjakovë, qëndron deri në vitin 1937, por meqenëse Ulema Mexhlsi i Shkupit ishte i ndarë në dy rryma: rryma kombëtare së cilës i paraprinte Ferat Bej Draga, përkrahës i së cilës ishte edhe Bajram ef. Agani, dhe rrymës proserbe, dhe për shkak se Bajram ef. Agani ishte një kundërshtar i madh i planeve për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi, dhe për shkak se një rëndësi të madhe i kushtoi sensibilizimit të popullatës shqiptare për arsimim dhe edukim, e detyrojnë që të transferohet në detyrën e imamatit ofiqar në Shtip të Maqedonisë, ku shërbeu deri në prill të vitit 1941.

Për shkak se qenë krijuar rrethana të reja pas nisjes së Luftës së Dytë Botërore, hafëz Bajram ef. Agani u kthye nga Shtipi në Gjakovë, dhe më 1 maj 1941, u emërua imam ofiqar përsëri në Irzniq, detyrë të

cilën e kreu deri në vitin 1945. Kurse pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore u kthye në Gjakovë, në detyrën e mëhershme në Xhaminë e Qerimit dhe si ndihmësofiqar në Këshillin Popullor të Komunës së Gjakovës, deri më 1946.

4.

Vitet pas Luftës së Dytë Botërore kërkonin edhe riorganizimin edhe të institucioneve fetare.

Në kuadër të rrethanave të reja të krijuara në Kosovën e aneksuar nga Serbia, nën tutelën e Federatës, me gjithë vështirësitë tjera, riorganizimi i Bashkësisë Islame ishte një sfidë në vete. Ishte largpamësia, urtësia, vizioni dhe këmbëngulësia e ulemasë shqiptare që arriti të gjente formën më të mirë për riorganizimin saj në rrethana të pafavorshme për fenë islame dhe popullatën myslimane.

Kështu, në Konferencën e Përgjithshme të Nëpunësve Fetarë të RS të Serbisë, mbajtur më 20 gusht 1947, hafëz Bajram ef. Agani zgjidhet kryetar i Kryesisë, kryetar i Kuvendit të Vakëfit dhe kryetar i Këshillit të Kuvendit të BFI-së, asokohe të RS të Serbisë, me seli në Prishtinë. Hafëz Bajram ef. Agani e udhëhoqi këtë institucion midis viteve 1948-1959.

Hafëz Bajram Agani, kryetar i BI (1955)

Nën udhëheqjen e hafëz Bajram ef. Aganit, Bashkësia Islame e Kosovës arriti të konsolidohej si në nivelin lokal ashtu në atë qendror. Hafëz Bajram efendiu, së bashku me ulematë e kohës, miratoi edhe aktet e nevojshme normative, siç janë statuti i vitit 1948, dhe më pastaj nxori edhe rregulloret e brendshme, si dhe rihapi me shumë mund e sakrificë më 1951, Medresenë e Ulët.

Hafëz Bajram efendiu udhëhoqi me sukses dhe përfaqësoi me dinjitet Bashkësinë Islame të Kosovës, edhe në nivelin e Kryesisë Supreme të Bashkësisë Islame në ish-Federatën Jugosllave, ku shquhej për diskutimet, vizionin dhe idetë e tij për të ardhmen e Bashkësisë

Islame të këtyre trevave, me theks të veçantë për gjendjen e Bashkësisë Islame në Kosovë.

Hafëz Bajram Agani me Reis ul Ulemanë Haxhi Sulejman ef. Kemura, gjatë vizitës së këtij të fundit në Kosovë

Hafëz Bajram ef. Agani, ishte i respektuar dhe i çmuar nga të gjithë anëtarët tjerë të kësaj Kryesie, sidomos nga kryetari i Bashkësisë Islame të Maqedonisë, Bedri ef. Hamidi, dhe në veçanti nga Reis ul-ulema Sylejman ef. Kemura, me të cilin kishte raporte të ngushta, siç shihet edhe nga vizitat e përbashkëta në vende të ndryshme të botës Arabe-Islame.

5.

Pas mbylljes së medreseve shumëshekullore të Kosovës nga pushteti komunist, popullatës myslimane të këtyre anëve iu pamundësua që ata të shkolloheshin në ndonjë shkollë fetare të tyre. Duke e ndier këtë nevojë dhe duke ditur rëndësinë e hapjes së një shkolle fetare islame në gjuhën shqipe, hafëz Bajram ef. Agani, do të angazhohet me mish e shpirt që e një e tillë të hapet në Kosovë.

Kështu, me iniciativën dhe punë e tij të pashoq, më 1 nëntor 1951, do të nisë punët Medreseja e Ulët Shqiptare e Prishtinës, me myderrizët e parë të saj, mësuesin e shkollës kombëtare, myderrizin Ahmed ef. Mustafën, që ishte edhe drejtues i parë i saj, pastaj hafëz Ishak Saidin, veteranin i arsimit kombëtar, Haki Krasniqin etj. Kurse Hafiz Bajram ef. Agani do të ligjëronte lëndët gjuhë arabe, akaid/besim, ah-lak/etikë dhe husniat/kaligrafi.

Nga 1 janari 1953 deri më 15 dhjetor 1956, hafëz Bajram ef. Agani ka qenë drejtor i medresesë.

Gjatë kohës sa ishte në medrese si myderriz dhe për katër vjet edhe drejtues i saj, Hafiz Efendiu dha një kontribut të çmueshëm në arsimimin dhe edukimin e nxënësve të medresesë, i cili shquhej sidomos për dijet e tij të thella dhe metodologjinë e avancuar pedagogjike-didaktike.

6.

Krahas udhëheqjes së Bashkësisë Islame dhe medresesë, hafëz Bajram Efendiu, në vitin 1951 do ta themelojë "Bibliotekën Qendrore të Vakëfit" në Prishtinë.

Meqë Kosova kishte trashëguar një fond librar shumë të pasur me dorëshkrime e libra në gjuhët orientale dhe duke ditur rëndësinë dhe vlerat e tyre dhe nga frika e shkatërrimit dhe humbjes së tyre, hafëz Bajram ef. Agani, më 24 shtator 1951, do të themelojë "Bibliotekën Qendrore të Vakëfit" në Prishtinë, që njëhej edhe me emërtimet "Kutubhaneja e Vakëfit" ose shkurt "Biblioteka e Vakëfit". Dhe jo vetëm kaq, por Bajram ef. Agani ishte angazhuar personalisht edhe në pasurimin dhe mbushjen me libra e dorëshkrime të kësaj biblioteke, duke pasuruar kështu fondet e saj me një numër të madh librash e dorëshkrimesh islame, dhe kishte punësuar edhe bibliotekistin e saj Faik Hamdibegollin nga Prishtina. Për më tepër, duke qenë një dashamir i madh i librit, një dijetar dhe intelektual i mirëfilltë, hafëz Bajram ef. Agani, më 2 shtator 1958, kishte hartuar edhe një katalog me 256 faqe të dorëshkrimeve dhe librave që posedonte kjo bibliotekë, që përfundon me numrin 2092 njësi-qitape.

7.

Bajram ef. Agani u dallua edhe si iniciator dhe nismëtar i literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë. Ai, duke parë mungesën e literaturës islame në gjuhën shqipe dhe nevojën e besimtarëve për të njohur fenë e tyre, më 1957, së bashku me Mehmet Gjevorin, botuan të përkthyer Ilmihalin dhe Jasini Sherifin, botime këto që shënuan fillimin e veprimtarisë botuese islame në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi.

Kurse në vitin 1954, hafëz Bajram efendiu, në përgjigje të nevojave të kohës dhe kërkesave të besimtarëve, kishte hartuar edhe një "Takvim" për llogaritjen e kohëve të namazit dhe festave fetare, por i cili mbeti në dorëshkrim.

Ai qe edhe nismëtar i kultivimit të gjuhës shqip edhe në hydbet, vazet e nasihatet që mbanin imamët gjithandej nëpër xhamitë e Kosovës.

Për këtë qëllim, ai që atëherë kishte përgatitur 52 hydbet tematike dhe shumë ligjëratat të shtypura me makinë shkrimi, dhe ua kishte dërguar të gjithë imamëve të Kosovës, duke vënë kështu një bazë të mirë në gjuhën e ligjërimit shqip nëpër xhamitë e Kosovës.

Faksimile të hytbes të përgatitura nga hafëz Bajram ef. Agani

8.

Hafëz Bajram ef. Agani, vdiq më 13 prill 1962, duke e lënë këtë botë, në të cilën mbolli shumë fidanë shpresëdhënës e frytdhënës, të cilës i dha shumë punë të hairit e të bereqetshme, ashtu edhe siç jetoi ashtu edhe vdiq, i dalluar në kuptimin e plotë të fjalës, i thjeshtë e modest dhe admirues i zjarrtë i arsimit dhe i së vërtetës, popullor në çdo pikëpamje, me virtyte e cilësi të larta prej myderrizi, dijetari e intelektual të nderuar.

Angazhimi, puna, kontributi dhe përkushtimi i hafëz Bajram Aganit në dekadën e parë pas Luftës së Dytë Botërore, për Bashkësinë Islame në Kosovë, në veçanti dhe për institucionet e saj në përgjithësi, e bëjnë atë një strateg të pasqor, një vizionar të thellë e largpamës, një personalitet që në kohë të vështira e plot kthesa, diti dhe arriti të vinte themele të forta e të qëndrueshme, që i bënë ballë stuhisë së monizmit e komunizmit.

Burimet dhe literatura:

- Arkivi i Kosovës, Fondi Bashkësia e Fesë Islame - Drejtorja e Vakëfeve - Prishtinë, 1951-1954.
- Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, “Katalogu i dorëshkrimeve të Bibliotekës së Vakëfit”, libri nr. 1, 1958.
- Koleksioni i hytbeve të Bajram ef. Aganit, (dorëshkrim), pronë e Ferat ef. Gërgurit dhe Mustafë ef. Dervishollit, ish-nxënë të myderriz Bajram Aganit.

- Revista "Glasnik Vrhovnog Islamskog Starjesinstva" FNRJ, nr. 7-9, 1951, Sarajevo.
- Dr. Haki Kasumi, “Bashkësitë fetare në Kosovë 1945 – 1980”, Prishtinë, 1988.
- Elmaz B. Plava, “Plava dhe Gucia në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare” (kujtime dhe dokumente historike), SHB, “Marin Barleti”, Tiranë, 2002.
- Ibn Lanza, “Pasqyrë e shkurtër e veprimtarisë së Medresesë në Prishtinë” (me rastin e 20-vjetorit), "Edukata Islame", nr. 15-16, Prishtinë, 1975.
- Sadik Mehmeti, “Hafëz Bajram ef. Agani ishte edhe hafëz-i kutub”, Dituria Islame, nr. 200, mars, 2007, Prishtinë, (f. 41-42).
- Ramadan Shkodra, Aziz Pireva, “Bibliografi e botimeve islame në gjuhën shqipe në Kosovë”, 1957-1997, Prishtinë.

Ramadan Shkodra
Sadik Mehmeti

**HAFIZ BAJRAM AGANI (1899-1962) -
HODJA, PEDAGOGUE, DISTINGUISHED LEADER
AND VISIONARY**

(Summary)

It is a well-known fact that civilized nations prosper as they among other things recognize and appreciate in an objective manner the work and the efforts of their predecessors; they continue where their predecessors left off, adapting to modern day demands, improving things, wherever such a thing was required. Others lag behind because of the mistaken concept that everything starts and ends with them.

رمضان شكودرا

صادق محمد

حافظ بيرم آغاني (١٨٩٩-١٩٦٢)

(عالم و معلم و قيادي ز زعيم ذات بصيرة مشهورة)

(خلاصة البحث)

من المعروف سلفا بان الامم المتحضرة قد ازدهرت بالتوفيق عال ذلك بأنهم عرفوا و ثمنوا و قدروا بموضوعية عمل و التزام سلفهم الصالح فهم واصلوا حيث وقف فيه أجدادهم طبعاً طبقاً لمتطلبات الزمن الذي يعيشون فيه عملاً على استكمال و تحسين حيث كان في حاجة الى ذلك و نخلف الآخرون بسبب تمسكهم بالمفهوم الخاطيء "بأن التاريخ يبدأ و ينتهى معى".

KUMTESË

Hajrullah Hoxha

KONTRIBUTI I HFZ. BAJRAM EF. AGANIT NË FUSHËN E ARSIMIT DHE SHTYPIT FETAR

Fillimisht falënderoj Zotin e madhërishëm që më mundësoi të marrë pjesë në këtë sesion shkencor, të mbajtur me rastin e shënimit të 50-vjetorit të ndërrimit jetë të myderrizit tonë të nderuar dhe të paharruar Hfz. Bajram ef. Agani, mëshira e Allahut xh.sh.qoftë mbi të.

Me këtë rast kam nderin dhe kënaqësinë që si një ish-nxënës i tij të shpalos disa kujtime dhe vlerësime të mia modeste lidhur me kontributin e Hfz. Bajram ef. Aganit në fushën e arsimit dhe të shtypit fetar.

Padyshim njeri ndër ylematë shqiptarë më të dalluar të shekullit XX, i cili ka lënë gjurmë të pashlyeshme si në fushën e organizimit dhe veprimit institucional të Bashkësisë Islame në Prishtinë, ashtu në fushën e arsimit dhe shtypit fetar, ka qenë Hfz. Bajram Agani. Hfz. Bajram ef. Agani ishte një alim i shquar përparimtar, intelektual dhe vizionar i mirëfilltë, si dhe njeri i brumosur me ndjenja patriotike, fetare dhe atdhetare. Atë e karakterizonte urtësia, devotshmëria, singëriteti, modestia, bujaria dhe guximi intelektual. Përveç gjuhës amtare, ai ka ditur edhe katër gjuhë të huaja: arabishten, turqishten, persishten dhe boshnjakishten. Si i tillë, ai me plot të drejtë mund të radhitet në

mesin e atyre njerëzve për të cilët në Kur'anin famëlartë Allahu xh.sh. ka thënë: *"Ai ia jep urtësinë atij që do, kurse atij që i është dhënë urtësia, atij i janë dhënë shumë të mira"* (El-Bekare :129)

Hfz. Bajram Agani rrjedh nga një familje e njohur me tradita patriotike, fetare dhe kombëtare nga Plava, e cila për shkak të masakrave gjatë luftërave okupuese serbo-malazeze në vitin 1912, ishte detyruar të shpërngulet në Gjakovë. Pas diplomimit të tij me sukses të shkëlqyeshëm në medresenë e madhe të Gjakovës, në vitin 1926, ishte emëruar për imam ofiqar në xhaminë e re në Gjakovë, ndërsa më vonë në vitin 1928, u emërua imam në xhaminë e Lagjes Qerimi. Në vitin 1938, për shkak të mbështetjes së kandidaturës së Ferat beg Dragës, me rastin e votimit në Bashkësinë e Fesë Islame, Ylema Mexhlisi i Shkupit, në shenjë ndëshkimi e transferoi për imam ofiqar në Shtip të Maqedonisë. Në realitet, në vitin 1937, u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme në Bashkësinë Islame për Serbinë Jugore-Kosovë dhe Maqedoni, me seli në Shkup. Për komisar të Kuvendit të Vakafit apo Naib, siç quhej në atë kohë, u paraqitën dy lista. Listës së parë i printe lideri i njohur Ferat beg Draga, i cili me përkushtim të madh i mbronte interesat politike dhe nacionale të popullatës shqiptare në Jugosllavinë monarkiste dhe se pas tij u rreshtuan si paria shqiptare ashtu ylemaja në Kosovë dhe në Maqedoni. Ndërsa, listës së dytë i printe boshnjaku, Fevzia Haxhihamziq, pas të cilit qëndronte elementi boshnjak gorantërbesh dhe qarqet qeveritare jugosllave.

Përkundër presioneve dhe përpjekjeve të pushtetit që të fitonte krahun e F. Haxhihamziqit, falë angazhimit të imamëve dhe parisë shqiptare fitoi lista e Ferat beg Dragës. Me këtë rast, kundër tij do të reagonte ashpër si elementi boshnjak ashtu edhe qarqet shtetërore jugosllave. Me këtë rast, ithtarët e Haxhihamziqit shkuan në Beograd, dhe u ankuan te kryeministri i atëhershëm Dragisha Cvetkoviç, duke thënë: "Ferat Draga po dëshiron që të shqiptarizojë komunitetin musliman të Serbisë Jugore". Ndërkaq, gazetari Zufer Musiq, ish-nxënës i Medresesë së Madhe (e ashtuquajtura e kral Aleksandres) në Shkup, lidhur me këtë kishte shkruar në gazetën "Veçer": "Nëse Bashkësia e Fesë Islame duhet t'u shërbejë interesave të dikujt, atëherë duhet t'u

shërbej interesave të serbëve, e jo të shqiptarëve, të cilëve po u prin Ferat beg Draga". Vlen të theksohet se në fund të vitit 1944, personi në fjalë ishte komandant i brigadave partizane-çetnike, i cili i likuidoi në mënyrë barbare parinë e Drenicës, në vend se t'i dekoronte për organizimin dhe udhëheqjen e luftës vullnetare në mbrojtje të popullatës myslimane të Novi Pazarit, nga çetnikët serbë, të udhëhequr nga gjenerali famëkeq Drazha Mihailoviq.

Albanofobi famëkeq Vaso Çubrilloviq pas disa viteve, në referatin e tij me titull "Problemi i pakicave në Jugosllavinë e Re" mbajtur në nëntor të vitit 1944 në Beograd, fitoren e krahut të Ferat beg Dragës në këto zgjedhje e vlerësoi në këtë mënyrë: "Pas marrëveshjes zgjedhore mes Stojadinoviqit nëpermjet Mehmet Spahës, kur arriti Ferat beg Draga ta zgjeronte autoritetin e Komunitetit Mysliman në Serbinë e Vjetër (Kosovë) dhe në Maqedoni, me seli në Shkup, separatistët shqiptarë fituan një armë të fuqishme në duart e tyre. Ata për dy-tre vjet aq shumë e shfrytëzuan këtë favor, saqë morën në duart e tyre gjithë organizatën fetare dhe arsimore të myslimanëve në Jug. Nëpërmjet saj u organizuan politikisht dhe kaluan në sulm ..."

Hfz. Bajram ef. Agani, pas kthimit të tij nga Shtipi, në vitin 1941, shërbeu si imam ofiqar në xhaminë e Irzniqit deri në vitin 1945, dhe si ndihmës ofiqar pranë Këshillit Popullor të Komunës së Gjakovës, deri në fund të viti 1946. Pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1947, u formua Bashkësia e Fesë Islame për R.P.S, me seli në Prishtinë. Falë aftësive të tij profesionale dhe administrative, në konferencën e përgjithshme të nëpunësve fetarë të Bashkësisë Islame të RPS, mbajtur më 20 gusht 1947, për udhëheqës të këtij institucioni të rëndësishëm dhe me përgjegjësi të madhe, u zgjodh Hfz. Bajram Agani. Duhet theksuar se për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe rrethanave të ndërlikuara politike në atë kohë pakkush do ta lakmonte apo do ta kishte guxim që të merrte një detyrë të tillë mbi vete.

Më qëllim të organizimit dhe konsolidimit të radhëve të imamëve dhe ngritjes së tyre në pikëpamje profesionale, me angazhimin e tij, në fillim të viteve të pesëdhjeta të shekullit të kaluar u formua Shoqata Ilmije (Ylemave) në Prishtinë. Në këtë shoqatë u anëtarësuan ima-

mët, muezinët, punëtorët e administratës të Bashkësisë Islame dhe personeli i Medresesë. Ajo kishte organet e veta nga këshillat në terren deri te Kuvendi, dhe se vepronte në kuadër të Bashkësisë Islame, duke marrë pjesë në të gjitha format organizative të jetës fetare në territorin e saj. Do theksuar se Shoqata e Ylemave ka luajtur rol jashtëzakonisht të madh në botimin e literaturës fetare në gjuhën shqipe, siç janë : Ilmihali i vogël, Jasini, Takvimi, Edukata Islame etj.

Hfz. Bajram Agani, gjithashtu, si një intelektual i mirëfilltë dhe arsimdashës i flaktë, pas marrjes së detyrës së kryetarit të Bashkësisë Islame, brengën më të madhe e kishte hapjen e një medreseje në gjuhën shqipe në Prishtinë, ngase sistemi komunist i kishte mbyllur të gjitha medresetë në Kosovë. Duke qenë i vetëdijshëm se pa kuadro të reja fetare nuk mund të ketë as jetë të mirëfilltë fetare, ai u angazhua me vetëmohim në plotësimin e kushteve të domosdoshme, ndërkaq pas marrjes së lejes nga organet kompetente në vitin 1951, e hapi medresenë Alaudin në Prishtinë. Kjo ishte medreseja e parë dhe e vetmja që u hap pas Luftës së Dytë Botërore, jo vetëm në Kosovë, por në të gjitha viset shqiptare që jetonin nën studimin jugosllav. Prandaj, në këtë medrese i vijonin mësimet nxënësit nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës. Gjenerata e parë në medrese u regjistrua në vitin shkollor 1951-1952, ndërsa e dyta, për shkak të mungesës së kushteve të nevojshme, u regjistrua në vitin 1955-56, dhe se ne i takonim gjeneratës së dytë. Mësimi në medrese zhvillohej në gjuhën shqipe dhe sipas plan-programit të reformuar, ku përveç lëndëve fetare mësoheshin edhe lëndët shkencore. Medreseja Alaudin në fillim ishte shkollë e ulët fetare katërvjeçare, ndërsa nga viti 1962, u shndërrua në shkollë të mesme fetare. Hapja e medresesë Alaudin në Prishtinë, u prit me gëzim të madh ndër besimtarët e fesë islame, ngase deri më atëherë shumë prej tyre thoshin se pasi u mbyllën të gjitha medresetë do të vijë koha kur nuk do të ketë hoxhë as për t'i përcjellë në varr. Andaj, hapja e medresesë ishte si një garant kryesor për vazhdimin e ekzistencës së Islamit në vendin tonë. Nga ana tjetër, ajo ua përforcoi njerëzve shpresën dhe vullnetin për të jetuar në trojet e tyre stërgjyshore, e jo për t'u shpërngulur për hir të fesë në Turqi.

Medreseja në të ardhmen u bë vatër e vërtetë e arsimit dhe kulturës Islame në gjuhën shqipe për të gjitha viset shqiptare në Jugosllavi e më gjerë. Ndërsa në kohën e regjimit të Millosheviqit, ajo u shndërrua në çerdhe të tubimeve politike dhe të patriotizmit kombëtar dhe atdhetar shqiptar.

Hfz. Bajram ef. Agani një mandat ka qenë drejtor i medresesë, kurse mësimdhënës i rregullt ka qenë prej themelimit të saj deri në shkuarjen e tij në pension në vitin 1959. Lëndët kryesore të cilat i ligjëronte në medrese kanë qenë: Gjuha arabe, gjuha turke, Akaidi, Ahlaku etj. Si në mësim ashtu në edukim, qysh në atë kohë ai përdorte metoda bashkëkohore pedagogjike. Në orët e mësimi ai vinte i përgatitur, ishte orator i mirë, fliste logjikshëm, rrjedhshëm dhe kuptueshëm. Për shkak të mungesës së teksteve shkollore, lëndët na i diktonte përmendësh. Ndërkaq lëndët që kërkonin shembuj siç ishte Akaidi, gramatika arabe, Ahlaku, i diktonte me fjalë dhe i shkruante në tabelë, kurse ne i përshkruanim prej saj.

Si me rastin e mbajtjes së ligjëratave për nxënësit në medrese ashtu edhe për xhematin në xhami, Hfz. Bajram ef. Agani, trajtonte tema aktuale dhe bashkëkohore nga lëmi të ndryshme. Ndër temat më kryesore për të cilat fliste zakonisht kanë qenë: Vlera e besimit të drejtë Islam në jetën e njeriut, rëndësia e diturisë fetare dhe shkencore, vlera dhe dobitë e moralit dhe etikës islame, vlera e punës dhe fitimit në mënyrë të ndershme, rëndësia e pastërtisë së përgjithshme në jetën e njeriut dhe vlera e dashurisë për fenë, kombin dhe atdheun. Për secilën temë të lartpërmendur ai sillte argument nga Kur'ani famëlartë dhe tradita e ndritshme e jetës së Muhamedit a.s. Ato i komentonte në mënyrë racionale, duke e lidhur domethënien e tyre me kohën dhe nevojat aktuale të myslimanëve në vendin tonë. Në këtë mënyrë, Hfz. Bajram ef. Agani kishte për qëllim vetëdijesimin si të nxënësve të medresesë ashtu të popullatës myslimane, se vetëm me zbatimin e parimeve të trajtuara në temat e lartpërmendura, si individ i ashtu shoqëria mund të realizojë harmoni ndërnjerëzore dhe jetë të begatshme në këtë botë si dhe jetë të lumtur në botën tjetër.

Hfz. Bajram ef. Agani ka qenë ithtar i devotshëm i Tariki mustekimit-rrugës së drejtë të ehli syneitit vel xhematit. Si i tillë ai ka qenë kundërshtar i pakompromis i sekteve dhe të tarikateve të ndryshme, duke argumentuar me fakte se ato kanë devijuar nga rruga e vërtetë dhe e kanë përçarë unitetin e botës myslimane. Më kujtohet kur në një natë të madhe bashkë me një shok shkuaam në teqenë e Kaderive në Prishtinë, për të parë se çfarë programi të ziqrit po zhvillohej në të. Ditën e nesërme, pasi që kishte kuptuar se kemi qenë në teqe, na qortoi ashpër, duke thënë se ata (dervishët) janë në gjendje t'i bëjnë 99 të mira me qëllim që ta lënë në derë një bidat (risi në fe) të tyre. Nëse dëgjoj se keni shkuar edhe një herë, do të jeni të përjashtuar nga medreseja.

Me rastin e mbylljes së medreseve nga regjimi komunist, shumica dërrmuese e nxënësve të tyre kishin mbetur pa i marrë diplomat. Një numër i konsiderueshëm i tyre, duke qenë të aftë tashmë e kryenin detyrën e imamit, por sipas ligjit pa diploma nuk kishin të drejtë në dekret. Si të tillë ata nuk kishin të drejtë as në sigurimin social as në pension. Bashkësia Islame me në krye Hfz. Bajram Aganin, me qëllim të kualifikimit të tyre në fund të viteve të pesëdhjeta organizoi kurse verore, ku shumica dërrmuese e pjesëmarrësve në këto kurse i morën diplomat dhe fituan të drejtën e dekretimit për imam.

Përveç kontributit të lartpërmendur në fushën e organizimit të Bashkësisë Islame dhe të arsimit fetar, Hfz. Bajram ef. Agani ka dhënë kontribut të çmueshëm edhe në fushën e shtypit fetar. Me iniciativën dhe angazhimin e tij në vitin 1957, u botua libri: "Ilmihali i vogël" për njohuritë fillestare të fesë Islame. Ky ishte libri i parë fetar i botuar në gjuhën shqipe në trevat shqiptare në Jugosllavi. Gjithashtu, pas dy vjetëve u botua libri: "Mësimi i shkurtër mbi namazin dhe Jasini sherifi". Botimi i këtyre dy librave u prit në popull me gëzim të madh, ngase për herë të parë atij iu dha mundësia për të mësuar parimet themelore të fesë Islame përmes fjalës së shkruar në gjuhën amtare.

Pasi që Bashkësia Supreme Islame kishte marrë vendim për përkthimin ose mbajtjen e hytbeve-ligjëratave të ditës së xhumasë në gjuhën amtare, Hfz. Bajram ef. Agani u angazhua në përgatitjen e tyre

për xhumatë e tërë vitit. Me këtë rast ai zgjodhi tema nga fushat e ndryshme me përmbajtje bashkëkohore. Për shkak të shkuarjes së tij në pension dhe moskujdesit të të tjerëve, këto hytbe mbetën të pabotuarara edhe pse në atë kohë ato ishin tepër të nevojshme, sidomos për imamët që nuk ishin në gjendje për t'i përgatitur vetë. Përveç hytbeve në fjale Hfz, Ef. Agani e kishte përgatitur në gjuhën shqipe edhe texhvidin - rregullat për leximin e drejt të Kur'anit, me të cilin shërbeheshin nxënësit e medresesë dhe të tjerët. Edhe ky tekst mbeti i pabotuar.

Gjithashtu, do theksuar se para disa ditësh mr. Sadik Mehmeti, duke hulumtuar material në Arkivin e Kosovës, për jetën dhe veprën e Hfz. Bajram ef. Agani, kishte hasur një fletore me tabela kalendarike të takvimit për vitin 1954, në gjuhën shqipe dhe boshnjake në dorëshkrim. Shkaku i mosbotimit të tij me siguri duhet të jetë mungesa e mjeteve materiale. Përgatitja e këtyre tabelave kalendarike nga Hfz. Bajram ef. Agani qysh në atë kohë më së miri e dëshmon përkujdesjen dhe përkushtimin e madh të tij ndaj shtypit fetar në gjuhën shqipe. Takvimi për herë të parë në gjuhën shqipe do të botohet në vitin 1970, do të thotë pas plot 15 vjetësh, i përpiluar nga shkruesi i këtyre rreshtave. Nga tërë kjo që u tha më lart, mund të konkludohet se Hfz. Agani ka qenë nismëtar i publicistikës islame në gjuhën shqipe duke i paraprirë mulla Sherif ef. Ahmetit dhe të tjerëve.

Hfz. Bajram ef. Agani, gjithashtu, një kujdes të veçantë i ka kështu ruajtjes së trashëgimisë islame në vendin tonë. Ai në vitin 1951 e themeloi Bibliotekën qendrore të Vakfit në Prishtinë, ndërsa në vitin 1958, bëri evidencimin e të gjitha librave të saj, duke i shënuar emrin dhe autorin e secilës prej tyre në regjistër të posaçëm. Në faqen e parë të këtij regjistri, mjaft me rëndësi, është vënë shënimi në gjuhën osmane dhe në gjuhën serbo-kroate, me domethënie: "Regjistrimin dhe evidencimin e të gjitha librave të Bibliotekës së Prishtinës, me të gjitha të dhënat e nevojshme, me dorën e vet i ka hartuar-përpiluar kryetari i Kryesisë së Fesë Islame për Republikën Popullore të Serbisë, Hfz. Bajram ef. Agani, Prishtinë, më datën 2.IX.1958."

Regjistri ka përmasa 24x34 cm dhe mbledh brenda kopertinave të forta. Ka gjithsej 128 fletë (256 faqe) të mbushura me shënime. Regjistri fillon me numrin rendor 1 dhe përfundon me numrin rendor 2.092. Kjo domethënie që Kutubhaneja e Vakëfit asokohe kishte 2.092 njësi bibliografike - "qitape" në gjuhët arabe, turke, persiane dhe boshnjake (8 sosh). Prej tyre 476, del të kenë qenë dorëshkrime të vjetra që u takonin fushave të ndryshme shkencore-fetare islame. (Mr. Sadik Mehmeti: Hfz. Bajram ef. Agani ishte edhe Hafiz-i kutub", Dituria Islame nr. 200)

Hfz. Bajram ef. Agani ka qenë njohës i mirëfilltë i gramatikës dhe gjuhës arabe. Në vitin 1958, një delegacion i Bashkësisë Islame të Jugosllavisë, me në krye Reis Uleman H. Sylejman ef. Kemura vizitoi Egjiptin dhe disa shtete tjera arabe. Njëri nga anëtarët kryesorë të këtij delegacioni ishte edhe Hfz. Bajram ef. Agani, i cili e përfaqësoi me sukses dhe në mënyrë dinjitoze Bashkësinë Islame, me seli në Prishtinë. Përkitazi me këtë profesori ynë i nderuar Husein ef. Gjoza, me një rast kur ishim nxënës në vitet e 60-ta në Sarajevë na pati thënë: "Gjatë vizitës sonë në shtetet arabe Hfz. Bajram ef. Agani më mirë e fliste gjuhën arabe me gramatikë se ne që kishim studiuar atje".

Në vitin 1959, Hfz. Bajram ef. Agani u detyrua nga pushteti të jepte dorëheqje dhe të shkonte në pension, me arsyetim të lodhjes nga punët e shumta dhe moshës së shtyrë. A gaboi diç politikisht apo pse e pengonte pushtetin komunist veprimtaria e tij aktive, atë ditë e sot nuk dihet por arsyetimi zyrtar kinse për shkak të lodhjes nga punët e shumta dhe moshës së shtyrë nuk qëndron aspak, ngase personi që u caktua në vend të tij ishte më i dobët fizikisht dhe më i vjetër se ai për dhjetë vjet. Lidhur me këtë thuhet se vetë Fadil Hoxha e kishte thirrur në zyrën e tij dhe ia kishte komunikuar vendimin e lartpërmendur, ndërsa më vonë në vend të tij e kishte propozuar dajën e vet H. Mustafa ef. Canhasin. Si mënyrën e pensionimit ashtu të zëvendësimit të tij Hfz. Bajram ef. Agani, me plot të drejtë, i përjetoj shumë rëndë. Me rastin e një takimi me të në bisedë e sipër kur i shpreha keqardhje për daljen e tij në pension ai më tha: More bacë (kështu e kishte zakon të thoshte) "Pasi përballova problemet e shumta dhe vështirësitë mate-

riale dhe i përmirësova kushtet për punë normale si në Bashkësinë Islame ashtu në medrese më hoqën prej kryetarit. Tani kushdo që të vijë në vendin tim pas meje, e ka të lehtë sepse të gjitha i ka të gatshme". Pas shkuarjes së tij në pension, si në Bashkësinë Islame ashtu në medrese për një kohë të gjatë dominoi pasiviteti dhe vendnumërimi deri me ardhjen e M. Sherif ef. Ahmetit për drejtor të medresesë dhe në krye të shoqatës së Ylemave, në fund të viteve të gjashtëdhjeta.

Hfz. Bajram ef. Agani e udhëhoqi me sukses Bashkësinë e Fesë Islame në Prishtinë, në periudhën më të rëndë politike dhe ekonomike, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Ai veprimi në kohën kur regjimi komunist deklaronte se feja është e lirë, kurse në praktikë e pengonte dhe e luftonte me të gjitha mjetet e mundshme. Përveç propagandës antifetare që e bënë për çdo ditë aktivistët e partisë komuniste, organet e pushtetit në çdo qytet uzurponin ose rrënonin objektet e vakëfit në emër të nacionalizimit ose të rregullimit të infrastrukturës sipas planit urbanistik. Me këtë rast disa xhami u mbyllën, duke u shndërruar në magazina ose u rrënuan. Ai veprimi, gjithashtu, në kohën kur një numër i konsiderueshëm i hoxhallarëve kishin botëkuptime konservative si për fenë ashtu edhe për botën dhe jetën në përgjithësi. Ata imamë që ishin të aftë, të vendosur dhe që gëzonin autoritet në popull, pushteti i atëhershëm nuk i donte, ngase ishin të papërshtatshëm për të, ndërsa ata që ishin luajalë dhe servil ndaj tij, pushtetit i preferonte, por populli nuk i donte ngase i konsideronte si bashkëpunëtorë të tij.

Hfz. Bajram ef. Agani veprimi në kohë kur më tepër se 90 % e popullatës, për shkak të ndalimit të shkollimit të saj në gjuhën amtare nga regjimi okupues serbo-sllav, ishte analfabet. Ndërsa, ata që ishin të shkolluar, shumica dërrmuese e tyre ishin antifetarë dhe në vend se ta akuzonin fajtorin e vërtetë për prapambetjen e popullatës shqiptare, e akuzonin fenë islame dhe hoxhallarët.

Nga ana tjetër, ai bashkë me popullin shqiptar, udhëheqës shpirtëror i të cilit ishte përjetoi momente të rënda dhe të dhimbshme. Ai përjetoi aksionin për heqjen e ferexhesë apo mbulesës së femrave që ishte bartur me shekuj, duke i detyruar imamët për të thënë para popu-

llit se ajo nuk ka të bëjë asgjë me shariat. Përjetoi aksionin e grumbullimit të armëve nga pushteti kur njerëzit rriheshin nga udbashët deri në vdekje. Përjetoi aksionin për grumbullimin e tepricës së drithit kur njerëzve u merrej edhe milli në magje. Dhe në fund e përjetoi edhe finalen e të gjitha këtyre, e ajo ishte shpërngulja e mijëra familjeve shqiptare në Turqi, bashkë me disa hoxhë me në krye myderrizin e famshëm shumëvjeçar të medresesë së Pirinazit në Prishtinë, mulla Ahmet ef. Mardoqin, Allahu e mëshiroftë! Si sot më kujtohet ajo ditë kur dolëm për ta përcjellë dhe për t'i dëshiruar rrugë të mbarë në stacion të trenit, si nxënës të medresesë që ishim. Më këtë rast, aq shumë popullatë ishte tubuar, sa të mbushej mendja se tërë Prishtina me rrethinë kishte dalë për ta përcjellë. H. Ahmet ef. Mardoqi ishte një burrë i pashëm, shtatgjatë, mjekërbardhë dhe i veshur në uniform të hoxhës. Ai kishte dalë në dritare të trenit dhe në shenjë të përshëndetjes dhe lamtumirës ua bënte me dorë popullatës së tubuar, e cila në të njëjtën mënyrë, me lot në sy i dëshironte rrugë të mbarë.

Hfz. Bajram ef. Agani, edhe pse u ballafaqua me të gjitha këto katrahura, kur nuk u ndal së angazhuari në organizimin e Bashkësisë Islame dhe në zhvillimin e jetës fetare në mbarë territorin e saj deri që u detyrua dhunshëm që para kohe të shkonte në pension. Mbrojtja e tij me përkushtim e parimeve islame në kohën e sundimit të sistemit komunist - antifetar në vendin tonë më së miri dëshmon për guximin intelektual të tij dhe gatishmërinë për t'u ballafaquar me pasoja të ndryshme në emër të kryerjes së detyrës së tij me nder dhe dinjitet.

Falë njohurive të tij të gjithanshme, sjelljeve dhe veprimeve të tij korrekte dhe punës vetëmohuese, Hfz. Bajram ef. Agani ishte i respektuar, jo vetëm te nxënësit dhe xhemati, por edhe tek intelektualët dhe njerëzit e ndershëm të pushtetit. Për nga fizionomia, ai ishte një burrë shtathollë mesatar dhe mjekërshekurtër, shkonte i pastër dhe i veshur pedant me uniformë të hoxhës, përkatësisht me shall të rregulluar mirë dhe mantel të gjatë në vend të xhybes. Ai ecte drejt dhe dinjitetshëm sikur të ishte ndonjë oficer ushtrie dhe si i tillë e hijeshonte jo vetëm vendin, por edhe rrugën kah kalonte.

Unë personalisht me Hfz. Bajram ef. Aganin kam pasur raporte të mira miqësore, si gjatë shkollimit në medrese ashtu pas tij. Shpeshherë kam pasur rastin, pas namazit të ikindisë për ta përcjellë (shoqëruar) nga xhamia e Çarshisë deri në shtëpi, duke biseduar me të. Pas përfundimit të medresesë Alaudin në Prishtinë, isha në dilemë të madhe, a të regjistrohesh në medresenë e Gazihusrev begut në Sarajevë apo jo, për arsye se gjenerata jonë kishim ardhur në medrese me gjimnaz të ulët. Si të tillë në plan-program kemi pasur vetëm lëndët fetare, andaj edhe kemi pasur mundësi për t'u aftësuar më tepër në aspektin profesional. Një ditë kur i tregova këtë profesorit tim të nderuar Hfz. Bajramit, ai më tha: "Pse jo more bacë, gjithsesi duhet të regjistrohesh dhe ta vazhdosh shkollimin në medresenë e Sarajevës, pasi që ti je një nxënës i shkëlqyeshëm, dhe ajo medrese është më e lartë me rang se e jona, mandej e mëson edhe gjuhën serbokroate." Kur i thash në mënyrë nënçmuese se çka po më duhet mësimi i saj, ai më tha se ajo është gjuhë zyrtare e shtetit, andaj nëse punësohesh në administratë ose ta bën Zoti nasip për të ardhur në vendin tim, atëherë patjetër duhet ta dish atë. Pas këtyre këshillave të singerta të tij, vendosa të regjistrohem në medresenë e Sarajevës, të cilën e përfundova me sukses të shkëlqyeshëm në vitin 1963. Andaj, me vazhdimin e shkollimit në këtë medrese me insistimin e tij, përveç përfitimit në aftësimin profesional fetar-shkencor, mësimi i gjuhës boshnjake (serbokroate) me shërbeu jashtëzakonisht gjatë tërë jetës sime si në aspektin administrativ ashtu në aspektin e botimeve fetare, duke u shërbyer me literaturë të ndryshme, të botuar në Sarajevë.

Në vitin 1962, Hfz. Bajram ef. Agani, në moshën 64-vjeçare ndërroi jetë dhe u varros me nderime të larta në Prishtinë. Unë si ish-nxënës i tij pata rastin dhe nderin t'ia këndoj suren e Fatihës pranë varrit të tij.

Edhe pse ka kaluar më tepër se gjysmë shekulli nga ajo kohë, Hfz. Ef. Bajram Aganit, edhe sot meriton dhe na obligon që me pietet të lartë dhe me respekt të madh ta përkujtojmë personalitetin dhe veprën e tij madhështore. Unë personalisht e ndjej veten krenar dhe të privilegjuar që kam pasur fatin të isha nxënës i tij dhe përherë i jam mirënjoh-

hës për diturinë dhe edukimin e mirëfilltë që kamë marrë prej tij, të cilat më kanë shërbyer gjatë gjithë jetës sime.

Zoti i madhërbashkësor e shpërbleftë atë me begatitë e Tij të pakufishme dhe na bashkoftë me të në xhenetin Firdevs! Amin!

Në fund Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës i uroj sukses në vazhdimin e organizimit të sesioneve të tilla shkencore për ndriçimin e jetës dhe veprës së personaliteteve të dalluara fetare, të cilat dhanë kontribut të çmueshëm për çështjen e fesë, kombit dhe atdheut.

Hajrullah Hoxha

THE CONTRIBUTION OF HAFIZ BAJRAM EFFENDI AGANI IN THE FIELD OF EDUCATION AND THE RELIGIOUS PRESS

(Summary)

Initially, I would like to thank God, who gave me the possibility to attend this scientific session, which is held on the 50th anniversary of the death of Hafiz Bajram effendi Agani, may God's mercy be upon him.

On this occasion, I, as a former student of his, have the honour and pleasure to evoke memories and to present his contribution in the field of education and the religious press.

خير الله حوجا

مساهمة حافظ بيرم أفقندی آغانى فى مجال التعليم و الصحافة الدينية

(خلاصة البحث)

بداية أشكر الله العظيم الذى أعطانى الفرصة لكى اشارك فى الندوة العلمية التى تنعقد بمناسبة مرور ٥٠ عاما من وفاة مدرسنا الحافظ بيرم آغانى رحمة الله رحمة واسعة .

بهذه المناسبة يسرنى كتلميذ له ان افض ببعض الذكريات و التقديرات المتواضعة حول مساهماته فى مجال التعليم و الصحافة .

RRYMA ISLAME

*Osmon Softiq**

SELEFIZMI

Selefizmi është termi i cili në kohën e fundit përmendet shpesh, me të cilin shënohen lëvizjet dhe drejtimit e shumta bashkëkohore islame, si dhe grupet militante në botën arabe. Ky stereotipizim i selefizmit ka qenë temë e konferencës së mbajtur, më 18 dhe 19 janar 2014 në Doha, të cilin e ka organizuar Qendra për Studime AJCS e El Xhezires. Qëllimi i këtij takimi eminent ndërkombëtar ishte demistifikimi i selefizmit, si drejtim brenda shkollës sunitë islame, me ndihmën e ekspertëve botëror akademikë dhe liderëve të formave të ndryshme të lëvizjes selefite. Në konferencë po ashtu është prezantuar edhe studimi për selefizmin me titull: “Fenomeni selefit, shumëllojshmëria organizative dhe politike”, të cilin e ka publikuar AJCS-ja që e kanë përgatitur hulumtuesit e kësaj qendre.

Rivali kryesor ideologjik i ideologjive politike sekulare në botën arabe ka qenë dhe mbetet Islami. Derisa në shtetet arabe sekulare Islami në mënyrë sistematike është shtyrë në margjinat e jetës politike, në sistemet monarke, Islami ka pas rol të rëndësishëm në shoqëri, por jo si faktor politik i pavarur, por si burim i legjitimitetit dhe përkrahjes së dinastive pushtetmbajtësve. Në monarkinë më të madhe dhe më të fuqishme arabe Arabinë Saudite, Islami jo vetëm që nuk ka qe-

në i marginalizuar, por edhe sot shërben si burim kryesor i legjitimitetit të familjes qeverisëse Al-Saud. Drejtimi islam i cili rrënjët e thella i ka pikërisht në këtë shtet është i njohur si selefizmi (Salafijah). Në kohën më të re, posaçërisht pas invadimit sovjetik në Afganistan më 1979, dhe më vonë pas invadimit amerikan në Irak më 2003, me ç’rast Iraku është shndërruar në shtetin e parë arab me shumicë shiite pas rënies së dinastisë shiite Fatimide në Egjipt, në shekullin X, pas kësaj ngjarjeje përsëri ka ardhur deri te forcimi dhe zgjerimi i selefizmit, dhe atë jo vetëm në botën arabe por edhe në planin global. Ky drejtim i islamit sunit gjatë dekadës së kaluar është zgjeruar edhe në bashkësitë myslimane në diasporë. Njëri prej njohësve më të mëdhenj francez të lëvizjeve islame bashkëkohore Oliver Roy, fenomenin e zgjerimit të selefizmit në Perëndim e ka quajtur “islam të globalizuar”.

Sipas selefistëve, kulturat lokale dhe traditat popullore paraqesin rrezik për ruajtjen e islamit të vërtetë. Sinkronizimi i kulturave lokale me islamin, paraqesin shkakun themelor të inovacioneve në fe, konsiderojnë selefistët. Prandaj, selefistët kulturën e shohin si armik potencial të islamit autentik. Për këtë shkak, konsideron Roy, dekulurimi sistematik i myslimanëve është një prej çaqeve të lëvizjes selefite. Në atë mënyrë selefistët duan që nga praktika myslimane t’i heqin të gjithë elementët e huaj nga islami, të cilët janë akumuluar gjatë historisë.

Me dëshirën që të ruajnë islamin burimor, selefistët përjashtojnë traditat (adetet) popullore, me ç’rast dëshirojnë që islamin ta tërheqin plotësisht nga konteksti historik. Prandaj, talibanët po shkatërrojnë statujat budistike në Afganistan, selefistët radikalë demolojnë varrezat historike, rrënojnë tyrbet, teqetë dhe të ngjashme. Shembulli më i ri i përpjekjes së dekulurimit të myslimanëve nga selefistët militantë të cilët janë duke luftuar në Siri, është kërcënimi i tyre se do të demolojnë tyrben (varrin) e Sylejman shahut, gjyshit të themeluesit të dinastisë osmane, Osman Gazit, e cila gjendet në Siri, dhe e cila me marrëveshjen e arritur me francezët ka mbetur pjesë e territorit sovran turk. Përveç kësaj, selefizmi po bëhet faktor i rëndësishëm në disa vende arabe, sikurse Libani, ku më parë ka qenë i padukshëm apo i marginalizuar. Edhe pse numri i madh i grupeve të ndryshme islamike

theksojnë se janë pasues të selefizmit, ky fenomen islamik nuk është unik dhe homogjen. Se kemi një pluralizëm të lëvizjeve selefite, është edhe konkluzioni i përfundimit të konferencës, e cila është mbajtur në fund të janarit të vitit 2014, në Doha, në organizim të Qendrës për Studime (AJCS) të El Xhezires.

Kjo qendër hulumtuese në një vend i ka tubuar disa prej ekspertëve islamë më të rëndësishëm dhe autoritetet e drejtimit selefite nga bota arabe, por edhe ekspertë të njohur akademikë perëndimorë, të cilët merren me studimin e këtij fenomeni, për të diskutuar trendët selefite dhe që të përpiqen të përcaktojnë drejtimin e lëvizjes së këtij fenomeni islamik, i cili është zgjeruar jashtë kufijve të Arabisë Saudite, dhe u bë me ndikim gjatë gjithë Lindjes së Afërt, veçanërisht në Egjipt, Liban, Siri, por edhe i vendeve magrebe në Afrikën Veriore. Për shkak të ndërrimeve turbulente të shkaktuar me zgjimin arab, selefizmi gjithnjë e më shumë po merr dimensionin politik dhe është faktor i pashmangshëm në botën bashkëkohore arabe. Shumica e selefistëve ndajnë qasje puritane interpretimit islam, i cili nënkupton rezistim të gjitha llojeve të risive në fe. Selefistët insistojnë në zbatimin strikt të islamit në mënyrën si ka vepruar i dërguari i Zotit Muhamedi a.s dhe gjeneratat e hershme të myslimanëve (salafë), bashkëkohësit e tij (sahabët), si dhe gjenerata myslimane e cila ka jetuar pas tyre (tabi'in). Të gjitha gjeneratat e myslimanëve që kanë ardhur pas tyre në terminologjinë islame nënkuptohen si të fundit (khalaf). Pjesëtarët e selefizmit shpesh citojnë thënien (hadithin) e Muhamedit, me të cilin i dërguari i islamit ka paralajmëruar që bashkësia myslimane (ummah) do të ndahet në 73 fraksione të ndryshme (firqah). Vetëm njëra do të posedojë besimin e saktë dhe do të jetë e shpëtuar. Të gjitha të tjerat do të përfundojnë në ferr (xhehenem).

Shpëtimi është i garantuar vetëm për ata që e ndjekin Kur'anin (Librin e Zotit) dhe sunetin (praktikën e pejgamberit). Selefistët për atë qëllim paralajmërojnë rrezikun nga risitë në fe (bidate), si dhe mbështetjen e fesë me argumente tjera, përveç këtyre dy burimeve themelore islamike, pasi që sipas tyre, një qasje e tillë e besimit rrezikon të tërheqë në heretizëm. Selefistët, për dallim nga drejtimit tjera

islame (p.sh. racionalistët, tradicionalistët dhe modernistët), i karakterizon skepticizmi ndaj interpretimit racional të burimeve të islamit, Kur'anit dhe sunetit. Selefizmi nuk toleron lirinë dhe pluralizmin e interpretimit të islamit, të cilët janë karakteristik për racionalistët, modernistët dhe sufistët.

Selefistët rrezikun më të madh të islamit origjinal dhe të vërtetë e shohin në racionalizmin në njërën anë dhe misticizmin në anën tjetër. Për këtë shkak është e njëjta shmangie e tyre ndaj filozofisë islame (falsafah) si dhe ndaj misticizmit apo sofizmit (tasavvuf). Për shkak që racionalizmi është i inspiruar nga filozofia greke dhe logjika, kjo sipas selefistëve është e papranueshme dhe mund të dërgojë në herezi (largim nga burimi). Njohja e fesë, pohojnë selefistët, duhet të vijë vetëm nga burimet islame, Kur'ani dhe suneti dhe praktika e gjeneratës së hershme myslimane (salaf). Mosbesimi i selefistëve ndaj shkollës racionale islame shihet më së miri në lidhshmërinë e tyre, do të mund të themi më mirë për opsionin e tyre ndaj mësimave të ibn Tejmijes. Ky dijetar dhe autoritet i njohur islam ka jetuar në shekullin XIII në hapësirën e Sirisë së tanishme, ka hedhur poshtë racionalizmin, i cili në kohën e tij ka qenë i vlefshëm, si drejtimi kryesor islam në kuadër të shtetit të atëhershëm islam. Në kohën e tij, të cilit i ka paraprir epoka e artë e islamit të dinastisë së Abasidëve, bota islame i është ekspozuar agresionit të mongolëve nga Lindja dhe kryqtarëve nga Perëndimi, ndërsa stagnimi i brendshëm dhe ndikimi negativ i misticizmit kanë kërcënuar të rrënojnë mesazhin e vërtetë islam.

Ibn Tejmije pasi që ka qenë i akuzuar për herezinë e antropomorfizmit, me ç'rast ka refuzuar të pranojë interpretimin metaforik tëtributeve të Zotit, të përfshira në Kur'an, bile dy herë ka qenë edhe i burgosur. Ky k propaganduar qasje selefite të islamit, përkundër akuzave të shtetit zyrtar dhe dijetarëve islamikë racionalistë. Për këtë arsye Ibn Tejmije vlen si shembull themelor dhe inspirim për selefistët, pasi që ka qenë i gatshëm të sakrifikojë jetën për mbrojtjen e bindjeve të tij fetare. Janë të njohura fetvat e tij, me të cilat ka lejuar mundësinë e rezistencës ushtarake kundër mongolëve, edhe pse ata nominalisht

ishin myslimanë, pasi që kanë shfrytëzuar kodet e tyre kulturore në kuadër të qeverisjes, nga ata të cilit i ka përshkruar Kur'ani.

Pas ibn Tejmijes, Ahmed ibn Hanbeli (ibn Hanbel), njëri prej themeluesve të katër shkollave juridike islame (medhhebe), zë vendi të posaçëm dhe vlen si burim i inspirimit për ndjekësit selefitë islamë. Ibn Hanbeli ka jetuar në shekullin IX, pas profetit Muhamed, dhe ka kundërshtuar qasjen racionale të interpretimit të islamit, i cili për këtë shkak ka qenë edhe i burgosur. Shkolla juridike e themeluar në mësimin e tij në kohën e sotme mbizotëron në Arabinë Saudite dhe në shumicën e shteteve të Gadishullit Arabik, përveç Omanit. Është interesant se selefistët bashkëkohorë ndjenjë mosbesim të madh ndaj lëvizjeve islame të mëparshme, ndjekësit e të cilëve veten e quanin selefitë, të cilët kanë qenë të inspiruar prej mësimave të reformatorëve modernë të mendimeve islamike, sikur Xhemaludin Afgani (1839-1897), Muhamed Abduhu (1849-1905) dhe Reshid Rida (1865-1935). Fakti që edhe këta reformatorë islamikë dhe modernistë e konsiderojnë veten selefistë, kjo shpeshherë sjell huti dhe ngatërrim.

Selefistët e sotëm, reformatorët islamë të përmendur i kundërshtojnë për shkak të ndikimit të ideologjive perëndimore në mendimet e tyre, ashtu që shpesh i karakterizojnë, veçanërisht Muhamed Abduhun, si racionalistë të prirë në devijim lidhur me mendimin islam. Disa selefistë të pamend i akuzojnë për "agjentët britanikë", të cilët janë infiltruar mes myslimanëve për të minuar mendimin islam të vërtetë. Kjo tregon në të vërtetë se deri në çfarë mase disa selefistë janë të gatshëm të shkojnë në kritizimin e kundërshtarëve të vet. Pavarësisht besimit të njëjtë dhe metodologjisë të cilën e përdorin, madje në kuadër të vet selefizmit, me kohë kanë ardhur deri te ndarjet e thella dhe mospajtimet. Megjithatë, këto ndarje janë shkaktuar për shkak të interpretimit të ndryshëm të kontekstit shoqëror modern, e jo në dallimet në besim dhe metodologji, të cilat janë të përbashkëta për të gjithë selefistët. Të preokupuar me çështjen se si në mënyrë më të drejtë të zbatojnë parimet islamike të përhershme dhe të pandryshueshme të bazuara në Kur'an dhe sunet për shoqërinë myslimane bashkëkohore, e cila u është nënshtruar ndryshimeve të përditshme, dijetarët islamikë

të drejtimit selefist, edhe pse në mënyrë identike u qasen burimeve të së drejtës islame (shariatit), komentojnë ndryshe çështjet bashkëkohore politike dhe shoqërore, në rastet dhe rrethanat të caktuara. Ashtu që interpretimet e ndryshme kontekstuale kanë prodhuar lëvizjet e ndryshme në kuadër të bashkësisë selefite myslimane.

Për hir të kuptimit analitik më të mirë të fenomenit të selefizmit, është i mundur identifikimi i tri drejtimeve më të rëndësishme në kuadër të shkollës selefite islame: apolitik (puritanik), politik dhe xhihadik. Selefistët apolitikë i karakterizon qasja neutrale politike e fesë, me aksentin kryesor në propagandimin e islamit (da'vah), përsosje personale në fe dhe devotshmëri si dhe dhënia e rëndësisë së madhe të edukimit islam. Marrja me politikë aktive e cila nënkupton shfrytëzimin e islamit si model inspirues i rregullimit të bashkësisë shoqërore si dhe pikë referuese, nga këndvështrimi i protagonistëve të këtij drejtimi, paraqet devijim dhe largim nga rruga e drejtë. Ajo, sipas tyre, çon në devijim nga islami i vërtetë. Ky trend selefit më së shumti është prezent në Arabinë Saudite, ndërsa avokues më të mëdhenj të tyre janë pjesëtarët të ulemasë së vjetër saudite, të establishmentit shtetëror fetar.

Për këtë shkak është evidente roli i madh i Arabisë Saudite në zgjerimin e këtij mësimi islam nëpër gjithë botën, veçanërisht në vendet, ku myslimanët jetojnë si pakica fetare. Kjo ndihmë nënkupton ndërtimin e xhamive, medreseve, botimin e literaturës islame dhe të ngjashme. Selefistët apolitikë kanë respekt të posaçëm ndaj dijetarëve islamë, pa ndihmën dhe udhëheqjen e tyre është e pamundur të zotërohet mesazhi i vërtetë islam. Për atë arsye është edhe respekti i tyre i veçantë për Ibn Hanbelin dhe Ibn Tejmijen.

Njëri prej dijetarëve kryesorë selefitë apolitikë ishte edhe Muhamed Nasir al-Din al-Albani (1914-1999). Al-Albani, me prejardhje shqiptare nga Shkodra, i cili u shpërngul në Siri, ka qenë njëri prej kundërshtarëve më të ashpër të politizimit të islamit. Ai gjithashtu ka kundërshtuar fuqishëm përdorimin e dhunës për realizimin e qëllimeve politike, si dhe është e njohur fetvaja e tij për çështjen e Palestinës. Al-Albani ka konsideruar, pasi që Izraeli ka okupuar Palestinën, Pale-

stina nuk është më shtet islam, dhe se palestinezët duhet të shpërngulen në shtetin tjetër mysliman. Me këtë edhe ndjekësit e shejhut Al-Albani kanë qenë të befashuar me mosnjohjen e lëvizjeve bashkëkohore politike. Fetvaja e lartpërmendur e tij ka shkaktuar dobësimin e reputacionit të tij. Protagonisti i qëndrimeve të ngjashme ka qenë edhe dijetari islamik sirian Seid Ramadan al-Buti, i cili ka qenë apologetik dhe kurrë nuk e ka kritikuar regjimin despotik të Bashar al-Asadit. Kuptohet që qëndrimi i këtillë i një dijetari islamik më së mirë flet për mosnjohjen e mundësive bashkëkohore politike, veçanërisht të marrëdhënieve ndërkombëtare, nga selefistët apolitikë dhe tjetërsimi i tyre nga realiteti.

Prandaj, nuk befason se selefistët apolitikë nuk paraqesin kërcënim të veçantë për regjimet autoritare arabe dhe mbrojtësit e tyre të fuqishëm në Perëndim. Al-Albani në dy raste ka ligjëruar në Arabinë Saudite, dhe pas viteve të 60-ta kaloi në Siri, e më tej në Jordani. Shejh Albani ka inspiruar numër të madh të dijetarëve të rinj selefite në Arabinë Saudite, i cili pas viteve të 70-ta ka themeluar lëvizjen e njohur (al-xhama'a al-Salafija al-Muhtasiba). Kjo lëvizje në fillim ka qenë në mënyrë të skajshme apolitike, por më vonë ka ardhur deri te radikalizmi i disa anëtarëve të tyre. Kjo ka rezultuar me rebelimin e disa grupeve radikale kundërshtarë të regjimit dhe pushtimin e Qabesë në Mekke gjatë vitit 1979. Mirëkuptimi i rolit qendror të dijetarëve islamë në kuadër të selefizmit, veçanërisht raporti mes nxënësit dhe mësuesit, është i rëndësishëm për kuptimin e përgjithshëm të drejtimit selefite. Dijetarët konsiderohen mbrojtësit dhe kujdestarët e dijes fetare. Ata janë pasardhësit e profetit Muhamed. Vetëm ata janë të pajisur në mënyrë adekuate me dije për interpretimin e saktë të islamit dhe se vetëm ata dinë mesazhin e tij të vërtetë.

Dijetarët islamë paraqesin vargun që i lidh me gjeneratën e selefëve. Pa ata do të zhdukej njohuria fetare, dhe në këtë mënyrë propagandimi i tevhidit do të vinte në pikëpyetje. Ky rol qendror i dijetarëve në selefizëm bazohet në ajetin e njëmbëdhjetë të kaptinës (sures) Al-Muxhadala, në të cilin flitet për atë që Zoti do të ngrejë në shkallë më të larta ata që besojnë dhe atyre që është iu dhënë dituria. Për këtë

shkak selefistët apolitikë kujdes të posaçëm u kushtojnë shkencave fetare. Qendrat më të njohura të islamit selefite janë Universiteti Islamik në Medine dhe Universiteti Umm al-Qura në Mekke. Këto qendra prodhojnë numër të madh të dijetarëve islamë selefite, të cilët veprojnë gjatë gjithë botës islame dhe perëndimore.

Selefizmi, djepi i të cilit është në Arabinë Saudite, ka zhvilluar specifikat e veta, ashtu që kryesisht e nënkuptojnë si vehabizëm, ndërsa ndjekësit e tij vehabistë. Barazimi i selefizmit saudit me vehabizmin ka arsye historike. Pasi që reformatori më i njohur islam në gadishullin Arabik ishte Muhamed ibn Abdul-Vahhab (1703-1791), ithtarët e tyre kanë marrë emrin sipas tij, edhe pse ata vetë nuk e përdorin këtë term, porse preferojnë që të quhen vetëm myslimanë, ose muvehidunë, ndjekës të fesë në një Zot, përkatësisht mbrojtës të njëshmërisë së Zotit apo unitetit (tevhidit). Edhe pse selefizmi apolitik saudit në pikëpamje historike mbështetet dhe bazohet në mësimet e Ibn Hanbelit dhe Ibn Tejmijes, në zhvillimin e drejtimit bashkëkohor selefite më së shumti ka ndikuar Abdyl-Vehabi, i cili ka qenë i inspiruar me mësimet literale, të ashtuquajtura shkolla islame neohanbelite, të cilët i kanë mësuar Ibn Tejmije dhe Ibn Kajjim al Xhezvije. Doktrinën të cilin e ka predikuar Abdyl Vehabi ka qenë shumë e thjeshtë, pasi që ka mbështetur rikthimin revolucionar drejt islamit origjinal, i cili është praktikuar në kohën e peygamberit Muhamed. Në shekullin XVIII, kur ka jetuar Abdyl Vehabi, Perandoria Osmane ka qenë pothuaj në mbarim të fuqisë së saj, fuqitë koloniale perëndimore, posaçërisht Anglia dhe Franca kanë qenë në ngritje të sipër. Përveç saj, drejtimi shiit në kuadër të islamit, i cili ka mbizotëruar në Persi (Iran), ka paraqitur kërcënim për mësimin islam në gadishullin Arabik, veçanërisht në krahinën e Nexhdit, ku lindi edhe selefizmi modern.

Faktori që po ashtu ka inkurajuar rishikimin kritik të praktikimit islam në gadishullin Arabik dhe domosdoshmërinë e reformave revolucionare, ishte edhe sofizmi (drejtimi mistik islam), i cili ishte zgjeruar dhe ka marrë elementet e papranueshme, sikurse që ishte ndërmjetësimi mes Zotit dhe njeriut, rolin e të cilëve e plotësonte shejhat sufi. Vizita varrezave të tyre (tyrbeve) nga myslimanët, sipas

perceptimit selefit të islamit, ka qenë e drejtuar kundër principeve themelore të doktrinës islame, të cilën janë përpjekur ta mbrojnë. Faktoret e sipërpërmendur kanë ndikuar në lidhjen e aleancës mes ithtarëve të Abdyl Vehabit dhe fisit Al-saud, i cili në atë kohë është imponuar si forcë ushtarake në gadishullin Arabik, dhe që ka kërkuar që nën pushtetin e saj të vërë kontrollin, duke kundërshtuar kryesisht pushtetarët e atëhershëm që kanë vepruar në shërbim të Portës në Stamboll, dhe të cilët janë konsideruar, jo vetëm dekadentë por edhe jokompetentë të mbrojnë islamin e vërtetë.

Pasuesit e selefizmit kanë shkuar aq larg në puritanizmin e tyre, sa që kanë dënuar dhe ndaluar përdorimin e muzikës, poezisë, konsumimin e duhanit, e ndonjëherë edhe të qeshurit me zë. Por, për këtë lëvizje mund të thuhet, sado që ai mund të duket, megjithëse nuk ka qenë revolucionare e vërtetë, pasi që është identifikuar me monarkinë e familjes Al-Saud. Kontradiksioni i vetë mësimi të vehabizmit është i veçantë pasi që koncepti i monarkisë në Kur'an fare nuk ekziston dhe si i tillë nuk ka bazë fetare, edhe pse doktrina themelore e mësimi vehabit është rikthimi në burimet e vërteta islame, Kur'anit dhe praktikës së pejgamberit Muhamed. Për dallim nga selefizmi saudit (vehabizmi), me selefizëm po ashtu nënkuptohet lëvizja reformiste islame, e cila ishte zhvilluar në Indi dhe Egjipt, gjatë shekullit XIX. Ky drejtim reformist në kuadër të islamit, nuk ka asgjë të përbashkët me modelin integrist puritanik saudit të islamit, të cilin një shekull më parë e ka nisur Muhamed ibn Abdyl Vehab. Protagonistët e kësaj lëvizjeje të shekullit XIX ishin Xhemaludin Afgani, Muhamed Abduhu dhe Reshid Rida. Ata kanë qenë të brengosur për shkak të pafuqisë së botës islame në krahasim me botën krishtere perëndimore, e cila ishte në ngritje shkencore, teknologjike, ekonomike. Okupimi i Egjiptit nga Napolon Bonaparta dhe kolonizimi i Afrikës Veriore nga francezët, si dhe dominimi britanik i nënkontinentit indian kanë qenë goditje mahnitëse për botën myslimane, e cila deri në fund të shekullit XVIII ishte superiore ndaj Perëndimit. Këtë lëvizje reformiste selefite i pari në Indi e ka nisur Afgani.

Pikërisht në bazë të ideve të tri reformatorëve islamë të sipërpërmendur, në Egjipt në fillim të shekullit XX është krijuar lëvizja islame Vëllazëria Myslimane. Për dallim nga kolegët e tyre apolitikë, selefistët aktivë politikë theksojnë rëndësinë e posaçme të zbatimit të islamit në sferën politike. Këtë qëndrim të tyre e bazojnë në bindjen se politika pashmangshëm ndikon në çështjet e drejtësisë shoqërore. Ata, cekin se për ligdhënesin e pranojnë vetëm Zotin, me ç'rast në mënyrë të hapur bien në kundërshtim me vështrimet bashkëkohore perëndimore në çështjen e parlamentarizmit. Shkolla e vjetër e selefistëve në Arabinë Saudite, edhe sot është dominuese në interpretimin islam dhe e vetmja ka monopolin mbi interpretimin e drejtë të lëvizjeve aktuale politike në vend dhe botë. Sigurisht që kjo shkollë plotësisht e kontrollon establishmentin shtetëror fetar dhe ka ndikim të madh në politikën shtetërore. Me këtë pozitë që ka me të madhe e shfrytëzon propagandimin e versionit puritanik të selefizmit. Fillim viteve 80-ta, e posaçërisht gjatë viteve 90-ta në Arabinë Saudite është paraqitur shkolla e re të dijetarëve të rinj selefitë, të cilët i janë kundërvu shkollës dominuese. Këta dijetarë të rinj theksojnë se janë më të vetëdijshëm dhe më të aftë, e me këtë edhe më të kualifikuar që parimet islame selefite t'i aplikojnë në kontekstin shoqëror bashkëkohor. Ata, për këtë shkak janë me të vërtetë kritikë ndaj strukturave qeveritare autokratike. Gjenerata e re e selefistëve sot paraqet opozitë ndaj ulemasë së vjetër, e cila e mbron pushtetin autokratik në Arabinë Saudite. Kjo, po ashtu shkon në favor të faktit se selefizmi tani as në djepin e tij ku ka lindur, nuk është më homogjen. Diskursi mysliman selefit në Arabinë Saudite ndryshe është zhvilluar nga shtetet tjera arabe, të cilat ishin ekspozuar kolonizimit perëndimor, e më vonë lëvizjeve revolucionare, të cilat kanë imponuar ideologjinë sekulare politike. Për shkak të përvojës historike të ndryshme, ulemaja saudite nuk ishte e detyruar të merrej me çështje politike, posaçërisht jo në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ata kryesisht janë marrë me idetë se si të parandalojnë devijimet në fe, ndërsa politikën e kanë lënë në duar të pushtetarëve. Ky homogjenitet origjinal i lëvizjes selefite gradualisht ka filluar të ndryshojë gjatë viteve 60-ta të shekullit të kaluar, kur nga Egjipti në

Arabinë Saudite filluan të vijnë anëtarët e Vëllazërisë Myslimane, të cilët tentonin të ikin nga shtypja dhe tortura e regjimit sekular autokratik të Naserit në Egjipt. Kuadrot me arsimim të lartë të Vëllazërisë Myslimane, lëvizje të cilin në vitin 1928 e themeloi Hasan al-Bena, në atë kohë ishin të mirëseardhur në mbretërinë e Arabisë Saudite. Qeveria e Arabisë Saudite atëherë e ka njohur si pasuri intelektuale të cilin duhet shfrytëzuar për zhvillimin e vendit, posaçërisht në sferën e arsimimit. Anëtarët me reputacion të Vëllazërve Myslimanë janë angazhuar në universitetet saudite për të ngritur gjeneratat e reja të myslimanëve dhe kanë publikuar një numër të madh të publikimeve shkencore. Shumicën e fondit të librave që ishte në dispozicion në atë kohë në vend, janë reprodukuar pikërisht nga anëtarët e Vëllazërve Myslimanë. Ata me vete kanë sjell qasje të re të interpretimit islam, të cilën e ka karakterizuar diskursi i fuqishëm politik, i cili për rastin saudit ishte raritet i llojit të vet. Vëllazërit myslimanë kanë qenë segmenti mysliman politikisht më i vetëdijshëm dhe më i sofistikuar në botë. Me dekada kanë qenë politikisht aktivë dhe kanë pas njohuri të mira të marrëdhënieve ndërkombëtare, e veçanërisht të botës perëndimore. Ata ishin mësues të cilit vetëm mund të dëshiroheshin si të tillë. Vëllazërit myslimanë kryesisht kanë trashëguar qasje racionale të islamit, për dallim nga selefistët sauditë. Por, njëri nga liderët udhëheqës të Vëllazërve Mysliman, Sejid Kutbi ka qenë i njohur për orientimin e tij selefist. Kutbi ka qenë i njohur si shtegtar i madh i Ibn Tejmijes dhe Muhamed ibn Abdyl Vehabit, imami sipas së cilëve, selefistët sauditë kanë marrë emrin “vehabitë”.

Sejid Kutbin, për shkak të rolit të tij opozitar ndaj diktatorit egjiptian Naserit, është var në burg në vitin 1966. Vëllai i tij Muhamed Kutbi ka qenë profesor me renome në shtet, në mesin e studentëve të tij ka pasur edhe persona nga Bosnjë e Hercegovina. Intelektualë të spikatur nga radhët e Vëllazërve Myslimanë në Arabinë Saudite, kanë arritur të shkollojnë një numër të madh të dijetarëve islamë, politikisht të vetëdijshëm, në mesin e tyre edhe Safar al Havvali dhe Selman el Avde, kritikuesit më elokuentë të regjimit saudit në Riad, nga radhët e ylemasë selefite islamike. Disa dijetarë këtë trend të ri, i cili është

krijuar nën ndikimin e Vëllazërve Myslimanë, e quajnë “selefizm të politizuar”. Gjenerata e re e dijetarëve selefistë politikisht e vetëdijshme, ka besuar se ka përgjegjësi morale dhe fetare të sillet në mënyrë kritike ndaj çështjeve politike në vend, duke përfshirë edhe kritikën e pushtetarëve dhe politikën shtetërore, që deri atë kohë ishte e pamenduar.

Gjatë kohës kur Sadam Hysejni ka kryer invadimin në Kuvajt, kjo gjeneratë e re e dijetarëve islamikë selefistë seriozisht i është kundërvu ylemasë së vjetër, e cila ka lëshuar fetvanë (pëlqimin fetar), me ç’rast nga ana islame ka arsytuar stacionimin e trupave ushtarake amerikane në token e Arabisë Saudite, duke cekur se stacionimi i tyre, nga aspekti i establishmentit fetar zyrtar, është konsideruar ofrimi i ndihmës mbretërisë saude. Gjenerata e re e dijetarëve selefistë i është kundërvu fetvasë së lartcekur. Ky moment ishte pikë kthese në zhvillimin e selefizmit dhe ka kontribuar në fragmentim të tij. Safar al-Havali ka deklaruar se stacionimi i trupave amerikane në token e Arabisë Saudite, është strategjia e hartuar mirë për fillimin e kolonizimit të botës islame. Al-Havali ka kritikuar establishmentin zyrtar fetar se ka vlerësuar gabimisht qëllimet amerikane dhe se fetvaja është në të vërtetë thirrja për kolonizimin e vendit. Selefistët e rinj, politikisht të vetëdijshëm, po ashtu kanë kritikuar establishmentin zyrtar fetar për mosnjohjen politike, posaçërisht të diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, për të cilën janë të sigurt se nuk kanë gabuar. Kritika e tyre nuk ka qenë e drejtuar në llogari të besimit me të cilin edhe vetë e ndajnë me establishmentin fetar, kritika ka qenë para gjithash me moskuptimin e kontekstit bashkëkohor me të cilët ka të bëjë fetvaja. Prandaj, fjala është për interpretimin e ndryshëm politik, e jo interpretim të parimeve fetare.

Drejtimi i tretë brenda selefizmit, i cili është me siguri edhe më kontrovers, i cili gjatë dekadës së kaluar ka ngjallur më së shumti interesim, por edhe frikë, si në Perëndim, ashtu edhe në Lindje, janë të ashtuquajtur xhihadistët ose tekfivistët selefist. Ky trend militar selefist mori qëndrim mjaft rixhid kur është fjala për ndryshimet shoqërore dhe politike. Në kontekstin modern, xhihadistët besojnë se ndryshimet

radikale shoqërore janë të mundshme të kryhen vetëm me luftë të armatosur dhe revolucion. E përbashkëta e të tri drejtimeve të përmendura selefite është se kanë bindje të njëjtë teologjike. Pavarësisht nga to, ata megjithatë ofrojnë interpretime të ndryshme të botës bashkëkohore dhe problemeve që ekzistojnë në botë. Ata botën e perceptojnë dhe e interpretojnë në mënyra të ndryshme, e me këtë edhe ofrojnë formula të ndryshme për zgjidhjen e problemeve bashkëkohore të botës islame. Prandaj, çështja thelbësore mes selefistëve ishte mbi të gjitha mospajtimi në analizën kontekstuale të shoqërisë dhe botës, e jo në vetë besimin. Nga ky kontekst shoqëror varet ajo se pjesëtarët e bashkësisë selefite a do të bëhen xhihadistë, islamistë politikë apo do të mbajnë qëndrim neutral. Me fjalë tjera selefizmi si drejtim islamik mjaft është i megjulluar dhe lëviz prej pacifikut, te ai revolucionar deri tek ai militant.

Selefizmi si lëvizje islame në kuadër të islamit sunit, gjatë disa shekujve të kaluar ishte dukuri marginale në kuadër të bashkësisë myslimane globale (umma), të cilin gjatë gjithë kohës së ekzistimit e ka karakterizuar qasja heterogjene e kuptimit islam në praktikë, nga ai tradicional, racional-filozofik, mistik (sufist), shkencor, si dhe modern dhe politik. Selefizmi është unik në të, pasi që ka qenë i kundërshtueshëm në të gjitha aspektet e tij. Drejtimi islam, i cili posaçërisht gjatë gjysmës së shekullit XX ka tërhequr vëmendjen e opinionit publik botëror, është i ashtuquajtur i islami politik, i cili sot shënohet si islamizëm.

Nën termin islamizëm nënkuptohet ideologjia politike, parimet dhe platforma politike e të cilëve është e inspiruar dhe bazuar në parimet islame. Lëvizja islame politike më e madhe, më e rëndësishme dhe më me ndikim është Vëllazëria Myslimane (Ihvan al Muslimun). Kjo lëvizje të cilin e ka themeluar Hasan el Benna, në vitin 1928, ka arritur të përvetësojë një numër të madh ithtarësh në botën islame dhe konsiderohet forcë dominuese islame në Egjipt, Sudan, Jordani, Siri, Tunizi, Jemen dhe Palestinë, por ka ndikim edhe në monarkitë e gadishullit Arabik. Partia pro-islamike për Zhvillim dhe Drejtësi (AKP) në Turqi, ka trashëgimi të kësaj lëvizjeje. Për dallim nga Vëllazërit Mys-

limanë, selefizmi deri sot ka përfaqësuar fuqinë minoritare në kuadër të islamit. Por, pas shpërthimit të pranverës arabe erdhi deri te forcimi i papritur i selefizmit jashtë kufijve të gadishullit arabik, dhe atë jo vetëm si trend fetar por edhe fenomen politik. Selefizmi si i tillë në sferën politike të forcave të reja në Lindjen e Afërt shfaqet si kundërshtar më i rëndësishëm ndaj ideologjisë politike të Vëllazërve Myslimanë. Këtë aspekt veçanërisht duhet marrë me qëllim të kuptimit më të lehtë të raportit armiqësor të politikës zyrtare të Arabisë Saudite dhe fqinjëve të saj të afërt (aleatëve) të gjirit arab ndaj ideologjisë, programit politik dhe personaliteteve, të cilët personifikojnë Vëllazërit Myslimanë.

Konflikti i ideologjisë së Vëllazërisë Myslimane dhe mësimi selefist, e në kohën e fundit edhe partive selefiste më të reja, nga njëra anë, dhe lëvizjeve militante (xhihadiste), nga ana tjetër, ka sjellë te polarizimi politik në botën arabe pas shpërthimit të pranverës arabe me të gjithë atë që ky term nënkupton, e që është liberalizimi politik dhe mediatik i shoqërive totalitare arabe, demokratizimi dhe participimi i partive islame në jetën politike.

Disa analistë besojnë se hyrja e lëvizjeve selefiste në sferën politike është njëra nga reperkusionet më të rëndësishme të pranverës arabe. Është interesant se selefistët para vitit 2011, participimin politik e kanë konsideruar të palejuar dhe anatemë. Kanë besuar që themelimi i partive politike me parashenjë islame është në konflikt të drejtpërdrejtë me mësimin islam dhe si e tillë është jo e lejuar. Ky lloj raporti kundër rolit të islamit në politikën moderne edhe sot është karakteristikë themelore e sistemit politik në Arabinë Saudite, djepin e selefizmit dhe financierin kryesor të lëvizjeve të shumta selefiste në botën arabo-islame dhe bashkësitë myslimane të diasporës në Perëndim.

Gjatë tre vjetëve të kaluara në botën arabe, duke përfshirë edhe vendet e Afrikës Veriore, ka ardhur deri te politizimi rapid i lëvizjeve selefiste dhe themelimi i partive politike, me qëllim të participimit politik në jetën parlamentare të shoqërive arabe. Kjo ka sjellë riorganizimin politik islam në skenë, në të cilin gati gjatë tërë shekullit të kaluar ka dominuar vetëm ideologjia e Vëllazërve Myslimanë, dhe atë në

formën opozitare, e në kohën e fundit edhe në pozitë me qeveri në Marok, Libi, Tunizi dhe Egjipt para puçit ushtarak i kryer nën udhëheqjen e gjeneralit Al-Sisit. Selefistët në Egjipt kanë themeluar disa parti politike, në mesin e të cilëve janë: al-Nur (Drita), al-Asalah (Autentik), al-Vatan (Atdheu), al Bina vatanmijja (Zhvillim dhe Ndërtim), al-Fadilah (Virtyt), Partia Reformiste në Tunis, Partia e Renesansës dhe Virtytit në Marok, Partia e Bashkuar e Rugës së Drejtë në Jemen dhe të tjera. Për çfarë pjesëtarët e lëvizjeve selefiste papritur kanë themeluar një numër të madh të partive politike, që deri atëherë kanë vepruar vetëm në fushën e shoqërisë civile, fokusi i të cilit ka qenë në mënyrë të theksuar apolitik dhe i përqendruar vetëm në përhapjen e modelit selefist të kuptimit islam, edukimit dhe aktiviteteve bamirëse? Për më tepër, liderët selefistë nuk kanë bazë fetare dhe justifikim për këtë ndryshim dhe transformim nga mënyra e veprimit pacifik dhe apolitik në politik dhe aktiv. Është interesant se shumica e dijetarëve selefistë deri kohën e fundit kanë cituar rregullisht kaptina nga Kur'an, duke vërtetuar në ndalimin e marrjes me politikë e posaçërisht me anëtarësim në parti politike apo themelimin e tyre, për të cilin gjatë gjithë kohës kanë urreyer Vëllezërit Myslimanë, të cilët aktivisht janë marrë me politikë. Këtij transformimi kanë kontribuar shumë aktorë, në mesin e tyre edhe ndërrimi i papritur i klimës politike dhe liberalizimi i sistemit politik pas zgjimit arab. Selefistët qartë kanë ndier që qëllimet e tyre më lehtë mund të arrijnë me participim sesa me shfrytëzimin e metodave tradicionale të thirrjes (davvah), të cilët kanë qenë më të përshtatshëm për sistemin autoritar të mbyllur dhe restriktiv.

Selefistët janë frikësuar se nëse vijnë në pushtet Vëllezërit Myslimanë, ata do të tentojnë të eliminojnë selefistët, dhe atë jo vetëm nga skena politike por edhe nga sfera e shoqërisë civile, me ç'rast ata do të marginalizoheshin tërësisht. Selefistët me këtë veprim, po ashtu kanë dashur të dërgojnë mesazhin se janë të aftë të marrin pjesë në procese politike, pasi që janë kritikuar për papërvojë politike dhe mosposedimin e njohurive për t'u marrë me politikë. Përveç arsyeve të lartpërmendura të cilat me të vërtetë janë pjesërisht të sakta, duket se motivimi kryesor selefist për veprim politik ka qenë frika e tyre nga

dominimi i Vëllezërve Myslimanë, forcës politike me përvojë shumë më të madhe në suaza të modelit politik islamik. Ky lloj i zhvillimit në kuadër të lëvizjes selefiste ka sjellë edhe në zgjerimin e ndryshimeve në kuadër të vetë selefizmit, pasi që edhe më tutje një numër i konsiderueshëm i selefistëve edhe më tej kundërshtojnë themelimin e partive politike. Konflikti politik brenda selefizmit ka sjellë deri te lufta psikologjike, e cila bëhet me sjelljen e fetvave kontradiktore për dhe kundër participimit politik. Kjo edhe më shumë e ka thelluar hendekun mes selefistëve pacifistë dhe rivaleve të tyre militantë.

Para se shoqëritë e ndryshme selefiste filluan themelimin e partive politike, selefistët militantë apo xhihadistët kanë provuar dhe shpesh kanë marrë jo vetëm përkrahje logjistike për operacionet e tyre ushtarake në pjesët e ndryshme të botës arabe dhe islame, por në radhët e tyre kanë arritur të rekrutojnë një numër të konsiderueshëm të luftëtarëve dhe operativistëve, duke përfshirë edhe nga radhët e bashkësive myslimane në Perëndim, ku jetojnë si pakica në diasporë. Fillimi i participimit politik selefist, logjikisht ka sjellë marrëdhëniet e tyre në pikëpyetje. Duke pranuar legjimitetin politik partipicues selefistë në mënyrë automatike kanë pranuar se qëllimet e tyre tani mund të realizohen në kuadër të proceseve politike, e jo me rezistencë ushtarake, posaçërisht jo me mënyrën e veprimit terrorist. Por, praktika e deritanishme e participimit politik selefist ka treguar se ata janë operatorë politikë relativisht jokompetentë, duke marrë parasysh se nuk kanë arritur rezultate të duhura në skenën politike. Përgjashtim bën vetëm partia selefiste Al-Nur, e cila ka arritur rezultat të mirë politik si forca e dytë politike, pas Vëllezërve Myslimanë, tani organizata politike e cila është e ndaluar kohë më parë në Egjipt. Halil al Anani hulumtues i Institutit të Lindjes së Afërt në Uashington, theksoi se pas shmangies disadekadëshe nga politika dhe shpallja e sistemit demokratik si i huaj për Islamin, selefistët në Egjipt janë bërë "kumbar" të politikës islame. Pse kumbarë! Rrjedhimisht pasi që janë pozicionuar mes Vëllezërve Myslimanë dominues, të cilët janë në skenë tetë dekada dhe lëvizjeve radikale islamike, të cilët për dallim nga Vëllezërit Myslimanë nuk kanë ngurrar të përdorin dhunë dhe terrorizëm kundër që-

llimeve të qeverisë, por edhe ndaj civilëve e posaçërisht të turistëve të huaj.

Mossuksesi i partive selefiste në fushën politike i ka trimëruar kundërshtarët e tyre brenda selefizmit të kërkojnë ndalimin e punës së partive fetare, pasi që janë treguar joefikas. Pas kësaj është mundësia e madhe që të thuhet se hyrja avanturiste e selefistëve në politikë do të shkaktojë një rishikim të rolit të këtillë në politikë dhe kthim në tokë të sigurt, në fushën e prozelitizmit religjioz dhe veprimit arsimor dhe humanitar, ku janë treguar shumë më të suksesshëm. Selefistët egjiptian, sipas orientimit të tyre, janë të përafërt me selefite saudë, e jo lëvizjes së hershme reformatore egjiptiane të shekullit XIX, e cila ishte i inspiruar me idetë reformiste të Muhamed Abduhut. Është interesant se edhe diktatori i dikurshëm egjiptian, Hysni Mubaraku, gjatë kohës së tij i ka përkrahur dhe nxitur selefistët në zgjerimin e tyre në fushën e ndikimit shoqëror, jo në mënyrë të drejtpërdrejtë me veprim politik, ashtu që në atë mënyrë kanë dobësuar ndikimin e kundërshtarëve të tyre seriozë politikë Vëllezërit Myslimanë. Ky reformator i njohur mysli-man, siç cek Albert Hourani (dikur njohësi kryesor i zhvillimeve arabe në Perëndim), ka thirrur në rikthim të islamit burimor për të cilin ka besuar se është në harmoni të plotë me arritjet shkencore dhe racionale, të cilët kanë lansuar përparimin teknologjik të botës perëndimore. Selefistët bashkëkohorë thërrasin në kuptimin e islamit ortodoks dhe literal, pra mbështetjen në rezonimin intelektual në bazë të bindjes së shëndoshë dhe të logjikës (ixhtihad).

Përveç selefizmit politik, vëmendjen e opinionit publik botëror e tërheqin lëvizjet e ndryshme militante me parashenja islame, të cilat thirren në interpretimin selefist të islamit, dhe jo vetëm që hedhin mundësinë e participimit politik, por edhe haptas janë kundër çdo veprimi politik. Ata demokracinë, pluralizmin dhe liberalizimin e shoqërive i konsiderojnë të huaja sipas mësimi islam. Kjo ka të bëjë, me siguri me formacionet xhihadiste, të cilët sot janë duke luftuar në pjesët e ndryshme të botës arabe, dhe atë nga Algjeria në perëndim, deri në Siri, Irak dhe Jemen në lindje, të cilët cekin se janë duke luftuar për vendosjen e sistemit të islamit, i cili i tejkalon dallimet mes mysli-man-

nëve në aspektin gjeografik, nacional, etnik, fisnor etj. Qëllimi i tyre është vendosja e kalifatit islamit (hilafet) sipas shembullit të periudhës së hershme islame. Këto grupe militante theksojnë se janë zëdhënës autoktonë të drejtimit selefist islam, ndërkaq botën bashkëkohore e shohin sipas këndvështrimit të tyre të periudhës mekkase të islamit, në të cilin ka mbizotëruar besimi dhe mosbesimi. Ata termin e xhihadit, i cili ka shumë kuptime, e reduktojnë kryesisht në termin e luftës në emër të islamit. Luftëtarët e tyre rekrutohen kryesisht nga radhët e shtresave të varfra dhe të marginalizuara të shoqërive arabe, mosha e të cilëve është mes 16-30 vjeç.

Niveli i arsimimit të tyre është i ulët, ndërkaq arsimimi i tyre fetar është në shkallën pothuajse zero. Një numër i madh i tyre jo radhë janë marrë edhe me aktivitete të vogla kriminale. Si të tillë, janë tejet të përshtatshëm për indoktrinimin sistematik dhe programimin për realizimin e qëllimeve të mentorëve të tyre politikë e ushtarakë. Shembulli më i mirë i këtyre selefistëve militantë është Ansar al-Shariah (ndihmësit e sheriatit) në Tunizi, të cilët paraqesin problem serioz për lëvizjen e matur islame Ennahda, e cila është e bazuar në idetë e Vëllezërve Myslimanë. Shembulli i Tunizisë, më së miri flet se sa janë të rrezikshëm selefistët militantë xhihadistë për modelin e bashkëjetesës dhe stabilitetit për të cilin përpiqen islamistët e matur. Edhe qeveria e matur islamike në Tunizi, në gusht të vitit 2013, i ka shpallur organizatë terroriste pas vrasjes së liderit opozitar. Vizioni i tyre i sistemit islam në të ardhmen, jo që është në kolizion me sekularistët, krishterët, hebrenjtë dhe pakicat tjera fetare në botën arabe, por ata paraqesin problem serioz edhe për islamistët e matur. Xhihadistët sot operojnë posaçërisht në Siri, ku janë duke luftuar kundër regjimit të Bashar al Asadit, dhe në Irak, ku janë duke provuar të destabilizojnë regjimin shiit të Nuri al Malikit, në Bagdad. Ekzistojnë organizata dhe nënorganizata të shumta të këtyre grupeve militante selefiste xhihadiste. Ndër më të njohurat janë Shteti Islamik Irak dhe Siri (ISIL), i cili sipas disa analistëve është e lidhur me Al-Kaidën, paraardhëse e të gjitha organizatave xhihadiste, të cilin e kanë themeluar Osama bin Ladeni dhe Ajman al Zavahiri. Ajo çka është karakteristike për këtë

drejtim selefist është se ata sipas mendimeve të dijetarëve islamë respektivë, kanë dalë nga korniza e islamit dhe paraqesin sekt të posaçëm, i cili përkujton sektin e harixhive që ishte paraqitur në kohën pas vdekjes së pejgamberit Muhamed, sekt i cili ka qenë i njohur për vrasjet politike të kundërshtarëve të tyre, e të cilët harixhitë shumë lehtë i kanë shpallur jobesimtarë e me këtë edhe caqe legjitime të ndjekjes së tyre.

Këta xhihadistë radikalë, po ashtu thirren edhe tekfivistë, pasi që praktikojnë doktrinën e tekfirit (takfir), të cilët lejojnë vrasjen madje edhe të myslimanëve formalë, pasi që i shpallin për jobesimtarë, që nuk ka kurrfarë baze në mësimin islam.

*Burimi: Al Jazeera
Osman Softić*

* Osman Softić është teolog i diplomuar dhe magjistër i marrëdhënieve ndërkombëtare nga Universiteti UNSW në Sidnej. Merret me hulumtimin dhe analizën e çështjeve politike-ekonomike globale, me theks të posaçëm në Azinë Juglindore dhe rajonin e Pacifikut.

*Përktheu dhe përshtati:
Faik Miftari*

Osmon Softiq

SALAFISM

(Summary)

Recently, the term salafism is used interchangeably with Islamic movements or militant groups in the Arab world. These stereotypes were the topic of the conference organized by the Al Jazeera Center for Studies in Doha on January 18 and 19, 2014. The main objective of this international conference was to demistify salafism as a movement within the sunni school of Islam with the help of reknown experts (academicians) and leaders of the Salafi movement. During the opening session of the conference, the Al Jazeera Center for Studies launched the recent publication of their book, "The Salafist Phenomenon: Organizational Diversity and Policies".

عسمان صوفتيش

السلفية

(خلاصة البحث)

السلفية مصطلح كثير الاستعمال في الاونة الاخيرة و التي يقصد بها الحركات و الاتجاهات الاسلامية المعاصرة و الجماعات المسلحة تواجدة في العالم العربي . هذا النوع من النمط السلفي كان موضوعا للمؤتمر الذي عقد بتاريخ ١٨-١٩ يناير سنة ٢٠١٤ بعاصمة الدوحة القطرية تحت تنظيم مركز الدراسات الجزيرة . لقد كان الهدف من هذا الاجتماع العالمي ازالة الغموض عن السلفية كاتجاه داخل المدرسة السنية الاسلامية ز ذلك بمساعدة الخبراء العالميين والاكاديميين و كذلك عن طريق حضور زعماء سلفيين من مختلف الحركات السلفية .

وفي المؤتمر تم عرض دراسة عن السلفية تحت عنوان : "ظاهرة السلف التنوع التنظيمي و السياسي" و الذي تم نشره من قبل مركز الدراسات للجزيرة و الذي تم اعداده من قبل الباحثين بهذا المركز.

HISTORIOGRAFI

Zachary Karabell

ZOTI I DY TOKAVE

Kur fundi erdhi përfundimisht, ai ishte katastrofë. Ai ishte gjithashtu i pakuptimtë. Pas më shumë se një mijë vjetësh, qyteti i Kostandinopojës, vatra e perandorisë më të madhe që bota e krishterë ka njohur, u pushtua nga një ushtri myslimane. Por, derisa Sulltan Mehmeti II, që më pas u bë i njohur si Pushtuesi, marshoi në Kishën e Aja Sofias, në qendër të Kostandinopojës, Bizanti që atëherë pushoi së ekzistuari si perandori, përveç si emër.

Mehmeti erdhi në pushtet i ngarkuar me kompleksin real Oedipal. Babai i tij, Murati, kishte zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme kufijtë e sundimit otoman, dhe kur Murati vdiq më 1451, Mehmeti e pasoi atë - për herë të dytë. Pas fitoreve kundër hungarezëve dhe serbëve, Murati abdikoi më 1444, për t'u kthyer vetëm nga gjykata kur Mehmeti adoleshent, kokëfortë dhe përbuzës i këshilltarëve të babait të tij, u dëshmua i paaftë për të qeverisur me efikasitet dhe jo i gatshëm të punojë me vezirin e caktuar nga Murati, për ta udhëhequr princin e ri. Megjithatë nuk ka dokumente për atë që kishte ndjerë Mehmeti, kur u emërua dhe pastaj befasi u largua nga babai i tij autoritar, është e vështirë të besohet se e mori këtë me lehtësi. Në portrete, nga fytyra e tij e definuar nga hunda e gjatë dhe e mprehtë dhe mjekra klasike e një

princi otoman, është e vështirë të dallohet karakteri i tij. Por, sjellja e tij e mëvonshme sugjeron se ai kurrë nuk ia fali apo harroi atë që babai i tij kishte bërë dhe Kostandinopoja pagoi çmimin e tepërt dhe fatal.

Babai i tij kishte fituar gati çdo konfrontim me gati çdo kundërshtar me të cilin Otomanët ishin përballur, por një çmim e shmangu atë. Kostandinopoja ishte marrë saktësisht njëherë, më 1204, por jo nga myslimanët. Venedikasit kishin arritur atë që asnjë fuqi tjetër nuk e kishte bërë - as sllavët, as hunët, as vala e parë e ushtrive arabe që ishin shfaqur në shekujt VII dhe VIII, dhe as turqit selxhukë në shekullin XI. Për pesëdhjetë vjet pas plaçkitjes brutale të Kostandinopojës më 1204, latinët sunduan qytetin perandorak, dhe perandori bizantin qëndroi në mërgim. Në mes të shekullit XIII, u kthye familja perandorake, por gati jo triumfuese. Për dyqind vjetët e ardhshme, Bizanti ishte më shumë emër dhe legjendë sesa fuqi reale e aftë të përcaktojë se çka të zhvillohej në lindje të Mesdheut apo në Ballkan. Duke kontrolluar vetëm disa mijëra milje katrorë tokë, sundimtarët modernë të perandorisë dikur të fuqishme shikonin të paaftë Otomanët që po i mbyllnin në qytetin e tyre.

Megjithatë Bizanti ishte tkurrur dhe perandori i saj ishte kthyer në një njeri me mantel, i cili mezi arrinte të mbledhte pesë mijë njerëz për të mbrojtur qytetin, ai mbeti simbol i fortë si relikti i fundit e Romës. Vetëm për këtë arsye, ishte cak meritore për ambiciet e Mehmetit të ri. Dhe madje me një grusht mbrojtësish, muret e qytetit dhe pozita e tij strategjike midis ujërave të Cepit të Artë dhe Bosforit paraqisnin një sfidë të vështirë për çdo kundërshtar që dëshironte ta pushtonte atë. Teknologjia e rrethimit nuk kishte avancuar mjaft për të çarë mbrojtjen. Nga majat matanë skajit të ujërave, disa mbrojtës mund të shkatërronin anijet që tentonin të ankronin. Disa nga paraardhësit e Mehmetit ishin përpjekur ta merrnin qytetin dhe kishin dështuar, madje numerikisht më të shumtë. Kostandinopoja ishte e dobët, por akoma mund të mbronte veten.

Mehmeti ishte i vrullshëm, arrogant dhe vlonte nga fyerja, por madje edhe në moshën 21-vjeçare, dinte më së miri për të sulmuar qyte-

tin e papërgatitur. Ai përgatiti një ushtri të madhe, ndërtoi flotë, dhe autorizoi ndërtimin e një artilerie vigane para se të niste sulmin kundër Kostandinopojës në pranverën e vitit 1453.

Bizantinët bënë më të mirën që mundën. Disa anije e mercenarë gjenuez dhe venedikas erdhën t'i ndihmojnë, derisa shumica e Evropës refuzoi kërkesën e perandorit të Kostandinopojës për ndihmë. Disa të krishterë perëndimorë sugjerojnë se nëse perandori do të ishte i gatshëm t'i përkulej papës, do të merrte ndihmë më aktive, por ky nuk ishte çmimi që ishte i gatshëm të paguante. Derisa Kisha Romake kishte shpallur veten si autoriteti doktrinar suprem në Perëndim, Kisha Ortodokse Lindore kurrë nuk e kishte pranuar që papa ishte diçka më shumë sesa peshkopi i Romës, i denjë për respekt, por jo përkulje. Duke pasur zgjedhjen midis kapitullimit ndaj papës dhe dorëzimit të Otomanëve, Kostandinopoja preferoi të pafetë. "Më mirë turbani i myslimanit midis Kostandinopojës", thoshte shprehja, "sesa shamia e kokës së latinë". Perandori Konstantin ishte lënë me dredhinë e tij, njohurinë e brendshme të mureve që ishin ndërtuar nga perandori Teodosius një mijë vjet më parë, dhe lutje. Këto nuk mjaftonin.

Megjithëse Konstantini ndante emrin e themeluesit të qytetit, ai nuk ndante fatin e njëjtë. Gjeneralët otomanë bënë atë që ishte konsideruar e pamundshme dhe çanë portën e hekurt që mbronte Cepin e Artë nga anijet armike. Mehmeti kishte numrat në anën e tij dhe shfrytëzoi dendësinë e mbrojtjes dhe dobësitë në fortifikime. Dhjetëra mijëra ushtarë të tij u futën në qytet dhe e pushtuan atë. Konstantini hoqi simbolet e tij perandorake, u përfshi në sulmin e furishëm dhe vdiq. Ai deklaroi se nuk do të kujtohet si perandori, i cili shpëtoi qytetin më të madh në botë në momentet më të nevojshme të tij.

Liria e religjionit dhe "Pushtuesi"

Ushtria otomane hyri në qytet më 29 maj 1453. Pasi bizantinët kishin refuzuar të dorëzoheshin, Mehmeti i kishte lejuar trupat e tij të grabisnin dhe të plaçkitnin; ata do të rebeloheshin po të mos kishin bërë këtë. Por, qyteti tashmë ishte shpopulluar dhe të gjithë, përveç

disa kishave e pallateve ishin braktisur. Disa kronika të mëvonshme perëndimore përshkruajnë plaçkitjen tmerruese, por ka pak dëshmi për këtë. Pavarësisht sesa shkretues psikologjikisht, dëmi fizik ishte relativisht i butë, ndaj pasurisë dhe njerëzve.

Mehmeti u drejtua për Aja Sofia. Për një milenium, kisha kishte qëndruar si monument i perandorisë, qendrës së Krishterimit Lindor. Në fund të majit 1453, një gjuhë e huaj u dëgjua nën kubetë e saj, ndërsa pushtuesit zëvendësuan ritet e vjetra me të tyre. Kisha jehoi me zërin e shehadeit, dhe thirrjen myslimane për namaz. Pas kësaj, Aja Sofia do të bëhej xhami, me emrat e katër kalifëve të parë që rrethonin kubën e saj kryesore. Kur Mehmeti hyri i pari, ashtu siç thotë legjenda, një ushtar po përpiquej të ngrinte me forcë pllakat në dyshe. Sulltani e goditi me cep të shpatës dhe i tha "Për ju mjaftojnë thesari dhe të burgosurit. Ndërtesat e qytetit më takojnë mua".

Sulltani shumë shpejt ndaloi plaçkitjen. Qyteti do të bëhej kryeqytet i perandorisë së tij, dhe ai nuk dëshironte ta ngarkonte me rinovime të panevojshme. Vendi në formën e tanishme ishte për të ardhur keq dhe kishte nevojë për meremetime. Në muajt e ardhshëm, Otomanët i dhanë formë qytetit, në aspektin material dhe kulturor. Disa fisnikë bizantinë kishin ikur; të tjerët ishin kapur robër; disa ishin liruuar me shpërblesë; dhe disa ishin ekzekutuar. Por, Mehmeti nuk mund t'ia lejonte vetes që i gjithë qyteti të boshatisej nga banorët e tij grekë. Për të ruajtur funksionimin e tij, ai siguroi popullsinë se të drejtat e tyre do të respektoheshin. Ai madje u përpoq të joshte ata që ishin larguar për t'u kthyer dhe u ofroi pagimin e dëmshpërblimeve nëse pasuria e tyre ishte dëmtuar apo shkatërruar.

Si një nxitje shtesë, Mehmeti premtoi se nuk do të ndërhynte në religjion. Perandori, Bizanti ishte në krye të Kishës Ortodokse, dhe me shkuarjen e tij, patriku ishte zëvendësimi logjik. Por, në kohën e rënies së qytetit, patriku në pushtet ishte jashtë vendit, dhe në vend të tij, Mehmeti iu drejtua Gennadiusit - një nga murgjit më të respektuar në qytet, i cili ishte i njohur si shumë i pavarur dhe njësoj i egër me kundërshtarin e tij në Romë - dhe shpalli se ai do të ishte lideri i Kishës.

Më vonë është thënë se Mehmeti urdhëroi zyrtarët e tij të kërkojnë në Kostandinopojë për dikë që është i denjë për emërim. Sipas fjalëve të një kronisti bashkëkohor grek, “Gennadiusi ishte njeri shumë i zgjuar dhe i shquar... Kur sulltani e pa atë, dhe për pak kohë u dësh-mua urtësia, matura dhe ndershmëria e tij, dhe gjithashtu fuqia e tij si orator e karakteri i tij religjioz, ai u impresionua shumë dhe fitoi shumë respekt e nder tek ai, dhe i dha të drejtën që të vijë tek ai në çdo kohë, dhe e nderoi me liri e bisedë.” Në janar 1454, sulltani caktoi patrikun e ri dhe i dha autoritet mbi çështjet e përditshme të popullsisë së krishterë, “jo më pak sesa gëzonte më parë nën sundimin e perandorëve”.

Shkalla e pushtetit të patrikut ishte shkruar në një kartë të hartuar nga veziri i sulltanit. Gennadiusi ishte më shumë se udhëheqës shpirtëror i grekëve ortodoksë, të cilët kishin rënë nën sundimin otoman. Ai ishte në shumë mënyra mbreti i tyre, me pushtetin për të taksuar e gjykuar dhe autoritetin për të caktuar përfaqësuesit lokalë kudo në perandori. Ngjashëm si perandori bizantin, ai kishte më shumë ndikim sesa krerët e kishave të tjera të krishtera në Lindje. Derisa në fund i përgjigjej sulltanit dhe shtetit otoman, në çështjet që radhiteshin që nga lindja e martesë e deri te vdekja, duke përfshirë pronat, taksat dhe tregtinë ndërkomunale, ai kishte liri të gjerë veprimi. Otomanët sundonin, por Mehmeti II nuk kishte interes në menaxhimin në detaje të jetëve të shtetasve të krishterë. Kjo do të kishte kërkuar më shumë burokraci dhe më shumë përpjekje. Më mirë të gjente një partner dhe t’ia delegonte punën e ndyrë të administratës tek ai.

Nuk dukej e qartë për askënd në atë që kohë që Mehmeti njëherësh mund të ishte aq i pamëshirshëm me fisnikët dhe klasën sunduese dhe aq i mëshirshëm ndaj pjesës më të madhe të njerëzve dhe liderëve të tyre fetarë. Por, kjo është në kundërshtim me nocionin modern, se nuk ka ndarje midis fesë dhe shtetit në Islam. Mungesa e ndarjes thuhet të jetë në kontrast me murin që ndan pushtetin sekular dhe atë religjioz në Perëndim. Deri tani, të paktën deri në shekullin XIX, këto mure nuk ekzistojnë në botën perëndimore, ndërsa e gjithë struktura nuk ka qenë kurrë koherente kur është zbatuar për botën myslimane.

Për shembull, Perandoria Bizantine, të cilën e shkatërruan otomanët, kurrë nuk ka ndarë sferat për religjion dhe politikë. Perandori ishte njëherësh kreu i shtetit dhe kreu i kishës - dhe kjo formulë është kopjuar edhe në pjesë të tjera të botës së krishterë, duke përfshirë Reformimin e Anglisë, ku mbreti kërkoi bindjen e kryepeshkopit të Canterburyt. Gjatë gjithë historisë bizantine, perandori impononte doktrinën, udhëhiqte fushatat ushtarake dhe ftonte gjykatësit të ndëshkonin ata që nuk pajtoheshin me ortodoksinë perandorake. Siç e kemi parë, refuzimi i të krishterëve koptë të Egjiptit, për t’iu përkulur autoritetit të perandorit dhe patrikut në Kostandinopojë në shekujt VI dhe VII, ishte një nga arsyet për lehtësimin e pushtimit arab të Egjiptit, shpejt pas vdekjes së Muhamedit.

Përkundrazi, derisa ka pasur raste kur sundimtarët myslimanë tentuan të diktonin doktrinën, këto ishin përjashtim dhe jo rregull. Në një kuptim, sulltani otoman kishte pushtet të pakufizuar mbi nënshtetasit e tij. Ai kishte pushtet mbi jetën dhe vdekjen. Por, me fjalë të tjera, ai ishte po aq i detyruar, dhe në teori ashtu si nënshtetasit, ndaj ligjit fetar, si çdo mysliman tjetër. Sikur sundimtarët e mëhershëm, ai u nënshtrohej dijetarëve dhe gjykatësve, të cilët përbënin ulemanë. Madje, edhe kur sulltani otoman shtoi titullin e kalifit në shekujt e mëvonshëm, ai nuk ushtronte autoritet total doktrinar. Vërtet, ai mund të nxirrte vetë ligje nëse ishin apo jo në pajtim me ligjin fetar (shariat). Por, ai kishte nevojë dhe kultivoi mbështetjen e ulemasë. I vetmi kuptim në të cilin mund të thuhet se nuk ka ndarje midis kishës dhe shtetit në Islam, është se nuk ka kishë. Përjashtimi i mundshëm është Irani. Pas shekullit XVI, mullahët shiitë të Iranit, gradualisht u bashkuan në një institucion që në hierarkinë dhe koherencën e tij i ngjan Kishës Katolike, por pa mundësinë për të detyruar besimtarët e devijuar. Pothuajse kudo tjetër, Islami nuk ka asnjë trup qendror e qeverisës fetar. Gjatë gjithë historisë së shoqërive myslimane, nga shfaqja e institucionit klerikal në Bagdad, gjatë kalifatit abasid përgjatë evolucionit të Sufizmit dhe formave të tjera të devocionit individual, sferat politike dhe doktrinare janë dalluar dhe janë qeverisur nga njerëz të ndryshëm.

Ndarja de fakto ndihmon shpjegimin se pse Mehmeti ishte aq indiferent ndaj religjionit të nënshtetasve të vet. Si shumica e sundimtarëve perandorakë, otomanët bënë dallim midis shtetit dhe njerëzve. As Mehmeti e as ndonjë nga otomanët nuk tregoi interes në konvertimin e popullsisë së krishterë greke të Kostandinopojës. Përkundrazi, otomanët ofruan nxitje për të inkurajuar grekët të punojnë me regjimin e ri për rigjallërimin e qytetit dhe për t'ia kthyer madhësitë. Për ta, të krishterët e Kostandinopojës, të drejtat e tyre fetare të paprekura, dukej se kishin pranuar sundimtarët e rinj. Arkitektët e krishterë grekë hartuan planet për të forcuar dhe rindërtuar muret dhe fortifikimet e shkatërruara që në fund dështuan të mbronin qytetin. Ata dizajnuan xhami dhe ndihmuan Mehmetin të transformojë Aja Sofinë në shtëpi myslimane të adhurimit. Ata gjithashtu ndërtuan një treg të gjerë të ri të mbuluar, i cili do të bëhej Bazaari i Madh i famshëm i Stambollit, dhe drejtuan shumë prej stendave e dyqaneve të tij.

Po të kishte ndaluar Mehmeti me pushtimin e Kostandinopojës, ai do të kishte marrë nofkën “Pushtuesi”. Por, ai ishte akoma i ri dhe ambiciet e tij nuk ishin ngopur. Ai mposhti kundërshtarët e vjetër të babait të tij në Hungari dhe Serbi, dhe ngurtësoi kontrollin otoman mbi pjesën më të madhe të Ballkanit dhe bregdetin jugor të Detit të Zi. Përgjithësisht, qytetet dorëzoheshin, hapnin portat e tyre për sulltandin në vend që të provonin vdekjen dhe shkatërrimin. Otomanët ndërruan flamurin e armëpushimit. Kur premtuan të mbronin të drejtat e popullsisë lokale, e bënë këtë.

Sigurisht, disa dekada pas udhëheqjes së ushtrive të tij, Mehmeti u lodh dhe u sëmur. Ai nuk u plak me hirësi dhe arritjet e tij nuk e bënë të gëzuar. Ai piu shumë dhe u bë gjithnjë e më dyshues për ata që ishin rreth tij. Duke i bërë një psikanalizë të padrejtë nga një distancë disa shekulle, mund të thuhet se ai bëri gjithçka që mundi për të larguar memorien e babait të tij, dhe dështoi. Po të kishte konsultuar një udhëheqës sufist, mund të kishte mësuar se mund të shkonte në fund të botës, të fitonte çdo betejë, dhe të bëhej i pasur përtej imagjinatës, por derisa ia dorëzoi shpirtin e tij Zotit, mbeti i shqetësuar dhe i pasuksesshëm. Dhe i tillë ishte, derisa vdiq më 1481. I rrethuar nga mjekë

çifutë dhe persianë të paaftë për ta shëruar, kur kishte arritur moshën 49-vjeçare.

Megjithëse evropianët ishin frikësuar nga humbja e qytetit për të cilin kishin bërë aq pak për ta ndihmuar dhe aq shumë për ta minuar, çfarëdo afiniteti që ndjenin ishte një iluzion. Në të vërtetë, të krishterët e Evropës Perëndimore ishin më të huaj dhe më armiqësorë ndaj Bizantit Ortodoks sesa otomanët. Otomanët dhe bizantinët kishin luftuar për mbi njëqind vjet, dhe ata gjithashtu kishin jetuar krah për krah, derisa secili kujdesej për armiqët e tjerë. Babai i Mehmetit ishte martuar me një princeshë bizantine-serbe, që nuk ishte hera e parë e as e fundit që një otoman mysliman martonte një të krishterë për arsye të shtetit. Të dy perandoritë ishin lidhur jo vetëm me lidhje martesore, por edhe me ato financiare. Për shumë vjet, para Mehmetit, sulltani otoman i paguante një tarifë vjetore perandorit bizantin, pasi që otomanët preferonin një Bizant joefektiv sesa një fuqi rivale në Kostandinopojë, që kontrollonte udhëkryqet vitale. Më vonë, në shekullin XIX, fuqitë evropiane do të bënin të njëjta kalkulime rreth otomanëve, ndërkaq perandoria do të mbijetonte jo për shkak se ishte e fuqishme, por për shkak se ishte e dobët.

Evropa dhe Otomanët

Perandoria Otomane zgjati gati pesëqind vjet, më shumë sesa një grusht i dinastive që ka njohur bota. Bizanti dhe Roma para saj, secila kanë mbijetuar më shumë se një mijë vjet, por vetëm otomanët mund të pohojnë se e njëjta familje ka sunduar njëri pas tjetrit që nga fillimi e deri në fund. Megjithëse mund të ketë pasur disa shkrime të favorshme të trungut familjar, ka pasur një zinxhir të vazhdueshëm që shtrihej nga Osmani në shekullin XIV e deri te sulltani i fundit, Mehmeti VI, në dekadën e parë të shekullit XX. Për krahasim, dinastitë evropiane rrallë kanë zgjatur më shumë se disa qindra vjet dhe zakonisht kanë sunduar një zonë jo më të madhe se një provincë otomane. Në pjesën më të madhe të pesë shekujve, megjithatë, Perandoria Otomane ka rrethuar gjithë Mesdheun lindor. Që nga fillimi i shekullit

XVI e deri në fillim të shekullit XX, ajo ka sunduar gjithashtu Afrikën Veriore dhe Egjiptin; Kaukazin midis Detit të Zi dhe atij Kaspik; Gadishullin e Krimesë dhe rajonet rrethuese; gjithë Lindjen e Mesme nga Izraeli i sotëm e deri te kufijtë e Iranit; dhe Ballkanin, duke përfshirë Greqinë, Serbinë, Kroacinë, Bullgarinë, Rumaninë dhe pjesë të Hungarisë së sotme.

Në memorien kolektive të Perëndimit, shfaqen gjatë. Më shumë sesa vala e parë e pushtimeve arabe, më shumë se myslimanët e Spanjës apo Salahudini e ushtritë e tij, Otomanët janë thurur në vetëdijen e Evropës moderne. Në kohën kur monarkitë e centralizuara të Perëndimit dhe Evropës Qendrore po shfaqeshin, ata u përballën me një kundërshtar, madhësia, organizimi, pasuria dhe fuqia e të cilit rrëgojnë çdo gjë që mund të grumbullohej. Sunduesit e Spanjës, Francës, Anglisë, tokave gjermane dhe Perandorisë së Shenjtë Romake mund të kenë menduar veten si titanë, por kundër Otomanëve, ata mezi vlerësoheshin si pigme. Duke vepruar në marrëveshje, flotat e italianëve, kalorësit e Spanjës e Francës, dhe këmbësorët e Hungarisë, Polonisë, Austrisë dhe Prusisë, arritën të menaxhojnë humbjen totale, por deri në shekullin XVIII, hija e asaj që e quajtën “turqit e pabesë” mbuloi madje kthjelltësinë e ditëve të tyre.

Gradualisht, Otomanët humbën avantazhin e tyre konkurrues, dhe në fund të shekullit XVIII, monarkët e Evropës dhe Rosisë ndryshuan rrjedhën. Edhe atëherë, perandoria u tkurr, por nuk u shkatërrua. Ndryshe nga shumë rajone të tjera të globit, pjesa qendrore e Perandorisë Otomane kurrë nuk u pushtua apo u sundua nga evropianët. Perandoria u tkurr, por tokat qendrore të Turqisë dhe pjesë të mëdha të Lindjes së Mesme, duke përfshirë Irakun dhe Arabinë, mbetën nën sundimin otoman deri në fund të Luftës së Parë Botërore.

Të afërt në fqinjësi, Otomanët dhe evropianët ishin ndarë nga një humnerë e gjerë kulturore. Religjioni, megjithatë, ishte ndoshta linja më pak e rëndësishme ndarëse. Otomanët ishin udhëhequr nga një familje turke, origjina e së cilës, siç kanë theksuar shumë studiues, ishte e mbështjellë me paqartësi. Shumë pak dihet për Osmanin, themeluesin e dinastisë, ashtu siç dihet pak për Romulin e Remin, të parët

mitikë të Romës. Pothuajse nuk ka asnjë të dhënë të shkruar për Otomanët, për shekullin e parë të ekzistencës dhe kundërshtarët e tyre të parë - serbët, hungarezët, bizantinët, dhe emirët turq në Anadoll, e as nuk ka shumë të dhëna të lëna për humbjet që kanë pësuar nga Otomanët.

Gjatë kohës, Evropa u bë familjare me shtetin Otoman, por deri në shekullin XIX, punët e saj të brendshme mbetën të errëta. Sulltani dhe haremi i tij u bënë legjendarë, por disa perëndimorë kuptuan se si qeverisnin, luftonin apo jetonin otomanët. Ambasadorët perëndimorë në Stamboll, shkruan kronika për kryeqytetin perandorak, por ata kishin kontakte të kufizuara me elitën dhe iu ishin treguar vetëm ato aspekte të jetës në pallat, që ishin të lejuar t'i shihnin. Deri në shekullin XIX, kur otomanët ishin të detyruar të hapnin më shumë shoqërinë e tyre për vëzhgimin e huaj, u hoq maska, edhe atëherë vetëm pjesërisht.

Një rezultat i injorancës ishte imagjinata. Në kronika imagjinare, shpesh banale, perëndimorët sjellin imazhin e sulltanit të shërbyer në harem nga femra të ruajtura nga eunukët nga Afrika nën-Sahariane dhe të mbrojtur nga ushtria e skllëvërve të marrë si robër derisa ishin të rinj dhe të trajnuar për jetën e ashpër si luftëtarë, të cilët janë të gatshëm të vdesin posa urdhëron sulltani të marrin frymë. Në dhomën e tij të fronit, të rrethuar nga vezirë që komplotojnë fushatën e ardhshme kundër Perëndimit, sulltani Otoman rri ulur, i mbyllur në mister. Si monarkët lindorë që i ka rivalizuar, ai rrallë lejonte vizitorët t'ia ngulnin sytë, që vetëm rriste atmosferën e misterit. Perëndimorët mbushnin boshllëqet në diturinë e tyre me frikë dhe transformuan sulltanin në një luftëtar të shenjtë të vendosur të asgjësojë fuqinë e krishterë për të përmbushur atë që kishte nisur Muhamedi, dhe për të marrë hakun e botës myslimane për humbjen e Spanjës.

Kjo përzierje e gjysmë të vërtetave dhe legjendave ushqeu shqetësimin perëndimor. I frikësuar, ngurrues dhe admirues kundër dëshirës, sulltani sundoi një perandori të frikshme në kufijtë e Evropës. Megjithatë turqit ishin vetëm një nga grupet e ndryshme në perandori, fjala “turk” u bë përfaqësim për të gjitha gjërat otomane, dhe jo pozitive.

Për anglezët, sikur për shumicën e evropianëve, fjala “turk” do të thoshte barbarizëm dhe egërsi.

Në mungesë të dëshmisë për të kundërtën, karikatura ishte marrë si fakt. Madje, edhe pasi që Perandoria Otomane u tregua shtet si të tjerët, me fuqitë e saj dhe më shumë se pjesa e saj e dobësisë, imazhi kurrë nuk u zbeh. Në fakt, ai vazhdoi në gjithë perandorinë. Memoria e luftëtarëve turq që luftonin në emrin e Zotit mysliman kundër ushtrive të Krishterimit mbijetoi rënien e otomanëve dhe u ngulit në kulturën perëndimore. Kur Turqia aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Evropian në fillim të shekullit XXI, zërat francezë, gjermanë dhe holandezë murmuritën jorehatinë që Turqia ishte shumë e huaj, shumë ndryshe dhe ndoshta shumë myslimane. Megjithatë këto shqetësime ishin aluzione që kishin luftuar otomanët për shekuj dhe në fund kishin fituar, Evropa nuk duhej të lejonte turqit të gëzojnë frytet e kësaj fitore të arritur me vështirësi.

Reputacioni i otomanëve ka vuajtur gjithashtu edhe nga lëvizjet nacionaliste që përfshin Ballkanin dhe Lindjen e Afërt, në shekujt XIX dhe XX. Së pari, grekët në vitet 1820, dhe pastaj hungarezët, serbët, bullgarët, rumunët dhe në fund arabët e Lindjes së Afërt definojnë veten si kombe që ishin pushtuar, brutalizuar dhe heshtur nga autokratët otomanë. Për grekët dhe njerëzit tjerë të Ballkanit, pati një element shtesë religjioz: myslimanët otomanë pohuan se kishin shtypur të krishterët. Madje, edhe arabët, të cilët morën virusin infektues të nacionalizmit para Luftës së Parë Botërore, distancuan veten nga otomanët, megjithatë fortësia e tyre kryesore e grindjes ishte më shumë etnike sesa religjioze.

Këtu si kudo tjetër, konflikti kishte marrë vëmendjen më të madhe, dhe në Perëndim nuanca religjioze ishte theksuar. Pa dyshim, sundimtarët e hershëm otomanë e konsideronin veten luftëtarë myslimanë. Ata e quajtën veten gazi, që në arabisht do të thotë “sulmues të shenjtë”, me qëllim që të lidhin veten me shokët e Muhamedit dhe dinastitë arabe që kishin sunduar pas vdekjes së tij. Në lidhjet e tyre me Perëndimin e krishterë, otomanët nuk ishin asgjë tjetër përveç paqësorë. Posa kishin mposhtur Bizantin e krishterë dhe kishin marrë kontro-

llin e Ballkanit, ata u drejtuan në fortesën e fundit të kryqtarëve frankë në ishujt Rodos, Kretë dhe Maltë, dhe në qytetet përgjatë Danubit, duke përfshirë Budan, Pestën, dhe mbi të gjitha, Vjenën.

Por, ajo që zakonisht nuk është vënë re dhe është harruar është se titulli i gazit ishte vetëm një nga linja e gjatë e titujve, të cilët përfshinin jo vetëm Zoti i Dy Tokave, por gjithashtu Zoti i Dy Deteve; Sulltani i arabëve, persëve dhe romakëve; Shpërndarësi i Kurorave të Sundimtarëve të Tokës; Sovrani i Detit të Bardhë, Detit të Zi, Rumelisë, Anadollit; Zoti i Rumit dhe Karamas, i Dulkadirit dhe Dijarbakrit, Azerbajxhanit, Sirisë, Alepit, Egjiptit, Jerusalemit të Shenjtë, Mekës së Nderuar dhe Medinës së Shenjtë, Xhidës, Jemenit, dhe shumë toka-ve të tjera; dhe Vetëtimja e Luftës, dhe Pushtuesi i Botës. Otomanët ishin krenarë për fitoret e tyre, krenarë për modelin e tyre si trashëgimtarë jo vetëm të kalifëve të parë, por edhe të Cezarit e Romës dhe monarkëve persianë të antikitetit, krenarë që sundonin Evropën dhe Azinë, Jerusalemin dhe qytetet e shenjta të Arabisë, dhe krenarë që monarkët e Evropës i frikësoheshin dhe i ofendonin. Fakti se otomanët ishin gjithashtu myslimanë, të cilët kishin korrë fitore që rivalizoheshin vetëm nga ato të kalifëve të shekullit VII dhe VIII, ishte vetëm një nder, por jo i vetmi.

Ajo që është harruar gjithashtu, është se për pjesën më të madhe të atyre pesëqind vjetëve, otomanët ishin indiferentë ndaj religjionit të nënshtetasve të vet. Perandoria sundohej nga një numër i vogël i guvernatorëve dhe gjykatësve dhe një ushtri e frikshme në kazemat e kryeqyteteve të çdo province kryesore. Përveç për sulltanin dhe familjen e tij, anëtarësimi në klasën sunduese nuk ishte i bazuar në racë apo religjion. Ai ishte i bazuar në sistemin e skllavërimit të organizuar të djemve të rinj. Të marrë nga fshatrat e tyre, ata u dërguan në shkollat në Stamboll, dhe në kryeqytetin perandorak në Adrianopojë, dhe u trajnuan si ushtarë apo si burokratë. Ushtarët ishin të njohur si jeniçerë, dhe shumë prej tyre nisën jetën si fshatarë të krishterë, të cilët u konvertuan pastaj në Islam. Islami i tyre, megjithatë, nuk ishte ortodoks, por i mbuluar me misticizmin e rendit sufist, të njohur si Bektashi, që kishte ruajtur shumë rite të krishtera.

Çdo vit, korpuset jeniçere shpërndaheshin në fshatrat e Ballkanit dhe Kaukazit dhe mbledhnin një kuotë të fëmijëve. Disa aspekte të sundimit otoman kishin gjeneruar shumë debat dhe dëshirë të keqe. Në shekullin XIX, praktika kishte përfunduar në masë të madhe, por memoria mjaftonte për të ngritur popujt e Ballkanit kundër sundimtarëve të tyre. Jeniçerët ishin robër në kuptimin që të drejtat dhe pasuria e tyre, prona dhe statusi ishin në tekë të sulltanit. Por, në shumë aspekte të tjera, ata ishin elitë e privilegjuar. Ndryshe nga afrikanët e robëruar në Amerikë, jeniçerët ishin klasa sunduese e një perandorie dhe gëzonin përfitimet shoqëruese. Megjithëse gjeneratat e mëvonshme të perëndimorëve dënuan hapur rekrutimin e detyruar, mundësia për të pasur djem që do ta ngrinte në poste të larta të perandorisë nuk shihej si padrejtësi e rëndë nga shumë familje. Përveç kësaj, në shekujt XV, XVI dhe XVII, asnjë fshatar - qoftë i krishterë apo mysliman - nuk kishte pritje të demokracisë së Jeffersonit. Klasa sunduese otomane ishte e ashpër dhe josentimentale, por ajo dallonte nga sundimtarët e Evropës, vetëm në efikasitet. Kur mbretërit e Francës apo Spanjës, kishin nevojë për mbledhjen e një ushtrie, trupat e tyre gjithashtu hynin në fshatra dhe dhunshëm rekrutimin të rinjtë e pranueshëm, duke mos kërkuar leje. Rekrutimi i korpuseve të jeniçerëve në Ballkan dhe Greqi, ishte në atë kuptim, jo i ndryshëm.

Derisa klasa sunduese otomane ishte myslimane, perandoria nuk ishte, dhe Islami nuk vepronte si zam për mbajtjen së bashku të pjesëve të ndryshme të shtetit. Shumica e popullsisë së tokave evropiane që kontrollohej nga otomanët ishte e krishterë dhe mbeti e tillë deri në fund. Madje edhe në rajonet si Egjipti dhe Iraku, ku myslimanët ishin shumicë, Islami sunit i klasës sunduese otomane ishte diçka e ndryshme nga Islami i shumë arabëve. Në përgjithësi, derisa sulltani e shpallte veten kalif dhe mbrojtës të qyteteve të shenjta të Mekës dhe Medinës, dukej se ai nuk kujdesej asnjë grimë për religjionin e nënshtetasve të tij. Nuk pati përpjekje për konvertimin e të krishterëve dhe çifutëve, e as otomanët nuk u përpoqën të impononin një version të ligjit mysliman. Të qenit mysliman nuk kishte asnjë garanci për

trajtim më të mirë nga guvernatorët lokalë, dhe të qenit i krishterë apo çifut nuk ishte domosdoshëm barrë që duhej të kapërcehej.

Derisa otomanët luftuan kundër shteteve të krishtera të Evropës, ata luftuan kundër shahëve shiitë të Iranit po me të njëjtin intensitet. Në asnjë rast propagandimi i Islamit nuk ishte motiv kryesor. Otomanët ishin dinasti e vendosur në zgjerimin dhe përjetësimin e sundimit të tyre. Sa u përket romakëve, mongolëve, hanëve dhe perandorive të tjera, pushteti ishte primar, dhe gjithçka tjetër ishte sekondare. Religjioni ishte mbi të gjitha një instrument kontrolli. Nëse manteli i religjionit mund të përdorej për të justifikuar zgjerimin, atëherë edhe më mirë. Nëse toleranca fetare ndihmonte qetësimin e nënshtetasve dhe ruajtjen e stabilitetit, atëherë le të ishte kjo.

Çifutët nën sundimin otoman

Formula otomane që theksonte bindjen ndaj sulltanit dhe indiferencën ndaj religjionit të nënshtetasve ishte zhvilluar para rënies së Kostandinopojës, por ajo u bë vitale për suksesin e perandorisë vetëm më pas. Duke lënë anash religjionin e nënshtetasve, sulltani ishte në gjendje t'i përdorte ata për rritjen e fuqisë së shtetit. Për shembull, në përpjekjen e tij për të rikthyer lavdinë e Kostandinopojës, Mehmeti urdhëroi mijëra njerëz në gjithë perandorinë të zhvendoseshin. Disa prej tyre ishin turq dhe myslimanë, por shumë të tjerë nuk ishin. Ortodoksët grekë nga qytetet e Anadollit me shkathtësitë e nevojshme u urdhëruan të lëvizin, dhe megjithëse iu ishte dhënë ndihma dhe iu ishin garantuar të ardhura dhe punë, atyre nuk iu ishte dhënë zgjedhja. Natyrisht, as ushtarëve të ushtrive të sulltanit. Dhe as mijëra çifutëve, shumë prej të cilëve jetonin në Ballkan. Aftësia e tyre për të vepruar si ndërmjetës midis Mesdheut lindor mysliman dhe Perëndimit të krishterë do të thoshte se ata mund, dhe më vonë e bënë, të luanin rolin kryesor në suksesin tregtar dhe ekonomik të shtetit otoman.

Nën bizantinët, çifutët ishin toleruar, por rrallë ishin pranuar. Në Kostandinopojën e krishterë, komuniteti i pasur çifut kryente të njëjtin funksion si ndërmjetës ekonomik që kishin kryer në qytete të tjera të

shumta në Mesdhe. Ata përfaqësoheshin në pallatin perandorak nga udhëheqësi i rabinëve, i cili ishte lider dhe avokat. Në sistemin bizantin, autoriteti i tij ishte i kufizuar. Nën otomanët, megjithatë, çifutët fituan më shumë autonomi dhe gjatë kohës u bënë mbështetës aktivë të sundimit të sulltanit. Pas pushtimit, Mehmeti lejoi kryerabinin, i cili i kishte shërbyer bizantinëve të mbante pozitën e tij. Ky rabin nuk ishte, siç kishin sugjeruar disa, kreu i të gjithë çifutëve në Perandorinë Otomane, megjithëse pozita e udhëheqësit të rabinëve do të bëhej traditë çifute. Fillimisht, ai ishte përgjegjës vetëm për komunitetin çifut të Kostandinopojës, i cili ishte mjaft i vogël më 1453, por që do të rritej shpejt në mijëra për shkak të politikave të risistemimit të Mehmetit.

I përballur me kryeqytetin pak të populluar dhe numrin e pamjaftueshëm të njerëzve të aftë për kryerjen e detyrave të komplikuar, Mehmeti urdhëroi mijëra çifutë të vinin në Kostandinopojë. Ata ishin zgjedhur, jo për shkak të besimit të tyre, por për shkak se ishin grup i bashkuar që posedonte shkathtësitë për të cilat shteti otoman kishte shumë nevojë. Zhvendosja e detyruar e çifutëve nga pjesë të ndryshme të Ballkanit dhe Anadollit, mund të mos ishte i kënaqshëm për ata që lëvizën nga shtëpitë e tyre, dhe për këtë ka pasur debate të nxehta midis studiuesve rreth karakterizimit të dekreteve të Mehmetit. Disa kanë krahasuar largimet me masakër dhe persekutime të fundit të shekullit XX. Të tjerët, duke përfshirë poetin çifut të shekullit XV, Elijah Capsali, kishin pak të flisnin për zhvendosjen dhe i shihnin otomanët si një përmirësim i rëndësishëm mbi regjimet perëndimore të krishtera në Evropë dhe sundimtarët e krishterë lindorë të Bizantit. Capsali, në fakt, e mori rënien e Kostandinopojës, si ndëshkim hyjnor kundër atyre që kishin abuzuar me çifutët dhe si shenjë e favorit të Zotit për ata që treguan tolerancë.

Shkurtimisht, nuk pati asgjë rreth politikave të Mehmetit që diskriminuan çifutët si çifutë, apo kundër çdo kategorie të krishterë si të krishterë në vetvete. Burokracia otomane i trajtoi të gjithë nënshtetasit si instrumente të shtetit dhe shërbëtorë të sulltanit, duke i përdorur dhe duke i rregulluar ashtu siç i përshtatej. Në këtë kuptim, të gjithë qyte-

tarët e perandorisë u diskriminuan nga sulltani dhe elita sunduese, dhe kishin disa të drejta të ndara nga ajo që sulltani i kishte lejuar. Në asnjë pjesë të botës në shekullin XV, situata nuk ishte në mënyrë dramatike e ndryshme. Derisa çifutët, të cilët u detyruan të zhvendosen në kryeqytetin e ri mund të kenë vuajtur, vetëm disa nga prizmi shumë i veçantë bashkëkohor mund të thuhet se kishin vuajtur për shkak të religjionit të tyre.

Dhe në fund të shekullit XV, çifutët e Kostandinopojës lulëzuan, dhe komunitetet çifute në pjesët e tjera të perandorisë jetonin jetë të sigurt dhe të begata. Skepticizmi dhe frika gjatë viteve të para të sundimit të Mehmetit, i kishin hapur rrugën pranimit dhe pastaj entuziazmit të plotë. Derisa çifutët dhe të krishterët duhej të paguanin një taksë për kokë, këto ishin kompensuar nga përfitimet tatimore që kishin marrë për krijimin e bizneseve së pari në Stamboll dhe pastaj në qytetet e tjera kryesore. Çifutët dominonin format primitive të bankave që ekzistonin, si dhe tregtinë me xhevahir, perla dhe satin. Komuniteti çifut i Egjiptit mbeti i paprekur, dhe kur Egjipti më në fund u pushtua nga otomanët në fillim të shekullit XVI, ata patën përfitime ekonomike. Dhe një komunitet i huaj i çifutëve gjeti shtëpinë në perandori dhe u pranua ngrohtësisht që është shumë në kundërshtim me atë që kishin lënë prapa.

Më 1492, pas rënies së mbretërisë myslimane të Granadës, monarkët triumfues të Spanjës përmbushën ambicien e vjetër të Kishës Katolike spanjolle dhe urdhëruan dëbimin e çifutëve. Me pak kohë për t'u përgatitur dhe në rrezik për jetët e tyre, mijëra persona paktuan atë që mundën dhe u larguan nga vendi. Qytetet e Evropës Perëndimore i shmangën, ndërsa Afrika Veriore ishte e ndarë në principata të vogla me vitalitet të vogël ekonomik. Por, otomanët shpallën se çifutët e dëbuar të Spanjës ishin të mirëpritur dhe do të merrnin ndihmë e mbështetje, duke përfshirë transportimin nga Spanja në qendër të perandorisë, në anën tjetër të Mesdheut. Çifutët u lejuan të vendosen në Stamboll, por sulltani deklaroi se do të ishte veçanërisht i kënaqur, nëse ata vendosen në një nga qytetet më të vjetra në Ballkan, Thessaloniki, i njohur gjithashtu si Selanik.

Jo të gjithë i mbijetuan udhëtimit. Një kronist i heshtur bashkëkohor thotë “Një pjesë e spanjollëve të dëbuar shkuan jashtë Turqisë. Disa prej tyre u hodhën në det dhe u mbytën, por ata që arritën atje mbreti turk i priti me mirësi, pasi ata ishin mjeshtër. Këta çifutë të shpërngulur ndanë vullnetshëm urtësinë dhe diturinë me sundimtarët e tyre të rinj, duke përfshirë njohuritë rreth arteve të luftës. Inxhinierët dhe mjeshtërit çifutë ndihmuan otomanët që të avancojnë prodhimin e artilerisë dhe mjetet e komplikua të rrethimit, të cilat sulltani i përdori mirë kundër evropianëve në shekujt XVI dhe XVII. Të larguarit e Spanjës u bënë kështu një aset i otomanëve”.

Disa nga të dëbuarit u vendosën në Stamboll, por pjesa më e madhe e tyre u vendosën në Selanik. Në mes të shekullit XVI, qyteti kishte një popullatë të konsiderueshme çifute dhe ishte bërë një metropol që mund të qëndronte krenar afër Stambollit. Çifutët e Selanikut ishin vetëqeverisës, i përgjigjeshin guvernatorit otoman dhe në fund sulltanit, por jo kryerabinin në Stamboll. Kjo filloi të ndryshojë në shekujt e mëvonshëm, pasi që sulltani u dha më shumë autoritet liderëve fetarë në kryeqytetin perandorak, që do të thoshte rritje të kompetencave jo vetëm për kryerabinin, por edhe për patrikët e kishave greke dhe armene. Fillimisht, çifutët e Spanjës që u vendosën në Selanik, konkurronin jo me çifutët e Stambollit, por me popullsinë e vjetër të çifutëve grekë, të cilët kishin jetuar në qyteti për një mijë e pesëqind vjet dhe kishin strehuar Shën Palin, në udhëtimet e tij në botën romake për të përhapur Ungjillin. Këto rivalitete u zbehën, megjithëse kurrë plotësisht, dhe pas çdo shekulli që kalonte, çifutët e Selanikut u bënë më të pasur, më të fuqishëm, dhe më të rëndësishëm për jetën tregtare të perandorisë.

Historia e famshme e çifutëve të Perandorisë Otomane ndryshon shumë nga trajtimi i vëllezërve të tyre në Evropën e krishterë deri në mes të shekullit XIII dhe natyrisht gjatë Holokaustit të shekullit XX. Mbretëritë e Evropës kujdeseshin shumë për religjionin e nënshtetasve të tyre dhe bënë luftëra shkatërruese për të detyruar besimin dhe për të shtypur herezinë. Otomanët ishin të pamëshirshëm si pushtues,

por posa arrinin fitoren ushtarake, ata preferonin sistem administrativ të butë dhe të qetë.

Kjo tolerancë mund të shpjegojë se pse disa të krishterë dhe çifutë u konvertuan në Islam gjatë shekujve otomanë, veçanërisht krahasuar me normat e mëhershme të konvertimit në Andaluzi apo në Lindjen e Afërt, Egjipt, dhe Persi pas ardhjes së Islamit në shekullin VII. Prezenca e shteteve të krishtera me rritje të fuqisë në Evropë, të cilat përfaqësonin mundësinë, megjithatë ndryshe, të një rendi dhe regjimi tjetër mund të ketë larguar gjithashtu të krishterët nga konvertimi. Faktorët e tjerë, megjithatë, neglizhenca dashamirëse e shtetit otoman i lejoi çifutët, grekët ortodoksë, armenët, katolikët, koptët, dhe të tjerët të jetojnë në paqe e siguri dhe të praktikojnë besimet e tyre të pa shqetësuar. Ka shumë arsye se pse otomanët ishin aq të suksesshëm dhe aq elastikë, por më e rëndësishmja ishte se ata u dhanë njerëzve mjaft autonomi për t'i mbajtur të kënaqur, besnikë dhe jo të interesuar në ndryshim.

Sulejmani dhe kulmi i perandorisë

Shumë prej banorëve të sotëm të Ballkanit do të hedhin poshtë karakterizimin e Perandorisë Otomane si tolerante dhe relativisht dashamirëse. Bullgarët, serbët dhe grekët nuk ndjenj kurrfarë dashurie për otomanët apo për turqit, dhe ata e kujtojnë perandorinë për brutalitetin dhe trajtimin e keq ndaj tyre. Çështja këtu nuk është nëse otomanët ishin mizorë; sikur shumica e fuqive perandorake, ata mund të ishin. Nuk është nëse guvernatorët individualë shfrytëzuan pushtetin e tyre për të vjedhë, përdhunuar, dhe përndryshe abuzonin nënshtetasit e tyre. Në trajtimin e tyre të fshatarëve të Ballkanit, megjithatë, otomanët nuk ishin as më pak e as më shumë mizorë sesa sunduesit feudalë në Evropë, që ishin ndaj argatëve të tyre. Disa guvernatorë otomanë ishin tiranë, të tjerët nuk ishin, dhe kishte të tillë që ishin të prirë për të tërhequr vëmendjen. Ka shumë kronika të shkruara nga njerëzit që i sunduan otomanët, të cilat përshkruajnë zotërinjtë e tyre në mënyrë shumë të ashpër. Disa nga këta theksojnë religjionin si linjë

ndarëse, por kjo nuk do të thotë se ishte ashtu. Linja ndarëse për otomanët ishte pushteti, kush e kishte dhe kush nuk e kishte.

Otomanët bënë atë që ishte e përshtatshme. Në kushtet e sotme, ata ishin realistë, jo idealistë. Sulltanët që nga Mehmeti mund të kenë përshkruar veten si luftëtarë të shenjtë kur niseshin kundër armiqve, por kur kishte të bënte me qeverisje, ata ishin në thelb pragmatikë. Formula e pashqiptuar ishte e bukur dhe elegante: perandoria sundohej nga një sulltan me pothuajse pushtet të pakufizuar, që i jepte përgjegjësi vetëm Zotit dhe në teori ulemasë, të cilët gati gjithmonë miratonin atë që dëshironte të bënte. Kjo përfshinte martesën me të krishtera, punësimin e çifutëve, dhe lidhjen e aleancave me shtetet katolike - asnjëra prej të cilave nuk ishte në mospërputhje me Islamin ortodoks siç kuptohej atëherë.

Burokracia otomane, si pasojë, nuk diskriminonte në baza të religjionit apo racës. Nga korpuset e jeniçerëve, shërbimi civil e deri te eunukët e pallatit, qeveria drejtohej nga një koleksion laraman i racave. Derisa të qenit jeniçer nuk detyronte konvertimin, shpesh pati më shumë formë sesa substancë të Islamit te këmbësorët, të cilët luftonin në betejat e sulltanit me shumë aftësi.

Tartarët, serbët, grekët, arabët, berberët, koptët, armenët, çifutët, sunitët, shiitët, druzët, nubianët, sllavët, bullgarët, hungarezët, gjeorgjianët dhe natyrisht turqit, kombinoheshin për të formuar një bashkim të çmendur gjuhësh, traditash dhe ritesh. Gjykata otomane në Stamboll dhe administratorë të ndryshëm provincialë u shërbyen gjithashtu venedikasve, gjenuezëve, fiorentinëve dhe romakëve, si dhe tregtarëve e përkthyesve nga Franca, Austria, Spanja dhe Anglia. Derisa klasa sunduese adoptoi nocionin e “turqizmit”, në fund të shekullit XIX nuk pati asgjë veçanërisht turke rreth shtetit otoman.

Gjithashtu, sulltani e shikonte martesën më shumë përmes lenteve të politikës sesa të racës, religjionit apo dashurisë. Bashkëshortet dhe gratë pa kurora të haremit vinin nga një varg i gjerë i grupeve etnike dhe feve të shumta. Qëllimi ishte lidhja e grupeve të ndryshme të perandorisë me sulltanin, dhe ishte e vështirë që ai të flinte vetëm me myslimane apo vetëm me turke. Kjo, si pasojë, do të thoshte se shu-

mica e sulltanëve - si dhe fëmijët e unioneve të tilla - ishin me etni të përzier. Perandoria nuk kishte vetëm administratë multikulturore; ajo kishte sulltan multikulturor.

Realiteti i vet haremit është në kundërshtim me mitin. Misteret joshëse të haremit u bënë një obsesion i perëndimorëve, të cilët fantazonin rreth netëve epushore, grave të vullnetshme, mëndafshit të shumtë, shumë jastëkëve dhe eunukëve të zinj me vathë ari dhe rrip të shpatave. Kjo ndodhi, ndoshta, pasi gratë perëndimore që hynë në harem raportuan më vonë, por kishte më pak seks dhe më shumë pirje çaji dhe qepje. Derisa një qëllim i haremit mund të ketë qenë kënaqja e dëshirave të sulltanit, qëllimi primar ishte sigurimi se ishte të paktën një trashëgimtar mashkull dhe grumbulli i nënave të mundshme reflektonte diversitetin e perandorisë. Kjo ishte, në këtë kuptim, një version i demokracisë seksuale të shkarkuar nga shqetësimet e racës, klasës apo religjionit.

Gatishmëria për të injoruar religjionin për t'u fokusuar në politikën praktike ka definuar sundimin e sulltanit më të madh të perandorisë - Sulejmanit. Megjithatë ai ishte i njohur si “Madhështori” në Perëndim, nofka e tij primare në botën otomane ishte e ndryshme, dhe e dukshme. Për nënshtetasit e tij, ai ishte “Ligjvënësi”. Gjatë sundimit të tij që zgjati mbi dyzet vjet, perandoria arriti kulmin. Pushtimet e tij sollën otomanët në portat e Vjenës në Perëndim dhe thellë në Persi në lindje. E gjithë Afrika Veriore hyri në kontrollin e tij formal, dhe principata e fundit kryqtare, pronë e Hospitalerëve në ishullin Rodos, e cila i kishte rezistuar të gjithë sfiduesve për mbi 200 vjet, u dorëzua pas një beteje të gjatë dhe të guximshme më 1526.

Por, derisa Sulejmani udhëhoqi ushtritë e tij drejt fitores në peri-feri, bërthama e perandorisë ishte paqësore, e begatë dhe stabile. Pas disa shekujsh lufte, otomanët arritën të konsolidonin sundimin e tyre. Dyzet e gjashtë vjetët e Sulejmanit në pushtet ishin dramatike, por më pak për shkak të presionit të jashtëm sesa zënkave familjare që u kthyen në vdekjeprurëse, ashtu siç ndodhën rëndom midis princërve otomanë. Në shumicën e aspekteve të tjera, ajo ishte një kohë e qetë dhe stabile. Sulejmani formalizoi dhe kodifikoi praktikën administrati-

ve që i kishte trashëguar nga babai dhe gjyshi i tij, dhe për gati treqind vjet pas kësaj, ligjet e tij qeverisën shtetin. Gjatë sundimit të tij, të ardhurat rridhnin në arkat në Stamboll; jeniçerët rekrutnin versionin e tyre të më të mirëve dhe më të zgjuarve; guvernatorët provinciale ishin dërguar nga kryeqyteti për të sunduar rehatshëm në emër të sulltanit; dhe vetëm shahët Safavid të Iranit në lindje dhe Habsburgët e Austrisë në perëndim ndaluan otomanët nga zgjerimi i shtrirjes së tyre nga Kina e deri te Kanali anglez.

Çdo majë është gjithashtu fillim i rënies. Ushtritë e Sulejmanit arritën fitore të tilla kaq të shpejta kundër hungarezëve më 1529, sa që ishin në gjendje papritmas të avanconin deri në Danub, në Vjenë. Ushtria nuk ishte përgatitur për rrethim të gjatë të qytetit dhe nuk ishte e pajisur për dimër. Pas bllokimit disa javësh, Sulejmani, i rehatuar në një tendë më luksoze se shumë pallate të Evropës, vendosi se ishte më e urtë për t'u tërhequr sesa shtyrja e jeniçerëve në një fushatë dimërore. Marshi drejt Vjenës kishte qenë aq i lehtë sa që ai kishte imagjinuar rikthimin në pranverën e ardhshme. Në vend të kësaj, kjo ishte një mundësi e humbur, dhe forcat otomane nuk do të kërcënonin më seriozisht qytetin deri në vitin 1683, kur ato dështuan edhe njëherë.

Gjatë këtyre viteve, diplomatët dhe tregtarët evropianë patën më shumë kontakte me otomanët. Sulejmani ishte figurë madhështore e enigmatike, por ai pranoi audiencat, dhe një numër diplomatësh shkruan përshtypjet e tyre. Shumica e asaj që thanë përforcojnë ndjenjën se otomanët, me Sulejmanin në krye, ishin plotësisht të huaj dhe në mënyrë brutale efektive.

Diplomacia e rregullt dhe bashkëveprimi i rastit nisi të largojë mistikën. Më 1520, një i dërguar venedikas përshkroi Sulejmanin e ri si “të gjatë e të hollë, me fytyrë të dobët e të madhe. Sulltani dukej miqësor dhe me humor të mirë. Thashethemet thoshin se ai... pëlqente leximin, ishte i ditur dhe tregonte gjykim të mirë”. Ai kishte të njëjtën hundë si shqiponjë sikur stërgjyshi i tij Mehmeti, dhe një fytyrë më të ngushtë të zbukuruar nga mjekra e rrallë otomane e favorizuar nga familja e tij. Kjo pamje nuk ndryshoi gjatë dekadave, megjithëse u bë më e zbehtë dhe më e verdhë me kalimin e viteve. Afër fundit të jetës

së tij, sulltani pranoi një emisar mendjehollë të quajtur Ghiselin de Busbecq, derisa “ishte i ulur në një divan të ultë, jo më shumë se një pëllëmbë mbi tokë dhe i zgjatur me shumë mbulesa e jastëkë të qëndisur me një punë elegante... Shprehja e tij... ishte asgjë tjetër përveç buzëqeshjes, dhe kishte rreptësi, e cila ndonëse e mërztishme ishte plot madhësi”. Duke lënguar nga gangrena, me vështirësi mblidhej, dhe i zbehtë për vdekje, Sulejmani vuante nga kombinimi i fuqishëm dhe i dhimbshëm i dinjitetit dhe tragjedisë.

Ai kishte çdo arsye për të qenë i pikëlluar. Pavarësisht fitoreve të tij, jeta e tij personale ishte e paqëndrueshme. Ai kishte thyer rregullin themelor të klasës sunduese otomane dhe ishte martuar me një nga skllavet e haremit. Sulltanët nuk duhej të dashuronin nënat e fëmijëve të tyre, por Sulejmani e bëri. Ajo, si pasojë, përdori pozicionin e saj për të përkrahur djemtë e saj dhe ktheu burrin e saj kundër fëmijëve të grave të tjera. Rezultati ishte vdekje kudo përreth. Sulejmani urdhëroi ekzekutimin e dy djemve të tij, dhe jeta e një tjetri përfundoi në rrethana të diskutueshme. Kur vdiq gruaja e tij, dy djemtë e tij të mbetur u kthyen kundër njëri-tjetrit, dhe kundër tij. Ai ekzekutoi edhe një tjetër, së bashku me disa nipër, duke lënë vetëm Selimin, i cili do ta pasonte atë.

Këto drama janë regjistruar sipas rregullit nga të dërguarit evropianë në qytet. Ngjashëm si perandorët romakë që kishin kombinuar aftësinë e hollë për të sunduar botën e njohur me dramat e errëta dhe të shtrembëruara familjare, Sulejmani dhe trashëgimtarët e tij patën jetë të udhëhequra nga pasioni, intriga, seksi dhe vrasja. Derisa disa nga këto histori ushqyen imagjinatën evropiane rreth turqve epsharakë, ajo që na intereson më shumë ne është se religjioni kurrë nuk hyri në ekuacion.

Do të thotë: Sulejmani autorizoi ndërtimin e një xhamie të madhe në Stamboll, “Sulejmanije”. Ajo ishte monumenti më i rëndësishëm mysliman në atë kohë, por mbi gjysma e punëtorëve dhe mjeshtërve që e ndërtuan atë ishin të krishterë. Veç kësaj, sulltani mund të ketë besuar për veten se është shërbëtor i devotshëm i Zotit, por ashtu siç ishte e vërtetë për klerin në Romë në atë kohë, një devocion i tillë nuk

parandalonte mëkatin. Papët Medici dhe Borgia autorizuan vepra arti, patën dashnore, dhe u përpoqën të sigurojnë mirëqenien e shumë fëmijëve të tyre të paligjshëm. Sulltanët otomanë u sollën në mënyrë shumë të ngjashme.

Mungesa e Islamit të ashpër e doktrinar ishte në kontrast të zymtë me rolin e religjionit në Perëndim. Sa më shumë që i afroreshin otomanët Evropës, ata i ofronin shembullin të krishterëve perëndimorë, të cilët kishin rënë në periudhën e gjatë të jotolerancës. Të lodhur me korrupsionin e Kishës Katolike, murgu gjerman Martin Luter, nisi një zinxhir ngjarjesh që shkaktuan reformimin dhe luftërat disa dekadëshe në Evropë. Luteri e shihte Perandorinë Otomane nën Sulejmanin si një shembull të tolerancës fetare. Megjithëse ai dënonte otomanët si “shërbëtorë të djallit”, për Luterin kjo ishte një kritikë e butë krahasuar me atë që tha për Papën dhe çifutët. Luteri shpresonte se një kishë e reformuar dhe e pastër një ditë mund të rivalizonte modelin otoman.

Disa dekada më vonë, filozofi francez Jean Bodin, ndonëse i bindur në besimin e tij katolik, shkroi favorshëm për otomanët, “Perandori i madh i turqve me devocionin më të madh se çdo princ tjetër në botë, ka nderuar dhe vëzhguar religjionin, të marrë nga stërgjyshërit e tij dhe edhe pse e urren, nuk i duken të habitshme religjionet e të tjerëve; por përkundrazi lejon çdo njeri të jetojë sipas ndërgjegjes së tij dhe lejon katër religjione të ndryshme: atë të çifutëve, të krishterëve, të grekëve dhe të muhamedanëve”. Duke jetuar në luftërat e religjionit që kishin ndarë Evropën në përgjithësi dhe Francën në veçanti, Bodin kishte dëshmuar kostot e jotolerancës. Protestantët dhe katolikët e shikonin njëri-tjetrin me përbuzje, sharje dhe i premtonin ndëshkim në këtë jetë dhe dënim në tjetrën. Perandoria Otomane përfaqësonte një alternativë që Bodinit nuk mund t’i ndihmonte, por ta admironte.

Islami i otomanëve nuk krijoi pengesë në lidhjen e aleancave me shtetet e krishtera, dhe Sulejmani u përfshi në politikën e Evropës, jo vetëm si kundërshtar, por edhe si partner strategjik. Evropa ishte vijëzuar me ndarje, veçanërisht midis protestantëve dhe katolikëve dhe midis dy familjeve mbretërore, habsburgëve dhe valoisëve, armiqësia e të cilëve ishte e hidhur dhe e thellë. Habsburgët sundonin Spanjën,

dhe nën Charlesin V ata qeverisën edhe tokat qendrore evropiane të Perandorisë së Shenjtë Romake. Valoisët kontrollonin Francën dhe paraqisnin sfidë për hegjemoninë Habsburge. Në Francisin I, armiqësia midis dy familjeve u bë personale. Dy monarkitë zhvilluan urrejtjen e qëndrueshme për njëra-tjetrën, e cila ishte e bazuar më pak në eksperiencën direkte sesa në synimet e dinastisë. Por, kjo nuk e bëri urrejtjen më pak të fortë, dhe ajo e shtyri Francisin I të gjykojë armiqët e habsburgëve, pavarësisht se kush ishin apo cilin Zot e adhuronin.

Habsburgët kishin më shumë territor dhe më shumë pasuri (veçanërisht duke ditur ardhjen e argjendit nga tokat e reja të Amerikës Jugore), por ata gjithashtu konfrontonin më shumë armiq. Jo vetëm Charles V ballafaqoi Francisin, por ai gjithashtu duhej të luftonte me princërit gjermanë protestantë, borgjezët rebelë holandezë, Anglinë gjithnjë e më të paparashikueshme, dhe natyrisht, Perandorinë Otomane të paduruar dhe ekspansioniste e udhëhequr nga sulltani, i cili tërhoqi burime siç duhej të pashterueshme për të pajisur ushtrinë e tij. Duke pushtuar hungarezët, Sulejmani doli ballë për ballë me habsburgët. Duke shikuar nga Parisi, Francisi vendosi në fillim të viteve 1520, që armiku i armikut të tij ishte mik, dhe i ofroi aleancë me Sulejmanin, cili duke njohur avantazhin strategjik, u pajtua.

Për pjesën e mbetur të jetës së Sulejmanit, francezët dhe otomanët punuan së bashku për të poshtëruar habsburgët. Aleanca ishte vazhdimisht ngacmuese për Charlesin V dhe trashëgimtarët e tij, por ata kurrë nuk u dorëzuan, pjesërisht për shkak të lidërshit të aftë dhe pjesërisht për shkak se Evropa Qendrore kurrë nuk ishte objektiv primar për Sulejmanin. Persia paraqiste kërcënim më të drejtpërdrejtë për otomanët, ashtu si sulmuesit venedikas pengonin tregtinë në Mesdhe. Por, ashtu siç ka shkruar një historian, “aleanca franceze ishte themeli i diplomacisë evropiane të otomanëve”. Sulejmani e dinte se partneriteti i tij me Francën i mbante Habsburgët në defensivë, dhe kjo i jepte mundësi të ndiqte ambicie të tjera. Ai gjithashtu minoi fuqinë e Habsburgëve, duke përzier kazanin brenda Perandorisë së Shenjtë Romake. Ai kontaktoi princërit protestantë dhe u ofroi mbrojtjen

e tij, duke pohuar se protestantët, pasi ishin ngritur kundër idhujtarisë së Kishës Katolike, ishin në rrugën e tyre ngjashëm me myslimanët e parë, të cilët kishin refuzuar idhujtarinë e mekasve.

Këto pjesë nga jeta e Sulejmanit mezi i bëjnë drejtësi sundimit të tij mbi dyzet vjeçar, por ato zbulojnë se shteti otoman ishte jo më shumë, dhe as më pak, i definuar nga besimi ashtu si habsburgët ishin të definuar nga krishterimi apo romakët nga çfarëdo kulti pagan që ishte i përhapur. Islami ishte pjesë e besimit qeverisës, por ai ndante hapësirën me imperativët e rendit ruajtës, propagandës së dinastisë, dhe garës për pozitë në çështjet e jashtme. Sulltanët nganjëherë përdorin islamin si nxitje dhe justifikim për luftë, por i afroreshin trashëgimisë së Muhamedit dhe kulturës luftuese për pushtimet e para arabe vetëm kur iu përshtatej atyre. Kur dëshironin të bënin gjëra që mund të shiheshin si problematike sipas ligjit dhe jurisprudencës islame, ata e bënin këtë pa hezitim, duke ditur se madje në ngjarje jo të ngjashme si ato që kundërshtonte ulemaja, të tjerët do të mbështesnin gjithçka që bënte sulltani. Shumë prej veprimeve të tyre do të kishin ngritur flamuj të tillë, nëse islami do të kishte qenë forca vitale që mbante perandorinë të bashkuar. Nuk kishte asnjë mënyrë për të justifikuar vëllavrasjen dhe rebelimin, duke përdorur Kur'anin apo hadithin, e as haremën apo sistemin e eunukëve për të bashkërenduar me ligjin islamik.

Trashëgimia otomane gjithashtu na detyron të rikonsiderojmë se çka kemi për qëllim kur themi "Islam". Aleancat që Sulejmani i çimentoit me francezët katolikë nuk e kanë shtyrë askënd të pyesë vërtetësinë e tij si mysliman. Autonomia që Mehmeti ua dha çifutëve, grekëve ortodoksë dhe armenëve, nuk paraqitën sfida për pozitën e tij si besimtar i devotshëm. Islami, si çdo religjion tjetër i rëndësishëm, është ombrellë që përfshin një gamë të gjerë virtytesh dhe një mori mëkatesh. Dijetarët dhe gjykatësit mund të kenë ruajtur të drejtën për të kritikuar sulltanin, por ata pothuajse kurrë nuk e ushtruan atë. Sundimtarët u panë si element i domosdoshëm pasi frenonin kaosin që pashmangshmërisht do të pasonte nëse shkatërrohej shteti.

Vdekja e Sulejmanit nuk i largoi menjëherë otomanët si kërcënim për Evropën. Një shekull më vonë, më 1683, një sulltan tjetër kërcënoi sërish Vjenën, dhe ishte shumë afër marrjes së qytetit. Por, edhe po të kishte pasur sukses, zor se otomanët do të kishin pushtuar Evropën. Rusët u bënë një armik i frikshëm, ashtu si francezët dhe anglezët. Dhe derisa rivalët e saj u zhvilluan, brenda perandorisë, shumë pak ndryshoi. Otomanët po humbnin ngadalë avantazhin e tyre konkurrues. Pas vitit 1683, Evropa nisi të zbrapset, dhe u vu ekuilibri. Për shekuj, otomanët qëndruan si monument të ekuilibrit. Pastaj, perandoria nisi të copëtohej, dhe kur u shkatërrua më në fund në fillim të shekullit XX, marrëdhëniet midis myslimanëve, të krishterëve dhe çifutëve morën drejtim për të keq.

*Përktheu nga anglishtja:
F. Morina*

Zachary Karabell

THE LORD OF TWO LANDS

(Summary)

When the end finally came, it was a calamity. It was also meaningless. After more than a thousand years, the city of Constan-tine, the seat of the greatest empire Christendom had ever known, was occupied by a Muslim army. But, by the time that Sultan Mehmed II, ever after known as the conqueror, marched into the church of Hagia Sophia, in the heart of Constantinople, Byzantium had long since ceased to be an empire in anything but name.

زقارى قارابيل

رب لاراضيين

(خلاصة البحث)

عندما جاءت النهاية المحتمة هي كانت كارثة . هو كان بلا معنى أيضا . بعد أكثر من ألف عام مدينة قوستانتينوبوليس مقر أكبر امبراطورية اعترف بها العالم المسيحي تم انهزامه من جيش للمسلمين . و في الوقت الذي قام به السلطان محمد الثاني و الذي اشتهر فيما بعد بلقب "الفتح" متوحها الى كنيسة "أيا صوفيا" في وسط العاصمة و منذ ذلك الحين بزنة توقفت على الوجود كامبراطورية بل استمرت كاسم .

PËRVJETOR

Mexhid Yvejsi

60-VJETORI I TEQESË BEKTASHIANE SHQIPTARE NË AMERIKË (1954-2014)

Më 15 maj 2014, u bënë 60 vjet nga dita e përrimit të Teqesë Bektashiane Shqiptare në Amerikë. Me kalimin e kohës, Teqeja Bektashiane Shqiptare erdhi duke zhvilluar veprimtarinë në fushën jo vetëm fetare, por edhe në atë atdhetare, shoqërore, arsimore, edukative, kulturore. Merita të veçanta kanë shumë veprimtarë, por këtu po veçojmë prijësin kryesor, Hirësinë e Tij, Baba Rexhep Beqiri, për të cilin në fund do paraqesim një jetëshkrim në shenjë nderimi e përkujtimi!

Feja Islame në Amerikë

Feja islame në Amerikë ishte e pranishme madje edhe para se të themelohen Shtetet e Bashkuara. Historianët kanë shënuar se deri në 30% e robërve zezakë nga Afrika, të sjellë në Amerikë, ishin myslimanë. Princi Abdul Rrahman nga Afrika Perëndimore, i liruar nga kryetari John Quincy Adams, më 1828, pas 40 vjetëve në burg, ishte një nga mijëra afrikanët myslimanë.

Myslimanët në Amerikë

Myslimanët nga Andalusia, vizituan kontinentin amerikan para se evropianët ta “zbulojnë” atë që sot quhet Amerika Veriore, shumë vite para Kristofor Kolombos, siç ka shkruar Sharif el-Idrizi, në shekullin XII. Myslimanët nga Afrika vazhduan ta praktikojnë fenë islame edhe në Amerikë, kjo binte në sy kur mbledheshin në vende të veçanta, private, ku kryenin faljen e namazit. Ruhen ende dy dokumente të vitit 1731, për myslimanët afrikanë, ku përmenden me emra dy besimtarë, Ayuba Sulejman Diallo dhe Omar Ibn Said.

Omar Ibn Said (1770-1864) është një shembull, dëshmi e dokumentuar e një besimtari të devotshëm, i cili erdhi në Amerikë, në vitin 1807. Lindur në vitin 1770 në Futa Tooro, sot Senegali, jetoi në Karolinën Veriore, edhe pse ishte skllav, e praktikonte fenë islame me përpikëri e devotshmëri. Ka shkruar disa tekste fetare në gjuhën arabe si: Lutje Zotit, Si të lutemi, Namazi, Bismilah, Fazat Kur'anore, ka shkruar edhe një autobiografi. Sipas një dokumenti kinez, i njohur si Sung Document, i vitit 1178, shënohet se udhëtimi i detarëve myslimanë te një vend i njohur si Mu-Lan-pi (Amerika). Abu Bekr, mbret mysliman i Perandorisë Maliane, në vitin 1310, ka udhëhequr një seri udhëtimesh detare te Bota e Re.

Xhamitë në Amerikë

Xhamitë në Amerikë nuk shërbejnë vetëm si objekte fetare adhurimi, por ato shërbejnë edhe si objekte shoqërore, kulturore... Sipas një studimi me titull “The Mosques in America: A National Portrait,” (Xhamitë në Amerikë: Një Portret Kombëtar), Myslimanët në Shtetet e Bashkuara janë që disa breznit, shumica me prejardhje nga vendet arabe, që nga koha e Perandorisë Osmane, si Siria, Libani, Jordani. Shumica prej tyre janë arabë, turq, kurdë, shqiptarë.

Sipas studimit të lartpërmendur, xhamia e parë është ndërtuar nga shqiptarët në vitin 1915, në Main. Në vitin 1919, shqiptarët myslima-

në themeluan xhaminë e dytë në shtetin Connecticut. Pas shqiptarëve, në vitin 1926, në Brooklyn, N.Y., tatarët nga Polonia themeluan një xhami.

Myslimanët afro-amerikanë themeluan xhaminë e parë në Pittsbu-
rgh, PA, në vitin 1930. Komuniteti libanez e hapi xhaminë e parë në
vitin 1935 në Cedar Rapids, Iowa.

Myslimanët afro-amerikanë nën udhëheqjen e Shejh Daud Ahmed
Fejsalit themeluan xhaminë në Nju-Jork, në vitin 1955. Sot, në Ame-
rikë janë mbi 3000 xhami, shumica prej tyre janë themeluar pas vitit
1970.

Shqiptarët në Amerikë

Ishte viti 1876, kur shqiptari i parë shkeli në truallin amerikan. Si-
pas disa burimeve, ky shqiptar ishte nga Korça, dhe më pas ndërroi
drejtimin, duke u vendosur në Amerikën e Jugut, dhe duke përfunduar
më pas në Argjentinë.

Ishte viti 1889 kur shqiptari i dytë, i cili vuri këmbë në tokën ame-
rikane. Ky ishte Kolë (Nikolas) Kristofori, prej fshatit Katund të Kor-
çës, që arriti në Amerikë. Ky është emigranti i parë shqiptar që është
regjistruar dhe i njihen gjeneralitetet. Në vitin 1900, kur ende s'kishte
Shqipëri, numri i shqiptarëve, të cilët jetonin në Amerikë, ishte 42,
kryesisht në shtetin Massach. Prejardhja e tyre ishte kryesisht nga ju-
gu i Shqipërisë, dhe vinin nga zonat më të thella. Sipas studiuesit
Haris Silajxhiç, në fundin e Luftës së Parë Botërore (1918) numri i
shqiptarëve ishte 50 mijë.

Çfarë është sufizmi apo tesavufi?

Sufizmi apo Tesavufi, në mënyrë të përgjithshme nga dijetaret
kuptohet të jetë dimension i brendshëm i Islamit.

Besimi i brendshëm apo ezoterizmi ka të bëjë me përjetimin e
Islamit përbrenda. Ekzistojnë shumë ajete të Ku'ran-it që urdhërojnë,
këshillojnë, udhëzojnë të kuptuarit e Islamit përmes zemrës apo siç
shprehen dijetarët sufi, përmes syrit të zemrës.

Sufizmi ka shumë rende, drejtime, rrugë apo siç njihet te ne, tari-
kate. Tarikatet mund të jenë Sunni ose Shi'i. Disa nga tarikatet më të
njohura janë: Uveysi, Kadiri, Rifa'i, Sa'adi, Halveti, Shazili, Nakshi-
bendi, Suhreverdi, Çishti, Tixhani, Mevlevi, Melami, Bektashi, Be-
devi, etj.

Grupe të vogla misionarësh sufinj ishin të stërvitur, të përgatitur,
të ndritur, kishin një udhërrëfyes (murshid), kurse të tjerët ishin dervi-
shë të bindur, të ushtruar dhe kishin një mision të caktuar: Me shemb-
ullin e tyre si misionar, me urtësi, devotshmëri, maturi, mbollën farën
dhe nga ato farë doli, mbiu Islami ndër shqiptarë.

Misionarët e parë ishin Sari Salltek Babai, Sejjid Ali Babai, Qamil
Babai, të gjithë ishin nxënës, dervishë të përgatitur nga Haxhi Bektash
Veliu (1248-1341), por misionarët, që u përhapën në shumë anë, në
veshje nuk dalloheshin prej klerikëve vendës të krishterë, kështu ishin
të mirëpritur prej popullsisë, në pamje si krishterë, por vepronin si
myslimanë...!

Pas depërtimit, shtrirjes së Perandorisë Osmane në pjesën evropia-
ne, nga të gjithë popujt e Ballkanit pjesa dërrmuese e popullit shqiptar
e pranuan Islamin, kurse popujt tjerë pjesërisht. Pranimi i Islamit nga
shqiptarët, që pa dyshim një bekim, një mëshirë nga Krijuesi ndaj
këtij populli, sepse u ndërpre procesi i sllavizimit, greqizimit, latinizi-
mit, me një fjalë erdhi dita e shpëtimit, sepse u këput, u zhduk procesi
i asimilimit...

Me shkëputjen, me zhdukjen e procesit të asimilimit, filloi ndër
shqiptarë një ringjallje morale, shpirtërore, ekonomike, kulturore, de-
mografike...

Prej shekullit 15-të, diku edhe më herët, filluan të ngrihen në qyte-
tet kryesore institucionet fetare islame si xhami, teqe, medrese, tyrbe,
mejtepe, kurse nga shekulli 17-të, 18-të e 19-të, kur popullsia shqip-
tare me shumicë kishte pranuar fenë Islame, pati një lulëzim kulturor
në të gjitha në trojet shqiptare. Në këtë periudhë u zhvillua letërsia
shqipe me alfabet arab, e njohur si "letërsia e bejtexhinjve", që studiu-
esit e krahasojnë me letërsinë "alhamiada" që zhvilluar më parë në
Spanjë.

Nëpër mejtepet, teqetë, medresetë e kohës, nxënësit mësonin osmanishten, arabishten e persishten dhe ishin në gjendje të lexonin e të kuptonin librat fetarë, historikë, letrarë, filozofikë, juridikë, të vendeve të ndryshme. Disa nga nxënësit, studentët, i vazhdonin pastaj studimet e larta në Stamboll, Bagdad, Kairo, Isfahan...Me diplomimin e tyre u formua një elitë intelektuale dhe një rreth shkrimtarësh, vjershëtarësh, të cilët me poezitë e tyre turqisht, persisht e arabisht përpiqeshin t'u ngjasonin poetëve të letërsisë osmane, perse, arabe...Por, meqë shumica e popullit shqiptar që e përqafoi Islamin nuk dinte gjuhë tjetër përveç gjuhës shqipe, atëherë filluan të shkruajnë në gjuhën shqipe me alfabet arab.

Sufizmi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Është e rëndësishme për të kuptuar historinë dhe zhvillimin e sufizmit në Amerikë, në mënyrë që të fitojë me të vërtetë një ndjenjë e rolit të kësaj tradite shpirtërore brenda peizazheve të ndryshme fetare që sot gjenden në Shtetet e Bashkuara.

Sufizmi ka kaluar nëpër shumë faza në zhvillimin e saj si një traditë e përhershme shpirtërore brenda Shteteve të Bashkuara.

Paraqitja më e hershme e sufizmit në Amerikë, u zhvillua në fillim të viteve 1900, me anë të dijetarëve, shkrimtarëve dhe artistëve, të cilët shpesh merrnin informacion mbi sufizmin përmes lëvizjes orientaliste. Shembuj të figurave perëndimore që ishin të ndikuar nga sufizmi përfshijnë Ralph Waldo Emerson, Rene Guenon, Reynold Nicholson, dhe Samuel Lewis.

Këta individë ndihmuan për të futur konceptet e Sufizmit për audiencat më të mëdha nëpër shkrimet e tyre, diskutimet dhe metodat tjera të ndikimit. Emerson, për shembull, është ndikuar nga poezia sufiste persiane, si ajo e poetit Sa'adi, dhe ky ndikim është pasqyruar më pas në poezinë e Emersonit. Rene Guenon dhe Nikolson iu ofrojnë lexuesve perëndimorë disa nga Sufinjtë e shquar për herë të parë në gjuhën angleze, sidomos kryeveprën Mathnawi të Xhelaluddin Rumiut.

Grupe të ndryshme sufiste janë zhvilluar mes viteve 1950-1960 dhe 1970. Idries Shah (1924-1996) është një nga individët më të rëndësishëm që e popullarizojë Sufizmin në Shtetet e Bashkuara, dhe ndoshta shkrimtari më i njohur, Sufi në Perëndim.

Sot, shumë njerëz në Shtetet e Bashkuara janë përfshirë në sufizëm. Shumica e bashkësive sufiste në Shtetet e Bashkuara janë degë të rendeve mistike që ekzistojnë në të gjithë botën dhe kanë burimin në shoqëritë tradicionale myslimane. Shembuj të rendeve sufiste që kanë krijuar komunitetet e tyre në Shtetet e Bashkuara janë Tarikati Xherrahi, Nakshbendi, Mevlevi, Tixhani, Kadiri, Nimetullahi, Çishtii, Bektashi etj.

Tarikati Bektashi

Tarikati Bektashi, sikur shumica e tarikateve tjerë në fenë Islame, e ka marrë emrin prej pasuesve, ndjekësve, nga themeluesi, Haxhi Bektash Veliu.

Kush ishte Haxhi Bektash Veliu?

Haxhi Bektash Veliu ishte i biri i Ibrahimit, të birit të Sejjid Musait, që ishte i biri i Sejjid Hasanit.

Sejjid Hasani ishte i biri i Sejjid Ibrahimit, kurse ky ishte i biri i Sejjid Mehdiut, i cili ishte i biri i Sejjid Muhammedit, i biri i Sejjid Hasanit.

Sejjid Hasani ishte i biri i Ibrahim Mukerrem Muxhabit, që ishte djali i Imam Musa Qazimit, i cili rrjedh nga Familja e Bekuar e Muhammedit (a.s.)

Haxhi Bektash Veliu (1248-1341) ishte një burrë i edukuar, ishte i arsimuar, një personalitet i shquar, njeri i ditur, shpirtërisht shumë i ngritur, i udhëzuar, veprat e tij janë më e mira dëshmi...

Një natë, Haxhi Bektash Veliu e kishte parë në ëndërr Pejgamberin (a.s.), i cili i kishte thënë:

"O djalë! Mbaje të pastër rrobën tënde, që t'i përfitosh të mirat".

Haxhi Bektashi tha se e pyeta Pejgamberin (a.s.):

"O Pejgamber i Zotit! Po, cila është rroba ime?"

Pejgamberi (a.s.) ishte përgjigjur:

"Zoti ty të ka mbuluar me pesë lloje rrobash, të cilat janë:

"Rrobat e Islamit, të Imanit, të Njeshmërisë, të Njohurisë dhe të Dashurisë. Këto janë rrobat që duhet t'i mbash pastër, nga ana e jashtme dhe nga brenda."

Kur e pyetën një ditë Haxhi Bektashin, se kush janë besimtarët e vërtetë? Ai kishte thënë:

"Besimtarë të vërtetë janë ata të cilët i zbatojnë detyrimet e Sheri'atit."

Gjatë shekujve, besimtarët myslimanë të tarikatis bektashiane vërtet ishin të mbuluar me këto pesë lloje rrobash: Islamin dhe Imanin e mbanin pastër, Njeshmërinë (Teuhidin) e kishin në zemër, kishin njohuri të lartë, kurse dashurinë të zjarrtë...

Dashurinë e zjarrtë për sufizmin Haxhi Bektash Veliu e mori nga sufiu i njohur, Lukman Perende, kurse frymëzimin shpirtëror nga Hoxha Ahmed Jeseviu...

Haxhi Bektash Veliu ka udhëtuar shumë, ka takuar shumë dijetarë nëpër vende të ndryshme, ka kryer edhe Haxhillëkun, në vendet e she-njta, Mekke e Medine, prandaj edhe sot e kësaj dite e gëzon titullin Haxhi...

Haxhi Bektash Veliu në moshën 34-vjeçare, në vitin 1282, në vendin e quajtur Sulxhe Kara Ujuk, në Anadoll, e themeloi Teqen, ku përgatiti besimtarë, misionarë, të cilët të frymëzuar nga ai filluan të përhapin Bektashizmin nëpër Turqi, Persi, nëpër vendet arabe dhe në Ballkan...

Në vitin 1341, pas një veprimtarie të gjatë e mjaft të frytshme, Haxhi Bektash Veliu ndërroi jetë në moshën 93-vjeçare...

Përveç Udhës Bektashiane, Haxhi Bektash Veliu na ka lënë edhe disa vepra: librat që janë në qarkullim edhe sot e kësaj dite, si "Mekalat" dhe "Fevaid Fukara", si edhe shumë poezi që janë përplot frymë shpirtërore, që kanë porosi dhe që këndohen me melodi...

Gjatë historisë shumëshekullore, Tarikati Bektashi ka arritur sukses të mëdha, por ka pësuar edhe humbje të rënda... Kjo është një histori në vetë...

Teqeja Bektashiane Shqiptare në Amerikë

Gjatë viteve të errësirës komuniste në Shqipëri, për besimtarët bektashianë në Amerikë, ka shërbyer si një dritë, një dritë e pashuar, Teqeja Bektashiane Shqiptare, e cila është përruruar më 15 maj 1954, në Taylor, në afërsi të qytetit të njohur industrial, Detroit, në shtetin Michigan, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pas themelimit të xhamive, themelimi i Teqesë Bektashiane ishte një ëndërr e vjetër, kjo ëndërr, me ardhjen e Dervish Rexhebit, jo vetëm që u shpejtua, por edhe u realizua! Si ndodhi kjo?

Në qytetin industrial, Detroit, kishte shumë shqiptarë, kryesisht nga Shqipëria e Jugut, të cilët kishin biseduar për këtë çështje disa herë. Por, mbledhja vendimtare ishte ajo që u mbajt më 24 tetor 1953, në S.Andrews Hall, 431 E. Congress Street, në Detroit.

Vlen të përmendet se grupi nismëtar përbëhej nga këta zotërinj: Gani Mosho, Jashar Petrusha, Beçe Banushi, Muhamed Zagari, Qemal Boshanji, Qani Prespa, Dule Këlcyra, Abaz Murtezai, Nevruz Selfo, Surja Gorica, Haki Kozeli, Resul Shkëmbi, Selman Zagari, Xhafer Demiri dhe Zenel Poloska.

Në këtë mbledhje u vendos që të hapet fushata për mbledhjen e ndihmave për themelimin e Teqesë Bektashiane Shqiptare në Amerikë. Përveç fushatës që u hap, në këtë mbledhje u zgjodh Komisioni i Parë Administrativ i Teqesë me këtë përbërje:

Gani Mosho, kryetar, Nevruz Selfo, arkëtar, Selman Zagari, sekretar, kurse, Jashar Petrusha, Qani Prespa, Dule Këlcyra, Abaz Murtezai dhe Resul Shkëmbi, kontrollor.

Qysh në ditën e parë, fushata filloi mbarë, vetëm në Detroit u mbledhën 8.000 dollarë! Më vonë, fushata vazhdojë edhe në qytete tjera të Amerikës, si në Çikago, Nju-Jork, Boston dhe në Kanada.

Komisioni, së bashku me grupin nismëtar, pa humbur kohë, filloi të hulumtojë një vend të përshtatshëm për themelimin e Teqesë. Vendi i përshtatshëm, me ndihmën e Zotit, u gjet shpejt, ky vend ishte qyteti i vogël Taylor, rreth 20 km. nga qendra e Detroitit, një zonë fushore, bujqësore.

Ndërtesa që u shndërrua në Teqe ishte një fermë, e cila së bashku me banesën u ble për 25.000 dollarë, me disa përmirësime të nevojshme që u bënë çmimi u rrit edhe për 5.000 dollarë dhe gjithçka ishte gati, përveç lejes nga Governori i Shtetit Michigan. Për këto formalitete, si edhe Statutin e Teqesë, ka punuar avokati i mirënjohur shqiptaro-amerikan, S. Theodor Kotelly, i cili i në këtë drejtim ka punuar me përkushtim.

Governatori i Shtetit Michigan e dha lejen përkatëse, madje duke shprehur kënaqësinë që në shtetin e tij po themelohej një institucion i ri fetar. Kështu, pas tetë muajve, që nga mbledhja e parë, në Detroit, Teqeja e Parë Bektashiane Shqiptare i çeli dyert më 15 maj 1954.

Në krye të Teqesë Bektashiane, si udhëheqës shpirtëror, u vu Dervish Rexhebi, i cili më vonë u gradua me titullin Baba. Si u bë ky gradim? Ky gradim u bë sipas rregullave bektashiane, me vullnetin e shprehur me të shkruar nga anëtarët e Komisionit të Teqesë Bektashiane, si edhe një numër besimtarësh bektashianë në Amerikë e Kanada, si edhe me dekretin e shenjtë, të lëshuar nga Gjysh Siriu i Teqesë Bektashiane në Kajro të Egjiptit.

Komisioni i Teqesë Bektashiane i shkroi Gjysh Siriut:

”Ne dashamirësit bektashinj, duke marrë parasysh të kaluarën e ndritur patriotike të Teqesë Bektashiane, me qëllim që të kemi një simbol kujtimi për gjithë atë veprimtari, si edhe për nevojat tona fetare, vendosëm dhe blemë këtu në Detroit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, një vend ku themeluam një Teqe, në krye të së cilës kemi vënë Dervish Rexhebin. Duke marrë parasysh cilësitë e Dervish Rexhebit, na duket se ky është i përshtatshëm për ta kryesuar Teqenë tonë me titullin Baba. Sipas rregullit tradicional, i drejtohem i asaj Gjyshate, duke iu lutur që, po t’a shohë të përshtatshëm, t’i lëshojë dekretin e shenjtë.”

Gjysh Siriu, i cili ndërroi jetë në Kajro, më 4 janar 1963, e lëshoi dekretin dhe e dërgoi në Amerikë, të përcjellë edhe e me një letër, ku ndër të tjera, thoshte:

”Pikë së pari ju përgëzoj me gjithë zemër për iniciativën njerëzore dhe fetare që morët, duke ngrehur një Teqe në Amerikë, të parën Teqe Bektashiane në atë vend të lirë e të bekuar. Kjo vepër ju nderon, siç ju nderojnë edhe kaq e kaq vepra tjera të ndritura, të kryera nga ju, gjatë shumë vjetëve, në fushën kombëtare, kulturore dhe fetare...Brenda në këtë letër ju dërgoj dekretin e shenjtë për dorëzimin e Dervish Rexhebit, si Baba titullar i Teqesë Bektashiane në qytetin Detroit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës...

Dervish Rexhebi ka të gjitha cilësitë e duhura për të zënë postin e Babait në atë Teqe. Perëndia dhe Haxhi Bektashi qofshin kurdoherë me ju.”

Nën udhëheqjen e Baba Rexhebit, për një kohë të shkurtër, Teqeja Bektashiane Shqiptare filloi të përparojë, myhibët të shtohen, dervishët erdhën njëri pas tjetrit. Dervish Arshiu nga Vlora, ishte larguar nga Shqipëria, në vitin 1949, erdhi nga Teqeja e Turballisë në Greqi, pas tij erdhi Dervish Lutiu nga Gjirokastra, por ishte larguar që në vitin 1929, dhe shërbente në Teqenë Bektashiane në Kajro. I treti erdhi Dervish Bajram Gurkuqi nga Gjakova, por që shërbente në Teqenë Bektashiane në Kajro. Më në fund erdhi Dervish Bektashi nga Turqia me prejardhje shqiptare. Me dervishët shqiptarë, nën udhëheqjen e Baba Rexhebit, që erdhën nga tri kontinente, Evropa, Azia dhe Afrika, Teqeja Bektashiane në Detroit të Amerikës, që në fillim dukej si një bahçe në lulëzim, por tani duket si një Shqipëri e vogël në mërgim!

Teqeja është larg qytetit industrial Detroit, ku jetojnë e punojnë qindra, mijëra shqiptarë, por kjo nuk ishte rastësi, por ka një arsye, të cilën e ka shpjeguar Baba Rexhebi, gjatë një interviste me korrespondentin e gazetës së përditshme “The Detroit News”, më 30 prill 1955, në prapësinë e përvjetorit të parë të themelimit të Teqesë, ku, përveç tjerash, Baba Rexhebi ka thënë:

”Sipas besimit bektashian, ekzistojnë dy jetë: jeta e trupit dhe jeta e ndërgjegjes. E para përbën pjesën shtazore. E dyta përbën pjesën

njerëzore. Lufta midis këtyre dy jetëve farkëton parimet morale të njeriut. Prandaj, të gjitha teqetë tona janë larg qyteteve plot zhurmë. Janë në vende të izoluara, ku ne mund të lutemi e të mendojmë në qetësi dhe ta ndjejmë veten më afër Zotit.”

Teqeja Bektashiane Shqiptare e ngritur, e themeluar, e zgjeruar, e zhvilluar, e zbukuruar, mundi të funksionojë falë vullnetit, urtësisë të Baba Rexhebit.

Si e njoha Baba Rexhebin?

Baba Rexhebi (1901-1995)

Për herë të parë emrin dhe zërin e Baba Rexhebit e kam dëgjuar përmes valëve të “Zërit të Amerikës”, në vitin 1965, kur vdiq Fan S.Noli, më 13 mars 1965)

Për herë të parë për Baba Rexhepin kam dëgjuar nga Baba Bajram Gurkuqi, në vitin 1968, kur ai e vizitoi Gjakovën.

Për herë të parë me Baba Rexhebin jam takuar më 26 dhjetor 1972, në Teqenë Bektashiane, në Taylor, Michigan, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kush ishte Baba Rexheb Beqiri?

Baba Rexhebi u lind më 15 gusht 1901, në lagjen “Dunavat”, Gjirokastrë. Ishte djalë i hoxhës. Hoxha, babai i tij, quhej Mulla Rifat Beqiri, kurse nëna e tij quhej Sabrije, motra e Baba Selim Elbasanit, e cila ishte mbesa e Baba Aliut...

Mësimet fillestare i kreu në Gjirokastrë, te myderrizi i njohur Mulla Ragibi, ku prej tij, përveç tjerash mësoi edhe gjuhët klasike islame: arabishten, persishten dhe turqishten...

Kurse më vonë kreu edhe Liceun e Gjirokastrës, ku mësoi, përveç tjerash, edhe dy gjuhë tjera, frëngjishten dhe italishten.

Djaloshit të ri, të gjitha këto njohuri, me gjithë se e ngrihen, e edukuan, e formuan, por zjarrin e dashurisë nuk ia shuan...! Cila ishte kjo

dashuri? E thoshte vetë: Kjo dashuri ishte rruga mistike - që të bëhej sufi...!

Që të bëhej sufi ai kishte pak përparësi, sepse djaloshi Rexheb ishte rritur në Teqenë e Zallit, ndër bektashinj, pranë Baba Selimit dhe Babës Ali, prej të cilëve ishte frymëzuar me Dritën e Islamit, përmes Dritës së Kur'anit...

Në Teqenë Bektashiane apo siç quhet ndryshe “Teqeja e Zallit” në Gjirokastrë, pranë Baba Selim Elbasanit, dajës së tij, djaloshi i ri, Rexheb Beqiri, u dorëzua si Dervish në tarikatin Bektashi...

Tani, Dervish, më vonë gradohet Baba, në vitin 1954, nga Baba Sirriu i Kajros, Egjipt, Baba Rexhebi, zyrtarisht dhe publikisht e fillon veprimtarinë e tij në tarikatin Bektashi...

Ka marrë pjesë në hartimin e Statutit Themeltar Bektashian...

Ka marrë pjesë në organizimin e Kongreseve Bektashiane, të mbajtura në vitin 1926, 1929, në Teqenë e Turanit në Korçë...

Baba Rexhebi: Kundërshtar i komunizmit

Gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1944-), Baba Rexhebi, meqë i kishte të zhvilluara ndjenjat fetare-atdhetare, nuk u pajtua me fashizmin-nazizmin, aq më shumë nuk u pajtua kurrë me komunizmin...Komunizmin, jo vetëm që e kundërshtoi, por e luftoi me pushkë në dorë...

E kundërshtoi, e luftoi, siç thoshte:

“Komunistët s’kishin Zot, fe as atdhe... Komunistët këtë kurrë nuk ia harruan, në mungesë të tij, me vdekje e dënuan”...

Më 28-29 nëntor 1944, Baba Rexhebi me disa atdhetarë, si Mid’-had Frashëri, Hasan Dosti etj., nga Shkodra kalojnë në Mal të Zi, dhe nga aty me barka nëpër Detin Adriatik dalin në Itali, ku qëndrojnë deri në vitin 1948.

Në vitin 1948, Baba Rexhebi u shpërngul nga Italia në Egjipt, ku u vendos në Teqenë Bektashiane, e cila njihet në histori me emrin Teqeja e “Kajgusëz Sulltanit”, i cili ka qenë një mision i paparë...Në

këtë teqe, ku shërbente Baba Siriu, Baba Rexhebi qëndroi katër vjet, deri në vitin 1952.

Në vitin 1952, Baba Rexhebi nga Egjipti u shpërngul për në Nju-Jork, SHBA, ku e kishte motrën, zonjën Zejnebe, por më vonë shkuan në Detroit, të shtetit Michigan, afër Kanadasë.

Në qytezën e quajtur Taylor, që shtrihet në një fushë shumë pjellore, Baba Rexhebi me ndihmën e shqiptarëve, pa dallim feje, krahine apo ideje, themeloi Teqenë e Parë Bektashiane - Shqiptare-Amerikane...

Teqeja Bektashiane - Shqiptare-Amerikane u përrua më 15 maj 1954, e cila me kalimin e kohës erdhi duke u zmadhuar, duke u zbutur dhe veprimtaria e saj duke u shtuar... Aty punonin me përkushtim, përveç Baba Rexhebit, edhe dervishët, si dervish Arshiu, dervish Bajrami..., i pari nga Jugu, Vlora, i dyti nga Veriu, Kosova, (nga Gjakova)...

Baba Rexhebi, si udhëheqës i Teqesë Bektashiane, përveç veprimtarisë fetare-atdhetare, është marrë edhe me krijimtari, duke na dhuruar disa vepra me rëndësi...

Nga kjo veprimtari vlen të përmendet revista “Zëri i Bektashizmit”, në gjuhën shqipe dhe angleze, ku dallohen shkrimet e Baba Rexhebit rreth fesë islame, filozofisë islame, tesavvufit-sufizmit dhe parimet e Bektashizmit...

Në vitin 1964, me rastin e 10-të vjetorit të themelimit të Teqesë Bektashiane, z. Xhevat Kallajxhi, i cili punonte si gazetar profesional në Uashington, në “Zërin e Amerikës”, Teqeja Bektashiane e botoi librin e tij me titull: “Bektashizmi dhe Teqeja Bektashiane në Amerikë”, ku ndihmën kryesore të lëndës e kishte nga Baba Rexhebi...

Baba Rexhebi, në vitin 1970, botoi librin me titullin: “Misticizma Islame dhe Bektashizma”. Ky libër monumental, cili ka 389 faqe, është shtypur në Nju-Jork, nga Waldon Press.

Në vitin 1997, Teqeja Bektashiane e Gjakovës, nën kujdesin e Baba Mumin Lamës, me miratimin e Kryegjyshit në Tiranë, botoi librin: “Hadikaja ose Kopshti i të përsosurve” të Fuzuliut, të përkthyer në gjuhën shqipe nga Baba Rexhebi.

Përkthyes i këtij libri, i cila ka në përmbajtjen e tij 11 kapituj me gjithsej 497 faqe, Baba Rexhebi, ka shkruar, në vend të parathënies, shkrimin me titull: Dy fjalë me lexuesit për Fuzuliun, ku ndër të tjera shkruan:

“Baba Qazimi (Bakalli) i Kosovës, përkatësisht i Gjakovës, me ndërmjetësimin e Baba Bajramit (Gurkuqi, edhe ky nga Gjakova, por që shërbente në Teqenë Bektashiane në Amerikë, ku edhe ndërroi jetë më 22 dhjetor 1973), më detyroi t’ia bëja një përkthim modest Hadikase. Kështu ia fillova punës dhe e përktheva në vitin 1969...”

Dikur, propaganda e komunistëve të Tiranës, me në krye Enver Hoxhën, Ramiz Aliun, e sidomos Bedri Spahiu, përmes Radio Tiranës dhe “Zërit të Popullit”, e paraqitnin Baba Rexhebin si kriminel, gjakpirës, tradhtar..., por e vërteta ishte ndryshe. Baba Rexhebi ishte i urtë, i kulturuar, fetar, atdhetar, ishte për Bashkimin Kombëtar...

Baba Rexhebin e kam njohur për së afërmi, kemi biseduar, debatuar hapur, jo me orë, në ndonjë pasdite, por me javë, me muaj, ndër vite... Atëherë, si i ri, kam përfutur shumë prej tij... Si ishte ai?

Ai ishte, sikur e kishte shprehur të fliste dhe shpesh e përsëriste,

”Bukuria e njeriut është fjala e bukur e tij.

Lartësia e tij janë veprat e tij me drejtësi ”.

Fjala e bukur e tij, që shprehej me urtësi, sjellja e tij fisnike, dituria enciklopedike, frymëzuese, udhëzuese, ka lënë mbresa në ndërgjergjen time, e besa të secilit që ka pasur rastin të bisedojë me te.

E kanë çmuar, vlerësuar edhe personalitete fetare-atdhetare si Fan. S. Noli, Imam Vehbi Ismail, Salih Efendi Myftija, Imam Isa Hoxha, Abaz Kupi, Mid’had Frashëri, Anthoni Athanasi, dr.Rexhep Krasniqi, ing.Xhafer I.Devi, dr.Mentor Çoku, Imam Beqir Maloki, Hafiz Tahir Kolgjini, Xhevat Kallajxhi, si edhe personalitete të ndryshme amerikane, afrikane, aziatike, evropiane, prej tyre vlen të përmendet studiuesja, shkrimtarja, profesoresha Frances Trix, e cila ishte dishepull e Baba Rexhebit...!

Fjala e bukur e tij, lartësia e veprave të tij me drejtësi, si në Shqipëri, në Itali, në Egjipt, Afrikë dhe në Amerikë, më së miri dëshmojnë se Baba Rexhebi është një personalitet që vlen ta përkujtojmë...

Në muajin gusht, 1901, kishte lindur, në muajin gusht, 1995, në ditën e dhjetë, ndërroi jetë – kaloi në jetën e vërtetë, por nuk e pa Shqipërinë e dashur, por të shkretë...!

Me rastin e 60-vjetorit të Teqesë Bektashiane (1954-2014), ne që jemi ende, hala, në këtë dynja, le të lutemi për shpirtin e tij të ndritur me një el-Fatiha! Amin!

Burimet kryesore:

1. Gabbay, T. (1988). A discussion and a description of a sample of American Sufi practitioners. Dissertation Abstracts International, 49 (09), 3987. (UMI No. 8817270).
2. Godlas, A. (2003). Sufism, the west and modernity. Retrieved September 20, 2004, from <http://www.uga.edu/islam/sufismwest.html>
3. Guenon, R. (1962). The crisis of the modern world. (A. Osborne & M. Pallis, and R. Nicholson, Trans.). London: Luzac.
4. Guenon, R. (2001). Insights into Islamic Esoterism and Taoism (H.D.
5. Webb, G. (1995). Sufism in America. In T. Miller, (Ed.), America's Alternative Religions (pp. 249-258). Albany: State University of New York Press.
6. Williams, L.F. (1974). Sufi studies: East and west. New York: E. P. Dutton & Co., Inc.
7. Curtis IV, Edward E. Muslims in America: A Short History (2009)
8. Curtis IV, Edward E. Encyclopedia of Muslim-American History (2010)
9. Ghanea Bassiri, Kambiz. A History of Islam in America: From the New World to the New World Order (Cambridge University Press; 2010) chronicles the Muslim presence in America across five centuries.
10. Edwin E. Jacques, The Albanians: An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present, 1995
11. Fischer, Bernd J. "Albanian refugees seeking political asylum in the United States: process and problems" in Journal of Ethnic and Migration Studies 31.1 (2005)
12. Smith, Jane I; Islam in America (2nd ed. 2009)
13. Xhevat Kallajxh, Bektashizmi dhe Teqeja Shqiptare në Amerikë, me parathënie të Baba Rexhebit. 1964

14. Baba Rexhebi, "Misticizma Islame dhe Bektashizma", Waldon Press, New York, 1970, 389 faqe.
15. Syrja Xhelaj, Baba Rexhebi qiell urtësie, Shtypëshkronja "Urtësia Bektashiane", Tiranë, korrik, 2013, 271faqe.
16. Vehbi Bajrami, Shqiptarët e Amerikës, botuar nga Albanian Publishing, Nju-Jork 2003, 1007 faqe.

Mexhid Yvejsi

60TH ANNIVERSARY OF THE ALBANIAN BEKTASHI TEKKE IN THE USA (1954-2014)

(Summary)

On May 15, 2014, the 60th anniversary of the Albanian Bektashi Tekke in the USA was marked. As time passed the tekke became a noted center not only in the field of religion but also a center of patriotic, social, educational, cultural activity, etc. Despite the fact that many activists deserve praise for their work, in this paper we will focus on the life and work Baba Rexhep Beqiri, the founder and the head of the Bektashi tekke in the USA. In honor and memory of him we will present a brief biography of his.

مجيد عويسى

٦٠ عاما على تاريخ التكية البكتاشية للالبان فى أمريكا

(١٩٥٤-٢٠١٤)

(خلاصة البحث)

بناريخ ١٥ مايو من سنة ١٩٥٤ تمت ٦٠ عاما من افتتاح التكية البكتاشية الالبانية فى أمريكا . و مع مرور الوقت قامت التكية البكتاشية بنمو نشاطها ليس فى مجالها الدينى وحده بل كذلك فى المجال الوطنى و الاجتماعى والتعليمى و الادبى و الثقافى. ويرجع الفضل الى ذلك الى كثير من الناشطين و يمكن ان نخص بهذا الصدد رئيس التكية الشيخ بابا رجب بكيرى .

MEDIA

Mr. Rexhep Suma

GLOBALIZMI I IDENTITETIT

Duket se gjithçka në planetin tonë është mbështjellë nga rrjeta e globalizimit. Zygmunt Bauman, njëri nga sociologët më të njohur, të angazhuar në problematikën e globalizimit, e shpreh në mënyrë mjaft lakonike situatën e sotme: Globalizimi është i pashmangshëm dhe i pakthyeshëm. Ne jetojmë tashmë në botën e ndërlidhur e të ndërvarur në shkallë planetare. Gjithçka që ndodh në një vend të saj prek jetën e tjetrit dhe të ardhmen e të gjithë njerëzve kudo që ndodhen. Kur vlerësojmë ose gjykojmë masat e përshtatura në një mjedis të dhënë, ne duhet të marrim patjetër parasysh reagimet dhe pasojat në pjesën tjetër të botës. Asnjë shtet a territor sovran, sado i gjerë, sado i populluar dhe sado i pasur që të jetë, nuk mund të mbrojë i vetëm kushtet e jetesës, sigurinë, prosperitetin afatgjatë, modelin social ose vetë ekzistencën e qytetarëve të tij. Varësia jonë e përbashkët shtrihet tashmë në çdo skaj të planetit (Le Nouvel Observateur, 2007:24).

Me globalizmin përshpejtues të pesëdhjetë vjetëve të fundit janë rritur lidhjet midis jetës personale të tipit më intim dhe mekanizmave çrrënjësues (të marrëdhënieve shoqërore nga kontekstet lokale të ndërveprimit). Mediet e komunikimit masiv kanë arritur kulmin e zhvillimit teknologjik dhe më këtë zhvillim sikur identitetet dhe kulturat që

janë jashtë korporatave gjigante mbeten të izoluara dhe jokonkurruese në tregun global.

Përmes ndërveprimit shoqëror, individit e mëson domethënien e fesë dhe e përjeton ndjenjën e identitetit personal dhe grupor. Njeriu në kontekstin social e përjeton fenë në mënyrë subjektive. Ai ndikohet prej kuptimeve të formësuara dhe të mësuara nga shoqëria.

Në kushtet dhe rrethanat e demokracisë së tanishme liberale, që Ballkani Perëndimor asnjëherë në historinë e vetë nuk i ka shijuar, identitetet kolektive në numër më të madh, duhet patjetër ta zvogëlojnë karakterin e vet autoritar (ngaqë, ai nuk konsiderohet si burim i lirive dhe i të drejtave) dhe se përmes koncepteve neoliberales ai duhet të na sigurojë të drejtat e barabarta. Raportet e reja shoqërore, sipas këtij principi, janë të mundshme vetëm përmes sistemit politik – pra decentralizimit, rajonizimit dhe subrajonizimit.

Sot, në botë janë duke ndodhur procese të atilla, që sugjerojnë se në të ardhmen procesi i stabilitetit do të jetë shumë i diskutueshëm po qe se nuk ushtrohet procesi i decentralizimit.

Është sugjeruar shpesh se mediat kanë efekte potencialisht të thella në formimin e identitetit social të të rinjve.

Rrjetet sociale në përgjithësi konsiderohen si një "zgjatje e jetës së përditshme dhe një mjet i ndryshimit kulturor. Kështu, formimi i identitetit, si një koncept shoqëror, është duke u transformuar në mënyra të reja dhe madje edhe me përmasa globale.

Gjithë ideja e traditave fjala për të duket mjaft e çuditshme. Nga ata shpeshherë lind pyetja se pse do të duam të bëjmë të njëjtën gjë si gjeneratat e mëparshme? Çfarë është kaq e madhe në lidhje me të kaluarën? Mediet e popullarizuara nxisin dëshirën për të krijuar mënyra të reja të jetës brenda kontekstit të sistemit kapitalist, edhe pse çështja e identiteteve dhe trajtimi i tyre në mënyrë të duhur në medie në shkallë globale mbetet një dëshirë që ekziston ndër popuj që do të duhej të kishin ndikim dhe peshë në respektimin dhe njohjen e identiteteve periferike.

Nocioni globalizëm tashmë ka përfshirë çdo fushë të jetës, dijës dhe zhvillimeve të ndryshme. Epoka në të cilën jetojmë njihet si epo-

ka e globalizmit. Ky nocion fillimisht u përdor si një përshkrim neutral i një procesi të qenësishëm në ndikimet botërore të revolucionit teknologjik. Një përkufizim ndihmës u dha në vitin 2000, nga profesori Çarls Doran, i cili e shpjegoi fenomenin si “ndërveprim të teknologjisë informative dhe i ekonomisë globale. Ai dallohet në sensin e intensitetit, fushës, volumit dhe vlerës së transaksioneve ndërkombëtare në sferat informative, financiare, tregtare dhe administrative anekënd botës. Një rritje e theksuar në përqindjen e këtyre transaksioneve në dekadën e fundit, rrjedhimisht edhe në nivelin e tyre, është manifestimi më i matshëm i procesit të globalizimit”. (Doran, 2000:6).

Një nga pasojat e modernitetit është globalizimi

Ky është më tepër sesa përhapja e institucioneve perëndimore anembanë botës, ku shkatërrohen kultura të tjera. Globalizimi, i cili është një proces i zhvillimit të pabarabartë, që fragmentalizohet ndërsa ndërlihet, paraqet forma të reja të ndërvaresisë botërore ku, për ta thënë edhe një herë, nuk ekzistojnë të “huajt”. Këto ndërvaresi krijojnë, në të njëjtën kohë, forma të reja të riskut dhe rrezikut, por nxisin edhe mundësi më të mëdha për sigurinë globale. As globalizimi i jetës shoqërore nuk është proces që është përmbyllur. Në botë ndodh që mundësohen shumë lloje përgjigjesh kulturore si një tërësi. Lëvizjet përtej “modernitetit” ndodhin në një sistem global, i cili karakterizohet nga pabarazi të mëdha të pasurisë dhe të pushtetit, të cilat ndikojnë vetvetiu këto lëvizje. (Giddens, 2001:176).

Teknologjia moderne po e eliminon ndikimin e distancës gjeografike, ndërkohë që po shumëfishon llojshmërinë e mjeteve, sferën e shkatërrimeve dhe numrin e pjesëmarrësve të aftë për të planifikuar dhunë. Në të njëjtën kohë, reagimi kundër globalizmit e përqendroi zemërimin te Shtetet e Bashkuara, si caku më i qartë. Në këtë mënyrë globalizimi universalizon cënueshmërinë, madje duket sikur e përqendron armiqësinë tek Amerika. (Brezekinski, 2004:24).

Në botën moderne ngjeshja e globalizuar është rrjedhim i sistemeve të komunikimit dhe teknologjive që krijojnë një menjëhershëri që

para tre dekadave ishte e paimagjinueshme. Duke shkruar këtë kapitull, kemi pasur mundësi që përmes “postës” elektronike të bisedojmë me shumë kolegë evropianë dhe amerikanë-jugorë, me qëllim që t'i marrim parasysh shkrimet e tyre të fundit. Imazhet e televizionit ato të internetit dhe të medias së shkruar, ua mbjellin njerëzve anekënd botës vetëdijes për një botë më të madhe. Shumë grupe që po i bëjnë ballë perëndimizimit, e kuptojnë se ngashënjimi nga teknologjitë moderne mediatike e vështirëson pa masë izolimin e tyre prej ndikimeve globale. Ngjeshja moderne është fryt i globalizimit të veprimtarisë ekonomike. Përderisa në të kaluarën jo shumë të largët veprimtaria ekonomike kryesisht ka qenë lokale dhe rajonale, sot gjithnjë e më tepër horizonti i ndërvaresisë ekonomike është i zgjeruar, ai i përfshin të gjitha shoqëritë, të gjitha kontinentet dhe së fundi, gjithë botën. Spektri i gjendjes ekonomike globale vështirë të imagjinohet. Ai do të thotë se vendimet e marra në vende të largëta nga njerëzit e fuqishëm e të panjohur ndikojnë në shumë aspekte të jetës ekonomike të përditshme të njeriut. (McGuire, 2007: 472).

Zhvillimi i ndjenjës së përkatësisë

Identiteti gjithmonë nënkupton që individit të gjejë vend në një kolektiv shoqëror më të madh: së pari kolektivi duhet ta pranojë këtë pozitë në mënyrë që individit të zhvillojë ndjenjën e përkatësisë, e cila është e një rëndësie të madhe për vetëdijen e tij për vetveten dhe për mënyrën e sjelljes në situata të ndryshme në botë. Kjo zhvillohet në rrafshin simbolik dhe në këtë mënyrë krijohet ndjenja e përkatësisë shoqërore, njëherësh edhe baza për vetëdijen për vetveten dhe për solidaritetin e mundshëm mes individëve dhe anëtarëve të kolektiviteve shoqërore, mes të cilave ekziston ndjenja e lidhjeve shpirtërore. (Castells, 2002b: 24).

Fundamentalizmi modern në të gjitha kulturat ka arritur sukses të pashembullt në politizimin e dallimeve kulturore, edhe përkundër faktit që edhe ai vetë në skenat të ndryshme ku ka arritur fuqinë paraqet në forma jashtëzakonisht të ndryshme, mu sikurse edhe modernizimi

kundër të cilit shpreh revoltën. Prandaj, ai nuk është një formë e re e fesë, por vetëm e fuqisë/ pushtetit. Në të shihet se edhe kultura politike që e karakterizon identitetin modern evropian nuk mund ta gjejë vendin e vet (pavarësisht se në çfarë tradite bazohet dhe çfarë forme të shpëtimit iu ofron besimtarëve të vet) nëse e respekton kornizën të cilën nuk mund ta përcaktojë vetë. Ndër të tjera edhe për faktin se kur është fjala për të tanishmen dhe të ardhmen, krishterimi nuk mund të jetë bazë e identitetit të Evropës. (Meyer, 2009:98).

Identiteti luan rol kyç në komunikimin ndërkulturor dhe ndëridentitar, duke shërbyer si urë lidhëse midis kulturës dhe komunikimit. Vitet pas Luftës së Ftohtë qenë dëshmitare të fillimit të ndryshimeve të befasishme në identitetin e popujve e të simboleve të këtyre identiteteve. Politika globale nisi të riformësohej, duke iu përshtatur vijave kulturore (Huntigton, 2004:17).

Krijimi i identitetit

Për dikë identiteti tingëllon si detyrim, derisa për të tjerët është ngushëllim. Ku, me vetëdije thuhet se meqë identiteti bart me vete pohimin përcjellës të përkatësisë në çdo rreth socio-kulturor, në njëfarë mënyre e përcakton jetën e njerëzve, si zakonisht mungojnë udhëzimet, se si ta vendosim, definojmë dhe ta mbajmë identitetin në shoqërinë moderne (si formë sociale që do t'i lidhë shumë shoqëri) dhe në fund të fundit, prej çka do të përbehej ai. Kalimet nga identiteti shoqëror, kulturor dhe politik, kryesisht bëhet fluide dhe jo të përcaktuara, sikurse që shprehja e identitetit i lidh të gjitha këto aspekte, veçmas kur bëhet fjalë për Europën. Kjo nuk është rastësisht kështu. Tema e identitetit evropian ka herë paraqet sfida si për diskursin politik ashtu edhe për atë sociologjik. (Meyer, 2009:9).

Po të dalim në rrafshin e formimit të kombeve në ish-Jugosllavinë, ku bënte pjesë edhe Kosova si njësi federative e atij sistemi, hasim analiza që janë orvatur të shpjegojnë strukturën e re të kësaj federate shumëkombëshe jugosllave e kanë shqyrtuar me kujdes çështjen e kushteve të veçanta në të cilat janë formuar shtetet ballkanike. Kjo çështje

tje nënkupton edhe çështjen e formimit të kombeve apo popujve, tiparet e caktuara të përfytyrimeve dhe koncepcioneve mbi kombin e popullin, raportin midis shumicës dhe pakicave kombëtare brenda shteteve shumëkombëshe. Me këso çështje lidhet problemi i identiteteve “kombëtare” apo “etnike”, pastaj problemi i marrëdhënieve të tyre brenda një shteti shumetnik apo midis shteteve fqinje, si dhe ndikimi i këtyre marrëdhënieve në vendosjen e pushtetit politik. Ajo që i cilëson identitetet kombëtare në Ballkan, në shekujt XIX e XX, është dominimi shumë i fortë i kolektivitetit mbi individin dhe mbi veçantinë e vetes. Disa analistë të Ballkanit e kanë zhvilluar shpjegimin sipas të cilit “identitetet” artificiale (të veçanta e të moçme) e kanë penguar sajimin e identitetit jugosllav, të shikuar si i “natyrshëm” dhe modern. Ky shpjegim, në fakt shpreh bartjen e modelit politik francez brenda një hapësire tjetër të Europës Juglindore. Kjo teori artificialiste për identitetet nuk u përgjigjet plotësisht realiteteve historike të Ballkanit. Mirëpo, edhe më pak e bindshme është teoria substancialiste dhe esencialiste e identiteteve, që është e përhapur në hapësirën ballkanike, e që supozon se disa grupe (popuj, etni) janë të përcaktuara me tipare të pandryshueshme, të lindura apo organike (Kullashi, 2003:76).

Mirëpo, në dekadat e fundit demokracitë perëndimore kanë kaluar nëpër kriza të identitetit, që është manifestuar në mungesë të vullnetit për të artikuluar principe organizuese. Brenda këtyre demokracive ne jemi dëshmitarë të një mosangazhimi të politikanëve dhe një rritje të radikalizmit në mesin e popullsisë, kryesisht të rinjtë. Gjithashtu, kemi parë edhe një rritje të mosfunksionimit psikologjik, si dhe rrjedhimisht rritje të dukurive negative. Këto simptoma dhe sindroma nuk mund të vihen barrë e kushteve ekonomike, pasi që janë prezente edhe në shtetet e pasura edhe në të varfëra, edhe te njerëzit që jetonin në klasa të mesme edhe tek ato të klasës së ulët. Ajo që mund të jetë e mundshme është fakti që liria e ofruar nga Përendimi ka dështuar t'u ndihmojë njerëzve që të ndërtojnë një identitet të mirëfilltë që do t'u ndihmonte t'u përballonin më lehtë situatave të ndryshme. Ne zhvillojmë identitetin tonë në raport me të tjerët. Përfshirja e supozimeve kulturore, ideve dhe aspiratave të ndryshme na orienton neve nga mo-

rali. Në botën e ditëve të sotme, pra në shoqëritë multi-kulturore, nevoja për të zgjedhur është e pranishme në çdo vend, ndërsa çështja mund të jetë banale (cilën pastë dhëmbësh duhet ta përdorë?) ose mund të jetë edhe esenciale (ku mund ta gjej kuptimin e jetës sime?). Mirëpo, pa norma të caktuara kulturore, ne nuk mund të përcaktohem se cila zgjedhje është e mirë e cila është e keqe. Çka llogaritet e duhur e çka e gabuar?.

(Hoffman, 2014).

Filozofi Philippe Lacou-Labarthe në një artikull mbi temën e identitetit thekson se “motivi i identitetit-motivi i vetes- i paraprin shumë temës filozofike të subjektit, vetëdijes” dhe se “tematika e identitetit i paraprin, siç dëshmon edhe vetë organizimi i gjuhëve, filozofikes-politikës, dhe duket madje themeluese në këtë kuptim. Sidoqoftë, vetja i paraprin polisit dhe çështjes së qeniesimit.

Të pretendosh se perceptimi nuk është realitet do të thotë të sugjerosh se imazhi i subjektit është gënjeshtër. Duket qartë se nuk është gjithmonë kështu dhe shpresohet të jetë *rrallë* kështu. Është detyrë e personave që merren me marrëdhëniet publike ta ndërtojnë dhe t'i rikthehen kësaj pike. Jo vetëm që detyra e krijimit të një imazhi pozitiv duhet të jetë përparësi absolute, por me këtë detyrë duhet të koordinohet edhe përgjegjësia e vlefshmërisë së faktit, se imazhi nuk bazohet mbi tym dhe pasqyra, numra shpejtësie ose klishe të tjera që supozojnë mashtrime e marifete. Imazhi po ashtu është edhe sinonim i *reputacionit*, një term që lë të kuptohet një nivel vërtetësie, ndërsa *imazhi* merr një konotacion më sipërfaqësor, ndoshta edhe iluziv. Këto dallime nuk janë të rëndësishme. Megjithatë, agjencitë kombëtare të marrëdhënieve publike është krijuar praktika të “menaxhimit të reputacionit” për t'i dhënë rëndësinë e duhur seriozitetit të kësaj çështjeje. Por, askush nuk ka krijuar ende një praktikë të individëve, është e vërtetë se *veprat flasin më shumë se fjalët*, por fjalët kanë rëndësi në krijimin dhe ruajtjen e reputacionit. (Marconi, 2010: 70).

Në sferën ballkanike çështja e pakicave ishte një çështje e rëndë e shteteve ballkanike: kjo përcakton marrëdhëniet midis tyre dhe del si tregues i nivelit të tolerancës politike e kulturore të një shteti ballka-

nik. Konventat ndërkombëtare, që u miratuan në fillim të shekullit XX, kishin për qëllim të vënë njëfarë rendi dhe të sjellin norma për mbrojtjen e pakicave.

Fundja, kufijtë e shteteve ballkanike u fiksuan me marrëveshjen e Versajës, pas Luftës së Parë Botërore, dhe ata ishin rezultat i interesave dhe zonave të ndikimit të fuqive fitimtare, në veçanti Francës dhe të Anglisë. Pas krijimit të shteteve, elitat nacionaliste orvaten t'u mveshin (sigurojnë) shteteve të tyre një histori të gjatë para-shtetërore, duke glorifikuar një të kaluar të shpikur dhe duke dashur të vënë një vazhdimësi shtetërore që nga koha antike. Kjo e pati shtyrë Çerçilin të thotë se “popujt e Ballkanit janë të ngarkuar me më shumë histori se çdo të mund të bartnin” (Kullashi, 2003:99).

Ashtu siç e definon edhe komunikologu Rachel, pikërisht përmes komunikimit tonë (nganjëherë kompleks) me të tjerët, familjen tonë, miqtë dhe personat nga kultura dhe identitete të ndryshme ne arrijmë të kuptojmë vetveten dhe identitetin tonë. Gjithashtu, nëpërmjet komunikimit ne arrijmë të shprehim dhe përçojmë identitetin tonë te të tjerët. Njohja e identitetit tonë është mjaft e rëndësishme në ndërveprimet kulturore.

Themelimi për së pari i vetëdijes së identitetit, hapësirës dhe kohës në kornizën e përvojës historike dhe të të vërtetave në veprim, është kushti *sine qua non*, i ekzistencës brenda historisë dhe mundësisë për të kontribuar në përvojën e njerëzimit. Është e pamundur të shpëtosh nga pasiviteti derisa mendësia strategjike të mos jetë mbështetur në një pretendim ekzistencial... Ndërsa popujt të cilët rënojnë vetëdijen e tyre të identitetit, duke përjetuar një fraksion radikal në mendësinë strategjike, e vënë në rrezik ekzistimin e tyre historik, popujt të cilët e ngrijnë këtë mundësi, duke parë si mjet përjashtues ndaj popujve të tjerë, shpeshputen nga vetëdija njerëzore e përbashkët dhe përjashtohen vetë. (Davutogllu, 2010:50).

Doneri dhe lufta kulturore

Çdo popull ka mënyrën e vet tradicionale të të ushqyerit, ashtu siç dallojmë popujt në fusha të tjera siç është veshja, mënyra e banimit dhe organizimi familjar e shoqëror. Ushqimi, si veprimtari tradicionale, është i lidhur me kulturën e një populli. Secili popuj identifikohet me ushqimin që konsumon. Italianët identifikohen me pizza, gjermanët njihen me kartoffelsalat, një ushqim mjaft tradicional gjerman, i përbërë nga patatet, flia për shqiptarët, orizi për kinezët, doner-kebab i turqve, bageti i francezëve, etj etj.

Shumë bashkëkohore është që këto “kultura ushqimore” të këmbëhen dhe s’ka asgjë të keqe që këto ushqime të servohen në çdo metropol të këtij globi, pasi që jetojmë në kohën e globalizmit që asgjë s’mund të pengohet dhe të kufizohet.

Por, që ushqimi të shndërrohet në konflikt dhe luftë për identitet, kjo ka nodhur vetëm në qytetin e “ilimunizmit dhe lirisë” - Parisin.

Sipas një medie në këtë vend për të djathtën, kebab doner (ushqim tradicional turk) është shndërruar në simbol pushtimi të myslimanëve në Francë. Është mënyrë e fuqishme e sulmit. Ajo që e ha një njeri tregon edhet çfarë është. Kështu preket pika më delikate e identitetit. Pierre Raffard, hulumtues francez i kuzhinës turke, thotë se është produkt nomad, që nuk zhduket, dhe se për francezët, kebabi është tërheqës ekzotik, pak i kushtueshëm dhe mund të hahet fare lehtë, edhe derisa je duke ecur në rrugë.

Robert Menard, prefekt i qytetit jugor Beziers, pasi që fitoi zgjedhjet i dha komunës të drejtën ekskluzive për blerjen e secilit biznes që mbyllet në qendrën historike të qytetit, si mënyrë për kufizimin e përhapjes së dyqaneve të donerve. Bilez ai është edhe bashkëthemelues i uebfaqes “Bulevardi voltaire”, ku kjo vebfaqe para një viti botoi një artikull, duke parashikuar se si Franca, më 2047, ku sipas tij, të gjitha gratë mbanin shami, derisa kebabët kishin zëvendësuar gogatën”.

Ai, në një intervistë, shprehet i vendosur dhe thotë që dua të jem në gjendje të vendos se çfarë do të shitet në qendër të qytetit. Dyqanet me doner-kebab paraqesin kërcënim për imazhin historik dhe për identitetin e qytetit.

Por, kjo është sa u përket të tjerëve, por si është gjendja në rrafshin tonë. Sa rrezikojnë identitetin tonë shqiptar, ushqimet jotradicionale shqiptare, e folmja e përditshme dhe në media përdorimi i fjalëve të huaja, emri i dyqaneve (gati të gjitha në emërtime globale), etj, etj.

Këto ishin vetëm disa teza për diskutim që kur një popull i zhvilluar në kulturë e në qytetërim, siç është Franca, ndjen rrezik për imazhin e qytetërimit francez që ka edhe mekanizma shtetërorë që e mbron të veten, atëherë çfarë është halli jonë dhe sa ndjehemi të rrezikuar ne si identitet shqiptar???

Identiteti fetar është një dimension i rëndësishëm i identiteteve të shumë njerëzve, si dhe një burim i zakonshëm i konfliktit ndërkulturor. Shpesh, identiteti fetar ngatërrohet me identitetin racial/ etnik që do të thotë se mund të jetë problematike ta trajtosh identitetin fetar thjesht lidhur me përkatësinë ndaj një feje të caktuar.

Komunikimi ndërkulturor midis grupeve fetare, mund të jetë gjithashtu problematik. Dallimet fetare kanë qenë në themel të konflikteve nga Lindja e Mesme, në Irlandën e Veriut, në Indi/ Pakistan, në Bosnjë e Hercegovinë. Edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konflikti fetar ka detyruar mormonët të emigronin nga Nju-Jorku në Ohajo dhe Illionis dhe më pas në Utah. Çdokush duhet të jetë i lirë ta praktikojë fenë e vet, por konflikti mund të rezultojë nga imponimi i besimeve të një feje te të tjerët, të cilët mund të mos ndajnë ato besime. Në vitin 2003, gjykatësi i Gjykatës së Lartë të Alabamës, Roy Moore, u gjet në shkelje të ligjit të ndarjes së kishës nga shteti, për refuzimin ndaj heqjes së monumentit të Dhjetë Urdhërimeve nga ndërtesa e Gjykatës së Lartë të Alabamës. (Judith & Nakayama, 2010:121-122).

Kriza e prototipit intelektual

Islami nuk dikton një formë të veçantë të identiteti kulturor. Për këtë ka arsye doktrinare dhe historike. Mungesa e një autoriteti qendror fetar, apo udhëheqësi, në traditën islame i del para autoritarizmit si model i diskutimit të çështjeve fetare në sferën publike. Kjo është provuar nga shumësia e shkollave besimore-juridike, si dhe nga dallimet e njohura të mendimit mes tyre. (Kalin, 2012:263).

Shfaqja e rinisë islame në peizazhin perëndimor ka prodhuar një qëndrim të ri dhe problematik. Larg prej vendeve të tyre të origjinës, si myslimanë në një vend jomysliman, për më tepër në një vend të industrializuar, këta adoleshentë, studentë dhe të moshuar, shprehin dëshirë të fortë për të qenë myslimanë dhe nevojën e thellë për përgjigje dhe rregulla të kthjellëta islame. Për shkak të sfondit të tyre nuk kanë marrë arsim fetar zyrtar e as flasin arabishten, ata kanë formuar bindjen se nuk mund t'i kontribuojnë përpunimit të identitetit mysliman në Evropë, duke menduar gabimisht se përgjigjja e vetme e përshtatshme është ajo ilegale dhe se vetëm fikhu mund t'i zgjedhë të gjitha problemet e tyre. (Ramadan, 2011:172).

Kriza që ka përfshirë botën islame në përgjithësi, është kryesisht një krizë e prototipit intelektual nga elita udhëheqëse, të cilët drejtuan dhe i dhanë formë evolucionit kulturor në botën myslimane përmes një strukture unike edukative. Transformimi i imponuar qytetërimor që zuri vend në botë myslimane pas procesit të perëndimimit, synoi të formonte një elitë të re intelektualësh përmes vendosjes së një rregullimi institucional, i cili do të drejtojë dhe justifikojë këtë transformim qytetërimor.

Por, para politikave të zbatuara në shekullin e fundit, është e pamundur për të pretenduar që ky rol i elitës së re ka qenë legjitimuar nga pnerspektiva e masave, në të kundërt, është krijuar një polarizim mes kulturës elite dhe kulturës masive, që vetë tenton për të gjetur kanale të reja për procesin e socializimit. (Davutoglu, 2009: 189-190).

Ekuilibri është thelbësor për Islamin, dhe kur më shumë kështu se në shoqëri: ekuilibri esencial është midis din-it (fesë) dhe dynjas-së (botës); është një ekuilibër, jo një ndarje, midis të dyjave. Myslimani jeton në të tashmen, në botën reale, por brenda kornizës së fesë së tij, me mendjen tek e ardhmja pas vdekjes. Prandaj, po të jetë afarist, akademik apo politikan, ai nuk duhet t'i harrojë ligjet morale të islamit. Në botën postmoderne dynja-ja po prish ekuilibrin, duke cenuar dhe uzurpuar din-in.

Islami është në thelb feja e baraspeshës dhe tolerancës, që sugjeron dhe inkurajon gjerësinë e vizionit, qëndrimeve globale dhe përmeshjen e fatit njerëzor në univers. Po media jomyslimane, me sulmet e saj vazhdimisht kokëforte, ia ka dalë në portretizimin e një imazhi negativ të tij. Ajo mund t'ia ketë dalë edhe në ndryshimin e karakterit mysliman. Myslimanët, për shkak të reagimit emocional ndaj sulmit, të fuqishëm dhe tërë vrer, po dështojnë në ruajtjen e veçorisë thelbësore të Islamit. (Ahmed, 2012:99).

Karlaili (Carlyle) vuri dikur në dukje se tre elementët më të mëdhenj të shoqërisë perëndimore ishin baruti i zi, tipografia dhe feja protestante. Ai do të kishte shtuar një të katërt në epokën tonë, median audivizive. Ne e kemi indentifikuar postmodernizmin si erën e medias; për ta kuptuar postmodernizmin është e nevojshme të kuptohet media. Për definicion, televizioni është mbase instrumenti më i rëndësishëm i medias elektronike moderne. Ashtu si kinemaja dy gjenerata më parë, ai është mjeti kryesor i komunikimit i kohërave tona. Ai përbën një ndarje radikale me të shkuarën. Ashtu siç vë në dukje ky ekspert:

Fjala e shkruar (dhe në veçanti, fjala e shtypur) operon nëpërmjet koherencës logjike, zhvillimit narrativ nga shkakut te pasoja, universalitetit dhe abstraksionit, qartësisë dhe një toni të vetëm zëri, dhe kështu, i inkurajon ato. Nga ana tjetër, televizioni është kalimtar, episodik, i veçantë, konkret dhe dramatik në metodën e të vepruarit. Domethëniet e tij kanë arritur nga dallimet dhe pranëvendosja e shenjave në dukje kontradiktore dhe "logjika" e tij është gojore dhe pamore (Fiske & Hartley, 1988:15).

Pavarësisht nga ngjyra, raca, gjuha dhe feja, njeriu ka një identitet të qartë të formës së vet. Ky model unik nuk është rezultat i evolucionit, sepse evolucioni, po të ekzistonte, nuk do të ndalej në një pikë, por do të vazhdonte pambarimisht, e me këtë do të ndërronte edhe formën e njeriut. Shembull tipik është fëmija në bark të nënës, i cili për nëntë muaj fiton gjatësinë afërsisht prej 50 centimetrash, ndërsa gjatë tërë jetës së tij pas lindjes, rritet edhe 120 e më së shumti edhe 150 centimetra. Pra, po të vazhdonte “evolucioni” i rritej së foshnjës si në bark të nënës, njeriu do të bëhej i gjatë njëqind metra. Nga ana tjetër, po të besohet se majmuni është shndërruar në njeri, evolucioni do të bënte që njeriu të vazhdonte evolucionin e tij, ashtu që ai do të shndërrohej në një krijesë me formë tjetër dhe me natyrë tjetër. Por, kjo nuk ka për të ndodhur kurrë, sepse identiteti i tij është i vulosur, ashtu si ka shpallur Zoti në Kur’an:

“Ne njeriun e kemi krijuar në formën më të bukur” (Et-Tin,4).

Prandaj, ky identitet është i dhuruar nga Krijuesi, ndërsa misioni moral që i është ngarkuar njeriut si mëkëmbës i Zotit në Tokë, realizohet në raport me Krijuesin. Në këtë kontekst, njeriu është lënë i lirë të zgjedhë a do të besojë apo jo dhe me cilën fe do të identifikohet e si do të sillet. Natyrisht, duke u ngarkuar me përgjegjësi për zgjedhjen që ka bërë. Nga ana tjetër, feja është si çelës edhe për shpjegimin e krijimit të botës, në të cilën njeriu jeton dhe të cilën ai nuk e ka krijuar vetë, po e ka gjetur të krijuar. (Krasniqi, 2010:98).

“A nuk e dinë ata, të cilët nuk besuan se qiejt dhe toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ato të dyja dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi; a nuk besojnë?. Dhe në të (tokë) Ne kemi krijuar bjeshkë të paluhatshme që të mos i lëkundë ata, dhe nëpër to kemi bërë luginë e rrugë, në mënyrë që ata të dinë të orientohen. Qiellin ua kemi bërë kulm të sigurt, por ata zbrapsen prej atyre argumenteve. Ai është që krijoi natën dhe ditën, diellin e hënën dhe secili prej tyre noton në orbitë”. (El Enbija, 30-33)

Sa i përket identitetit fetar, ai integron të gjitha identitetet tjera dhe i harmonizon brenda vetes, ndërsa asnjë identitet tjetër nuk mund ta integrojë dhe harmonizojë identitetin fetar nëse ai nuk ekziston.

Prandaj, në letërsinë dhe në filozofinë perëndimore të shekujve XIX e XX, më shumë flitet për krizën e identitetit, për fragmentimin e njeriut dhe individit, për dyzimin e tij, për tjetërsimin e tij. (Krasniqi, 2010:99).

Mitet evropiane

Nga ana tjetër, miti për Europën e krishterë dhe kontinentin islam është njëri prej stereotipave të ngulitur më së thelli, barabar në mënyrë jokritike i përvetësuar edhe në rrafshin e komunikimit të përditshëm, si dhe në nivelin më të lartë të shkencave shoqërore historike. Ky mit ideologjik i krijuar dhe po ashtu ideologjikisht i përjetësuar, është shkaku kryesor që Europa, sidomos në pjesët me traditën kryesisht të krishterë, sot ka probleme serioze me identitetin vetjak. Këto probleme arrijnë edhe nivelin e dezinformimit, konfuzionit dhe harresës së plotë. Viteve të fundit gjithnjë e më shumë dhe gjithnjë e më zëshëm jehon pyetja: “A do të dëshirojë Europa e krishterë të lejojë të bëhet edhe kontinent i myslimanëve!? Konferencat e shumta, simpoziumet, debatet publike, diskutimet në TV, i xhirojnë këto çështje në të gjitha variacionet, nga ato ekstreme djathtë dhe haptazi anti-islame, deri te modelet e buta të tolerancës multikulturore, në të cilat theksohet e drejta e tjetrit (ashtu edhe të myslimanëve), të pranohet nga evropianët, pa marrë parasysh faktin që ai tjetri (pra myslimanët), nuk është evropian. (Muhiq, 2013:327).

Shumica e evropianëve sot me rezervë e pranojnë të dhënë se në shumë vise të Europës, islami ka arritur herë-herë madje edhe dy shekuj para krishterimit, madje edhe më shumë është i pranishëm nga krishterimi (Haveriq, 2004). Kjo tezë përfshin një spektër të gjerë referencash dhe materiale bibliografike arkivore, me analizë të hollësishme historike të rrethanave shoqërore të asaj kohe. Përkundër praktikës së përhapur në shkencë, e cila në mënyrë jokritike, e ka mundësi edhe në mënyrë tendencioze, shfaqjen e islamit në Gadishullin Ballkanik, në mënyrë rigoroze e lidh me fillimin e shtetit osman, duke injoruar kështu dëshmi të shumta, të cilat flasin për përhapjen dukshëm

më të hershme të islamit në Europën Juglindore, konkretisht në kufijtë e Bosnjës. Haveriqi, në mënyrë të dokemntuar i lëviz këta kufij disa shekuj më herët, madje në mes të shekullit VII, që sërish do të thotë se islami është i pranishëm në Bosnjë, plot 12 shekuj, dhe se po aq gjatë ka ndikuar në formimin e identitetit të Bosnjës dhe të bosnjakëve!!(Muhiq, 2013:329)

Autori në vazhdim sjell shembullin e përhapjes së krishterimit në truallin e Danimarkës së sotme në vitin 820, me misionin e Ansgarit nga Amiena, territori i Skandinavisë nuk e ka pranuar krishterimin para fundit të mijëvjeçarit të parë të erës së re dhe fillimit të shekullit XI; përafërsisht në të njëjtën kohë me përhapjen e krishterimit në Europën Lindore dhe Qendrore. Kështu Vladimiri, princi i Rusisë së Kievit, e pranoi krishterimin në vitin 988, pothuajse në përputhje të përkryer me misionin e vëllezërve Cirili dhe Metodi, të cilët perandori bizantin Mihaili III e dërgoi në zonën e Moravisë, kur krishterimi depërton në rajonet veriore të Gjermanisë dhe Polonisë së sotme, ndërsa në Hungari krishterimi zyrtarisht është pranuar në vitin 1001, me dekretin mbretëror.

Derisa krishterimi, me përjashtim të Perandorisë Romake, përhapet nëpër Europë kryesisht nëpërmjet ndikimeve misionariste, apo me pranimin nga ana e shtetit, i cili deri atëherë nuk kishte qenë i krishterë, islami në Europë hyn si shtresim kulturor dhe klishe dominuese shpirtërore, në të cilën janë bazuar tre shtete të mëdha të fuqishme dhe jashtëzakonisht të organizuara. Nga halifi i emevitëve dhe abasitëve, i cili qysh në vitin 711 qe forcuar në truallin e Europës, së pari në gadishullin Iberik, që më vonë të përhapet në pjesët jugore të Francës së sotme, Zvicrës, sikurse edhe praktikisht në të gjitha ujdhesat e Mesdheut Perëndimor. (Muhiq, 2013:329)

Globalizimi

Globalizimi i gjen shqiptarët të pasuruar me dy fe të mëdha botërore - islamin dhe krishterimin. Kështu edhe identiteti shpirtëror i shqiptarëve manifestohet në këto dy botëra shpirtërore. Në këtë shpejtësi të ekspansionit dhe shtrirjes së procesit të globalizimit sipas Ferid Muhiqit, të projektit të globalizimit duhet rikujtuar se identitetin e një populli, përkatësisht elementet kryesore të identitetit janë feja dhe gjuha. Në këtë periudhë të shpejtësisë së madhe të realizimit të procesit të globalizimit të dyja këto, edhe gjuha edhe feja, janë në rrezik. Përderisa gjuha është një interes i drejtpërdrejtë, ajo është shumë më afër rrezikut për asimilim. Sidomos kur bëhet fjalë për njerëz të cilët për interesa dhe qëllime të ndryshme kanë emigruar në një vend, ku gjuha e tyre amtare nuk përdoret, për gjuhën e tyre nuk bisedohet, se ajo vetëm rrezikohet, porse ajo gati se nuk ekziston fare. Ndërkaq, në rrethana, feja është dhe mbetet i vetmi element që e mbron dhe e mban gjallë identitetin kombëtar. Ndërkaq, nëse bëhet fjalë për një fe me karakter jouniversal apo për ndonjë fe nacionale/kombëtare, atëherë fati i saj është i njëjtë sikur i asaj gjuhe në vend të huaj. (Nesimi, 2014:100).

Ashtu si historia e feve të tjera botërore, as Europa moderne nuk duhet të interpretohet si një fazë në procesin e vet të zhvillimit të ndonjë kodi gjenetik. Këtë kod tani do të shënojmë si “mem” dhe që kjo analogji në bazë të organizimit të mos jetë lehtë të hidhet poshtë, por megjithatë çështja sillet në skemën gjenetike. Në këtë mënyrë, arrijmë te një lloj i interpretimit hermetik të kulturës që reduktohet në biologjizëm, e që tani do të duhej interpretuar me nocione nga fusha e kulturës. Nga kjo del se në fillim të çdo akti “krijimi”, secila kulturë fetare e ka formësuar programin e vet të memories, i cili më tej duhet të rrotullohet si mekanizmat e orës. (Meyer, 2014:83)

Në librin e tij, të kthyer tashmë në klasik, “Ç’është globalizimi” (1997), Ulrich Beck, sociologu më i madh evropian mbi këtë temë,

pohon se globalizimi, në tërësinë e vet paraqitet si një proces në vazhdim të të cilit shtetet nacionale dhe sovraniteti i tyre kushtëzohen dhe lidhen në mënyrë të tërthortë nga aktorët ndërnacionalë, nga format e pushtetit, nga orientimet, identiteti dhe rrjetet e tyre... Në këtë kuptim, “specifika e globalizimit sot (e sigurisht edhe në të ardhmen) konsiston në shtrirjen, densitetin dhe stabilitetin, të spikatura empirikisht të rrjeteve, të lidhjeve reciproke rajonale-globale e të vetëpërcaktimit të tyre masmedior, ashtu si edhe të hapësirave sociale e të flukseve të tyre të imazhit në nivel kulturor, politik, financiar, ushtarak dhe ekonomik...”

Ndonëse përvijohet një ide e përgjithshme se era globale do t'i shkrijë kufijtë dhe dallimet midis kombeve, kulturave, njëlloj si tregjet dhe monedhat, është pikërisht e kundërta ajo që na mësojnë mendimtarët modernë. Identitetet kulturore në kushtet e globalitetit, nëse janë të forta e të thellë-rrënjësura, e veçanërisht nëse arrijnë të kultivohen, spikasin dhe kanë shumë më tepër mundësi të dalin në pah, sesa më parë. Shqipëria, qoftë me historinë, kulturën fetare, juridiko-zakone, me krijuesit dhe heronjtë e saj, i ka të gjitha mundësitë ta lulëzojë identitetin e vet të spikatur edhe në këtë epokë të “fluiditetit” të shumë gjërave. (Kulla, 2010).

Të gjitha gjallesat krijojnë lidhshmëri me rrethin me anë të perceptimit dhe reagimit. Njeriu është lloji i vetëm i gjallesave që reagimet çliron nga hegjemonia e perceptimeve. Sjellja e njeriut nuk janë të kufizuara me perceptimin e botës së jashtme dhe reagimin ndaj saj në momentin përkatës, sepse njeriu, bile edhe pas humbjes së trupave dhe ngjarjeve nga plani i perceptimit, mund të vazhdojë t'i përfytyrojë të njëjtit (trupa) në mendjen e vet. Njeriu me operacionet mendore mbi projeksionet simbolike të trupave dhe ngjarjeve jep gjykime dhe merr vendime lidhur me veprat që do t'i bëjë. Njeriu, me veprat që i bën sipas vendimeve të tij jashtë ndikimit të stimuluesve konkretë të humbur nga plani i perceptimit, ngrihet në një nivel më të lartë të sjelljes nga ai i të gjitha gjallesave të tjera. (Ozakpënar, 2009:15)

Shumë shkencëtarë dhe politikanë socialë kanë një tendencë ta paraqesin islamit si një element të pakompromentueshëm përkundrejt

konsensusit të përgjithshëm të komunitetit global. Konkluzioni i mëposhtëm i Fukajamës është një shembull i mirë e kësaj qasjeje: ”Por, tani jashtë botës islame, duket se ka një konsensus të përgjithshëm që pranon kërkesën për një demokraci liberale që të jetë forma më racionale e qeverisjes, që është shteti, i cili realizon më së shumti, si dëshirën racionale ashtu edhe e njohjen racionale “. (Fukajama, 1992:212).

Mënyra e kategorizimit në vijën “ne”- “ata” bazohet në dallimet kulturore të njerëzve dhe grupeve shoqërore. Për të kuptuar problemin e identitetit kulturor është e domosdoshme të studiohet funksioni i identifikuesit, gjegjësisht marrëdhënia mes identitetit dhe identifikuesit që më shpesh kanë të bëjnë me gjuhën, besimin, traditat, artin, dhe në përgjithësi faktet që e përbëjnë një sistem vlerash.

Sipas Erving Goffman-it, identiteti kulturor u mundëson grupeve shoqërore që në kontaktet me vete të vetëpërcaktohen, t'i përcaktojnë grupet tjera dhe të marrin qëndrim lidhur me to. Teoricieni amerikan, S.Huntigton, pohon se është identiteti kulturor - e jo ideologjitë politike ose ndarjet ekonomike-faktori përkufizues i çintegritimit shoqëror dhe konflikteve në epokën e pas Luftës së Ftohtë (Siljanovska, 2007: 27-28; Atanasov, 2003:13).

Në Europë njerëzit janë mësuar që të jenë model për pjesën tjetër të botës. “Globalizmi evropian” është maja më e latë e kësaj shprehje. Me këtë rast shpeshherë harrohet se shoqëritë vetëm në kohë krize mësojnë të kalojnë në një faqe të re, prandaj edhe Europës iu deshën shekuj të tërë të luftërave fetare, e më pastaj edhe dy luftërave botërore shkatërruese, me miliona njerëz të vdekur, për të parë se insistimi i vjetër në shtet nacionale e çoi në rrugën qorre dhe të tregojë gatishmëri që mbi vete të marrë rrezikun e rrugëtimit të paprovuar të bashkimit transnacional, që më vonë u konstatua se paraqet shans të madh. Edhe përkundër suksesit të deritanishëm, që paraqet precedent historik, Europa më askujt nuk i mban leksione. Aq më tepër që risitë që vijnë me modernitetin dhe globalizmin nuk mund të kapërcehen përmes metodave të vjetra dhe të provuara. Pasi që në mbarë botën diversiteti kulturor po bëhet gjithnjë e më i madh, edhe vetë Europa duhet të mësojë shumë nga ky fakt, në realitet jo nga i gjithë rendi si tërësi, por gjith-

sesi nga disa fusha të rëndësishme. Për shembull Azia Juglindore, si një rajon që në procesin e unifikimit politik është shumë mbrapa Bashkimit Europian, por në mënyrën e bashkëjetesës shumëshekullore të pjesëtarëve thuajse të të gjitha religjioneve të botës, paraqet shembull, pra, respektimi i ndërsjellë i diversitetit, pa dominim dhe pa kulturë primare.

Europa nuk është model i mirë, dhe i vetëm deri diku mund të shërbejë si shembull. Të gjitha religjionet botërore duhet të kontribuojnë në procesin e globalizimit pozitiv. Ky duhet të jetë proces i formimit të identitetit qytetar kozmopolit, nëse synojmë të ndalojmë zhvlerësimin gjithnjë më të madh të të drejtave dhe fuqisë vepruese të qytetarisë politike, e cila është kushtëzuar nga globalizmi negativ. Identiteti qytetar europian mund të jetë pjesë e këtij kozmopolitizmi, por jo si diçka e veçantë që ka përparësi mbi të gjithë të tjerët, por si diçka e veçantë që ka përparësi mbi të gjithë të tjerët, por si i barabartë në mesin e të barabartëve ose në radhë të parë, si vetëdije dhe përgjegjësi e aktorëve lidhur me atë se bota ka nevojë të zhvillohet në këtë drejtim. (Meyer, 2009: 230).

Media riformatizon identitetin personal

Por, në rrafshin medial shohim se mediet sociale janë agjenci më të shtrira tani që i shërbejnë edhe riformatizimit të identitetit personal, pasi, duke luajtur rolet në një fushë të mjegullt, me mundësinë edhe të paraqitjes së vetvetes ashtu si dëshmojnë të jenë dhe jo ashtu siç janë, individit fillon të ndryshojë nga brenda emocionalisht dhe po kështu gjykon se këtë ndryshe e përcjell edhe te bashkëkomunikuesit, numër të madh i të cilëve as i njeh dhe as do t'i njohë ndonjëherë. Mosnjohja i jep më shumë kreativitet po edhe konfuzitet emocional dhe po kështu edhe agresivitet psikik, duke e shndërruar nga një subjekt real në një subjekt virtual. Mashtrimi paraqitet kur një përdorues aktiv i faacebook-ut apo edhe i rrjeteve të tjera sociale, nga komunikimi simbolik, mendon se është tashmë një njeri shumë i popullarizuar, i respektuar, me profil të veçantë që i hap rrugën për veprime reale. Një

formë e këtij komunikimi të diskutueshëm janë edhe shkrimet që mund të mos jenë të autorit në adresën elektronike. (Berisha, 2014:65).

Një ndër idetë më të spikatura që më ka mbetur në mendje gjatë leximit të eseve të Roland Lamit, është shtjellimi i dukurisë së “vasalizmit të publikut” ose e “somnambulizimit të qytetarit”. Dhe në veten time këtë mbresë të fortë e gjej plotësisht të përligjur. Sepse me këtë akt, pra me “vasalizimin” ose “somnambulizmit”, shtypi, masmedia, përgjithësisht procesi i komunikimit, bën të kundërtën e misionit të vet: ikën nga ndriçimi dhe çlirimi i publikut drejt skllavërimit të tij mediatik, informativ dhe komunikativ. Skllavëria në emër të lirisë dhe nënshtrimi në emër të çlirimit janë ndër befasishtë më të dhimbshme në një shoqëri që pretendon të jetë demokratike dhe e qytetëruar.

Të gjithë jemi nën pushtetin e lajmit që vjen nga media. Të ulur në mbrëmje përballë ekraneve nuk shohim e nuk dëgjojmë gjë tjetër veçse ato që kemi lexuar gjatë ditës nëpër faqet e gazetave. Thënë ndryshe, jemi viktimë të zinxhirëve të komunikimit. Gjithë arsenalin mediatik dhe komunikativ derdhet me furi mbi shqisat tona, duke na imponuar atë që përbrenda që në fillim: realitetin që vjen te secili prej nesh i shndërruar, shpeshherë edhe i konvertuar. Shqipëria e ekraneve dhe ajo e mjedisëve na pengon të shohim, të ndiejmë dhe të ndryshojmë Shqipërinë reale.

Gjatë dy dekadave të fundit, dua, s'dua, jam edhe unë i detyruar ta përmend një nga fjalët që, për lexuesit mund të jetë e konsumuar, në mos e urryer, pra termin “transicion”; shoqëria shqiptare ka njohur disa “zbulime”. Një prej tyre ishte ambivalenca e problematikave etnike të vendit. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, por edhe në pjesën e parë të tij, Shqipëria nuk kishte pasur implikime nacionalizmi ose situata etnike inkandeshente. Shqiptarët dhe ato grupe të vogla etnikisht joshqiptare, që jetonin dhe jetojnë në këtë vend, kishin kufizuar ose ndrydhur brenda vetes reagimet e mundshme ndaj tjetrit etnikisht të ndryshëm. Por, liria i çliroi të gjithë dhe si pasojë edhe demonët e vjetër nacionalistë, të cilët, ndryshe nga gjithë periudhat e mëparshme, kanë pasur një valencë të dukshme në jetën e shoqërisë shqiptare. (Lami, 2014:11).

Përkundrazi, në epokën e elektricitetit, dallimet kombëtare fillojnë të bien njëri pas tjetrit dhe komunikimi kulturor, politik dhe ekonomik vendoset në një shkallë botërore. Bota e tërë gjen kështu një lloj uniteti global të vendosur mbi lidhje shoqërore të përshtatshme për këtë gjendje të re komunikimi në distancë dhe jashtëzakonisht të shpejtë.

Sigurisht media elektronike vlerësohet si kontribuuesi më i rëndësishëm në këtë proces. Roli i saj nga shumë specialistë të komunikimit lidhet me krijimin dhe shpërndarjen e dijes sociale në kuptimin më të gjerë. Imazhet dhe idetë që shpërndahen, shërbejnë për një numër të madh njerëzish, si i vetmi burim ndërgjegjësimi lidhur me një të kaluar të përbashkët (historinë) dhe me pozicion aktual në hierarkinë sociale, duke u kthyer në burim të rëndësishëm rregullash, normash dhe modelesh. Ky ndikim rritet akoma më shumë në kushtet e një shkëmbimi akeonomiko-politik të zbehtë si dhe në mungesë të organizimit shoqëror solid dhe izolimit relative të individëve (Kornhauser, 1968).

Jean Baudrillard, në gjykimin e George Ritzer-it, (2008) e përshkruan këtë botë të prodhuar nga media si hiper realitet. Për Baudrillard (1981), media rresht së qeni një pasqyrim i realitetit, pasi bëhet vetë një realitet, madje më real se vetë realiteti. E gjitha kjo lidhet me argumentin se mediat televizive, të specializuara në transmetimin dhe prodhimin e një kulture standarde, funksionojnë me qëllime të tjera dhe ndjekin strategji që kushtëzohen nga logjika që ndonjëherë nuk kanë të bëjnë aspak me probleme që flasin. Aq më tepër, sikurse është thënë dhe stërthënë tashmë shpesh herë që televizioni nuk mund të jetë asnjë institucion shkollor dhe as një qendër kulture dhe nuk mund t'i zëvendësojë këto të fundit. Zhvillimi i arsytimit mbi teknologjinë e informacionit ka vërtetuar se tjetër janë substratet materiale të komunikimit dhe tjetër gjë janë përmbajtjet semantike, kuptimore që ata përcjellin. Identitetin e bartësit të mesazhit e krijon në radhë të parë përmbajtja kuptimore e komunikimit dhe jo thjesht teknologjia e tij, pra media si infrastruktura materiale. (Fuga, 2009).

Konkluzion

Në përfundim, mund të thuhet se identiteti kulturor është në thelbin e imagjinatës bashkëkohore po aq sa edhe globalizimi me gjithë konsekuencat e tij.

Si rrjedhojë e saj, mediet dhe studimet mbi komunikimin e sidomos në sferën e shkencave sociale duhet të intensifikojë betejën në një fushë që është jo vetëm e gjerë dhe pjellore, por ka një sërë sfidash si aspekti konceptual, metodologjik, teorik edhe empirik.

Studimet mbi mediet dhe komunikimin nuk mund të kufizohet vetëm në mediet dhe teoritë e komunikimit, por që gjithashtu vazhdimisht duhet të vihet në pah po asthu edhe fuqia e fushës së sociologjisë, historisë, politikës dhe studimeve kulturore që nga një aspekt i dhuron gjerësi dhe thellësi në korpusin e tyre të njohurive për të arritur tek analizat e shëndosha dhe interpretimet empirike reale.

Thënë në terma operative, kjo do të thotë është tejet me rëndësi pasi që duhet kapur jo vetëm ato procese dhe kushte që mund të shpjegohet lehtësisht në drejtim të homogjenizimit, heterogjenizimit apo edhe hibridizimit, por ne kemi nevojë për të zgjeruar dhe thelluar imagjinatën tonë edhe më për të kuptuar pasojat e papritura të globalizimit.

Në këtë mënyrë, ne i hapim vetes liri veprimi më të gjerë dhe gati-shmërinë në kërkimin dhe analizën tonë që do të pasurojë korpusin tonë të njohurive të shoqërive dhe komuniteteve, përkatësisht kulturës dhe identitetit të tyre që duket të jetë burim i pafund për imagjinatën bashkëkohore në këtë botë shumë të globalizuar.

Referencat

- Ahmed, A.(2012), Postmodernizmi dhe Islami, Logos-A, Shkup, p.99.
- Berisha, I. (2014), *Mediakultura*, PEN Qendra e Kosovës dhe Kolegji Universitar AAB, Prishtinë. p.65.
- Brzezinski, Z. (2004), *The Chose: Global Domination or Global Leadership*, p.24.
- Castells,M.(2002b) *The Construction of European Identity* in, Rodrigues, Maria ban (Hag.), *The Knowledge Economy in Europe*, Cheltenham, Nortempton.
- Davutogllu, A. (2010), *Thellësia strategjike*, Logos –A, Shkup, p.50-51.
- Davutogllu, A. (2009), *Trasformimi qytetrimor dhe bota islame*, Logos-A, Shkup, p. 189-190.
- Doran F. Charles. (2000), *Globalization and statecraft*”.p. 6.
- Fiske, J. (1991), *Understanding Popular Culture* , London: Routledge & Hartley,J.(1988) *Reading Television*, London: Penguin Books p.15.
- Fuga, A.(2009), *Brirët e Dhisë*, Tiranë, Ora.
- Giddens, A. (2013), *The Consequence of Modernity*, përkthyer nga grup autorësh, Tiranë, Uet Press, p. 176.
- Haverić, D.(2004), *Islamization of Bosnia: Early Islamic influence on Bosnian society*, Deakin University, Victoria, 2004.
- Hoffman , E. (2014), *Flights from freedom*, <http://jordantimes.com/flights-from-freedom>, Amman, Dec 06, 2014.
- Huntigton, S.(2004), *Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botërorë*. Logos –A, Shkup, p.17.
- Judith N. Martin & Nakayama (2010), *Hyrje në Komunikimin ndërkulturorë*, Uet Press, Tiranë , p.121-122.
- Kalin, I. (2012), *Islami, arsyeja dhe bota moderne*. Logos –A, Shkup, p.263.
- Krasniqi,M.(2010), *Letërsia dhe besimet fetare*, Logos –A, Shkup, p.98.
- Kulla, N.(2010),<http://ëëë.kosova-sot.info/> , gazetë e përditshme kosovare, 28 qershor,2010, Prishtinë.
- Kullashi,M.(2003), *Përplasja e Identiteteve*, Pejë Dukagjini, p.76.

- Lami, R.(2014), *Komunikimi dhe marrëdhënia shoqërore*, Uetpress, Tiranë, p.11.
- Le Nouvel Observateur, (2007),Paris, France, nr.24.
- Marconi, J. (2010), *Marrëdhëniet publike*. Uet Press, Tiranë, p.70.
- Meredith B. McGuire (2007).*Religjioni konteksti shoqërorë*. Shkup, Logos-A,p.472.
- Meyer, Th. (2009), *(Die Identität Europas:Der Eu eine Seele?* Suhrkamp Verlag, Fraknfurt am Main., përkthyer nga Skënder Latifi.
- Muhiq, F.(2013), *Identiteti Islam i Europës*, përkthyer nga Nexhat Ibrahim,Logos-A, Shkup, p.327.
- Nesimi, Q. (2014). *Procesi i globalizimit dhe identiteti religjioz i shqiptarëve*, Philosophica Vol.1, N0.1-2.Tetova.2014,p.100.
- Ozakpënar, J. (2009), *Kultura dhe qytetërimi një teori e qytetërimit*. Logos-A, Shkup, p.15.
- Pajaziti, A. (2009), *Fjalor i Sociologjisë*, Logos-A, Shkup, p.253.
- Ramadan,T.(2011), *Të jesh mysliman evropian*, Logos-A, Shkup, p.172.

Mr. Rexhep Suma

THE GLOBALISATION OF IDENTITY

(Summary)

It seems that everything in our planet is affected by globalization. Zygmunt Bauman, one of the most distinguished sociologists whose primary research interest is globalisation, expresses the current situation in a very laconic way:

Globalization is irreversible. We already live in a world of interconnection and interdependence at the planetary level. Whatever happens at a certain location affects the lives of others and the future of all people wherever they are. Thus, whenever we do something we must take into consideration its consequences for the rest of the world.

No sovereign territory, however vast, populous, or rich it may be, can protect alone its own living conditions, safety, or long-term prosperity, its social structure or the existence of its inhabitants. Our interdependence is already global (Le Nouvel Observateur, 2007:24).

رجب سوما

عولمة الهوية

(خلاصة البحث)

يبدو بأن كل شيء في كوكبنا مغلف بشبكة من العولمة. و هكذا نرى زوغموند باؤمان احد اشهر علماء في علم اجتماع العولمة يعبر بصورة مقتضبة عن حالة اليوم قائلا : العولمة لا مفر منه و لا رجعة فيها . نحن نعيش اليوم في عالم متداخل و مترابط على مستوى العالم . كل ما يحدث في مكان معين يوءثر في حياة الاخر و مستقبل كل الناس اينما وجدوا ...ان اعتمادنا المشترك يمكن أن نراه اليوم في كل بقعة من المعمورة .

NË PËRKUJTIM TË ALIMËVE TANË

Vehbi Shatri

MULLA MEHMET EF. MAHMUTI (1893-1964)

Në historinë e arsimit dhe kulturës islame dhe kombëtare në Burim (ish-Istog) dhe më gjerë në shekullin XX, një vend të merituar zë padyshim edhe hoxha, mësuesi dhe edukatori, *Mulla Mehmet ef. Mahmuti*.

Koha kur jetoi dhe veproi ky personalitet i shquar që kohë e kthesave dhe rrethanave jo shumë të favorshme për popullatën e këtyre anëve dhe për Kosovën, në përgjithësi. Rrethanat shoqërore-politike, ndërrimi i pushteteve, secili më i ashpër se tjetri, ua vështirësuan shumë jetën shqiptarëve.

Për këtë arsye, pothuajse e gjithë barra kishte rënë mbi ulemanë e asaj kohe. Kah do të përcaktoheshin dhe kah do të drejtoheshin ulemaja, atë rrugë do ta ndiqte edhe xhemati, populli.

Është fat i mirë që në këto periudha të vështira, jetoi dhe veproi një brez i tërë i ulemave atdhetarë, të ditur e të përgatitur si në pikë-



pamje fetare, po ashtu edhe në pikëpamje kombëtare. Ishin këta burra të mëdhenj që udhëhoqën popullin, e udhëzuan dhe e mësuan atë drejt, saktë e mirë. Ishin këta dijetarë vepërmirë që nuk u luhatën në bindjet dhe pikëpamjet e tyre fetare e kombëtare, pavarësisht dhunës, torturave, provokimeve e nënçmimeve që u bënë sistemet e ndryshme dhe njerëzit e këtyre sistemeve. Falë këtij brezi të ndritur e meritëtor, vazhdoi pashkëputshëm kultura dhe tradita islame në vendin tonë.

Njëra nga ato personalitete dhe figura të rëndësishme të kësaj kohe dhe të këtij brezi, që la gjurmë në kulturën dhe traditën islame të Burimit, është edhe Mulla Mehmet Ef. Mahmuti. Për jetën dhe veprën e këtij alimi, sikundër edhe të shumë personaliteteve të tjera kombëtare e fetare të kësaj ane, nuk ka ndonjë shkrim shterues.

Prandaj, nisur nga ky fakt dhe fakte të tjera, ne mbledhëm aq sa që e mundur, të dhëna për jetën dhe veprën e Mulla Mehmetit, të cilat po i shpalosim, natyrisht pa pretenduar se do të thuhet të gjitha për këtë alim.

Mulla Mehmet ef. Mahmuti u lind më 3 janar 1893, në Pejë, nga babai *Mulla Mahmuti* dhe nëna *Merjemja*, bijë nga fshati Prilep.

Mulla Mehmeti rrjedh nga një familje me gjendje ekonomike mesatare, por me një traditë të mirëfilltë fetare dhe kombëtare, e njohur si dera e Dyl Shabanajve, që hiqnin rrënjë nga fshati Carrabreg, të Komunës së Deçanit.

Pas mbarimit të mejtepit, Mulla Mehmeti, kur i mbushi 12 vjet, u dërgua për t'i vazhduar mësimet e nisura në *Medresenë "Atik"*, në Pejë. Aty u dallua për zgjuarsin dhe edukatën. Për këtë arsye, akoma duke qenë talebe i medresesë filloi të shërbente si imam, meqë në këtë kohë i vdes i ati, i cili ishte imam në fshatin Tomoc të Istogut, prandaj Mulla Mehmeti e zëvendëson atë në të njëjtën xhami, detyrë kjo të cilën Mulla Mehmeti do ta kryejë deri edhe kur ndërroi jetë më 1964.

Medresenë Mulla Mehmeti e kishte mbaruar në vitin 1922, pra aty kishte mësuar për dhjetë vjet (1912-1922).


Mulla Mehmet ef. Mahmuti, gjatë kryerjes së detyrës së imamatit u shqua për shkathtësi dhe korrektësi, duke i bërë shumë hyzmet xha-

misë dhe xhematit. Për këtë ishte dhe mbeti njëri nga hoxhallarët më të respektuar të Istogut, emri i të cilit përmendet edhe sot e kësaj dite.

Mulla Mehmet ef. Mahmuti ishte dashamirës i arsimit, kombit dhe kulturës. Ishte i vendosur, bujar, i guximshëm, por edhe orator i mirë. “Shpesh ngrihej në këmbë kur fliste nëpër oda!” Ishte ligjërues i denjë, i matur, i afërm me xhematin, ndërkaq kur ai fliste, fjala e tij kishite peshë.

Mulla Mehmet ef., përveçse imam e hatib, ai ishte i angazhuar edhe si mualim/mësues në xhaminë e fshatit Tomoc, detyrë kjo të cilën e kreu me respekt dhe dashuri për 42 vjet me radhë. Përveç që mbante mejtepin në xhami, ai mbante mësim edhe në shtëpinë e tij, ku banonte afër xhamisë (në shtëpinë e imamatit të fshatit, siç njihej).

Për këtë detyrë, Mulla Mehmeti ishte dekretuar nga Ulema Mexhlisi i Shkupit, në vitin 1934, me dekretin nr. 1944. Për këto shërbime Mulla Mehmeti nuk merrte kurrfarë page.



Vendimi i Ulema Mexhlisit për emërimin
e Mulla Mehmet ef. Mahmutit mualim në fshatin Tomoc


Kontributi dhe autoriteti i tij dilte edhe përtej xhamisë, ku ai merrte pjesë, si në dasma, mexhlise të ndryshme, mevlude, ceremoni të varrimit, pajtim të gjaqeve e ngatërresave etj. Me një fjalim, aty ku e lypte puna, ishte edhe hoxha Mulla Mehmeti. Ai shpesh e përdorte një thënie, e cila është e njohur edhe sot: “*Shekes (ene e vjetër) meja thy rrfanen e mban ujin akoma, por me ja e thy funun ajo prishet krejt*”.

Nën juridiksionin (imamatit) e xhamisë së Tomocit, ku shërbente mulla Mehmeti, bënin pjesë edhe fshatrat: Tomoc, Lluga, Llukafci i Begut, Muzhovinë, Dobrushë, Prekallë, Gurrakoc, Kovragë, Llukafci i Thatë, Veriq, Gusar, Zallq, Dreje etj. Nëpër të gjitha këto fshatra Hoxha Mulla Mehmet ef. kryente shërbimet fetare dhe ishte i pranishëm në mexhlistet dhe tubimet e tyre.

Mulla Mehmeti shquhej ndër hoxhallarët e këtyre anëve edhe për bibliotekën e tij shumë të pasur me qitape. Pas vdekjes së Mulla Mehmetit, kjo bibliotekë kaloi në pronësi të vëllait të tij, Mulla Ali efendit, gjithashtu hoxhë dhe imam shumëvjeçar në fshatin Shushicë, të cilën e ruajti dhe e pasuroi edhe më shumë Mulla Aliu, derisa e dogjën serbët me gjithë shtëpinë e hoxhës gjatë ofensivës së vitit 1999, në Pejë. Me djegien e kësaj biblioteke shkuan për të mos u kthyer kurrë më edhe shumë dorëshkrime, libra, kronika dhe shënime për Pejën dhe Istogun, sepse ishte një bibliotekë hoxhallarësh, e trashëguar brez pas brezi nga i ati Mulla Mahmuti, të bijtë e tij, Mulla Mehmeti dhe mulla Aliu, që të gjithë hoxhallarë.

Për aq sa ka mbetur nga kjo bibliotekë dhe nga librat amë që i mbante Mulla Mehmeti, shohim se kishte një bukurshkim të rrallë, shumë korrekt dhe mjaft të lexueshëm.

Krahas detyrave të lartpërmendura, Mulla Mehmeti mbante edhe gjendjen civile për banorët e fshatrave që i përkisnin imamatit të xhemit të fshatit Tomoc. Ai në këtë detyrë ishte emëruar po nga Ulema Mexhlisi i Shkupit, në vitin 1934, me dekretin nr. 3194.




*Dekreti i Ulema Mexhlisit për emërimin
e Mulla Mehmet ef. imam ofiqar për imamatin e Tomocit*

Si imam ofiqar Mulla Mehmeti bënte regjistrimin e të lindurve, të vdekurve, të kurorëzuarve dhe të shkurorëzuarve të banorëve të fshatrave të imamatis të tij. Këto regjistrime, sikurse shihet, i ka bërë në tri gjuhë, varësisht prej ndryshimeve administrative. Deri në vitin 1939, ato janë bërë në gjuhën arabe, më pastaj në gjuhën serbe, kurse gjatë Luftës së Dytë Botërore në gjuhën shqipe.

Në mungesë të një zyreje, punën e ofiqarit Mulla Mehmeti e kryente në shtëpinë e tij, ku kishte një dhomë të posaçme, që shërbente si bibliotekë dhe si kabinet i tij. Janë ruajtur disa regjistra (defterë) të të kurorëzuarve, që ndaheshin në disa rubrika, si: numri rendor, emri i prindërit të djalit, mbiemri i djalit, vendbanimi i djalit dhe viti i lindjes.

Më pastaj vinte emri i vajzës, emri i prindërit të saj, mbiemri i saj, vendbanimi i saj, viti i lindjes së saj, sasia e meherit-pasuria si dhuratë që djali i jep vajzës/nuses sipas fesë islame. Më tutje janë rubrikat me shënimet e librit të protokollit, firma e imamit, numri i protokollit të Myftinisë, dhe në fund emrat e dëshmitarëve të aktit të kurorëzimit.



Faksimile nga Nga Libri i kurorëzimeve i mulla Mehmet ef. Mahmutit

Këto dokumente/defterë të shkruara me dorë nga Mulla Mehmet ef. Mahmuti ruhen edhe sot në Arkivin e Zyrës Civile në Gurrakoc, nga ku janë nxjerrë edhe këto faksimile.

Mulla Mehmet ef. Mahmuti ishte edhe udhëheqës i Vakëfit/Këshillit të Bashkësisë Islame të asaj kohe në Istog, siç kujton djali i tij Bahaidini, i cili thotë se në odën e Babës Hoxhë mbahej mbledhja me imamë, ku merrnin pjesë imamët e rrethit të Istogut, si Mulla Xhemajli, imam në fshatin Studenicë, Mulla Sadiku, imam në fshatin Uçë, mulla Ismeti etj.

Mulla Mehmet ef. Mahmuti shuhej edhe për një veçori tjetër, ai ishte nga ata hoxhallarë që dinte dhe merrte irtifa, dinte të bënte llogaritjen e kohëve të namazit, sipas lëvizjes së diellit.

Si përfundim, për të treguar se sa ka qenë i nderuar dhe i respektuar Mulla Mehmeti nga hoxhallarët dhe kolegët e tjerë, dëshmon edhe fakti se pas vdekjes së tij, imam në Tomoc vjen myderriz Mulla Ramush ef. Shatri (1909-1999, i vrarë nga forcat serbe), i cili kishte thënë se “unë nuk ulem në qyrsinë (vend i posaçëm nga ku hoxha ligjëron para xhemit në xhami) e kësaj xhamie, për shkak se aty është ulur dhe nga aty u ka ligjëruar besimtarëve Mulla Mehmeti, e unë Mulla Mehmetin e kam pasur mësues; unë nuk mund të ulem në vendin e mësuesit tim”. Nga kjo shihet se sa respektues mes vete kanë qenë ulemaja e kohës!

Mulla Mehmet ef. Mahmuti vdiq më 13 janar 1964, në moshën 71-vjeçare, në fshatin Tomoc, të Komunës së Istogut. Pas vetes ka lënë shtatë fëmijë, pesë vajza e dy djem.

Lusim Allahun e plotfuqishëm që të ketë pranuar veprat e tij dhe ta shpërblejë me Xhenet!

Vehbi Shatri

MULLAH MEHMET EF. MAHMUTI (1893-1964)

(Summary)

Mullah Mehmet ef. Mahmuti was a hodja and a scholar who has a distinguished place in the history of Islamic (and Albanian) culture and education in Burim and further during the XXth century.

The times in which he lived and worked were not that favorable for the people living in this area and Kosova in general. The social and political circumstances in Kosova, the change of regimes, in which the latter was even more oppressive than the former, made life for the Albanians very difficult.

ومبي شاطري

مولا محمد افندی محمود (١٨٩٣-١٩٦٤)

(خلاصة البحث)

انه في تاريخ التعليم و الثقافة الاسلامية و القومية في بوريم (الاستوغ سابقا) في القرن العشرين بلا شك يحتل العالم و المدرس و المؤدب مولا محمد افندی محمود .

ان الزمن الذي عاش و عمل فيها هذه الشخصية المرموقة لم يكن زمنا سهلا له و لشعبه في كوسوفا بصورة عامة . ان الظروف الاجتماعية و السياسية و تغيير المحتلين جعلتهم حياتهم صعبة .

REFORMAT FETARE

Abdolkarim Soroush

REFORMIMI I SHKENCAVE FETARE

1.

Dija shkencore mëton ta kuptojë natyrën, ndërsa dija fetare sheri-atin. Të kuptuarit mbështetet në hipoteza dhe kërkon një kategorizim, do të thotë, njeriu nëpërmjet aktit të të menduarit e vendos një çështje esenciale në koncepte dhe kategori universale. Këtu nuk mund të përjashtohet të kuptuarit e fesë. Pra, të kuptuarit e fesë paraprihet nga një sërë supozimesh dhe parimesh, të cilat janë kërkesa të nevojshme për kuptueshmërinë dhe interpretimin e saj.

Ky qëndrim i dukshëm "kantian" sot kuptohet më shumë se çdoherë tjetër. Por, para një shekulli, ky qëndrim jo vetëm që njihej si këndvështrim blasfemik në rrafshin fetar, madje cilësohej si një këndvështrim i dyshimtë edhe për sa i përket shkencës së natyrës. Pozitivizmi i John Stuart Mill (1806-873) dhe Francis Bacon (1909-1992) i tëri bazohet në idenë se ekzistojnë "fakte të gjalla" dhe se për t'i kapur ata mjaftojnë vetëm sy të hapur. Pra, për kuptimin e tyre na mjaftojnë vetëm sytë tanë e asnjë ndihmë tjetër. Por, zhvillimet e mëvonshme në filozofinë e shkencës vërtetuan qartë se këto "fakte të gjalla" nuk ekzistonin askund përveç se në fushat shterpë të halucinacioneve të egra të spekuluesve. Edhe në studimet e thjeshta induktive, ku ngjarjet e za-

konshme janë gjithmonë nën vrojtim, njeriu nuk mund të jetë i sigurt për listën përfundimtare të faktorëve relevantë e as për aspektet e drejta që i nënshtrohen përgjithësisht. Në të gjitha këto raste, njeriu duhet të jetë i pajisur me një skemë të paramenduar kërkimore, në mënyrë që ta dijë se prej nga duhet filluar dhe ku duhet mbaruar, çfarë duhet të përfshijë, nga çka duhet të ketë kujdes, çfarë të heqë si të papërshtatshme apo të panevojshme? Këto skema nuk janë të shenjta, ato mund të kritikohen, modifikohen, rafinohen apo edhe ndoshta ridefinohen, por ekzistojnë dy fakte absolute lidhur me to: një, shfrytëzimi i kësaj skeme në fushën e studimit dhe kuptimit është e pashmangshme dhe absolute; dhe dy, këto skema janë më të përsosura dhe më të pavarura se bota e përvojës.

Tani mund të themi se këto skema më shumë se gjithçka tjetër ndikojnë mbi tërë kontekstin e rezultatit përfundimtar të kërkimit. Paragjykimet nuk janë si katalizatorët kimikalë, roli dhe shërbimi i të cilëve fokusohet vetëm në lehtësimin e procesit së një refleksi kimik, por janë si faktorët e martesës dhe përcaktojnë interpozitën e saj, pra kush me kë të martohet, dhe sipas kësaj formohet i gjithë sistemi familjar (normal në koordinim me rrethanat dhe kushtet e paragjyksesit dhe të kohës në të cilën jeton ai).

Dallimi kryesor dhe më i rëndësishëm ndërmjet filozofisë pozitiviste dhe post-pozitiviste është se filozofët post-pozitivistë arriten të kuptojnë se nuk mund të ekzistojë vetëm vrojtimi me sy i një fakti, që nënkupton se vëzhgimi nuk mund të bëjë punën e vetëm, por pas tij duhet të qëndrojë një teori e caktuar. Me fjalë të tjera, teoritë absolutisht u paraprijnë vështrimeve, madje vetë vështrimet mbështeten në këto teori. Është interesant fakti se instrumentet shkencore të cilat duket se na sigurojnë vëzhgime dhe matje më precize (siç janë mikroskopët, pajisjet me rezonancë nukleare magnetike, etj.) nuk janë asgjë më shumë sesa supozime komplekse teorike. Këto supozime teorike janë aq të rregulluara dhe të përpikta sa që neve na mundësojnë t'i parashtrijmë natyrës pyetje dhe t'i sigurojmë përgjigjet po në këtë formë.

"Avancimi i vështrimeve krahas teorive" është një e vërtetë e shfaqur në historinë e shkencës dhe njëkohësisht edhe si një kërkesë e ne-

vojshme e metodologjisë shkencore, siç është logjika e të kuptuarit të natyrës. Ky depërtim i rëndësishëm që përshkon tërë qenien e shkencës, ka arritur t'i sintetizojë, duke i bërë pjesë të njëra-tjetrës logjikën, historinë dhe sociologjinë e shkencës dhe t'i shndërrojë ato në një tërësi të unifikuar, të quajtur filozofia e shkencës post-pozitiviste.

Në të njëjtin kuptim dhe plotësisht për të njëjtat arsye mund të thuhet se nuk ekziston asnjë tekst i vetmuar (i pastër) dhe teksti nuk e bart kuptimin e vet mbi supe. Prandaj, dhe teksti duhet t'i përshtatet kontekstit. Interpretimi i tij është fluid dhe pre-supozimet këtu hyjnë në punë po aq sa në çdo vend tjetër ku bëhet fjalë për të kuptuarit. Tekstet fetare gjithashtu nuk bëjnë përjashtim nga ky rregull. Si pasojë, interpretimi i atyre teksteve shndërrohet në subjekt të zgjerimit dhe kontraktimit sipas supozimeve që i paraprijnë apo pyetjeve që shtrohen lidhur me të. Këto supozime mund të jenë të natyrave të ndryshme, duke u nisur nga ato filozofike, historike e teologjike (kelamiste) e deri te supozimet më specifike siç janë ato gjuhësore dhe sociologjike. Këto supozime janë pjesë të "botëkuptimeve të kohës" dhe nuk zënë vend në kokë nëpërmjet arsimimit zyrtar (dhe zakonisht nuk përfitojnë në këtë mënyrë), ndërsa populli ato i shfrytëzon rrjedhshëm pa i kuptuar si duhet.

Tani, me qenë se pre-supozimet janë të lidhura me kohën në të cilën krijohen, ato mund të ndryshojnë dhe në fakt duhet të ndryshojnë. Dhe kështu dija për fenë apo shkenca e fesë - të cilat janë rezultat i të kuptuarit njerëzor - janë në ndryshim të vazhdueshëm dhe me qenë se personi vetëm nëpërmjet pre-supozimeve mund të dëgjojë fjalën e Shpalljes, atëherë kuptojmë se feja është e heshtur. Pra, interpretimi i tekstit për nga natyra është çështje shoqërore dhe varet nga komuniteti i ekspertëve (ashtu si të gjitha aktivitetet tjera shkencore) dhe kështu ai (teksti) është fluid, i ndryshueshëm dhe i pavarur nga interpretuesi në interpretues. Dhe në këtë mënyrë, këto interpretime mund të jenë të drejta, të gabuara dhe të dyshimta. Kurse vështruar nga prizmi i përsosmërisë së kësaj dijeje, mund të kuptojmë se argumentet apo faktet e paqëndrueshme apo të gabuara të dijes fetare janë po aq të rëndë-

sishëm sa dhe faktet dhe argumentet e vërteta të saj. Edhe dija fetare është vetëm një degë e dijes në përgjithësi, as më shumë e as më pak.

Rezultati i argumenteve të sjella më sipër mund të përmblihet shkurtimisht si në vijim:

1. Feja, ose me një shprehje tjetër "Shpallja" është e heshtur (e pazëshme në vete).
2. Shkenca e fesë është relative, do të thotë bazohet në pre-supozime.
3. Shkenca e fesë është kohore, sepse vetë pre-supozimet janë kohore.
4. Feja e shpallur në vetvete mund të jetë e vërtetë dhe pa kontradikta, por nuk mund ta themi këtë edhe për shkencën e fesë.
5. Feja mund të jetë e përsosur dhe gjithëpërfshirëse, por jo edhe shkenca e fesë.
6. Feja është hyjnore, por interpretimi i saj absolutisht është njerëzor dhe i kësaj bote.

Kjo pra është feja. Të gjitha këto dëshmojnë se feja gjithmonë është e rrethuar nga një mori të dhënash dhe diskutimesh, vazhdimisht duke marrë nga ajo e duke shtuar në të, interpretimi i së cilës mbetet konstant për aq kohë sa elementet e jashtme janë konstante, dhe sapo këto elemente të ndryshojnë, ndryshimi do të vërehet edhe në të kuptuarit e fesë. Prandaj, feja nuk ndryshon si pasojë e ndonjë komploti, lajthitjes së mendjes, manipulimeve jo legjitime apo interpretimeve ekstravagante. Është në fakt rezultati natyror i evolucionit njerëzor në të kuptuarit e njeriut në fushat dhe kontekstet jofetare që na detyrojnë ta kuptojmë fenë ndryshe. Dhe siç e cekëm më herët, faktorët e jashtëm janë faktorë jo vetëm për ndryshimin por edhe për qëndrueshmërinë e interpretimit fetar nëpër kohë të ndryshme.

Botëkuptimi i njeriut klasik, pikëpamjet e tij për natyrën, njeriun, Zotin, historinë, gjuhën, shoqërinë, lumturinë, sinqeritetin, arsyen, diturinë e kështu me radhë, reflektoheshin në të kuptuarit e tij për fenë. Njëjtë ndodhë edhe me njeriun modern, pra botëkuptimet e tij moderne mbi fenomenet e lartpërmendura gjithashtu ndikojnë në të kuptuarit e tij për fenë. Kështu dhe vijmë në përfundim se të kuptuarit e fesë nga njeriu klasik dhe modern është i ndryshëm dhe kjo është

arsyeja se pse duhet të ndryshojë dhe reformohet interpretimi i fesë në kohën aktuale.

2.

Ky konstatim i paraqitur edhe në "teorinë e zgjerimit dhe tkurrjes teorike të shariatit" mund të duket drejtpërsëdrejti një pjesë parësore e epistemologjisë, e cila nuk është e panjohur për hermeneuticistët dhe filozofët e shkencës. Por, ky konstatim ashtu si u shpalos më lart, ka pasur dy kritika serioze: E para, ai mund të mos u duket i besueshëm apo bindës dijetarëve që kanë mendësi historike. Këta dijetarë për të pranuar pretendimin e lartpërmendur mund të kërkojnë më shumë të dhëna historike dhe një arsyetim gjykuar sipas premisave a posteriori. E dyta, ky pretendim mund të duket si i pavërtetë madje dhe ide blasfemike për fenë. Sepse, sipas besimtarëve të vërtetë, natyra hyjnore e fesë garanton deri në pafundësi qëndrueshmërinë, relevancën dhe vërtetësinë e fesë. 'Relativiteti' dhe 'ndryshimi' janë karakteristika artificiale njerëzore, kurse aplikimi i kësaj qasjeje edhe në Shpalljen Hyjnore është tërësisht i gabuar. Për më tepër, duket sikur konstatimi në fjalë e vendos fenë në parime jo fetare (vërtetësia dhe saktësia e të cilave nuk janë të sigurta) dhe kjo rrezikon tërë mesazhin e fesë, misioni parësor i së cilës është që t'i ofrojë njeriut gabimtar një burim të pakontestueshëm sigurie dhe informimi.

Të dyja këto pyetje apo kritika, të cilat i specifikuam më lart si të meta të këtij konstatimi, janë shumë të rënda e të thella për t'i trajtuar në mënyrë të detajizuar në këtë shkrim, por megjithatë disa vërejtje janë me vend.

2-1.

Në fillim do të trajtoj pretendimin e historianëve. Konflikti midis shkencës dhe fesë në Evropë (pas shekullit 16) është një problematikë e njohur nga të gjithë. Sigurisht se nga këndvështrimi i mendimtarëve të cekët, konflikti mes shkencës dhe fesë rezultoi me eliminimin e fesë, ndërkaq shkenca në mënyrë absolute vërtetoi pavlefshmërinë e fesë dhe njëherë e përgjithmonë nxori në pah natyrën regressive të saj.

(Një mendim i tillë buron nga pozitivizmi i kulluar perëndimor). Ndërsa sipas mendimtarëve më seriozë (fetarë apo jofetarë) dhe sipas këndvështrimit epistemologjik, ky konflikt që një rast i volitshëm që nxori në shesh natyrën e vërtetë të këtyre dy rivalëve të moçëm, të cilët kishin arritur të krijonin epoka në vete (epoka e mëhershme kur mbizotëronte feja dhe epoka moderne, ku filloi të mbizotëronte shkenca). Kjo ngjarje gjithashtu vërtetoi se klerikët, d.m.th., personat të cilët seriozisht gjendeshin në pozitën e të kuptuarit të fesë) bujarisht dhe jo qëllimshëm shfrytëzonin botëkuptime mesjetare dhe para mesjetare për të interpretuar 'drejt' Librin e Shenjtë dhe sigurisht që ata nuk mund të vepronin ndryshe. Ata duhej ta shfrytëzonin këtë mirësi dhe ta kuptonin (ashtu siç e kuptuan dhe më vonë) se ekziston edhe një sistem i ri i pre-supozimeve dhe feja mund të kuptohej në koordinim me këtë sistem të ri të dijeve dhe në përshtatshmëri me mendësinë që mbizotëronte. Në këtë mënyrë dhe filloi procesi i ri i interpretimit dhe ashtu siç e dimë edhe sot, fenë filluan ta kuptonin duke u përqendruar në arritjet e reja shkencore jashtë fushës së fesë. Sigurisht që kjo çështje nuk kishte të bënte vetëm me atë se ata kuptuan për shembull përkthimin e gabuar të disa fjalëve nga gjuhët surjanite dhe greke. Por, diskursi fokusohet në gjuhën e fesë, pritjet e njeriut modern nga feja, e gjëra si këto, ku të gjitha ishin rezultat i hapave reformistë që në atë kohë ishin hedhur nga mendimtarë të mëdhenj të kohës. Secili nga këta diskurse dëshmonte saktë se sa i varur është interpretimi i tekstit me pre-supozimet dhe besimet/bindjet e mëhershme të besimtarëve. Pra, këtu duhet të kemi parasysh se në atë kohë për interpretuesin nuk mjaftonte që të sillte vetëm një interpretim të drejtë të tekstit, por ai duhej që interpretimin e tij ta koordinonte me mendësinë që mbizotëronte në atë shoqëri. Në qoftë se ndonjëri dyshon në këtë pretendim, atëherë të kthehet në histori dhe të shohë se të gjithë mendimtarët seriozë kanë vepruar në këtë mënyrë. Për shembull, mund të sjellim iranianin Sadrudin Shirazi (Mulla Sadra) (1572-1640) dhe ndjekësit e tij, të cilët me të vetmen gjë që krenohen është se arritën të sintetizojnë shariatin, filozofinë dhe misticizmin apo thënë më qartë, arritën të mishërojnë Arsyen (akl) me Shpalljen (vahj).

Si mund të realizohet ndryshe kjo gjë përveçse duke interpretuar rishtazi sheriatin brenda kornizave dhe parimeve të filozofisë? D.m.th., duke e vendosur sheriatin në kategoritë e filozofisë. Është e mundur që dikush të mendojë se esenca e kësaj përpjekjeje të Sadrudin Shirazit (pra pajtimi i Arsyes me Shpalljen) prejardhjen e ka në argumentimin racional të bindjeve fetare. Nëse këtij problemi i qasemi nga ky prizëm, atëherë do të thotë se borisë i kemi fryrë nga prapa. Për të argumentuar dhe vërtetuar një çështje fetare në formë racionale, individi njëherë duhet ta racionalizojë atë çështje, pra ta shpalosë në atë formë që arsyeja të mund ta vërtetojë me fakte racionale. (do të thotë, para se fenë ta argumentojë me filozofi, atë ta kuptojë filozofikisht). Si shembull mund të sjellim 'ringjalljen shpirtërore' në botën tjetër. Sadrudin Shirazi tepër qartë thotë se nuk i ka hije një filozofi të vërtetë që të mjaftohet me bindjen e zakonshme fetare rreth 'ringjalljes shpirtërore', por ai duhet të përpiqet të ketë një perceptim racional për ringjalljen. Për shembull, ai duhet të sjellë një definicion aristotelian për trupin, sipas të cilit, trupi përbëhet nga 'forma' dhe 'materia' dhe gjithashtu të vërtetojë edhe filozofinë e Sadrudin Shirazit se 'forma' është elementi përbërës i identitetit të sendit, e jo materia e saj. Vetëm me një qasje të tillë, filozofi mund të justifikojë në mënyrë racionale dhe metafizike 'ringjalljen shpirtërore' në botën tjetër. (pra të thotë se trupat në botën tjetër do të ringjallen vetëm në formë e jo në materie). Thënë ndryshe, kuptimi filozofik i tekstit sjell dhe miratimin apo interpretimin filozofik të tij.

Pajtueshmëria e dëshiruar mes fesë dhe filozofisë nuk mund të realizohet ndryshe përveç se njëra prej tyre të marrë ngjyrën e tjetrës; pra feja të vendoset në konjektura filozofike (apo më saktësisht të arrihet një kuptim filozofik i tekstit fetar). Vetëm në këtë formë mund të përfitojmë një pajtim midis fesë dhe filozofisë. Sipas po kësaj qasjeje, edhe kuptimi i fesë në kornizën e koncepteve mistike gjithashtu mund të jetë një hyrje për aprovimin ose justifikimin mistik të fesë, e kështu me radhë.

Islami mistik dhe Islami filozofik janë dy lloje të Islamit, dhe deri më tani kanë qenë më të artikuluar dhe më të rafinuar sesa të tjerët.

Por në praktikë, dukshëm ka lloje të panumërta të Islamit, e që të gjithë ndajnë të njëjtin funksion dhe kanë dukje të njëjtë: pra janë në koordinim dhe në balancë me sistemin e besimit dhe mendësisë së shumicës absolute të besimtarëve. (Diskutimi për të mirat dhe të këqijat e kësaj islamistike qëndron jashtë trajtesës që jemi duke e zhvilluar këtu). Tani në qoftë se fokusohemi në kontestimin e vlefshmërisë apo jovlefshmërisë së këtyre interpretimeve mistike dhe filozofike të Islamit, nuk do të ishte tjetër pos lajthitje nga qëllimi. Këto interpretime janë pjesë dhe momente të historisë së fesë. Në fakt, shkenca është një përzierje idesh të sakta dhe të gabuara. Pa marrë parasysh faktin se secili shkencëtar përpiqet të sigurojë fakte dhe ide të vërteta, por megjithatë shkenca nuk i kapërcen besimet dhe opinionet individuale të këtij apo atij shkencëtari të caktuar. Shkenca përveçse mund të ketë rezultate të vërtetuara dhe të faktuara, por gjithashtu nuk mund të thuhet saktë se ajo nuk ka gabime, keqkuptime, hipoteza të dyshimta, argumente dhe kundërgjegjësi. Në qoftë se shohim vetëm anën pozitive të këtij rrëfimi, atëherë do të thotë se kemi shtrembëruar historinë. Vetëm në shkencë humbjet (gabimet, hipotezat e dyshimta, etj.) janë po aq të rëndësishme sa fitoret (rezultatet shkencore), dhe që të dyja kanë të njëjtën vlerë shkencore. Për ta përsëritur edhe një herë, shkenca e fesë gjithashtu nuk bën përjashtim nga ky parim i shkencës.

Tjetër shembull mund të paraqesim faktin e 'Komentimit sipas opinionit' (Tefsir bi'rej), i cili nënkupton komentimin e Kur'anit, duke u mbështetur në opinione, mendime dhe dëshira personale të komentuesit. Myslimanët janë këshilluar të qëndrojnë sa më larg këtij komentimi, madje kemi edhe hadithin që thotë se ata individë që komentojnë sipas opinionit të tyre personal, në botën tjetër do të digjen në zjarrin e xhehnemit. Megjithëse asnjëherë nuk gjetën fundin mos-pajtimet e komentuesve të Kur'anit lidhur me idenë e 'komentimit sipas opinionit'. Të gjithë komentuesit në komentimet e tyre pretendojnë se nuk kanë ndjekur një rrugë të tillë dhe i akuzojnë komentuesit tjerë se kanë komentuar sipas opinionit personal. Dhe me të vërtetë është kështu, sepse nuk është e mundur që një komentues i Kur'anit, qoftë kjo edhe pa dëshirën e tij, të mos ndjekë opinionin apo percepti-

min e tij personal gjatë komentimit. Askush deri më sot nuk e propozoi një zgjidhje për këtë problem. Kjo dëshmon se sa problematike është kjo çështje. Në epokën tonë objekt i sulmeve të tilla qe edhe Al-lame Tabatabai (1903-1981), megjithëse ai në parathënie të 'Tefsir El Mizan', thotë se gjatë komentimit nuk është mbështetur në opinionin e tij individual.

Do të ishin sugjerime të perealizueshme ato sugjerime qëllimmira të disa intelektualëve modernë që deklarojnë se për të qenë individ komentues objektiv i Kur'anit duhet ta pastrojë trurin nga të gjitha mendimet dhe idetë e mëparshme dhe veçanërisht nga përmbledhja e fjalëve dhe rregullave gramatikore. Është e pamundur të realizosh një sugjerim të tillë, për arsye se vetë historia e fesë na dëshmon se askush nuk ka arritur ta aplikojë një metodë të kështillë. Mbi të gjitha, ky nuk mund të jetë një sugjerim ideal, sepse paralizon tërë procesin e komentimit. Individui nuk mund të qëndrojë i paanshëm dhe të mos prononcohet mbi atë se ka apo jo alegori dhe metaforë në fjalët e Zotit? Nuk do mend se këtë qëndrim nuk mund ta huazojë nga vetë tekstet fetare. Prandaj, pozicionimi pro apo kundër metaforave dhe alegorive në fjalët e Zotit janë dy mendime dhe opinione që duhet t'i ketë komentuesi para se t'i qaset komentimit të Kur'anit.

Atëherë si duhet ta kuptojmë këtë vërejtje se 'komentimi i Kur'anit duhet të jetë objektiv dhe larg opinioneve individuale? A nuk mbështeten gjithë komentimet e Kur'anit në një teori të caktuar? Në qoftë se është kështu, a s'do të ishte më mirë që këtë vërejtje ta kuptojmë në këtë mënyrë që (është e pamundur të mos shfrytëzohen opinionet dhe teoritë jashtë fetare, por) komentimin tonë të mos e mbështesim në teori të padëshmuara dhe pavërtetuara shkencërisht? Përgjigjja është pozitive. E gjithë kjo duhet kuptuar në këtë mënyrë. Pra, përsëri çdo gjë është e lidhur dhe varet nga teoritë, opinionet dhe rezultatet jashtë fesë.

Tabatabai në Tefsirin e tij shkruan se kelamistët, filozofët, mistikët dhe reformistët janë katër grupe, të cilët nuk përpiqen të nxjerrin kuptimet e sakta të fjalëve në Kur'an, por opinionet e tyre individuale ia atribuojnë Kur'anit dhe në këtë mënyrë ata bëjnë interpretimin

(te'vil) e tij. Pra ata, ajetet e Kur'anit i koordinojnë me opinionet e tyre (interpretimi është pozita më e lartë e komentimit sipas opinionit). Ai, veçanërisht për reformistët pohon se ata edhe fjalët si 'arsh', 'levh' dhe 'kalem' i interpretojnë si fjalë që nënkuptojnë sende materiale, pra të prekshme.

Në vazhdim ai thekson se të gjitha këto metodologji kanë të njëjtën të metë serioze: të gjithë pjesëtarët e këtyre grupeve përpiqen që mendimet shkencore e filozofike jashtë fesë t'i imponojnë ajeteve kur'anore dhe në këtë mënyrë një pjesë të kuptimeve reale dhe jofigurative të fjalëve i shndërrojnë në kuptime alegorike e figurative dhe kështu nëpërmjet interpretimit (te'vil), ajetet e Kur'anit i bartin në kuptime jo të drejtpërdrejta dhe të largëta.

Metodologjia e tij, siç thotë edhe ai, është ballafaqimi i një pjese të tekstit me një pjesë tjetër të tij, në mënyrë që kuptimi të njihet apo krijohet nëpërmjet qasjes hermeneutike (kjo tingëllon sikur gjoja në metodologjinë e tij nuk vërehet asnjë supozim). Ai gjithashtu në parathënien e tij kërkon që gjuha e Kur'anit të mos bartet pa masë në kuptime materiale të fjalëve, ngase as materialiteti e as struktura aktuale e sendit nuk janë nxjerrë nga kuptimi i fjalës. Fjalët, para se deri te ne të bartin kuptimin material dhe aktual të sendit, bartin kuptimin e shërbimit dhe dobisë së sendit. (tavolinë është ai send që shërben punën apo që ka dobinë e tavolinës, e jo tavolina që kemi ne sot, e gjëra të tilla si kjo). Si shembull mund të paraqesim fjalën 'peshore'. Në kuptimin e parë të kësaj fjale nuk kuptojmë dhe 'sahanin' e peshores, madje edhe peshoret digjitale quhen peshore. Ka mundësi që gjeneratat e mëvonshme të kenë një parafytyrim krejt ndryshe për peshoren, lloje të saj të cilat njeriu i sotëm nuk mund t'i shohë as në ëndërr. Andaj, nuk është me rëndësi se prej çfarë është prodhuar dhe si punon ajo peshore, por të peshojë dhe të kryejë punën e peshores. Sipas këndvështrimit të Tabatabaiut, nëse marrim parasysh këtë kuptim, na krijohen mundësitë t'i kuptojmë fjalët në Kur'an si 'el Mizan' (peshorja), 'levh', 'arsh', etj. dhe të mos përsërisim gabimet e kelamistëve dhe muhadithëve shkurtpamës, të cilët, kuptimet e fjalëve kur'anore i bartin në sende materiale dhe të zakonshme. Padyshim se ky mendim

është huazuar nga Imam Gazaliu (1058-1111), të cilin e ndoqën Mevlana (1207-1273) dhe Fejz Kashani (v. 1680). Gazaliu në librin 'Mishkatul Envar' thekson se, për shembull, me fjalën 'nur' duhet kuptuar 'dritën' jo materiale, (dritën e padukshme), ndërsa bartja e kuptimit të kësaj drite në kuptimin e dritës që ne e shohim, është figurative. Kurse kontestimi i këtyre konkluzioneve është tërësisht i parëndësishëm. Ajo që ka rëndësi këtu, nga një këndvështrim i favorshëm i epistemologjisë, është që të vëmë re se supozimet e mëdha që u shtruan deri këtu. Gjithashtu dhe dëshmia e njërit prej komentuesve më të njohur të dekadave të fundit, i quajtur Tabatabai, lidhur me historinë e tefsirit (dhe tërë historisë së fesë), i cili, mistikëve, filozofëve, kelamistëve dhe modernistëve u drejton akuza të rënda dhe të paqëndrueshme shkencërisht. Duke modifikuar termat dhe tonin ne mund të vijmë në përfundim se: Shkenca e fesë gjatë gjithë historisë ka qenë prodhim dhe riprodhim i komentuesve të ndryshëm të fesë dhe Kur'anit, dhe gjithnjë është rindërtuar po nga vetë ata. E kjo do të thotë se feja nuk është diçka më shumë sesa historia e dijes së fesë ose diçka më shumë se shkenca fetare.

Kështu dhe arrijmë në rezultatin se komentuesit gjatë gjithë historisë kanë bërë përpjekje të singerta që komentimin e Kur'anit ta pastrojnë nga mendimet jashtë tij, por këto përpjekje shumë qartë rezultuan në dështime të papara. Ndërsa ikja nga mendime të tilla (mendimet jashtë kur'anore) gjatë procesit të komentimit është e pamundur, qoftë në rrafshin praktik qoftë në atë epistemologjik. Thënë ndryshe, kjo pamundësi në rrafshin praktik buron nga pamundësia në rrafshin epistemologjik.

Një shembull tjetër që ndihmon në qartësimin e pretendimit tim mund të paraqesim edhe njëherë komentuesin e lartpërmendur Al'lame Tabatabai, i cili gjithashtu është dhe një njohës i nivelit të lartë i metafizikës. Ai me çdo kusht përpiqet të argumentojë se Kur'ani vërteton dhe mbështetë natyrën e shkakësisë. Ndërsa nga ana tjetër, Mevlana Xhelaledin Rumi mbron qëndrimin krejtësisht të kundërt dhe thotë se Kur'ani neve na mëson refuzimin e 'shkakësisë'.

Pejgamberët erdhën të thyejnë shkakësitë

I hodhën në saturn mrekuellitë

Kur'ani zbriti për thyerjen e shkakësisë

Për dinjitetin e dervishit dhe shkatërrimin e Ebu Lehebit

Pra nga fillimi deri në fund të Kur'anit

Shohim refuzimin e shkakut e sebebit.

Një shembull tjetër është dhe kritika e Tabatabai që ia drejton Muhamed Baker Mexhlisit (1616-1698). Mexhlisi ishte muhadithi më i madh i shekujve 16 dhe 17, i periudhës së safavidëve. Ai mbledhi hadithet në koleksionin prej 110 vëllimeve të quajtur 'Biharul Anvar'. Mexhlisi ishte kundërshtar i filozofisë dhe doli kundër përdorimit të fjalëve si 'ruh' dhe 'nefs' në kuptime metafizike. Prandaj, dhe Tabatabai kritikoi qëndrimet e tij, në këtë rast jo në kuptimin e vërtetë të fjalëve të sipërpërmendura, por rreth një fakti që ia atribuonte Mexhlisit, pra se gjuha e fesë u drejtohet vetëm shtresave të ulëta të popullit. Sipas Tabatabai, një mendim i tillë për gjuhën e fesë nuk qëndron, ngase një pjesë e fjalëve të Pejgamberit të Zotit u dedikojë gjithashtu elitave. Kështu dhe personi, këto fjalë duhet t'i vështrojë me një parapërgatitje të nivelit të lartë shkencor dhe filozofik. Tabatabai është i mendimit se refuzimi i filozofisë nga Mexhlisi rezultoi në kuptimin dhe interpretimin e gabuar e tepër të thjeshtë të teksteve më të sofistikuara islame.

Çështja e muteshabihat (homogjeniteteve) është edhe më e qartë se shembujt e mësipërm. Sipas ajetit 7 të sures Ali Imran, ajetet e Kur'anit ndahen në dy grupe: muhkemat (ajetet me kuptime të qarta) dhe muteshabihat (ajetet me disa kuptimësi). Kjo ndarje bëhet duke u mbështetur në ajetet, të cilët mund të kenë më tepër se një kuptim dhe në ajetet që kanë vetëm një kuptim. Rrallë janë ato ajetet si ky, për të cilin ekzistojnë mospajtime dhe divergjenca të shumta. Strumbullari i polemikave të komentuesve të Kur'anit sillet rreth këtyre dy pikave: e para është se cilat janë kuptimet e sakta të këtyre termeve, dhe e dyta, cili është qëllimi dhe sekreti i këtyre ajeteve 'të paqarta' që iu zbritën të dërguarit të Zotit?

Për pikën e parë, disa studiues thonë se vetëm shkronjat e para të disa sureve janë muteshabih (të paqarta), ndërsa ajetet tjera janë të kuptueshme dhe bartin vetëm nga një kuptim. Disa të tjerë vënë theksin se vetëm ajetet që rrëfejnë për botën tjetër dhe cilësitë e Krijuesit janë me shumëkuptimësi. Disa të tjerë theksojnë se vetëm ato ajete që flasin për parime dhe rregulla praktike duhet të llogariten prej ajeteve muhkemat (me një kuptimësi). Pra, mbi këtë çështje mund të jepen mendime të ndryshme.

Kurse për pikën e dytë, pra lidhur me atë se pse Kur'anit ka ajete të pakuptueshme ose me shumëkuptimësi janë hedhur mendime dhe hipoteza të çuditshme. Më poshtë do t'i përmendim vetëm disa prej tyre:

1. Ajetet muteshabih janë zbritur me qëllim që t'i dallojnë besimtarët nga mosbesimtarët. Besimi nuk mund të jetë ndryshe pos në mënyrë të adhurimit. Besimtarët besnikë pranojnë të gjithë ajetet e Kur'anit, madje edhe nëse disa prej tyre mund të mos jenë të kuptueshme. Ndërsa jobesimtarët mbështeten në arsyen e tyre dhe kështu refuzojnë konceptet gjysmë të ndriçuara dhe të paargumetuara.
2. Këto ajete janë vetëm mekanizma për të zgjuar kërshërinë dhe zhvilluar mendjen e njeriut, sepse mendja është shumë e respektuar dhe e pranuar te Krijuesi. Pra, ky është sekreti i këtyre ajeteve dhe përgjegjësinë që myslimanët e kanë për ta.
3. Ajetet muteshabih tërheqin zemrat e sëmura drejt Kur'anit, me qëllim që individët e tillë në Kur'an t'i kuptojnë qëllimet e tyre djallore. Por, ndonjëherë mund të ndodhë që ata të gjejnë rrugën e vërtetë të Zotit. Ata, gjithashtu, duke e lexuar tërë Kur'anin (ajetet muteshabih dhe muhkem) mund të ndriçojnë zemrat dhe kështu të gjejnë rrugën e vërtetë.
4. Feja dhe Shpallja u drejtohen të gjithë njerëzve, qofshin ata të shkolluar apo të pashkolluar. Për atë dhe disa ajete duhen të jenë të kuptueshme lehtë dhe disa të tjera të jenë më të sofistikuar dhe të thellojnë dimensionin intelektual të njerëzve të shkolluar.

Siç e shohim, asnjëra nga hipotezat e lartpërmendura nuk e konsideron të nevojshëm interpretimin e tekstit dhe të gjithë e heshtin një

çështje tepër të rëndësishme. Kjo çështje është se prezenca e ajeteve me shumëkuptimësi rrjedh nga vetë natyra e të kuptuarit të tekstit. Pra, ajetet vetvetiu nuk janë të pakuptueshme apo nuk kanë shumë kuptime, por pakuptimësia apo shumëkuptimësia e tyre lind gjatë procesit të komentimit apo interpretimit. Duhet thënë se teksti i Kur'anit në vetë është i kuptueshëm dhe sigurisht që bart një kuptim, por janë komentuesit ata të cilët gjatë komentimit nxjerrin kuptime të ndryshme dhe shumë herë dhe kontradiktore. Një gjë e tillë nuk ka të bëjë vetëm me Kur'anin, por edhe me shumë tekste tjerë, qofshin ata fetarë apo jofetarë. Prezenca e këtyre ajeteve me shumëkuptimësi është edhe shkak edhe pasojë e zgjerimit dhe tkurrjes teorike të dijes fetare. Kur të studiojmë me kujdes të veçantë procesin e kuptimit të tekstit (i cili gjithmonë ndjek një supozim të një hipoteze të caktuar), do ta kuptonim saktë kuptimin dhe arsyen e ajeteve muteshabih në Kur'an. Është interesant fakti se Kur'anit nuk na ofron asnjë mekanizëm apo udhërrëfyes që të kuptojmë mënyrën se si t'i përcaktojmë ajetet muteshabih dhe t'i klasifikojmë ato nga ajetet tjera. Historia e Islamit na tregon se myslimanët të gjithë ajetet e Kur'anit mund t'i kenë llogaritur si muteshabih. Dhe kjo qasje na bindë edhe më shumë se ekzistenca e ajeteve muteshabih rrjedh nga natyra e komentimit apo interpretimit dhe është një lloj hipoteze të cilën njeriun e pranon para se t'i hyjë komentimit të Kur'anit.

Por, disa teologë (mutekellim) mendojnë ndryshe. Sipas tyre, përmbajtja e Shpalljes (Kur'anit) ndahet në dy pjesë: esenciale dhe aksidentale. Përmbajtja aksidentale rrjedh si kërkesë apo nevojë e ambientit kulturor, shoqëror dhe historik të Shpalljes, dhe më përgjithësisht këto pikëpamje konsiderohen përtej fushës së caktuar të pritshmërisë që kemi për fenë. Ka shumë hadithe që lidhen me shqetësimet e Profetit lidhur me trajtimin e sëmundjeve, por në të vërtetë askush nuk i merr ato si esenciale në Islam, sepse këto nuk janë çështje për të cilat njerëzve u nevojitet Profeti. Njerëzit nëpërmjet gjykimit dhe studimit mund të gjejnë ilaçe dhe diagnostifikime për sëmundjet. Nëse është kështu, atëherë çfarë të themi për filozofinë, ekonominë, politikën e kështu me radhë? Disa nga pyetjet janë shumë vendimtare dhe deba-

tohen fort në mesin e intelektualëve myslimanë, por çështja kryesore shpesh ngelet e paprekur apo e pa diskutuar. Këta probleme nuk mund të zgjidhen, duke u bazuar në fakte historike apo tradicionale. Përkundrazi, tradita dhe historia duhet të kuptohen nëpërmjet këtyre zbulimeve dhe arritjeve shkencore.

Trajtimi i këtyre problemeve kërkon një qasje të mirëfilltë filozofike, politike, sociologjike dhe historike dhe këto i japin shkencës së fesë ngjyrën e kohës kur janë prodhuar. Dhe gjithashtu e kuptojmë se përse ixhtihadi i vërtetë në rrafshet si fikhu nuk mund të jetë produktivë pa u realizuar fillimisht një ixhtihad me parime fillestare. Kjo tregon se përse viteve të fundit jurisprudenca fetare në shoqëritë islame ka qenë aq e stagnuar. Nuk është për shkak të mungesës së dinamizmit në fikh, sepse shkenca e fikhut është 'konsumuese' dhe stagnimi i kësaj shkence rrjedh nga stagnimi i disiplinave të tjera që janë 'prodhuuese', si ekonomia, filozofia politike dhe sociologjia. Këto përbëjnë arsyet kryesore të stagnimit. Ndërsa tregimi i arsytimit me siguri është tjetër. Tash këtu duhet ta kuptojmë edhe më mirë statusin dhe rëndësinë e rizgjimit dhe intelektualizmit fetar. Thënë më saktë, rizgjimi mund të perceptohet në dy kuptime: rizgjimi i grimuar dhe i modifikuar.

Rizgjimi i grimuar përbëhet nga spastrimi i të kuptuarit aktual të fesë nga elementë të huaj, duke riaktualizuar dhe duke i vënë në vend dimensionet e neglizhuara të fesë. Një shembull për këtë është pa dyshim Imam Gazaliu. Ndërsa rizgjimi i modifikuar nga ana tjetër, është më i vëmendshëm dhe merret më së shumti me faktorët dhe elementet e jashtme të fesë dhe tekstit. Kërkon një kuptim të fesë sipas rezultateve dhe të vërtetave kohore të shkencës dhe dijes në përgjithësi. Përfaqësuesi më i denjë i këtij orientimi është Muhamed Ikbali, synimi kryesor i të cilit ishte vënia në pah e dominimit grek mbi kulturën islame. Të dyja këto qasje i shërbejnë qëllimit të njëjtë, sigurisht, për ta mbajtur gjallë dhe aktual mesazhin fetar. Dallimi është se në rizgjimin e modifikuar, qasja filozofike - shkencore është çështje parësore, ndërsa në rizgjimin e grimuar, kjo qasje ishte dytësore.

Kjo më sjell mua në fund të trajtimit tim të kritikës së parë. Por, para se ta kaloj këtë çështje, do të doja të theksoja se reformimi i interpretimit të fesë, për të cilën kemi më së shumti nevojë në kohën tonë, nuk mund të jetë i suksesshëm pa qenë vigjilent ndaj ndryshimeve të vazhdueshme në rrafshet e shkencës, dijes dhe mendimit. Nuk na sjellin asnjë dobi dhe të mirë parullat si: "rikthimi në rrënjë apo burim", "të promovojmë burimet dhe referencat e lëna anash" apo "të gjejmë një udhëheqës trim e largpamës". Nuk mund të reformojmë mendimin apo interpretimin e fesë pa ndryshuar hipotezat tradicionale, dhe nuk mund të kemi reformim pa njohur thellësisht fenë dhe mendimet e teoritë e reja jashtë sferës së fesë. Të vërtetat e zbuluara brenda dhe jashtë Shpalljes do të ekuilibrohen herët ose vonë. Për ta luftuar stagnimin dhe prapambetjen e brendshme duhet të ndryshojmë dhe t'i aktualizojmë burimet dhe referencat e jashtme. Të kuptuarit regresiv dhe i prapambetur i teksteve të Shenjta nga ana e myslimanit ka ardhur si pasojë e dekadencës dhe prapambetjes urisë kulturore, shoqërore dhe civilizuese dhe jo anasjelltas.

2-2.

Tani duhet të flasë për temën e dytë, e cila ka të bëjë me akuzën se gjoja pretendimi im rezulton në eliminimin e shenjtërisë së tekstit dhe si pasojë, mesazhi i përjetshëm i tij sakrifikohet nga fantazitë dhe hamendjet e aktualitetit dhe në këtë mënyrë minohet bindja e plotë e besimit (imanit).

Do të ishte mirë që ta filloja me një dialog të zhvilluar mes meje dhe një mikut tim, i cili ma shtroi këtë pyetje: "Cili është mendimi juaj për islamizimin e shkencës?, dhe pastaj me humor shtoi: "më duket se ti preferon shkencëzimin e Islamit në vend të islamizimit të shkencës?" "Asnjëra nga këto. Unë kam zgjedhur humanizimin e fesë." - iu përgjigja. Në fakt dhe kjo është themeli i teorisë sime 'Zgjerimi dhe turrja teorike e sheriatit'. Feja e shpallur, sigurisht se nuk mund të jetë fenomen njerëzor, por këtë nuk mund ta themi edhe për shkencën e fesë, e cila vjen si pasojë e konstruktimit dhe parashikimit njerëzor nga brenda dhe nga jashtë.

Racionalizmi, paragjykimi, egoizmi, kërkimi i së vërtetës, prirja për të harruar, lakmia, gabueshmëria, animi, vetëkënaqësia, ngadalësia, interesi, e të tjera me radhë, të gjitha në një mënyrë apo në një tjetër kanë ndikim në shkencën e fesë. E vërtetë, Shpallja është hyjnore, por a është hyjnor edhe interpretimi i Shpalljes? Interpretimi mund të jetë hipotetik, i gabueshëm, i ndryshueshëm, i pjesshëm, i gabuar, i njëanshëm, i devijuar, me paragjykime e i ndikuar nga kultura apo i paplotë, por vetë Zoti ka dashur që të ndodhë kështu. Ne jemi qenie njerëzore të gabueshme dhe kjo është e vërtetë. Rasti i fesë nuk është i ndryshëm nga rasti i natyrës. Edhe ajo është e nënshtruar ndaj njerëzimit. Nuk ka shkencë njerëzore të shenjtë dhe shkenca e fesë nuk bën përjashtim. Por natyrisht, Shpallja në vetvete bën përjashtim. Ndarja Shpallje - interpretim duhet të mbetet e paprekur. Jemi të gjithë të zhytur në një oqean interpretimesh, dhe gjithsecili mundohet të sjellë interpretimin e saktë. Për të kuptuar qëllimin e vërtetë të Shpallësit (Zotit) është një ideal drejt të cilit shkojmë të gjithë ne së bashku, por në fund kuptojmë se qëllimi i vërtetë i Tij ka qenë vetë përpjekja e njerëzimit.

Nuk po e themi këtë për ta ç'shenjtëruar të shenjtën apo për ta shenjtëruar fenë, por kjo është instanca më e thjeshtë dhe në të njëjtën kohë më delikate e natyralizimit të supernatyrës, apo nëse ju pëlqen të themi manifestim i supernatyrës në natyrale. Qasja sekulare ndaj metafizikës është e verbër, por ne këtu interpretimin njerëzor të tekstit e kuptojmë si Rishpallje e zbritur vetëm për ne! Në të kaluarën Shpallja i ka zbritur Muhamedit a.s., kurse tani ne nëpërmjet engjëllit të arsyës kohore e zbresim nga pozita e tekstit në pozitën e interpretimit. Me fjalë të tjera, ne nëpërmjet interpretimit Shpalljen e shohim njëjtë si një shkencëtar besimtar që e sheh natyrën si një vepër arti të Krijuesit. Nuk kemi bërë progres në fakt, por evolucioni me siguri është i garantuar.

Tani nga ky këndvështrim epistemologjik, besimi shihet si një angazhim i madh i besimtarëve për ta marrë fjalën e Zotit me seriozitet dhe për ta interpretuar atë me sinqeritet dhe në vazhdimësi, në mënyrë që të fitojmë udhërrëfime për jetën e tyre si para ashtu edhe pas vde-

kjes. Besimi është gjithmonë personal dhe privat, mund të jetë më pak apo më shumë i sinqertë, por dituria nuk mund të jetë ndryshe vetëm se kolektive, publike, e drejtë ose dhe e gabueshme.

Një qasje më e thellë në dije dhe shkencë na tregon se besimi i drejtë i besimtarëve është formuar sipas interpretimit të Shpalljes nga ana e tyre. Kështu dhe karvani i dijes i inspiruar nga të gjitha llojet e kompleksiteteve dhe kontradiktave po shtrembëron misionin e saj (dijes) fisnik. Por këto polemika, mospajtime dhe mendime të ndryshme nuk duhen të shkaktojnë urrejtje dhe armiqësi mes besimtarëve. Neve nuk na mbetet tjetër vetëm se të besojmë. Ja se çka na këshillon Mevlana Rumi:

*Tregtari frikacak me shpirt xhami
S'do as të fitojë e as të humbë
Kështu ai humbës është, e i poshtëruar
Do të fitonte dritë, nëse do të rrezikonte
Sepse gjithë të mirat gjenden në rrezikshmëri
Po ti zgjidhe rrugën e fesë, e shpëto
Nuk mund të bëhet tjetër gjë, pos
Të shpresohet në Zotin e Gjithëdijshëm*

Po të kuptohet kjo këshillë, do të hapet rruga për demokraci fetare dhe perceptim unik të feve hyjnore, të cilat na çojnë në pluralizëm fetar. Kjo do të sillte dy frute nga kjo pemë e mbarë.

A nuk ke kuptuar se si All-llahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë në tokë e degët e saj janë lart. E që me vullnetin e Zotit, ajo u jep frytin e vet në çdo kohë. All-llahu pra u parashtron njerëzve shembuj ashtu që ata të mendojnë. (Kur'an, Sureja Ibrahim, 24-25)

*Përktheu:
Abdulla Rexhepi*

Abdolkarim Soroush

REVIVAL OF RELIGIOUS SCIENCES

(Summary)

The science of nature is a human endeavor to understand the nature, and the science of religion is a human endeavor to understand religion. All understanding assumes suppositions and entails "categorization," that is subsuming the particular under universal categories and concepts. Understanding religion is no exception. It is preceded by certain assumptions and principles which are necessary conditions for its intelligibility and interpretation.

عبد الكريم سوروش

اصلاح علوم الدين

(خلاصة البحث)

ان المعرفة العلمية هدفها معرفة الطبيعة و معرفة الدين يهدف الى معرفة الشريعة الفهم يعتمد على فرضية و هو يحتاج الى تصنيف هذا يعنى بان الانسان من خلال عملية التفكير يضع شيئا مهما في مفاهيم و تصانيف عامة. هنا لا يمكن استثناء مفهوم الدين. مفهوم الدين سابق من مجموعة من الافتراضات و المبادئ التي تعتبر مطالب مهمة للفهم و التفسير

PORTRETE

Mr. Skënder R. Hoxha

MEHMED AKIF ERSOJ Të dhëna për jetën dhe aktivitetin letrar

Mehmet Akif Ersoj, u lind në fund të vitit 1873, në shtëpinë e familjes së vet që ndodhej në lagjen “Sarëgyzel” të zonës Fatih, në Stamboll. Data sipas kalendarit hixhri, sheval 1290, rastis mes datave 22 nëntor - 20 dhjetor 1873.

Ndonëse i ati i vuri emrin Ragëj, të afërmit dhe njerëzit e lagjes që s’u mësuan dot me shqiptimin e këtij emri të padëgjuar, të gjithë filluan ta thërrisnin Akif (Aqif) dhe kështu i mbeti emri, përveç babait që e thërriste me emrin e tij.

I ati i tij, ishte ardhur në Stamboll, në moshë të re nga fshati Shushicë i Kazasë së Pejës (Kosovë) për t’u shkolluar. Ai ishte Tahir Efendi (1826-1888), myderriz në medresenë Fatih, kurse e ëma, Emine Sherihe Hanëm (1836-1926).

Mehmet Akifin, në fillim të muajit shkurt 1878, kur ishte rreth katër vjeç e gjysmë, sipas traditës, Mehmed Akifin e regjistruan në shkollën Emir Buhari të lagjes.

Pas dy vjet mësimesh në këtë shkollë, në fund të vitit 1879, Mehmed Akifi kaloi në Iptidajen e Fatihut, në shkollën fillore. Po këtë vit, i ati filloi t’ia mësonte arabishten.

I ati i Mehmed Akifit, Tahir Efendiu, ishte, në të njëjtën kohë, mësuesi privat i familjes së Myhyrdar Emin Pashës (vd. 1908). Ai u jepte mësim djemve të Emin Pashës, Ma-hmud Kemal (1870-1956) dhe Ahmed Tevfik si dhe fëmijëve të tjerë të familjes.

Pasi mbaroi shkollën fillore trevjeçare, në vitin 1882, Mehmed Akifi filloi mësimet në rushdijen (uniken) e qendrës së Fatihut. Ndërkaq, mësimet e arabishtes me të atin vazhdonin. Veç kësaj ndiqte edhe mësimet e persishtes dhe të veprave Gylstan (Saadi) dhe Mesnevi (Xh. Rumi) që jepte Esat Dedei në xhaminë Fatih. Mehmed Akifi, i cili ndodhej shumë para moshatarëve edhe në turqisht e frëngjisht, tregonte se ishte i talentuar në përvetësimin e gjuhëve.

Mehmed Akifit iu zgjua kureshtja për poezi dhe ia nisi të lexonte libra me poezi, që në vitet e rushdijes. Vetë tregon se libri i parë poetik që lexoi, qe Lejlaja dhe Mexhnuni i Fuzuliut. Më 1885, pasi Mehmed Akifi e mbaroi rushdijen trevjeçare, i ati e la të lirë në zgjedhjen e profesionit. Atëherë, Mehmedi zgjodhi Shkollën Mylkije (Shkollë e Lartë e Administratës) dhe u fut në Liceun civil Mylkije Idadisi që ishte hapur si shkollë përgatitore për Mylkijen, ku studioi deri në vitin 1889.

Disa fjalë për babanë e Mehmet Akifit dhe familjen e tij

Nga të dhëna të librit “Fletët” (Safahat), vepër poetike e plotë e Mehmet Akif Ersojt, mësojmë se i ati i Mehmet Akifit, Tahir Efendiu vdiq në fund të vitit 1887, ose në fillim të vitit 1888. Vdekja e këtij personi të cilin nxënësi i vet, Ibnulemin, e cilësonte si njeri të mirë e të pastër, të virtytshëm, besëtar, bujar, dinjitoz, altruist, mjeshtër i përkryer i orientuar në rrugë të drejtë, e dëmtoi rëndë familjen shpirtërisht, moralisht dhe materialisht. Dihet se Tahir Efendiu, i cili qe martuar në moshën 45-vjeç dhe, pas Akifit, pati pasur edhe një vajzë, sillej me shumë dhembshuri ndaj familjes. Nga fjalët e shkruara nga Mehmet Akifi dyzetvjeçar për të atin kuptohet se sa qe kujdesur Tahir Efendiu për të birin Akif dhe se sa e pati dashur atë: “... Ai qe edhe babai, edhe hoxha (mësuesi) im. Ç’të di, prej tij e kam mësuar...”

Në pranverën e vitit 1889, kur familja Emin Pasha shkoi në vilën verore të Jabaxhëkut, ashtu si më parë, edhe kësaj radhe i morën me vete edhe fëmijët e hidhëruar të të ndjerit Tahir Efendi. Por, ditën e parë të ramazanit (13 maj 1889), u erdhi lajmi se shtëpia në Sarëgyzel ishte djegur. Familja mbetur pa babanë edhe pa shtëpi.

Por, ish-nxënësi besnik i Tahir Efendiut, Mustafa Sidki Efendi, vrapoi në ndihmë të familjes së ish-mësuesit, ku ndërtoi për ta një shtëpi të vogël mbi truallin e shtëpisë së djegur dhe e shpëtoi familjen e mbetur pa shtëpi.

Këtë vit, Mehmet Akifi mbaroi idadijen dhe kaloi në pjesën e lartë të mylkijes. Ndërkaq, kishte shumë nxënës që e kishin mbaruar këtë shkollë, por jo vetëm që e kishin të vështirë të gjenin punë, edhe rrogën e kishin të ulët.

Mehmet Akifi, familja e të cilit ndodhej në gjendje të vështirë ekonomike, duke e menduar këtë, vendosi të kalonte në shkollën Bajtar që sapo ishte hapur dhe kishte filluar mësimet në fund të atij viti. Nxënësve që e mbaronin këtë shkollë të veterinarisë civile, do t'u jepej punë menjëherë.

Mehmet Akifi, poet dhe sportist

Gjatë mësimëve katëvjeçare në shkollën Bajtar, M. Akifi mori mbresa pozitive nga mësuesit, shumica e të cilëve ishin mjekë dhe njerëz fetarë. Ky shkoi me të njëjtën dëshirë si në laborator, ashtu edhe në xhaminë e shkollës.

M. Akifi u mor shumë me poezi, veçanërisht në dy vjetet e fundit të shkollës. Në shumë poezi të tij ai imitonte letërsinë e Divanit dhe u shkroi shokëve letra të gjata në vargje. Më vonë, duke mos i pëlqyer shkrimet e këtyre viteve, i asgjësoi të gjitha.

Në po ato vit, M. Akifi u mor shumë edhe me sport dhe nisi të merrte pjesë në mundjet popullore në fshatrat përreth zonës ku ndodhej shkolla, ku korrte suksese ...

Ai vazhdoi të merret me sport edhe në vitet pas shkollimit.

Vitet e para të veterinarisë dhe botimet e para

Më 22 dhjetor 1893, M. Akifi mbaroi Fakultetin e Veterinarisë, duke zënë vendin e parë. Pastaj, më 26 dhjetor, bashkë me shokun e klasës, Simonin, i cili kishte dalë i dyti, u emërua ndihmësinsektor veteriner.

Më 22 dhjetor 1893, Mehmet Akifi botoi një gazel në revistën Hazine-i Funun (Thesari i shkencave). Ky gazel mbetet ende vepra e parë e botuar e M. Akifit.

Më vonë mori ky mbaroi përgatitjen si hafiz, mori edhe mësimet të arabishtes si dhe mësimet private në frëngjisht.

M. Akifi botoi edhe një gazel tjetër në numrin e datës 18 tetor 1894, të revistës “Hazine-i Fanun”.

Disa poezi dhe një kompozim poetik të quajtur “Terkibidend”, të shkruara gjatë kohës së qëndrimit në Edrene, janë gjetur në fletoren e një merakliu poezie nga Edreneja.

Në vazhdim, M. Akifi boton vjersha dhe përkthime në gazeta dhe revista të kohës...

Të dhëna të tjera nga jeta

- M. Akifi u martua më 1 shtator 1898, me të bijën e Mehmed Emin Bejit, Isme Hanmi;
- Ai pati shtatë fëmijë, nga të cilët, tre të parët, vajza;
- Në moshën 28-29 vjeç, M. Akifi lëshoi mjekrën;
- Më 17 tetor 1906, M. Akifi u emërua mësues i turqishtes zyrtare;
- Më 25 gusht 1907, u emërua mësues i gjuhës turke në Shkollën e Mekanikës Bujqësore (Çiftçilik Makinist Mektebi).
- Vëllimi i parë i përmbledhjes së tij poetike, “Safahat” (Fletët), u botua brenda muajit prill 1911.
- Në gjysmën e parë të vitit 1912, poezia “Në katedrën e Sulejmanijes”, prej 1002 vargjesh u botua në seri në shtatë pjesë. Kurse botimi si libër doli në muajin shtator. M. Akifi vazhdoi të shkruante gjatë tërë vitit, ku përveç poezisë shkroi edhe artikuj, kryesisht me temë nga letërsia...

- Më 1913, shkroi pesë artikuj dhe filloi botimin e poezisë “Në katedrën e Fatihut” me plot 1962 vargje. Kjo vepër u nda për botim në njëzet e tetë pjesë, nga të cilat, gjashtëmbëdhjetë pjesët e para u botuan brenda këtij viti. Pjesa e mbetur u plotësua brenda vitit 1914, pasi M. Akifi shkoi në Egjipt dhe u kthye që andej.
- Më 11 maj 1913, e la detyrën e veterinerit, ku pati punuar për njëzet vjet me radhë.
- Në ditën e tretë të janarit 1914, M. Akifi u nis për në udhëtimin drejt Egjiptit, i cili do të vazhdonte për dy muaj.
- Në fillim të marsit 1914, pas kthimit nga udhëtimi për në Egjipt, M. Akifi vazhdoi të shkruajë poezi dhe shkrime të tjera...
- M. Akifi bëri edhe shumë vizita zyrtare në kuadër të delegacioneve, sidomos gjatë vitit 1915, si në: Arabi Saudite, Medine, Damask, Bejrut e gjetiu.
- Një kohë, Mehmet Akifi pati edhe disa polemika me personalitete të kohës...
- Gjatë viteve 1916, 1917 pati edhe censurime në disa revista, të cilat u ndalën së botuari, por ndodhte edhe botimi i kohëpaskohshëm i tyre...
- Gjatë vitit 1918, u ribotuan disa nga librat e serisë së Fletëve (Safahat).
- Duke filluar nga 18 shtatori 1919, M. Akifi filloi nga botimi i veprës më të madhe e më të rëndësishme të tij, poezisë “Asimi”. Gjatë vitit u botuan dhjetë fragmente të poezisë. Në shtatëmbëdhjetë fragmente të dala me ndërprerje gjatë viteve 1919-1924, u botua pjesa prej 1086 vargjesh e poezisë, kurse pjesa prej 1206 vargjesh hyri në botimin e librit në vitin 1924. E tërë poezia përbëhet prej 2292 vargjesh.
- Njihet edhe si revolucionar dhe kontribues në Frontin për Çlirim Kombëtar...
- M. Akifi ishte figurë komplekse dhe interesante, me prirje dhe aftësi të rralla...
- Në vitin 1936 sëmundja i përparonte dhe vdiq ditën e diel, të datës 27 dhjetor 1936.

Mr. Skënder R. Hoxha

MEHMET AKIF ERSOY

Biography and literary works

(Summary)

Mehmet Akif Ersoy was born by the end of 1873 in the Sariguzel neighbourhood in the Fatih district in Istanbul (in the month of Shawwal 1290 according to the Islamic calendar, somewhere between November 22 and December 20, 1873).

His father gave him the name “Ragif”. However, his family and friends called him “Akif” because of the difficulties in pronouncing his original name.

اسکندر خوجا

محمد عاكف أرسوى

(معلومات عن حياته و نشاطه الادبي)

(خلاصة البحث)

ولد محمد عاكف أرسوى في آخر من سنة ١٨٧٣ في بيت أسرته في حي سارغيزل بمنطقة الفاتح بمدينة استانبول. كان تاريخ مولده يوافق التقويم الهجري شهر الشوال ١٢٩٠

بما ان اياه سماه "رغيف" فان الاقرباء و الناس الحى لم يتعودوا على هذا لاسم استمروا في نسميته عاكف بايتشاء ابيه الذى سماه باسمه الاصلى .

I ati Pajaziti dhe xhaxhai myderriz Adem efendiu, ishin atdhetarë të shquar dhe pjesëtarë aktivë të Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH).

Arsimimi

Naim efendiu, mësimet parashkollore i mori nga xhaxhai i tij, ho-xha i shquar Mulla Adem efendiu, ku edhe filloi rrugëtimi i tij drejt edukimit dhe mësimi. Shkollimin fillor e mbaroi po në vendlindje në vitin 1972/73, për të vazhduar të mesmen në Medresenë "Alaudin" në Prishtinë, të cilën e mbaroi në vitin shkollor 1978/79. Gjatë shkollimit në medrese u dallua për sjelljet, edukatën dhe përkushtimin në mësim. Pati fatin e mirë që ishte nxënës i myderrizëve të shquar të asaj kohe që ishin pedagogë në medrese, si Rashid ef. Osmani, Hasan ef. Nahi, Sadri ef. Prestreshi, Haxhi Sherif ef. Ahmeti, si dhe pedagogët e lëndëve shoqërore.

Gjatë kësaj kohe ai u dallua sidomos me organizimet letrare dhe kulturore që zhvilloheshin në kuadër të Shoqatës së nxënësve të medresesë dhe organit të tyre revistës "Drita e Kurani" (Nuru 'l-Kuran), revistë në të cilën Naim efendiu nisi rrugëtimin e tij të frytshëm të fjalës së shkruar. Në vitin shkollor 1978/1979, ishte kryetar i Shoqatës së Nxënësve të Medresesë.

Pas përfundimit të shkollës së mesme studimet i vazhdoi në Universitetin "Al-Azhar" të Kajros, në drejtimin "Usuluddin" (Apologjetikë dhe Filozofi Islame), ku edhe diplomoi më 1984.

Gjatë qëndrimit në Kajro, përveç se u dallua në studime, u angazhua edhe në shumë aktivitete të tjera, sidomos në njohjen e historisë së shqiptarëve të Egjiptit, dhe në takimin me të fundit e dinastisë shqiptare të Misirit, si me Qerim Haxhiun, Musa Haxhiun etj.

I frymëzuar nga dashuria, malli, përkushtimi, këshillat, mësimet dhe porositë e tyre për atdheun, vuri kontakte me shqiptarët që jetonin jashtë atdheut, të organizuar në qendra të ndryshme nëpër Europë, SHBA, Australi dhe Zelandë të Re.

BIBLIOGRAFI

BIBLIOGRAFIA PERSONALE E MYFTIUT TË KOSOVËS, NAIM EF. TËRNAVA (Skicë për monografi)

I. JETËSHKRIMI

Familja

Naim Tërnavë u lind më 7.01.1961, në fshatin Lismir të Komunës së Fushë-Kosovës, fëmija i tretë i prindërve Pajaziti dhe Refiqja.

Të parët e familjes së tij heqin rrënjë nga fshati Tërnavë, i rrethit të Toplicës, që i përkiste Sanxhakut të Nishit, nga ku u dëbuan me dhunë gjatë viteve 1878, dhe u vendosën në fshatin Lismir të Fushë-Kosovës.

Si shumë familje të tjera shqiptare të dëbuara me dhunë nga trojet e tyre stërgjyshore, edhe kjo familje ruajti dhe kultivoi me përkushtim ndjenjën, dashurinë dhe idealin për t'u kthyer herëdokur në vatrën e tyre. Këtë e dëshmon edhe mbiemri i tyre (Tërnavë), si shenjë identifikimi i prejardhjes së tyre nga fshati-vatra nga ku ishin dëbuar me dhunë.

Familja Tërnavë shquhet për kultivimin e atdhedashurisë dhe traditën fetare.

Përmes këtyre atdhetarëve të dëshmuar, Naim efendiu u njoh dhe vuri kontakte edhe me shumë gazeta, revista e botime të veçanta, që kishin nxjerrë rilindësit tanë në Misir dhe në vende të tjera, si dhe me shtypin e kohës, që e nxirrte Mërgata Shqiptare gjithandej nëpër botë, jashtë ndikimit dhe mendimit ideologjik komunist, që ishte instaluar në vendlindjet e tyre.

Studimet pasdiplomike i ka mbaruar në Universitetin e Hapur Amerikan të Kajros, në vitin 2003.

Veprimtaria

Pas kthimit në vendlindje, Naim ef. Tërnavë emërohet imam në xhaminë e fshatit të tij të lindjes, në Lismir, ku me përkushtim shërbeu deri në vitin 1995. Koha sa ishte imam, ishte një ndër periudhat më të vështira të historisë më të re të Kosovës, ishin këto vitet që shënonin rënien e komunizmit në njërën anë, dhe ripushtimin e Kosovës nga Serbia, në anën tjetër. Në këto rrethana, Naim efendiu me ligjëratat, derset, vazet e nasihatet edhe përtej xhamisë dha një kontribut të rëndësishëm në motivimin, orientimin dhe kapërcimin e këtyre sfida-ve dhe zhvillimeve shoqërore-politike me të cilat po përballej Kosova.

Në shtator të vitit 1985/86, nga ana e Kryesisë së Bashkësisë Islame, Naim ef. Tërnavë, emërohet pedagog i lëndës së Akaidit dhe më pastaj edhe i Filozofisë Islame, në Medresenë e Mesme "Alaudin" në Prishtinë. Përveç punës së palodhshme si pedagog, ai për nevojat e nxënësve hartoi edhe shtatë tekste për lëndët Akaid, Ahlak dhe Filozofi Islame, që shënon një periudhë të re në tekstologjinë islame në medrese.

Për dy mandate (1995-2003) ishte edhe drejtor i Medresesë "Alaudin".

Nga viti akademik 1994/95, u angazhua ligjërues i lëndës së Akaidit dhe Filozofisë Islame në Fakultetin e Studimeve Islame. Lëndën e Akaidit vazhdon ta ligjërojë edhe sot.

Naim Tërnavë nga fillimi i viteve të 90-ta ka ushtruar shumë detyra dhe funksione me rëndësi, jo vetëm në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, por edhe jashtë saj.

Gjendja e rëndë nëpër të cilën po kalonte Kosova, në fund të viteve '80, bëri që Bashkësia Islame e Kosovës të formonte Këshillin Iniciues për Ndihma, e cila ishte përpjekja e parë për t'u dalë në ndihmë punonjësve, të cilët i kishte nxjerrë me dhunë nga institucionet push-teti serb. Naim ef. Tërnavë, fillimisht ishte anëtar i këtij Këshilli, e më pastaj edhe drejtues i tij.

Për tri mandate ka qenë anëtar i Redaksisë së revistës "Dituria Islame" (1990-1991, 1992-1993, 1998-2000), ku ka dhënë një kontribut të shquar dhe ka botuar studime nga fusha e Akaidit. Kurse për dy mandate (1990-1998) ka qenë anëtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, dhe në mungesë të kryetarit të Kryesisë së Bashkësisë Islame, disa herë ka qenë edhe zëvendëskryetar i saj.

Me dëbimin e nxënësve dhe punonjësve arsimorë nga institucionet publike shkollore, u paraqit nevoja për riorganizimin e procesit arsimor paralel dhe të pavarur nga Serbia. Kështu, më 1989 u themelua Këshilli Iniciativ për Themelimin e Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë (LASH), që për një dekadë të tërë do të luante rolin e Ministrisë së Arsimit të Kosovës. Naim ef. Tërnavë ishte njëri nga katër anëtarët e Këshillit Iniciativ për themelimin e LASH-it, i cili u themelua pikërisht në Medresenë "Alaudin" në Prishtinë, e cili me tërë kapacitetet e veta që vënë në shërbim të kauzës kombëtare shqiptare.

Në fund të vitit 1997 dhe në fillim të vitit 1998, Kosova hyn në një fazë krejtësisht të re, ajo edhe praktikisht ishte në gjendje lufte, kurse popullata shqiptare përballej me vështirësi nga më të ndryshmet. Në këtë kohë, saktësisht më 9.03.1998, Bashkësia Islame e Kosovës, në kuadër të saj, formoi Këshillin e Emergjencës, të parin e këtij lloji në Kosovë, i cili do t'u vihej në ndihmë të dëbuarve dhe të dëmtuarve nga agresioni serb në zona të ndryshme të Kosovës, si dhe njësive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në krye të këtij Këshilli, që nga fillimi, u emërua Naim ef. Tërnavë. Pas përfundimit të luftës, ky

Këshill u transformua në Shoqatën Humanitare “Bereqeti”, të cilën deri në vitin 2002, e drejtoi Naim ef. Tërnavë.

Ishte edhe anëtar i Këshillit të Emergjencës në nivel republikan (1998-1999).

Nga viti 1999 deri në vitin 2003, ka ushtruar detyrën e kryetarit të Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Gjatë kësaj kohe ka zhvilluar shumë takime zyrtare në nivele ndërkombëtare kudo nëpër botë, gjithnjë në interes të çështjes së Kosovës.

Më 15 tetor 2003, zgjidhet kryetar dhe Myfti i Bashkësisë Islame të Kosovës. Në këtë post është rizgjedhur edhe në vitin 2008 dhe në vitin 2013.

Si Myfti i Kosovës, që nga viti 2003, përveç që ka pritur e takuar shumë personalitete të larta vendore e ndërkombëtare, ka marrë pjesë në shumë konferenca, seminare, kongrese, simpoziume e forume brenda dhe jashtë Kosovës. Në të gjitha takimet që ka pasur me përfaqësuesit ndërkombëtarë, Myftiu Tërnavë i ka njoftuar ata me realitetin kosovar dhe njëkohësisht ka kërkuar nga ata përkrahje për Kosovën, shtetësinë dhe njohjen e pavarësisë së saj.

Për kontributin e tij në shumë fusha ka marrë disa mirënjohje e çmime nga organizata, institucione dhe forume të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

II. MIRËNJOHJET DHE ÇMIMET

- Më 2005, është zgjedhur nënkryetar i Këshillit të Lartë Islamik për Evropë dhe Azi, me seli në Stamboll.
- Në maj të vitit 2007, gjatë vizitës në SHBA, respektivisht në shtetin e Kentakit, në qytetin Louisville (Luilvil), nga kryebashkiaku i këtij qyteti z.Terry E.Abrahamson Mayer, Myftiu Naim ef. Tërnavë është shpallur qytetar nderi i qytetit Louisville (Luilvil).
- Më 28.12.2011, Myftiut Naim Tërnavë i ndahet “Çmimi për Krijimtari, 2011”, nga Komuna e Fushë-Kosovës.

- Më 12.06.2013, në Akademinë solemne të organizuar nga Komuna e Fushë-Kosovës, me rastin e çlirimit të këtij qyteti, iu nda çmimi: “Qytetar Nderi i Komunës së Fushë-Kosovës”.

- Për herë të pestë me radhë që nga viti 2009-2013, nga Qendra Mbretërore për Studime dhe Hulumtime Islame, me seli në Aman të Jordanisë, renditet i 72-ti me radhë në mesin e 500 personaliteteve më me ndikim në Botën Islame.

III. Pjesëmarrja në konferenca dhe forume të ndryshme

- Simpoziumi Ndërkombëtar “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët”, organizuar nga Meshihati i Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, dt. 15-17.1992.
- Konferenca Ndërkombëtare “Për paqe dhe tolerancë”, organizuar nga “Fondacioni Thirrja e Ndërgjegjes” me seli në Nju-Jork, mbajtur në Vjenë, dt. 16-18.03.1999.
- Konferenca shkencore “Islami dje, sot dhe nesër”, organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 23-24.05.2003.
- Kongresi Ndërkombëtar “Toleranca në qytetërimin Islam”, organizuar nga Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Egjiptit, Kajro 28 prill- 1 maj 2004.
- Konferenca Ndërkombëtare “Mëshira e përgjithshme dhe Islami botëror”, organizuar nga “Organizata Botërore Islame për Thirrje”, me seli në Tripol të Libisë, 2004.
- Konferenca e Tretë e Këshillit Evropian të liderëve fetarë: “Integritet në Evropë”, Leuven-Bruksel, 07-11 nëntor 2004.
- Kongresi Ndërkombëtar “Islami, vlerë njerëzore qytetëruese”, organizuar nga Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Egjiptit, Kajro 17-20.04 2005.
- Konferenca Ndërkombëtare “Mbi koekzistencën paqësore dhe dialogu ndër fetar në Kosovë”, Prishtinë, 2-3 maj 2005.
- Konferenca Ndërkombëtare “Feja, kultura dhe identiteti islam në kohën bashkëkohore”, organizuar nga Këshilli i Lartë Islamik për Evropë, Stamboll, 5-9 shtator 2005.
- Sesioni shkencor “Kur’ani te shqiptarët”, organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë 26-27.12.2005.

- Kongresi Ndërkombëtar "Problemet me të cilat ballafaqohet Bota Islame dhe trajtimi i tyre në kontekstin e globalizmit", organizuar nga Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Egjiptit, Kajro, 6-9.04.2006.
- Kongresi i Parë Ndërkombëtar, "Al-Azhari dhe Perëndimi", organizuar nga Universiteti "al-Azhar", Kajro, 11-13.04.2006.
- Konferenca Ndërkombëtare "Konferenca ndërfetare mbi koekzistencën paqësore dhe dialogun", organizuar nga Kisha Norvegjeze, Pejë, 2-3.05.2006.
- Simpoziumi Ndërkombëtar "Gjashtë shekuj të Islamit ndër shqiptarët", organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës dhe Fakulteti i Studimeve Islame Prishtinë, Prishtinë, 16-17.09.2006.
- Kongresi Ndërkombëtar "Mosmarrëveshjet në Botën Islame dhe orvatjet e zgjidhjeve të tyre nën hijen e globalizmit", organizuar nga Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Egjiptit, Kajro, 4-6 mars 2007.
- Kongresi II Botëror "Provokimet kulturore e civilizuese për Botën Islame", organizuar nga Universiteti i "Al-Azharit", Kajro, 01-03.04 2007.
- Tryeza shkencore "Mesazhet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit", organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, Prizren, 12.06.2007.
- Konferenca për Evropë dhe Azi, "Takimi i liderëve myslimanë të Ballkanit", organizuar nga DIJANET-i i Turqisë, Sofje, 28. 09. 2007.
- Konferenca Ndërkombëtare "Për dialog ndërfetar dhe ndërcivilizues", organizuar nga Ministria e Kulturës së Maqedonisë, Ohër, 26-28 tetor 2007.
- Konferenca e Liderëve Fetarë Islamë të Ballkanit "Perspektiva dhe e ardhmja e përbashkët", Podgoricë 8-9. 03. 2008.
- Konferenca Ndërkombëtare "Përpjekjet për siguri në shoqërinë islame", organizuar nga Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Egjiptit, Kajro, 16-19.03.2008.
- Sesioni shkencor "Myderriz Sherif ef. Ahmeti - jeta dhe vepra", organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 17. 04. 2008.

- Konferenca Ndërkombëtare "Dialogu" organizuar nga Lidhja Botërore Islame", Mekë, 4-6 qershor 2008.
- Konferenca Ndërkombëtare "Një botë e përbashkët mes nesh", organizuar nga Qendra për Fe dhe Kulturë e Universitetit të "Yellit" në bashkëpunim me Universitetin "Al-el-Bejt", Nju Haven (në Haven), 28-31 korrik 2008.
- Konferenca Ndërkombëtare "Al-Azhari dhe Perëndimi - urat për të ardhmen", organizuar nga Universiteti "Al-Azhar", Kajro, 3-5 janar 2009.
- Ligjëratë me temën "Islami te shqiptarët", në Universitetin "Al el-Bejt" të Jordanisë, Aman, 5.03.2009.
- Ligjëratë me temën "Perspektiva e myslimanëve të Kosovës në Evropë", në Universitetin Islam Botëror të Amanit, Aman, 6.03.2009.
- Kongresi Ndërkombëtar "Reformimi i të menduarit islam", organizuar nga Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Egjiptit, Kajro, 6-8 prill 2009.
- Konferenca Ndërkombëtare "Burimet e njohurive fetare dhe metodat e reformave", organizuar nga Këshilli i Lartë Islamik të Euro-Azisë", Stamboll, 12-15 maj 2009.
- Kongresi III i organizuar nga Universiteti i "Al-Azharit", "E drejta e dialogut dhe kufijtë", Kajro, 28-30.06.2009.
- Akademi përkujtimore "60-vjetori i rënies së Mulla Idris Gjilanit", organizuar nga Shoqata e të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë, Prishtinë, 26. 11.2009.
- Konferenca e Liderëve Fetarë Myslimanë të Ballkanit, Prishtinë, 11-12.05.2010.
- Kongresi Ndërkombëtar "Qëllimet e së Drejtës islame dhe problematikat bashkëkohore", organizuar nga Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Egjiptit, Kajro, 22-25 shkurt 2010.
- Konferenca Ndërkombëtare, organizuar nga Lidhja Botërore Islame, Mekë, 18. 07. 2011.
- Kongresi Ndërkombëtar "Problemet dhe zgjidhjet e tyre", organizuar nga Liga Botërore Islame, Mekë, 11-12.07.2011.

- Konferenca Ndërkombëtare "Mësimet mbi fenë në institucionet publike të arsimit, përvojat nga rajoni dhe modalitetet e përshtatshme për Kosovën", organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë 14 -15 mars 2011.
- Konferenca e liderëve fetarë të Ballkanit "Denacionalizimi i vakëfit dhe përvoja e shteteve të tjera", Shkup, 29-30 maj 2011.
- Konferenca Ndërkombëtare "Këndvështrimi i diversitetit fetar, kulturor dhe shoqëror në Ballkan nga perspektiva globale" (Përvoja e Fethullah Gylanit si model dhe humane), Tiranë, 25 mars 2011.
- Sesioni shkencor: "Myderriz Sadri ef. Perstreshi, jeta dhe vepra", organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 22 shkurt 2012.
- Akademi përkujtimore: "Sadri efendi Prestreshi, shembull i sakrificës për vatan", Prishtinë, 22 shkurt 2012.
- Konferenca shkencore mbarëkombëtare "Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar", organizuar nga tri bashkësitë islame shqiptare, Tiranë, 28-29 shtator 2012.
- Konferenca "Gruaja, themel i familjes", organizuar nga UNFPA-misioni në Kosovë dhe Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 8.05.2013.
- Konferenca e Liderëve Myslimanë të Ballkanit "Roli i Islamit dhe prijësve fetarë në zgjidhjen e problemeve sociale dhe shpirtërore", Tiranë, 18 maj 2013.
- Konferenca Ndërkombëtare "Feja dhe pajtimi - cila është e ardhmja e dialogut ndërfetar", organizuar nga Qeveria e Kosovës, Pejë më 24-26 maj 2013.
- Konferenca Ndërkombëtare për Dialog Ndërfetar "Dialogun ndërfetar e kemi dëshmuar përgjatë shekujve", organizuar nga OSBE, Prishtinë 17.09.2013.
- Konferenca për Promovimin e Paqes në Kosovë "Fragmente nga terreri mbi paqen dhe pajtimin në Kosovë", organizuar nga Caritasi Zvicran dhe Fondacioni FES i Luksemburgut, Prishtinë, 20. 09. 2013.

- Sesioni shkencor: "Hfz. Bajram ef. Agani, jeta dhe vepra (1898-1962)", organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 7 dhjetor 2013.
- Akademi përkujtimore: "Hafiz Bajram Agani-Alim dhe udhëheqës i përkushtuar", organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë 07.12.2013.
- Konferenca ndërkombëtare "Bota Islame, problemet –zgjidhja e tyre dhe bashkëpunimi islamik", organizuar nga Lidhja Botërore Islame, Mekë, 2-4 mars 2014.
- Konferenca Ndërkombëtare "Promovimi i paqes në shoqëritë myslimane", Ebu Dhabi, 4-5 mars 2014.
- Konferenca Ndërkombëtare "Roli i Bektashizmit në sendërtimin e dialogut ndërfetar në Ballkan", organizuar nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane, Tiranë, 24 prill 2014.
- Konferenca Ndërkombëtare "Uniteti në diversitet", organizuar nga "Këshilli Islamik i Euro- Azisë, Bruksel, 13-14 maj 2014.
- Konferenca Ndërkombëtare Ndërfetare "Java e tolerancës", organizuar nga Qeveria e Kosovës, Prizren, 23-25 maj 2014.
- Konferenca për dialogun ndërfetar, organizuar nga OSBE, Prishtinë, 3 tetor 2014
- Forumi i Tretë Botëror i Dialogut Ndërfetar Katoliko -Mysliman, "Të punojmë së bashku për t'u shërbyer të tjerëve", Vatikan, 11-13 nëntor 2014.

IV. BIBLIOGRAFIA E MYFTIUT NAIM EF. TËRNAVA (1990-2013)

- Në këtë bibliografi janë përmbledhur punimet, kontributet e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, të botuara gjatë viteve 1990-2013.
- Bibliografia është e konceptuar në tri pjesë a njësi:
- Në pjesën e parë janë përfshirë monografitë, që kryesisht janë tekste shkollore për nxënësit e medresesë "Alaudin" në Prishtinë.

- Në pjesën e dytë janë përfshirë shkrimet, fjalimet, hytбет dhe intervistat e botuara në shtypin e Bashkësisë Islame ("Dituria Islame" dhe "Takvimi").
- Në pjesën e tretë janë përmbledhur kumtesat dhe referatet e botuara në vëllime dhe botime të veçanta.

Gjatë hartimit të kësaj bibliografie janë respektuar kriteret kronologjik dhe tematike.

Në këtë bibliografi nuk kanë zënë vend fjalimet, urimet, mesazhet, deklaratat, reagimet dhe intervistat e Myftiut, të botuara qoftë në shtypin vendor apo atë të huaj.

Për këtë arsye, kjo bibliografi sigurisht që nuk mund të quhet e plotë, porse mund të shërbejë si bazë për interesimet dhe kërkimet e të gjithë atyre që janë të interesuar për të njohur punën dhe veprën e Myftiut të Kosovës, mr. Naim ef. Tërnavë.

4.1. Monografitë

- Morali islam/Ahlaku-1, botoi: Medreseja e Mesme "Alauddin", Prishtinë 1993.
- Bazat e besimit/Akaidi-1, botoi: Merdeseja e Mesme "Alauddin", Prishtinë 1994.
- Pasqyrë e filozofisë islame; botoi: Medreseja e Mesme "Alauddin", Prishtinë 1995.
- Morali islam/Ahlaku-2; botoi: Medreseja e Mesme "Alauddin", Prishtinë 1996.
- Fraksionet në Islam/Akadi-4, botoi: Medreseja e Mesme "Alauddin", Prishtinë 1997.
- Islami besim i vërtetë dhe fetë e tjera-Akaidi-2", botoi: Medreseja e Mesme "Alauddin", Prishtinë 1998.
- Pejgamberia – Njeriu dhe përgjegjësia – Akaidi 3, botoi: Medreseja e Mesme "Alauddin", Prishtinë 1999.

4.2. Publikimet

- Liritë e njeriut; "Dituria Islame" (në vazhdim "DI"), nr. 18/1990, f.34.
- Rreth besimit në Zotin; DI, nr. 21/1991, f. 12-13.
- Dhuntia hyjnore; DI, nr. 24/1991, f. 20-21.
- Imam Vehbi Ismaili, publicist dhe veprimtar i shquar; DI, nr. 29/1991, f. 19 -20.
- Xhamia na njoftoi dhe na afroi ndërmjet vete; DI, nr. 35/1992, f. 22-23.
- Pa besim në Zotin nuk ka ngadhënjim, DI, nr. 98/1997, f. 41-42.
- Sektet antiislame, "Takvim/Kalendar 1417-18/1997", Prishtinë, 1997, f. 109-125
- U nënshkrua marrëveshja e Haxhit, DI, nr. 99/1998, f. 46-47.
- Pa edukimin shpirtëror nuk evitohen dukuritë negative në shoqëri, (kumtesë e lexuar në Seminarin e dytë me imamë dhe nëpunës të B.I. të Kosovës, Prishtinë: 13-14 dhjetor 1997): në DI, nr. 99/1998, shtojca, f. 19.
- Jeta pas vdekjes dhe ndëshkimi në varr; DI, nr. 100/1998, f. 16-19.
- Do ta ndajmë kafshatën e gojës së bashku dhe do të mbijetojmë gjendjen e rëndë; intervistë, DI, nr. 108-109/1999, f. 59-61.
- Islami nuk ka alternativë!; (1); DI, nr. 126/2000, f. 11-13.
- Islami nuk ka alternativë! (2); DI, nr. 127-128/2001, f. 24-26.
- Islami nuk ka alternativë! (3); DI, nr. 129-130/2001, 13-15.
- Islami nuk ka alternativë! (4); DI, nr. 131/2001, f. 17-18.
- "Fundamentalizmi islamik" është spekulim propagandistik; intervistë, DI, nr. 146-147/2002, f. 29-33.
- Jehudizmi-hebraizmi, "Takvim/Kalendar 1422-23/2002", Prishtinë, 2002, f. 53-67.
- Bashkësia Islame e Kosovës, është institucion që duhet ta kenë në konsideratë të gjithë, intervistë për "Diturinë Islame", DI, nr. 160-161/2003, f. 21-26.
- Hytbeja e Kurban-Bajramit, DI, nr. 163/2004, f. 60-61.

- Të përmbahemi nga çdo akt dhune, (Apel, 19 mars 2004), DI, 164/2004, f. 4.
- Kontributi i bashkësive fetare në stabilitetin, demokratizimin dhe paqen në Kosovë, fjalë e mbajtur në takimin e tretë të Këshillit Europian të prijësve fetarë në Leuven - Belgjikë 7-10 XI 2004, , DI, 172/2004, f. 9-11
- Hytbeja e Fitër-Bajramit, DI, 172/2004, f. 52-54.
- Fjala e Myftiut në iftarin e shtruar nga ambasadori amerikan, Filip Golberg, më 12 nëntor 2004, DI, 172/2004, f. 54-55.
- Xhemaludin Afgani (1838-1897), Takvim-Kalendar 2004, f. 81-104.
- Hytbeja e Kurban-Bajramit, DI, 174-175/2005, f. 55-56
- Intervistë e Myftiut për "Koha Ditore", 2 korrik 2005, dhe "Zërin" 2 korrik 2005., DI. 180-181/2005 Shtojcë.
- Hytbeja e myftiut për Fitër-Bajramin, DI, 183-184/2005, f. 57-58.
- Telegram ngushëllimi me rastin e vdekjes së presidentit Rugova, (për kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, familjen Rugova dhe qytetarët e Kosovës, DI, 186-187/2006, f. {2}.
- Ne duhet të përdorim autoritetin tonë për kthimin e besimit të ndërsjellë në mesin e popullatës së Kosovës, fjalë e mbajtur në konferencën mbi koekzistencën paqësore dhe dialogun ndërfetar në Kosovë, Pejë 2-3 maj 2006, DI, 190, f. 4-5
- Mesazhi i Myftiut me rastin e fillimit të muajit të shenjtë të Ramazanit, DI, 194/2006, f. 4.
- Hytbeja e Fitër-Bajramit, DI, 195-196/2006, f. 51-52.
- Hytbeja e Kurban-Bajramit, DI, 198/2007, f. 56.
- Vështrim apologjetik për veprën e Fetullah Gylenit "Kriteret ose dritat e rrugës", DI, nr. 198/2007, f. 32-33.
- Apel (me Dodë Gjergjin) 14 shkurt 2007, DI, 199/2007, f. {2}.
- Kushtetuta e ardhshme e Kosovës të njohë fetë tradicionale (Deklaratë), 14 shkurt 2007, DI, 199/2007, f. 3.
- Bashkësia Islame e Kosovës është munduar të krijojë një klimë të mirë për jetë të përbashkët të të gjitha feve, (intervistë), DI, 201/2007, f. 26.

- Reagim i Myftiut rreth planifikimit të sulmit terrorist mbi bazën ushtarake Fort Diks të Nju-Xherist në SHBA, DI, 202/2007, f. {2}.
- Pllaka për gjeneratat e reja që të mos harrojnë vendin, ku u mbajt Lidhja Shqiptare e Prizrenit, (fjalë përshëndetëse me rastin e Tryezës Shkencore për LSHP, të mbajtur në Prizren), DI, 203/2007, f. (2,65).
- Hytbeja e Fitër-Bajramit, DI, 207/2007, f. 50-51.
- Hytbeja e Kurban-Bajramit, DI, 210/2008, f. 58-59.
- Urimi i Myftiut të Kosovës, drejtuar qytetarëve me rastin e Shpalljes së Pavarësisë, DI, 211/2008, f. 3.
- Mesazhi i Myftiut me rastin e Shpalljes së Pavarësisë (15 shkurt 2008), DI, 211/2008, f. 8.
- Njihni pavarësinë e Kosovës, (apel i Myftiut Konferencës Islamike), 13 mars 2008, DI, 212/2008, f. 4.
- Fjala e Myftiut në akademinë përkujtimore me rastin e 10-vjetorit të vdekjes së H. Sherif Ahmeti, DI, 213/2008, f. 4-6.
- Botë e qytetëruar: Ju faleminderit për atë që keni bërë për këtë popull të përvojatur, (fjalë e mbajtur në manifestimin "Mesazhi i Paqes", Prishtinë, 26 maj 2008), DI, 214/2008, f. 4-5
- Ne aty kërkuam që të përshpejtohet njohja e pavarësisë së Kosovës, intervistë për "Dituria Islame", DI, 215/2008, f. 4-6.
- Detyrë e prijësve fetarë duhet të jetë përqendrimi në parimet fetare, fjalë e mbajtur në Universitetin "Yale" në SHBA, (28 gusht 2008), DI, 216-217/2008, f. 4-7.
- Hytbeja për Fitër-Bajramin, DI, 218/2008, f/4-5.
- Fjala e Myftiut me rastin e marrjes së Menshurës, (Prishtinë, 25 tetor 2008), DI, 219/2008, f. 8.
- Hytbeja e Kurban-Bajramit, 8. 12. 2008, DI, 220-221/2008, f. 4-5.
- Jam i kënaqur që i madhi Zot më ka mundësuar të jem në krye të BIK-ut në kohën kur Kosova fitoi pavarësinë, intervistë për "Dituria Islame", DI, 220-221/2008, f. 21-27.
- Kosovës i nevojitet një shoqëri e shëndoshë, intervistë për "Dituria Islame", DI, 230/2009, f. 49-51.
- Hytbeja e Myftiut për Kurban-Bajramin, DI, 233/2009, f. 32-33.

- Deklaratë e Myftiut për rastin Kçira, DI, 236/2010, f. 53.
- Rikujtimi i shëmbëlltyrës së Muhamedit a.s. (fjalë e mbajtur në manifestimin "Muhamedi a.s., shëmbëlltyrë e njerëzimit"), DI, 237/2010, f.5-7.
- Letra e Myftiut për deputetët e Kuvendit të Kosovës (Inkorporomi i lëndës Edukata Fetare në arsimimin fillor dhe të mesëm), DI, 237/2010, f. 50-51.
- Fjala e Myftiut në takim me Gadafin, DI, 240/2010, f. 8.
- Deklaratë e Myftiut të Kosovës pas vendimit të Gjykatës Ndërko-mbëtare të Drejtësisë, DI, 241/2010, f. 54.
- Deklaratë e Myftiut për Udhëzimin Administrativ 6/2010, DI, 241/2010, f. 54-55.
- Letra e Myftiut për Konferencën Islamike dhe Ligës Arabe, DI, 241/2010, f. 56.
- Hytbeja e Fitër-Bajramit, DI, 243/2010, f. 48-49
- Hytbeja e Kurban-Bajramit, DI, 245/2010, f. 4-5.
- Reagim lidhur me fjalën e patrikut të KOPS, Irinej, me rastin e shugurimit të peshkopit Teodosije, në Prizren, DI, 247/2011.
- Muhamedi a.s. shëmbëlltyrë për njerëzimin (fjalë e mbajtur me rastin e shënimit të Mevludit), DI, 248/2011, f. 5-9.
- Hasan ef. Nahi, personalitet i shekullit të njëzet (fjala e hapjes në sesionin kushtuar Myderriz Hasan ef. Nahi), DI, 248/2011, f. 53-54.
- Mësimi mbi fenë në institucionet publike të arsimimit përvojat nga rajoni dhe modalitetet e përshtatshme për Kosovën (fjalë e mbajtur në hapje të konferencës), DI, 249/2011, f. 5-7.
- Deklaratë e Myftiut me rastin e vrasjes së dy ushtarëve amerikanë në Frankfurt të Gjermanisë, DI, 249/2011, f. 52.
- Telegram urimi (për presidentin Sejdiu, kryeministrin Thaçi dhe kryeparlamentarin Krasniqi, me rastin e zgjidhjeve), DI, 249/2011, f. 52.
- Fetullah Gyleni u ka kushtuar jetën përpjekjeve për t'u dhënë përgji-gje sëmundjeve të shoqërisë (fjalë e mbajtur në Konferencën "Kë-

- ndvështrim i diversitetit fetar, kulturor dhe shoqëror në Ballkan nga perspektiva globale", Tiranë, 25 mars 2011), DI, 250, f. 68.
- Islami është fe e paqes (fjalë e mbajtur në takimin e liderëve fetar të Ballkanit në Shkup, 29 mars 2011), DI, 250, f. 69-70.
- Hytbeja e Fitër-Bajramit, DI, 254/2011, f. 6-7.
- Islami për vetëvrasjen, DI, 256/2011, f. 37-39.
- Raporti i Stefan Shvarcit - një pamflet i mbushur me shpifje, DI, 262/2012, f. 58-59.
- Veriut të vendit duhet t'i qasemi me maturi e mençuri, pa emocione, me durim e mirëkuptim, DI, 263/2012, f. 5-6.
- Hytbeja e Fitër-Bajramit, DI, 265-266/2012, f. 5-7.
- Ramazani - dhuratë vjetore për besimtarët nga i madhi Zot xh. sh., DI, 265-266/2012, f. 8-10.
- Telegram ngushëllimi për ambasadoren amerikane në Kosovë, znj. Tacyey Jacobson, DI, 267/2012, f. 59.
- Fjala e Myftiut në manifestimin e gurthemelit të Xhamisë Qendrore në Prishtinë, 8 tetor 2012, DI, 268/2012, f. 8-9.
- Hytbeja e Kurban-Bajramit, DI, 268/2012, f. 49-50.
- Fjala e Myftiut në hapje të konferencës shkencore "Kontributi i pri-jësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar", Tiranë, 28 shtator 2012, DI, 268/2012, f. 54-55.
- Deklaratë e Myftiut për heqjen e Lapidarit të Dëshmorëve në Preshevë, DI, nr. 271/2013, f. 55.
- Gruaja është elementi, struktura më e fortë brenda familjes, DI, nr. 275/2013, f. 5-8.
- Libër që vë në pah kontributin e ulemasë shqiptare për shtetin dhe kombin, DI, nr. 275/2013, f. 48.
- Fetë urdhërojnë dhe mësojnë për paqe universale, DI, nr. 276/2013, f. 5-7.
- Fitër Bajrami, festë e dashurisë dhe solidaritetit (Hytbeja për Fitër-Bajramin), DI, nr. 277-278/2013, f.5-6.
- Hytbeja e Myftiut për Kurban-Bajramin, DI, nr. 279/2013, f. 5-7.

- Fjala e Myftiut në promovimin e librit: "Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar", Tiranë, 3 shtator 2013, DI, nr. 280/2013, f. 48.
- Ndërtimi i paqes është rrugë pa alternativë, DI, 280/2013, f. 49-50.
- Fjala përshëndetëse e Myftiut në promovimin e librit: "Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar", Prishtinë, 13 nëntor 2013, DI, nr. 281/2013, f. 53.

4.3. Referate dhe kumtesa

- Fushat e veprimit filozofik në besimin islam, në: "Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët", (simpoziumi ndërkombëtar), botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 1995, f. 75-79.
- Tradita e aktivitetit fetar-islam në Kosovë është e vjetër mbi gjashtë shekulle, në: "50-vjet të Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë, botoi Medreseja e Mesme "Alauddin", Prishtinë, 2003, f. 4-11.
- Rëndësia e literaturës mësimore për aftësimin profesional të nxënësve, në: "Shtypi islam dje, sot dhe nesër - përmbledhje kumtesash nga Konferenca Shkencore (Prishtinë, 23-24 maj 2003), botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2005, f. 201-206.
- Jehona e Lidhjes së Prizrenit frymëzoi dhe fuqizoi shpirtrat dhe ndjenjat kudo ndër shqiptarë (fjala e hapjes), në: Mesazhet e Lidhjes së Prizrenit në raport me realitetin shqiptar sot, përmbledhje kumtesash nga Tryeza shkencore, Prizren, 12 qershor 2007, botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2010, f. 7-9.
- Haxhi Sherif Ahmeti: jeta dhe vepra (kryereferat), në: "Haxhi Sherif ef. Ahmeti - jeta dhe vepra (1920-1998)", Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 17 prill 2008), botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2010, f. 7-15.
- Shehidët ranë për Zot e atdhe, në: "Imamët dëshmorë-shehidë në luftën e fundit në Kosovë, 1989/1999 - Monografi, botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 2010, f. 5-12.

- Vështrim akaideologjik "Mevludit" të Tahir ef. Popovës, në: "Mevludi te shqiptarët", Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 22 prill 2009), botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2010, f. 227-233.
- Hasan efendi Nahi, personaliteti islam i shekullit njëzet (fjalë e hapjes), në: "Myderriz Hasan ef. Nahi - jeta dhe vepra (1905-1991), Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 5 shkurt 2011), botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2012, f. 9-13.
- Myderriz Sadri Prestreshi-njeri i sakrificës dhe idealeve, në: "Myderriz Sadri ef. Prestreshi - jeta dhe vepra (1917-2002), Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 22 shkurt 2012), botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2013, f. 7-10.
- Sadri ef. Prestreshi - shembull si duhet sakrifikuar e punuar për vatan, komb e fe, në: "Myderriz Sadri ef. Prestreshi -jeta dhe vepra (1917-2002), Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 22 shkurt 2012), botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2013, f. 172-175.
- Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar (referate në hapje të Konferencës), në: Konferenca shkencore 28-29 shtator 2012, botoi: KMSH-BIK-BFIM, Tiranë 2013, f. 14-16.

R. Shkodra
S. Mehmeti

RECENSION

NË PRISHTINË, U PROMOVUA RIBOTIMI I VËLLIMIT TË PARË TË REVISTËS "ZANI I NALTË"

Më 25 nëntor 2014, në Prishtinë, u promovua ribotimi i vëllimit të parë të revistës "Zani i Naltë", botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Në këtë manifestim që u mbajt në Amfiteatrin e Fakultetit të Studimeve Islame, qenë të pranishëm prijësit më të lartë të tri komuniteteve islame shqiptare, kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Skender ef. Bruçaj, reisi i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Sulejam ef. Rexhepi si dhe nikoqiri, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, nën kujdesin e të cilit u mbajt ky aktivitet.

Tre prijësit e Bashkësive Islame vlerësuan lart rolin e themeluesve të kësaj reviste, duke theksuar se ata patën një kontribut të madh në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

Pasi i përshëndeti të pranishmit që qenë në numër të konsiderueshëm, përfshirë këtu personalitete të shquara nga bota akademike, kulturore e fetare

nga të gjitha trojet tona, Myftiu Tërnava përgëzoi KMSH për punën që ka bërë me ribotimin e vëllimit të parë të revistës "Zani i Naltë", në të cilën është përmbledhur botimi i tre vjetve të parë të daljes së revistës (1923-1925).

Për qëllimin dhe objektivat që kishin revista si organi i parë zyrtar i KMSH në gjuhën shqipe, Myftiu tha: "Misioni i revistës "Zani i Naltë" ishte hapja e rrugës dhe krijimi i hapësirës së duhur për emancipimin, përparimin dhe edukimin e drejtë e të duhur të masës së gjerë. E konceptuar si revistë fetare islame, ajo këtë mision madhor e kreu me sukses. Mirëpo, ajo nuk ngeli në kuadër të një reviste thjesht fetare, por shumë shpejt "Zani Naltë" u shndërrua në një tribunë të mendimit fetar, filozofik, kulturor e atdhetar, ku rreth vetes mbledhi penat më të njohura të kohës, të cilët përmes faqeve të kësaj reviste, u ofruan lexuesve

kontribute nga disiplinat fetare islame dhe artikuj e studime të ndryshme me karakter filozofik, shkencor, historik, shoqëror, arsimor e kulturor, që i dhanë vlerë dhe e shquan këtë revistë nga të tjerat."

Kryetari i KMSH-së, Skender Bruçaj, përveç tjerësh tha: "Revista "Zani i Naltë" u themelua në vitin 1923, menjëherë pas ngritjes së institucionit të Komunitetit Mysliman, pas Kongresit të parë Mysliman Shqiptar. Botimi i saj ka zgjatur nga viti 1923 deri më 1939, kur Shqipëria hyri në një fazë tjetër historike, atë të Luftës së Dytë Botërore. Në këtë revistë, gjatë gjithë periodikut të saj vërehen tonet patriotike dhe atdhetare të shkruesve, të cilët lanë gjurmë të pashlyera me anë të shkrimeve të tyre.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Sylejman Rexhepi tha: "Revista "Zani i Naltë" ka qenë dhe mbetet edhe sot ajo që luan rolin e vet në shtimin e diturisë dhe emancipimin e popullit shqiptar". Ai tha gjithashtu tha: "Revista "Zani i Naltë", ka kontribuar për interesat e popullit shqiptar, edhe sot ky promovim bëhet në ditën kur përkujtohet Kongresi i Manastirit dhe në pragun e festës gjithëkombëtare të 28 Nëntorit."

Referatin vlerësues gjithëpërfshirës për historikun, rolin, veprimtarinë dhe rëndësinë që ka luajtur revista "Zani i Naltë" në ngritjen e vetëdijes kombë-

tare dhe fetare e majti Resul ef. Rexhepi, sekretar i Përgjithshëm i BIK-ut, i cili përveç tjerash tha: "Përmbajtja e këtij vëllimi që po e promovojmë sot, sikundër edhe gjithë numrat e "Zanit të Naltë" paraqet një punë të shkëlqyer që ngërthen në vete vlera shumëdimensionale, si në aspektin kombëtar, fetar, kulturor, edukativ e historik. Kjo, sikurse shihet edhe në editorialin e numrit të parë të kësaj reviste, kishte qenë edhe qëllimi i drejtuesve dhe botuesit të kësaj reviste, ku thuhet se "Zani i Naltë" ka për qëllim: "...M'ia zbulue popullit mysliman shqiptar të vërtetën e besimit në një mënyrë të thjeshtë e të pandërlkume..., si dhe me plotësue vllazninë ndërmjet të gjithë elementeve në Shqipni". Kjo me qëllim që, sikurse thuhet aty, "Me forcue themelet e një politike të shëndoshë e të thjeshtë kombëtare në shtetin tonë". Që nga numri i parë e deri në numrin e fundit që doli në vitin 1939, drejtuesit e revistës "Zani i Naltë" i mbetën besnikë dhe i kultivuan këto parime të shenjta e madhore.

Ndërkaq, drejtori për Kulturë i KMSH-së, Genti Kruja, u shpreh se aktivitete të tilla si ky i sotmi, marrin një rëndësi të veçantë për arsye se tregojnë edhe njëherë para mbarë opinionit publik, se rruga jonë është dhe duhet të jetë gjithmonë rruga e dijes dhe e urtësisë, e librit dhe e kulturës,

si një hallkë lidhëse dhe e vazhdueshme në zinxhirin e hapave dhe gjurmëve që na lënë hoxhallarët dhe dijetarët tanë të urtë e të ditur, paraardhësit dhe prijësit tanë myslimanë, të cilët ishin edhe plejada e fundit e rilindësve shqiptarë, të cilët me përkushtimin, devotshmërinë dhe punën e tyre bënë që ne sot pas shumë vështirësive, luftërave dhe persekutimesh nga më të egrat që ka parë shekulli XX, të trashëgojmë një pasuri të rrallë kulturore dhe studimore siç është edhe "Zani i Naltë", një zë kumbues i të vërtetës së pandryshueshme dhe të përhershme të dijes dhe mesazhit që ai përcjell, nën

dritën e pashtershme të fjalës së parë hyjnore të librit të fundit qiellor "Lexo".

Prijësit e tri bashkësive fetare islame shqiptare shprehën gatishmërinë që bashkërisht ta ribotojnë komplet kolonë e Zanit të Naltë" në 10 vëllime.

Të pranishmit në këtë aktivitet ndoqën edhe filmin dokumentar "90 vjet Zani i Naltë" të përgatitur nga produksioni i KMSH-së.

R. Shkodra

RECENSION

Naim ef. Tërnavë
Myfti i Kosovës

"ZANI I NALTË" - THEMEL I FORTË PËR VETËDIJEN FETARE E KOMBËTARE*

*I nderuari kryetar i KMSH, z. Skender
Bruçaj!*

*I nderuari Reis i Bashkësisë Islame të
Maqedonisë, z. Sulejman Rexhepi!*

*Të nderuar profesorë, studiues, ima-
më, studentë!*

*Të nderuar dashamirë të fjalës së
shkruar!*

Të nderuar të pranishëm!

Kam nderin e veçantë që në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim, t'ju falënderoj për praninë tuaj sonte në këtë manifestim promovues, kushtuar revistës "Zani i Naltë", e cila vjen te ne e ribotuar pas 90 vjetësh, si një sihariq i mirë dhe si një dhuratë e shtrenjtë për atë që shkruan e bënë ulematë tanë në fillimet e organizimit dhe the-

melimit të institucioneve të Komunitetit Mysliman Shqiptar, në kapërcyell të dekadës së parë të krijimit të shtetit shqiptar.

Të nderuar pjesëmarrës!

Themelimi i revistës "Zani i Naltë" është një nga vendimet më madhore intelektuale të Kongresit Myslimanin Shqiptar, i cili, përveç kësaj, nxori edhe vendime të tjera që u bënë themel i fortë dhe i qëndrueshëm në zhvillimin e jetës fetare, arsimore e kulturore të vendit.

Së këndjemi, "Zani i Naltë" është revista e parë zyrtare e Komunitetit Mysliman Shqiptar në gjuhën shqipe, e cila doli falë punës, angazhimit dhe vizionit të ulemave shqiptarë, para së

gjithash të Haxhi Vehbi Dibrës, dhe gjithë bashkëmenditarëve të tij, që vunë vulën e tyre në ngritjen e themeleve të institucioneve të Komunitet Mysliman Shqiptar.

Misioni i revistës "Zani i Naltë" ishte hapja e rrugës dhe krijimi i hapësirës së duhur për emancipimin, përparimin dhe edukimin e drejtë e të duhur të masës së gjerë. E konceptuar si revistë fetare islame, ajo këtë mision madhor e kreu me sukses. Mirëpo, ajo nuk mbeti në kuadër të një reviste thjesht fetare, por shumë shpejt "Zani i Naltë" u shndërrua në një tribunë të mendimit fetar, filozofik, kulturo e atdhetar, ku rreth vetes mbledhi penat më të njohura të kohës, të cilët përmes faqeve të kësaj reviste, u ofruan lexuesve kontribute nga disiplinat fetare islame dhe artikuj e studime të ndryshme me karakter filozofik, shkencor, historik, shoqëror, arsimor e kulturor, që i dhanë vlerë dhe e shquan këtë revistë nga të tjerat.

Revista "Zani i Naltë" kësaj fryme i mbeti besnik gjatë gjithë misionit të suksesshëm të saj për plot 16 vjet. Ajo mbeti model i fjalës së shkruar islame në gjuhën shqipe, ajo nxori dhe rriti shumë pena të spikatura që lanë gjurmët e tyre jo vetëm në letrat islame në gjuhën shqipe, por ajo promovoi edhe personalitete të cilët më vonë do t'i gjejmë në krye të institucioneve të ndryshme fetare e shtetërore. Për gj-

thë këto rezultate, një meritë të pakontestueshme e kanë të gjithë ata që në një mënyrë a në një tjetër kontribuuan për themelimin, botimin, mbajtjen, financimin dhe projektimin e fizionomisë së revistës "Zani i Naltë", e në veçanti këtë meritë e kanë drejtuesit e revistës, Ismail Maçi, Shyqyri Myftiu, Isa Domni, Haki Sharofi etj.

Sot, me ribotimin dhe leximin e vëllimit të parë të "Zanit të Naltë", ku janë përfshirë numrat e tre vjetve të parë të kësaj reviste, lexuesi e ka shumë të lehtë të kuptojë se ç'urtësi, filozofi, vizion, përkushtim, dashuri për Zotin e Pejgamberin, atdhedashuri e respekt për tjetrin, i ka veçuar këta dijetarë dhe njerëz të mirë.

Të nderuar të pranishëm!

Meqenëse për vlerat dhe rëndësinë që ka luajtur dhe luan sot revista "Zani i Naltë" si një burim i mirë informacionesh për kohën, kanë folur dhe kanë dhënë vlerësimet e tyre studiues të fushave të ndryshme, unë nuk e shoh të udhës të zgjas më shumë në këtë drejtim. Por, më lejoni që, më këtë rast, të shpreh konsideratën time dhe të përgëzoj Komunitetin Mysliman Shqiptar për nismën që ka marrë për të ribotuar në tërësi revistën "Zani i Naltë" që ka dalë në qarkun kohor ndërmjet viteve 1923-1939.

Uroj nga zemra dhe shpreh mbështetjen dhe përkrahjen time dhe të Ba-

shkësisë Islame të Kosovës, që ky projekt sa më parë të realizohet në tërësi dhe kështu ta kemi të kompletuar kolonën e "Zanit të Naltë" dhe ta promovojmë atë, ashtu sikurse e kemi dhe po e promovojmë sot vëllimin e parë.

Fundja, këtë e kemi detyrë ndaj të parëve tanë dhe përgjegjësi ndaj brezave që do të vinë. Njohja, respektimi dhe studimi në mënyrë meritore dhe objektive i trashëgimisë tonë, është obligimi ynë, sepse vetëm duke njohur të kaluarën mund të ndërtojmë të ardhmen dhe perspektivën.

Të nderuar të pranishëm!

Manifestimi i sotëm kushtuar "Zanit të Naltë" merr peshë dhe rëndësi edhe më të madhe ngase bëhet në vigjilje të dy përvjetorëve të rëndësishëm për popullin dhe trojet tona: Në përvjetorin e Kongresit të Alfabetit në Manastir dhe në vigjilje të festës gjithëkombëtare 28 Nëntorit, ngjarje

këto, për të cilat dhanë shumë mund dhe sakrificë dhe patën rol përcaktues edhe ulemaja shqiptare, kurse "Zani i Naltë", në të vërtetë, u bë zëdhënës besnik i jetësimit dhe zbatimit të vendimeve të këtyre dy ngjarjeve madhore në historinë e popullit shqiptar.

Dhe në fund, më lejoni të përgëzoj Komunitetin Mysliman Shqiptar, gjithashtu, edhe për një iniciativë tjetër, për nxjerrjen e revistës së re, duke ripërtërirë emrin e madh të "Zanit të Naltë". Qoftë e lartë dhe e përhershme jehona e revistës "Zani i Naltë"!

Lus Allahun e Madhërishtëm që për këso vepra të mira të tubohemi sa më shpesh!

Ju faleminderit!

* Fjala përshëndetëse e Myftiut në përurimin e Vëllimit të parë të ribotimit të revistës "Zani i Naltë", Prishtinë, 24 nëntor 2014).

RECENSION

Resul Rexhepi

REVISTA "ZANI I NALTË" ËSHTË NJË NDËRMARRJE E PROJEKTUAR NGA NJERËZ TË MËDHENJ, NGA ATDHETARË E ULEMA VIZIONARË E LARGPAMËS*

I nderuari Myfti i Kosovës, Naim ef. Tërnavë!

*I nderuari kryetar i Komunitetit Mysli-
man Shqiptar, Skënder ef. Bruqaj!*

*I nderuari reis i Bashkësisë Fetare
Islame të Maqedonisë, Sylejman ef.
Rexhepi!*

Të nderuar efendilerë!

*Të nderuar dashamirës të fjalës së
shkruar islame në gjuhën shqipe!*

Të dashur miq e të ftuar!

Zonja dhe zotërinj!

Kam kënaqësi të veçantë që para këtij auditori të nderuar, në këtë vend të bekuar, t'ju drejtohem me një fjalë rasti për promovimin e një vepre monumentale, dëshmi e një pune kolosale të një brezi të shquar të mendimtarëve fetarë shqiptarë, e realizuar në një kohë historike e domethënëse për shtetë-

sinë dhe kombin shqiptar, të cilën vepër e risjell në një vëllim puna me plot përkushtim e Komunitetit Mysli-
man Shqiptar.

Në të vërtetë, vëllimi i revistës "Zani i Naltë", të cilin po e promovojmë sot, përmbledh 20 numrat e parë me gjithsej 704, të kësaj reviste që dolën në qarkun kohore midis viteve 1923-1925, dhe është vëllimi i parë në kuadër të kolonës së "Zanit të Naltë" që pritet të botohet në tërësi.

Të nderuar të pranishëm!

Botimi i këtij vëllimi sot është i një rëndësie të veçantë edhe për faktin se përveç se na mundëson të njohim punën e vlefshme të paraardhësve tanë, po ashtu na mundëson që ta vlerësojmë drejt e objektivisht frymën, pikë-

pamjet dhe qëndrimet e Komunitetit Mysli-
man Shqiptar karshi problemeve dhe nevojave të kohës, të shprehura përmes organit të tyre që i dhanë një emër sa simbolik po aq edhe domethënëse - "Zani i Naltë".

Ribotimi i këtij vëllimi vjen si një ndihmesë e madhe edhe për komunitetet islame në trojet tona, të cilët tashmë kanë mundësinë e mirë që të njohin e të trajtojnë një pjesë të trashëgimisë së shkruar islame shqiptare në fillim të dekadës së sytë të shekulli të shkruar.

Përmbajtja e këtij vëllimi që po e promovojmë sot, sikundër edhe gjithë numrat e "Zanit të Naltë" paraqet një punë të shkëlqyer që ngërthen në vete vlera shumëdimensionale, si në aspektin kombëtar, fetar, kulturor, edukativ e historik. Kjo, sikurse shihet edhe në editorialin e numrit të parë të kësaj reviste, kishte qenë edhe qëllimi i drejtuesve dhe botuesit të kësaj reviste, ku thuhet se "Zani i Naltë" ka për qëllim: "...M'ia zbulue popullit mysliman shqiptar të vërtetën e besimit në një mënyrë të thjeshtë e të pandërlikume..., si dhe me plotësue vllazninë ndërmjet të gjithë elementeve në Shqipni". Kjo me qëllim që, sikurse thuhet aty, "Me forcue themelet e nji politike të shëndoshtë e të thjeshte kombëtare në shtetin tonë". Që nga numri i parë e deri në numrin e fundit që doli në vitin 1939, drejtuesit e revistës "Zani i Nal-

të" i mbeten besnikë dhe i kultivuan këto parime të shenjta e madhore.

Të nderuar pjesëmarrës!

Revista "Zani i Naltë" është një ndërmarrje e projektuar nga njerëz të mëdhenj, nga atdhetarë e ulema vizonarë e largpamës, të cilët me punën e tyre dhanë kontribut të çmuar në shpjegimin e mësimëve të fesë islame drejt dhe sakt dhe në bërjen e shtetit e formësimin e kombit. Është ky brezi i artë i prijësve të shquar myslimanë që lanë gjurmë të pashlyera në historinë tonë kombëtare dhe fetare, si Haxhi Vebi Dibar-hoxha që dhe fetvanë për Aktin e Shpalljes së Pavarësisë, e më vonë edhe themelues dhe kryetar i parë i Komunitetit Mysli-
man Shqiptar, ulematë e dëshmuar: Hafiz Ali Korça, Hafiz Ismet Dibra, Ismajl Maçi, Jonuz Bulej, Haki Sharofi, Ferit Vokopola, Qazim Hoxha, e shumë të tjerë, pa lënë anash këtu edhe personatetet tjera të mendimit politik, kulturor e letrar, siç ishte Mit'hat Frashëri dhe bashkëmendimtarë të tjerë. Kjo ka bërë që edhe 90 vjet pas shkrimet që janë botuar në "Zanin e Naltë", të mbesin prore aktuale dhe të tingëllojnë si të jenë thënë sot.

Të nderuar pjesëmarrës!

Duke shfletuar e lexuar faqet e revistës "Zani i Naltë", lexuesi s'ka si të mos bindet se firmat e vëna në këto

shkrime u përkasin atyre dijetarëve që qenë njohës të mirë të mësimëve të fesë, kulturës e qytetërimit islam. Ata, përmes revistës "Zani i Naltë", këto njohuri, i shprehën dhe ua ofruan lexuesve shqipfolës. Mirëpo, drejtuesit e revistës "Zani i Naltë" dhe bashkëpunëtorët e tyre, përveç se njihnin mirë mësimet fetare, ata njihnin mirë edhe traditën dhe historinë tonë. Ata e dinin se për çka kishte nevojë dhe çfarë i duhej shpirtit dhe mendjes së popullit shqiptar në atë kohë. Ata ishin të bindur se ngritja e ndjenjës fetare dhe kombëtare në një kohë kur po sendërtohej kombi dhe po jetësohej shteti, ishte detyrim i tyre nga Zoti dhe nga gjaku. Prandaj, revista "Zani i Naltë", s'kishte si të ishte tjetër veçse projekt i kolosëve të binomit Atdhe e Fe.

Pikërisht për këtë, nuk na habit fakti se themeluesit dhe penat e para të revistës "Zani i Naltë" qenë pjesëmarrës aktivë dhe patën rol aktiv në Shpalljen e Pavarësisë, në krijimin e Shqipërisë së lirë e të pamvarme, në themelimin e Komunitet Mysliman Shqiptar, dhe më pastaj krijim e organeve dhe institucioneve të tjera, në nxjerrjen e të parës reviste islame në gjuhën shqipe. Ata me mprehtësinë e lapsit, thellësinë e mendjes, motivimin hyjnor e atdhetar, kultivuan mësimet për njohjen e Krijuesit, edukimin shpirtëror, motivin për atdhedashuri dhe

kultivim të gjuhës e të kulturës shqiptare.

Të nderuar të pranishëm!

"Zani i Naltë" shtroi shtrat këtu e 90 vjet më parë, kur vendi gjendej përballë sfidave të mëdha. Mirëpo, megjithëkëtë kjo revistë, falë drejtuesve të KMSH-së të saj kohe, arriti të bëhej një zë i fuqishëm i së vërtetës, vazhdimësi e frymës dhe mendimit të rilindësve tanë.

Tematika e llojllojshme dhe cilësia e tyre, niveli i lartë teologjik, shkencor e kulturor i bashkëpunëtorëve, e kanë bërë revistën "Zani i Naltë" të njohur dhe të çmuar brenda dhe jashtë vendit, si një organ që ka dhënë mësim e mesazhe diturie, paqe mirësie bashkëpunimi, mirëkuptimi e tolerance ndër-fetare për të mirën e vendit.

"Zani i Naltë" qe një tribunë në të cilën gjetën hapësirën e duhur parashtrimi, analiza, diskutimi dhe debati për marrëdhëniet shoqërore e familjare, për emancipimi e femrës myslimane, për qëndrimet ndaj hallallit e haramit, kuptimi i drejtë i civilizimit dhe progresit, lufta kundër veseve shoqërore etj.. Një segment të rëndësishëm revista i ka kushtuar kultivimit të mirëkuptimit e bashkëjetesës, në përputhje me parimet kombëtare pa cenuar ato fetare të asnjë feje a besimi.

Me një fjalë, përmbajtja e revistës "Zani i Naltë" është një pasuri e çmu-

eshme kulturore, është një traditë e bukur fetare-atdhetare, është një ndihmesë e vyer në publicistikën e shkencën shqiptare në përgjithësi dhe në fushat islame në veçanti, sepse "Zani i Naltë" nuk ishte vetëm një tribunë për lëvizjen e mendimit islam në Shqipëri, të cilës i dha trajtë, shpirt e formë, por është e rëndësishme edhe për vetë historinë e shtypit tonë kombëtar.

Këtë, me të drejtë, e ka vënë në dukje edhe profesori i historisë bashkëkohore në Universitetin e Kalabrisë, Roberto Maroco della Roca, i cili duke dhënë vlerësime për revistën "Zani i Naltë, në veprën e tij "Kombësia dhe feja në Shqipëri, 1920-1944", konstaton, citoj: "Zani i Naltë" është një rrjedhojë për realizmin faktik të pavarësisë së shpallur më 1912... Revista ka tone të spikatura patriotike. "Zani i Naltë", - thekson ky profesor, - "jo pa një frymë triumfalizmi të vërtetë të fesë islame, nënvizon përhapjen e saj në tërë botën. Është për t'u shënuar këmbëngulja e revistës për sa i përket përhapjes së Islamit që po ndodhte në Perëndim, në Evropën që "ka humbur Perëndinë"".

Por jo vetëm kaq, roli i "Zanit të Naltë", dilte edhe përtej kufijve gjeografikë të Shqipërisë së sotme. Në kohën kur doli kjo revistë, Kosova, krahinat shqiptare në Maqedoni dhe vise të tëra në Serbi e Mal të Zi, po kalonin një nga periudhat më të vësh-

tira, ata po vuanin nën sundimin e Mbretërisë Jugosllave, ku gjuha dhe mësimi shqip ishin rreptësisht të ndaluara. Megjithatë, edhe në këtë kohë u gjeten mënyra që literatura islame në gjuhën shqipe që botohej asokohe në Shqipëri të depërtonte në këto vise. Këtë e dëshmon fakti se në bibliotekat e ulemave tanë të mëhershëm kemi gjetur ekzemplarë, jo vetëm të revistës "Zani i Naltë", po edhe të botimeve të tjera të botuara nga Këshilli i Naltë i Sheriatit në Tiranë.

Të nderuar të pranishëm!

Megjithëse revista "Zani i Naltë" kishte krijuar identitetin e saj, dhe megjithëse kishte arritur të krijonte një masë të konsiderueshme të lexuesve, ajo për shkaqe subjektive më 1939, ndërpreu botimin e saj, për të lënë pas një bagazh të çmuar fetar, kombëtar e kulturor, si dhe për t'i trasuar rrugën simotrave të tjera që u themeluan më vonë. Ndikimi i "Zanit të Naltë" qe i madh dhe sa më shumë që rridhnin ditët, aq më shumë i shtohej vlera dhe rëndësia kësaj reviste. "Zani i Naltë" mbeti si pikë referimi për studiuesit e kësaj periudhe, sepse ai ishte një si kronikë e kohës, ai u bë model për themeluesit e revistave të tjera që dolën më pastaj, sepse i tillë ishte "Zani i Naltë".

Të nderuar të pranishëm!

Mua nuk me mbetet tjetër të them, veçse të përgëzoj edhe njëherë punën që ka bërë Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, që ka marrë iniciativën për "rikthimin" e "Zërit të Naltë" dhe atë t'ua ofrojë masës së gjerë të lexuesve. Konsideroj se vëllim i revistës "Zani i Naltë" patjetër duhet që të zërë vend në bibliotekat tona, në bibliotekat e fakulteteve dhe medreseve tona, dhe të na shërbejë si një mbështetje e fortë në rrugëtimin tonë drejt njohurive dhe të arriturave të reja.

Dhe fare në fund, më lejoni të shpreh gëzimin tim për ndërmarrjen e Komunitetit Mysliman shqiptar për rinxjerrjen e kësaj reviste dhe vazhdimin e kësaj tradite të begatë. Kështu kjo revistë po i kthehet institucionit i cili i dha emrin, i dha fizionominë, e rriti dhe e zhvilloi këtë revistë.

Po ashtu më lejoni të shpreh një mirënjohje të posaçme për ish-kry-

etarin e Komunitetit Mysliman Shqiptar, Haxhi Selim Muçën, nën përkujdesjen e të cilit u përgatit ky vëllim, i cili sigurisht, që do të pasohet edhe nga vëllime të tjera, derisa të përmbyllet në tërësi i gjithë projekti. Përgëzoj po ashtu edhe drejtorin për kulturë në KMSH, Genti Krujen, i cili ka bërë një punë të madhe në mbledhjen dhe përgatitjen teknike të këtij vëllimi.

Lusim Zotin e Madhërishëm që kësso punë të hajrit të urojmë sa më shpesh dhe sa më shumë!

Ju faleminderit!

* Refetar i mbajtur në përrurimin e vëllimit të parë të ribotimit të revistës "Zani i Naltë", Prishtinë 24 nëntor 2014).

RECENSION

Genti Kruja

“ZANI I NALTË” - NJË ZË KUMBUES I TË VËRTETËS SË PANDRYSHUESHME*

*Të nderuar kryetarë të tre bashkësive
Islame, të Shqipërisë, Kosovës dhe
Maqedonisë, drejtues të lartë të
këtyre bashkësive!*

*Të nderuar studiues, njerëz nga bota
akademike dhe ajo e kulturës!*

Të nderuar miq dhe të ftuar!

Aktivitete të tilla si ky i sotmi, marrin një rëndësi të veçantë për arsye se tregojnë edhe njëherë para mbarë opinionit publik, se rruga jonë është dhe duhet të jetë gjithmonë rruga e dijes dhe e urtësisë, e librit dhe kulturës, si një hallkë lidhëse dhe e vazhdueshme në zinxhirin e hapave dhe gjurmëve që na lënë hoxhallarët dhe dijetarët tanë të urtë e të ditur, paraardhësit dhe prirësit tanë myslimanë, të cilët ishin edhe plejada e fundit e rilindësve shqiptarë, të cilët me përkushtimin, devot-

shmërinë dhe punën e tyre bënë që ne sot pas shumë vështirësish, luftërash dhe persekutimesh nga më të egrat që ka parë shekulli XX, të trashëgojmë një pasuri të rrallë kulturore dhe studimore siç është edhe “Zani i Naltë”, një zë kumbues i të vërtetës së pandryshueshme dhe të përhershme të dijes dhe mesazhit që ai përcjell, nën dritën e pashtershme të fjalës së parë hyjnore të librit të fundit qiellor “Lexo”.

Çdo shtëpi intelektualit dhe dijedashësi mysliman shqiptar të viteve 20 dhe 30 të shek. XX, do ta kishte pjesë së bibliotekës së vet, e pasur apo modeste qoftë ajo, revistën “Zani i Naltë”. E më pas shumë prej tyre e ruajtën dhe e fshehën si një relike gjatë komunizmit. Ne si Komunitet Mysliman

i Shqipërisë, pas shumë vitesh kërkimi dhe pune voluminoze arritëm që ta skanojmë të gjithë kolanën prej më shumë se 5.000 faqesh të 153 numrave të dalë nga 1923 deri më 1939, për 16 vjet të revistës “Zani i Naltë” dhe prej disa kohësh ka nisur puna për pastrimin në versionin digjital të çdo faqeje të skanuar të revistës “Zani i Naltë”, si një thesar i çmuar që është, duke e përgatitur si botim në 10 vëllime.

Ky botim vjen si faksimile e origjinalit me gjuhën zyrtare të atyre viteve. Po kështu është hartuar edhe përmbajtja, e ndarë sipas numrave të revistës me gjuhën origjinale. E njëjta gjë është bërë edhe me numrin e faqeve, të cilat janë të gjitha sipas origjinalit, ku revista pasardhëse ka vazhduar numrin rendor të revistës paraardhëse, e kështu në bazë të saj është ndarë edhe kolana në 10 vëllime.

Sot, pas Tiranës, ne po promovojmë edhe në Prishtinë, vëllimin e parë të kësaj kolone, të përbërë prej 720 faqesh, e cila i hap rrugë botimit dhe plotësimit të të gjitha vëllimeve në një kohë sa më të afërt.

Krahas këtij botimi, më 2012, kur të gjithë po përjetonim 100-vjetorin e ngritjes së flamurit, jo rastësisht Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, vendosi ta rithemelojë organin e vet të parë

zyrtar, revistën “Zani i Naltë” dhe sot pas 2 vjeësh ka dalë edhe numri i 9-të i saj, ku në këto 9 numra janë botuar rreth 100 artikuj shkencorë në rreth 1.000 faqe, ku dhjetëra studiues dhe personalitete akademike, shpalosën dijet dhe punën e tyre shkencore, në fusha tilla si shkenca islame, shkenca sociale, si sociologji, filozofi, psikologji, por edhe në histori, shkenca komunikimi, shkenca ekzakte, jurisprudence, gjuhë-letërsi, mjekësi etj., duke u bërë kështu një vlerë e shtuar në bibliotekat shqiptare.

Në fakt, myslimanët shqiptarë, kudo në trevat e tyre, historikisht kanë qenë promotorë në promovimin e vlerave të larta islame dhe ato atdhetare. Personalitetet e shquara shqiptare të kulturës islame ishin ata që u gjenden të parët së bashku me të gjithë bashkatdhetarët e tyre të besimeve të tjera, që në xhaminë Bajrakli dhe në Medresenë e Mehmet Pashës, ku kurorëzuan fatet e atdheut në Lidhjen e Prizrenit dhe më pas në vitin 1912 shpallën pavarësinë, duke filluar ndërtimin e shtetit shqiptar dhe duke kontribuar në të gjitha fushat për të mirën e vendit dhe popullit tonë.

Dua të shfrytëzoj gjithashtu edhe këtë tubim, që t’u bëj thirrje të gjithë studiuesve që të bëhen pjesë e tribunës

“Zani i Naltë”, si një revistë e të gjithëve.

Me dëshirën e suksesit nga Zoti i Madhëruar, shpresojmë që ky botim dhe të tjera si kjo që botojnë të tre bashkësitë tona, të përmbushin misionin e tyre në shërbim të dijes dhe kulturës,

kaq të dashura për popullin tonë dhe kaq të nevojshme për brezat e rinj.

Ju faleminderit!

* Fjalë përshëndetëse në përrurimin e Vëllimit të parë të ribotimit të revistës "Zani i Naltë", Prishtinë 24 nëntor 2014).

RECENSION

Nuridin Ahmeti

SHKUPI - NË OPTIKËN E NJË PUBLICISTI (Kim Mehmeti, Shkupi, Logos – A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2011, f. 263)

Në kuadër të bibliotekës së botimeve të veçanta të Shtëpisë Botuese “Logos- A”, me qendër në Shkup, në vitin 2011, është botuar edhe libri i shkrimtarit e publicistit të njohur, Kim Mehmeti, me një titull shumë domethënës dhe aktual: “Shkupi”.

Në fakt, ky libër është një ese historike, por që nuk mungojnë argumentet historike të ngjarjeve, të interpretuara në mënyrë sintetike dhe analitike.

Ky interpretim a shkrim i historisë nuk paraqet asnjë problem për Emanuel Kantin, i cili konstaton se “historia mund të shkruhet edhe në formë publicistike” (Immanuel Kant, *Ese në filozofinë historike dhe politike*, SHB “Fan Noli”, Tiranë, 2004, f. 148), dhe as për Isiaha Berlinin, Joste-

in Garderin, e Karl Poperin. Ky i fundit, për më tepër, pohon se shoqëria ka një kujtesë “të cilën ne zakonisht e quajmë histori” (Karl Poper, *Mjerimi i historicizimit*, Onufri, Tiranë, 1996, f. 26).

Përkitazi me këtë, autori i “Shkupit”, Kim Mehmeti, kur flet për vendbanimet, i thotë lexuesit se vendbanime nuk janë vetëm ato që i shohim dhe se “tërësinë e tyre nuk e përbejnë vetëm godinat e larta apo të ulëta, ato nuk janë vetëm ndërthurje e rrugëve luksoze dhe të atyre të varfërve, të rrugicave të padukshme, ku zhvillohet jeta në paraskenë” etj., Por, “qytetet janë tërësi kronikash të vulosura në mbamendjen e njerëzve, të gdhendura si shenja të padukshme nëpër trotualet e muret, ku janë vulo-

sur kujtimet për ngjarjet e ndryshme që kanë të bëjnë me fatet individuale e kolektive...; ato janë tërësi nënshkrimesh të ndrydhura që kanë lënë ndërtuesit e objekteve” (Shkupi, f. 191).

Përderisa, autores turko-amerikane, Burcu Akan Ellis, i është dashur që të qëndrojë për disa vite në Shkup, dhe në disa qytet të tjera të Maqedonisë, për të mësuar dhe më pas për t’i venë në letër disa nga problemet që lidhen me identitetin e një pjese të qytetarëve të Maqedonisë, për autorin Kim Mehmeti, kjo ishte një punë e zgjidhur, sepse ai ka lindur në rrethinën e Shkupit, është rritur dhe edukuar me hallat e banorëve të këtij qyteti, ka shijuar të mirat e të këqijat që i ofron ky qytet, i ka përjetuar intrigat e pushtetarëve në dy sisteme të ndryshme etj. Dhe pikërisht kjo e ka shtyrë autorin që këto përjetime personale dhe kolektive të banorëve të Shkupit, t’i përmbledhë mes dy kapakëve dhe t’ua ofrojë dhe t’i ndajë me një numër më të madh të lexuesve e bashkëkombësve të tij, që jetojnë përtej qytetit të Shkupit.

Libri “Shkupi” ka 264 faqe, me një format jo të zakonshëm të librave dhe me një përgatitje teknike, të cilës “do t’ia kishin lakmi edhe shtëpitë botuese anglosaksone”, thënie kjo e huazuar nga studiuesi boshnjak, Xhemaludin Latiç.

Përshkrimi dhe rrëfimi i ngjarjeve është ilustruar dhe e dokumentuar, po-

thuajse në çdo faqe, me fotografi, që i jep edhe më shumë vlerë argumentuese e dokumentare librit dhe gjithë asaj që është shkruar e thënë aty.

Teksa shfletojmë librin “Shkupi”, lexuesit s’ka se si të mos i bjerë në sy fakti se autorin e kësaj vepre më së shumti e bren e kaluara e qytetit të Shkupit, e bren dhe i qan zemra për atë që ka shkruar në pakthim, për atë që nuk është më, për ato objekte e personalitete, që nuk mund t’i kthejmë dot më, për ato dëshmi e fakte që kanë ikur për të mos i njohur kurrë më, dhe sikur autori i thotë lexuesit se sikur t’i kishim këto sot do të ishte shumë më lehtë për ne, për gjeneratën tonë, për banorët e Shkupit, dhe me gjerë.

Autori konstaton me të drejtë se, sikur lumi i Vardarit që ndan Shkupin në mes dhe me vete gëlltit rrjedhat e lumenjve të Lepencit, Treskës e Seravës (f.27), ashtu është edhe qyteti i Shkupit të sotëm, që sikurse lumi Vardar që ka grabitur ujërat e disa lumenjve, ky qytet ka bërë të padukshme edhe shumë gjurmë nga e kaluara prej disa shekujve, të cilat janë mbuluar me shtresa të reja (f.27), që nga Ilirët, që sipas autorit, e themeluan këtë qytet, i cili paraqet unazën e Dardanisë, qytet ky nga ku shpërndahen damarët e Ballkanit.

Shkupi i ndarë mospërmas nga lumi Vardar, me përmendoret e ngritura për të treguar lashtësinë e paqenë nga ata

që sot veten e quajnë maqedonas, nga ata që besojnë, thekson autori, që edhe; “dielli e hëna edhe qielli e toka kanë përkatësinë e tyre religjioze” **(f.29)**, edhe sot e kësaj dite vazhdojnë me shlyerjen e gjurmëve të lashtësisë të këtij qyteti, me ngritjen e përmendoreve, moslejinin për festimin e datave të çlirimit të Shkupit nga shqiptarët, që u bë katër herë gjatë historisë, i pari i udhëhequr nga Dervish Cara, i dyti në vitin 1880, i udhëhequr nga Jashar bej Kumbara, i treti në vitin 1912, nga Hasan Prishtina, dhe i katërti pas Luftës së Dytë Botërore **(f.203)**. Manipulime të tjera, gjithmonë në kurriz të shqiptarëve, u bënë edhe me regjistrimin e popullsisë, ku nga regjistrimi i parë i vitit 1948, numri i shqiptarëve gjithmonë është në rënie, pa dhënë asnjë përgjigje deri më sot, pse ndodh kjo, e shumë gjëra të tjera janë padyshim, mjete që çojnë, sipas autorit të këtij libri, në deshqip-tarizimin e qytetit.

Por, në të gjithë këtë padrejtësi, pjesën e tyre të fajit, sipas autorit Kim Mehmeti, e kanë edhe ata:

1. Shqiptarë që “duke u grindur me zjarimin e tyre lokalist”, thekson autori, “ata në të vërtetë e humbin një pjesë të së kaluarës dhe të sotmes së vet” **(f.29)**.
2. Fajin e kanë edhe ata që shkruajnë historinë, konkretisht mungesa e librave të mirëfillta, se këto libra si-

pas autorit, nuk janë shkruar akoma dhe se ato që janë shkruar deri më tani janë “si piktura, ku çdo gjë është ngjyrosur dhe është vendosur sipas prirjeve dhe dëshirës së autorit” **(f.66)**.

Pjesë me rëndësi në këtë libër është edhe çështja e feve, e trajtuar në këtë libër, që autori i quan “shtylla të rëndësishme për ta bërë jetën më të qëndrueshme dhe kuptimplotë” **(f.143)**. Për Shkupin por edhe për shqiptarët kudo në Maqedoni, çfarëdo partie me bindje politike që vjen në pushtet, kur është fjala kundëra islamit ato mbajnë qëndrime të njëjta, sa ma shumë ndërtime të kishave ortodokse dhe vënie të kryqeve nëpër kodrina të larta që të shihen nga të gjitha anët e vendit, por ajo më e dhimbshmja ishte dëbimi i popullatës myslimane në vitet e 50-ta për në Turqi. Autori është i bindur se “në Shkup dhe rrethinë, religjioni islam ndihmoi që të mbijetonte edhe përkatësia etnike” **(f.156)**, dhe theu çdo tabu se shkupjanët kishin ndërruar emblemat e tyre kombëtare me atë fetare. Dhe se prapa çdo trazire etnike, qëndron ana religjioze, kjo u dëshmuar edhe me trazirat e vitit 2001, konstaton autori i veprës “Shkupi”.

Si përfundim në këtë fjalë timen, do të thosha se monografia “Shkupi” e autorit Kim Mehmeti, është një nga librat më interesant, të shkruar për ndonjë qytet në kohët e fundit.

Ky libër është me interes për t’u lexuar, sepse hallet dhe peripecitë në të cilat ka kaluar popullata e Shkupit me rrethinë, posaçërisht ajo myslimane, për ç’gjë bën fjalë autori, nuk dallojnë shumë nga hallet dhe brengat e popullatave të qyteteve tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, pothuajse janë të njëjta.

Është libër interesant për t’u lexuar, sepse mënyra e ilustrimit artistik të fakteve dhe guximi për ta thënë të vërtetën historike, e bëjnë këtë libër të veçantë.

Është libër interesant për t’u lexuar, sepse libri është ese historike, në fakt ka disa zhanre në shtjellimin e ngjarjeve që e bën atraktiv për t’u lexuar, për të gjitha shtresat intelektuale, pa dallime profesionale.

Është libër interesant për t’u lexuar edhe për banorët e Prizrenit dhe të rrethinës, sepse aty lexuesi has shumë gjëra të përbashkëta, ndërmjet qytetit të Shkupit dhe Prizrenit, si: ekzistimi i grupeve ndërfetare e ndëretnike, tra-

shëgima e pasur kulturo-historike, kallahatë, xhamitë, kishat, urat etj., dhe padyshim se leximi i një monografie të tillë, ndoshta do ta nxiste kureshtjen e ndonjë lexuesi, apo studiuesi nga ky qytet, për të na dhuruar diçka të tillë edhe për qytetin e Prizrenit.

Në qoftë se dikur Gj. Fishta, në veprën e tij monumentale “Lahuta Malcis”, shkroi se si u end fati i Shqipërisë. Në veprën e tij “Shkupi”, autori Kim Mehmeti, por në një stil tjetër, ka shkruar se si u end fati i Shkupit dhe shkupjanëve me rrethinë.

Dhe fare në fund, më lejoni të them një gjë të njohur nga të gjithë ne, se qyteti i Shkupit, në mendjen dhe zemrën e shqiptarëve kudo që janë, ka një domethënie të veçantë. Shkupi, së bashku me Prizrenin tonë, ku jemi sonte dhe me Vlorën, paraqesin tri qendrat kryesore, paraqesin trekëndëshin historik të shqiptarëve.

Prizren, 22. 08. 2013

RAHMETLINJTË TANË

Qemajl Morina

KONTRIBUTI I PROF. MEHDI POLISIT NË SHTYPIN ISLAM TË KOSOVËS (27.11.1953-21.05.2014)

Më 21 maj të vitit 2014, u nda nga jeta prof. dr. Mehdi Polisi, pedagog shumëvjeçar i osmanishtes në degën e Orientalistikës, të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Të shkruash për veprimtarinë e prof. Mehdi Polisit, nuk është një punë e lehtë, sepse i ndjeri kontribuoi në shumë lëmi të shkencave. Ai pas vete la vepra autoriale, studime, hulumtime dhe përkthime. Mori pjesë në tryeza, konferenca shkencore e kongrese vendore, rajonale e ndërkombëtare. Pas vete la vepra me vepra vlerë të përkthyer nga turqishtja, arabishtja dhe boshnjakishtja. Lirisht mund të thuhet se prof. dr. Mehdi Polisi llogarite ndër osmonologët më të njohur bashkëkohor jo vetëm në trojet shqiptare, por edhe në Ballkan. Për këtë, si dhe shumë aspekte të veprave të tij në të ardhmen do të shkruajnë studentët e të ndjerit, të cilët me siguri do të trasojnë rrugën e profesorit të tyre.

Më këtë rast vlen të theksojmë se studiuesi dhe përkthyesi më i mirë i Sami Frashërit në gjuhën shqipe ishte prof. i nderuar Mehdi Polisi. Për këtë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, mbajtur në Prishtinë në vitin 2014 në Prishtinë,



prof i gjuhës turke, Irfan Morina, në temën e tij duke folur për Samiun me rastin e 114 vjetorin e vdekjes së tij, duke e kujtuar vdekjen e kolegut tij, ai kishte thënë: “Sot duhet ta kujtojmë osmanologun që e bëri Samiun të flasë shqip”.

Mirëpo, unë kësaj radhe do të ndalem në një aspekt të vetëm e ai ka të bëjë me aspektin e kontributit të tij në shtypin islam të Kosovës, me të cilin na lidhin kujtime nga e kaluara e jonë e përbashkët, nga pozita ime si përgjegjës i veprimtarisë botuese apo në aspektin e përgjegjësisë sime si kryeredaktor i revistave “Dituria Islame” apo më vonë “Edukata Islame”. Ajo që e kishte bërë këtë bashkëpunimin tonin të jetë më i ngushtë, ishte njohja e jonë e kahershme nga bankat e Medresesë së Mesme “Alauddin” të Prishtinës, kur neve na ndante vetëm një vit kalendarik.

Kështu që edhe pse më vonë ish-kolegu ynë, nga Medreseja në studimet e tij u orientua në drejtim tjetër, megjithatë, ai ishte i hapur për bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës dhe institucionet e saja.

Kështu shkrimin e parë që prof. Mehdi Polisi e botoi në “Diturinë Islame” mban titullin: “Adaptimet fonetike të arabizmave në gjuhën shqipe”. Kjo temë, meqenëse shtjellonte tezën e magistraturës u bo-

tua në tri vazhdimë: Nr.19/nëntor 1990; nr. 20/dhjetor 1990; nr. 21/janar 1991, Prishtinë.

Kështu në vazhdimin e parë, ai bënë fjalë për çështjen e transkriptimit të shkrimit arab, transkriptimit të bashkëtingëlloreve dhe zanoreve.

Në vazhdimin dytë, autori bënë fjalë për adaptimet e bashkëtingëlloreve, duke i ndarë në dy grupe: Bashkëtingëllore identike dhe bashkëtingëllore specifike arabe.

Në vazhdimin e tretë, prof. Polisi flet për adaptimin e zanoreve, duke i ndarë në zanore të shkurtra dhe të gjata.

Tema tjetër, për të cilën u diskutua një kohë bukur të gjatë, për të cilën meritë i veçantë i takon Elez Osmanit, në atë kohë redaktor i revistës “Dituria Islame”, si iniciator për fillimin e projektit dhe rëndësinë e tij.

Disa fjalë rreth Kamus al-a’almit; Abdul Beu (Frashëri). Dituria Islame, nr. 22-23/ shkurt-mars 1991, Prishtinë, (Seria e personaliteteve shqiptare në Kamus al-a’lam të Sami Frashërit do të vazhdojë deri në nr. 42 të kësaj reviste, nën rubrikën: Nga trashëgimia jonë kulturore).

Përdorimi i terminologjisë islame në gjuhën shqipe, Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, (përmbledhje punimesh të Simpoziumit Ndërkombëtar), Prishtinë, 1995. f. 317-322.

Leksiku islam pjesë përbërëse e leksikut të shqipes, Terminologjia islame, Prishtinë, 2006; edhe në Edukatë Islame, 2005.

Nuk ishin të rralla rastet kur Redaksia e “Diturisë Islame”, me rastin e botimit të ndonjë numri ekskluziv kërkonte nga bashkëpunëtorët e saj të shkruanin ndonjë temë të veçantë. Kërkesa të këtilla zakonisht i drejtoheshin edhe prof. Mehdi Polisit, të cilave iu përgjigjej me kënaqësi, qoftë edhe me përkthim nga boshnjakishtja, siç janë temat vijuese, me ç’gjë tregonte modestinë e tij prej dijetari.

- Shkaqet e shpalljes së Kur’anit, “Dituria Islame”, nr. 29/1991.
- Agjërimi, “Dituria Islame”, prill/1991
- Zekatu-l-Fitri, “Dituria Islame”, nr. 30/prill 1992

Me të ndjerin për herë të fundit para se të ndërronte jetë kemi bashkëpunuar në projektin e iniciuar Ministria e Vakufëve dhe çështjeve islame e Kuvajtit, që emërtohej me emrin “Enciklopedia kuvajtiane për botën islame dhe pakicat myslimane”.

Si zakonisht, obligimet i kryente me përpikëri dhe me sinqeritet të plotë. Temat të cilat i propozoheshin i merrte pa hezitim dhe në kohën duhur i prezantonte koordinatorit të grupit punues.

I ndjeri, po ashtu kishte qenë aktiv në revistën “HIKMET”, e cila kishte filluar të dalë vetëm një vit më parë, andaj në kohën kur ai kishte dhënë kontributin e tij më të madh, në nr. 6 të revistës lexojnë lajmin e vdekjes së prof. të nderuar. Por, ajo që Redaksia e revistës në fjalë ia kishte kthyer “të mirën me të mirë” ishte botimi i biografisë së të ndjerit dhe bibliografinë e tij që ai kishte lënë pas vdekjes së tij.

Me këtë rast kam nderin që ta falënderoj Redaksinë e revistës “Hikmet” për shërimin që i bëri revistës “Edukata Islame”, duke i huazuar këto të dhëna nga revista në fjalë.

Për këtë lusim Allahun e gjithëfuqishëm që profesorin tanë të nderuar ta shpërblejë me xhenetin Firdevs..

Mehdi Polisi, u lind më 27.11.1953, në fshatin Dobovjan, të Strugës. Shkollën fillore e kreu në Dobovjan dhe Veleshtë të Strugës, kurse të mesmen në Prishtinë, medresenë “Alaudin”, më 1973. Në vitin shkollor 1973/74, është regjistruar në Fakultetin Filozofik (tani Filologjik) të Universitetit të Prishtinës, në degën e Orientalistikës. Ka diplomuar më 1977. Është student i gjeneratës së parë dhe ndër të parët që ka diplomuar në degën e Orientalistikës në Prishtinë. Pas diplomimit ka punuar në Arkivin Historik në Ohër (1978/80). Më 1980, ka filluar punën në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, në degën e Orientalistikës, së pari si asistent, e pastaj si ligjërues i gjuhës turke. Më 1982/83, ka qëndruar në Stamboll të Turqisë, për hulumtime shkencore. Më 1988, në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, ka mbrojtur punimin e magjistraturës me titull “Adaptimet fonetike dhe morfologjike të huazimeve orientale në gjuhën shqipe” dhe më 1997, po në këtë fakultet, ka mbrojtur edhe punimin e disertacionit të doktoratës me titull: “Turqizmat në të folmet shqipe të Maqedonisë”, dhe kështu mori

gradën: Doktor i Shkencave Filologjike. Ndërkaq, nga 1 tetori i vitit 2004, deri më 1 tetor 2012, ka qenë prodekan i Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Ishte në marrëdhënie të rregullt pune si mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, në degën e Orientalistikës, në thirrjen universitare profesor i rregullt (ordinar). Është angazhuar edhe në Universitetin e Tetovës, (që nga themelimi i tij) (1994), në degën e Historisë për lëndën e Osmanishtes (në shkallën e dytë dhe pastaj edhe në shkallën e tretë të studimeve) dhe më vonë ligjëroi edhe lëndën e gjuhës turke në degën e Filologjisë Orientale në USHT (i angazhuar). Për lëndën Gjuhë turko-osmane ka qenë i angazhuar edhe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup, që nga themelimi i tij (1997), e deri në qershor të vitit 2002. Ishte anëtar për hartimin e Enciklopedisë së Republikës së Kosovës, sipas projektit të shtetit të Kuvajtit: Enciklopedia e Kuvajtit për Botën Islame dhe pakicat myslimane. Ka marrë pjesë aktive në tubime shkencore me kumtesa. Në moshën 60-vjeçare nga një sëmundje e shkurtër ndërroi jetë më 21.05.2014, në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë.

Prof. Polisi pati një veprimtari të bujshme shkencore dhe kulturore, megjithatë ai në mendjet tona do të mbetet i gjallë me dashurinë e pafund që kishte për Sami Frashërin. Për atë gati tërë jetën ia kishte kushtuar studimit dhe përkthimit të veprimtarisë së Sami Frashërit. Duhet theksuar se prof. Polisi ishte një bashkëpunëtor i palodhshëm dhe i sinqertë i revistës “Hikmet”, të cilën e ndihmoi në ditët më të vështira me punime, artikuj shkencorë, me këshilla e sugjerime. E lusim Zotin e Plotfuqishëm që ta shpërblejë me gradat më të larta të Xhenetit!

Në vazhdim do të përmendim disa nga veprat shkencore-kulturore të prof. Polisit:

Vepra autoriale dhe të përkthyer:

1. Sami Frashëri, Vepra 5, Dashuria e Talatit me Fitnetin, Rilindja, Prishtinë, 1984; Tiranë, 1992 (bot. i dytë); Logos-A, Shkup, 2002 (bot. i tretë); Logos-A, Shkup, 2004 (bot. i katërt) (në kuadër të kompletit të veprës së Sami Frashërit, me numrin e serisë 09. Vepra më e plotë e Sami Frashërit në gjuhën shqipe: 1-20 vepra).

2. Salih Gjukë Dugagjini, Shkrolaria e shqypes, BI e Kosovës, Prishtinë, 1991.
3. Sami Frashëri, Vepra 9, Personalitetet shqiptare në Kamus al-a’lam të Sami Frashërit, Logos-A, Shkup, 1994; 2002 (bot. i dytë); Logos-A, Shkup, 2004 (bot. i tretë) (me numrin e serisë 02).
4. Sahihu-l-Buhari në gjuhën shqipe 1, Prishtinë, 1995.
5. Sami Frashëri, Vepra 10, Qytetërimi islam, Prishtinë, 1999; Logos-A, Shkup, 2002 (bot. i dytë); Logos-A, Shkup, 2004 (bot. i tretë) (me numrin e serisë 13).
6. Sami Frashëri, Vepra 11, Gjuha, Prishtinë, 2001; Logos-A, Shkup, 2002 (bot. i dytë); Logos-A, Shkup, 2004 (bot. i tretë) (me numrin e serisë 07).
7. Gramatika e gjuhës turke, Logos, Prishtinë, 2002, Logos-A, Shkup, 2009 (bot. i dytë).
8. Sami Frashëri, Anekdota, Logos-A, Shkup, 2003; Logos-A, Shkup, 2004 (bot. i dytë) (me numrin e serisë 11).
9. Hafiz Ali Ulqinaku: Abetarja shqipe (Vepër e lënë në dorëshkrim me alfabet arab-osman). Është botuar në kuadër të Monografisë: Hafiz Ali Ulqinaku-Jeta dhe vepra, Logos-A, Shkup, 2005, f. 52-101.
10. Sami Frashëri, Qielli, Logos-A, Shkup 2004 (me numrin e serisë 16).
11. Sami Frashëri, Toka, Logos-A, Shkup, 2004 (me numrin e serisë 17).
12. Sami Frashëri, Njeriu, Logos-A, Shkup, 2004 (me numrin e serisë 18).
13. Sami Frashëri, Përsëri njeriu, Logos-A, Shkup, 2004 (me numrin e serisë 19).
14. Sami Frashëri, Mitologjia, Logos-A, Shkup, 2004 (me numrin e serisë 20).

Studime dhe artikuj të seleksionuar:

- Rreth disa orientalizme në Fjalorin e Gjuhës së sotme shqipe, Gjuha shqipe, nr. 1. Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1990.
- Adaptimet fonetike të arabizmave në gjuhën shqipe, Dituria Islame (në tri vazhdimë), nr. 19/nëntor 1990; nr. 20/dhjetor, 1990; nr. 21/janar, 1991, Prishtinë.
- Disa fjalë rreth Kamus al-a'lamit: Abdul Beu (Frashëri), Dituria Islame, nr.22-23/shkurt-mars 1991, Prishtinë (seria e personaliteve shqiptare në Kamus al-a'lam të Sami Frashërit do të vazhdojë deri në nr. 42 të kësaj reviste, në rubrikën: Nga trashëgimia jonë kulturore).
- Përdorimi i terminologjisë islame në gjuhën shqipe, Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët (përmbledhje punimesh të Simpoziumit Ndërkombëtar), Prishtinë, 1995, f. 317-322.
- Disa pika dalluese midis gjuhës shqipe dhe gjuhës turke, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2002.
- Sami Frashëri në fushën e Islamistikës (në vend të parathënies te vepra: Qytetërimi islam (shih këtë vepër).
- Abetarja shqipe e Hafiz Ali Ulqinakut - dorëshkrim, Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (XXIII/1), Prishtinë 2004.
- Interesimi i Sami Frashërit për shkencat natyrore, Filologji, nr 12, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2004.
- Kamus al-a'lami i Sami Frashërit, vepër me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 23/1, Prishtinë, 2004 f. 51-62; edhe në Jeta e Re, Prishtinë, 2005.
- Ndryshimet semantike të disa huazimeve orientale në gjuhën shqipe, Filologji, nr. 13, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2005, f. 1123-127.

- Kontributi i Hasan Kaleshit në gjuhësinë shqiptare, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr.24/1, Prishtinë, 2005, f. 403-410.
- Leksiku islam, pjesë përbërëse e leksikut të shqipes, Terminologjia islame, Prishtinë, 2006; edhe në “Edukatën Islame”, Prishtinë, 2005.
- Sami Frashëri – njeriu që shkeli në shumë fusha të dijes, Filologji, nr. 14, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2006, f. 65-85.
- Klasifikimi i huazimeve orientale në gjuhën shqipe sipas fushave të përdorimit, Filologji, nr. 15, Prishtinë, 2007, f. 45-62.
- Sami Frashëri, njohës i Kur'anit, Hëna e Re, nr. 192, shkurt 2007, Shkup.
- Togfjalëshi emëror dhe mbiemëror i shqipes krahasuar me togfjalëshin emëror dhe mbiemëror të turqishtes, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 26/1, Prishtinë, 2007.
- Kontributi i Hafiz Ali Ulqinakut për arsimin shqip në: Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar (Konferencë Shkencore, 28-29 shtator 2012), Tiranë, 2013, f. 134-140.
- Sami Frashëri, linguist i shquar, “Hikmet” (revistë shkencore), nr. 2, qershor 2013, f. 21-53.
- Interesimi i evropianëve për Botën Orientale-Islame sipas Sami Frashërit, punim i lexuar në konferencën shkencore: Problemet socio-kulturore dhe sfidat e bashkëkohësisë, Tetovë, 18-19 tetor 2013.

Përkthime letrare nga turqishtja:

- Të jap mend, “Rilindja”, 26.04.1984.
- Mbreti i plehut, “Bota e Re”, Prishtinë, 15 qershor 1985 dhe në “ Zëri i Rinisë”, 15 mars 1986, Prishtinë.
- Kolltuku, “Jeta e Re, 1/1986, Prishtinë.
- Çizmjja e një pashai pensionist, Rilindja, 30.06.1988.
- Unë nuk përzihem, “Rilindja”, 17.05.1990.

-Kujtimet e një bukurosheje (përkthim nga osmanishtja së bashku me shënime për autorin, aotor i të cilës është shqiptar: Hajredin Leskoviku, i cili ka jetuar në shek. 19 dhe ka shkruar disa vepra letrare), “Rilindja”, 5.12.1997.

Përkthimet nga arabishtja

-Yjet i duan fëmijët, “Flaka e Vëllazërimit”, 14.12.1977, Shkup.

-Pse heshti lumi? “Gëzimi”, nr. 3 .1978.

-I zhgënjyeri, botuar në përmbledhjen “ Proza arabe, Prishtinë, 1983.

-Përkthime nga boshnjakishtja

-Shkaqet e shpalljes së Kur’anit, “Dituria Islame”, nr. 29/1991.

-Agjërimi, “Dituria Islame”, prill/1991

-Zekatu-l-Fitri, “Dituria Islame” , nr. 30/prill 1992

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina	
A DUHET FAJËSUAR ISLAMIN PËR SULMIN	
NDAJ CHARLIE HEBDO, NË PARIS?	5
Mr. Ejup Haziri	
KARTA E MEDINËS DHE MAGNA CARTA LIBERTATUM	
(trajtesë krahasimtare).....	15
Myfti Abdurrahman ibn Jusuf	
VENDOSJA E DUARVE NË NAMAZ	45
Mr.sc. Artan Mehmeti	
TË KËRKUARIT E DITURISË SIPAS ISLAMIT	57
Kurra hfz. doc. dr. Xhevad Shoshiq	
KIRAETET E KUR'ANIT (Historiku i kiraeteve)	75
Shpend Avdiu	
KRIMET E ALENCËS BALLKANIKE	
SIPAS SHTYPIT SHQIPTAR TË KOHËS (1912-1913).....	87
Mr. sc. Rezehana Hysa	
ÇAMËRIA SHQIPTARE	101
Ramadan Shkodra	
Sadik Mehmeti	
Hafëz BAJRAM AGANI (1899-1962)	
- hoxhë, pedagog, udhëheqës dhe vizionar i shquar -	117
Hajrullah Hoxha	
KONTRIBUTI I HFZ. BAJRAM EF. AGANIT	
NË FUSHËN E ARSIMIT DHE SHTYPIT FETAR.....	127
Osmon Softiq	
SELEFIZMI	141
Zachary Karabell	
ZOTI I DY TOKAVE	163

Mexhid Yvejsi	
60-VJETORI I TEQESË BEKTASHIANE SHQIPTARE	
NË AMERIKË (1954-2014)	191
Mr. Rexhep Suma	
GLOBALIZMI I IDENTITETIT	209
Vehbi Shatri	
MULLA MEHMET EF. MAHMUTI (1893-1964)	235
Abdolkarim Soroush	
REFORMIMI I SHKENCAVE FETARE	243
Mr. Skënder R. Hoxha	
MEHMED AKIF ERSOJ	
Të dhëna për jetën dhe aktivitetin letrar	263
BIBLIOGRAFIA PERSONALE E MYFTIUT TË KOSOVËS,	
NAIM EF. TËRNAVA (Skicë për monografi)	269
Naim ef. Tërnavë	
NË PRISHTINË, U PROMOVUA RIBOTIMI	
I VËLLIMIT TË PARË TË REVISTËS “ZANI I NALTË”	291
Naim ef. Tërnavë	
"ZANI I NALTË" - THEMEL I FORTË	
PËR VETËDIJEN FETARE E KOMBËTARE	291
Resul Rexhepi	
REVISTA "ZANI I NALTË" ËSHTË NJË NDËRMARRJE	
E PROJEKTUAR NGA NJERËZ TË MËDHENJ,	
NGA ATDHETARË E ULEMA VIZIONARË E LARGPAMËS	295
Genti Kruja	
“ZANI I NALTË” - NJË ZË KUMBUES	
I TË VËRTETËS SË PANDRYSHUESHME	301
Nuridin Ahmeti	
SHKUPI - NË OPTIKËN E NJË PUBLICISTI.....	305
Qemajl Morina	
KONTRIBUTI I PROF. MEHDI POLISIT NË SHTYPIN ISLAM	
TË KOSOVËS (27.11.1953-21.05.2014)	309
Përmbajtja	319